



# Dialogu obligim hyjnor

Qani Nesimi





© LOGOS - A  
2 0 0 5



S H K U P  
PRISHTINË  
TIRANË



السلامة

▲ mr. Qani Nesimi

▲ Dialogu  
▲ obligim hyjnor





السلامة

mr. Qani Nesimi

Dialogu  
obligim hyjnor







## Përmbajtja:

Parathënie .....	9
PJESA I .....	11
Dialogu - nevojë e përhershme .....	13
Etika islame - e pandryshueshme dhe autentike .....	25
Si mund të bëhet njeriu i ahlakshëm – i moralshëm sipas konceptit islam? .....	35
Njeriu dhe mijëvjeçari i ri .....	39
Islami dhe toleranca .....	46
Liria e njeriut dhe besimi në Allahun xh.sh.....	58
Qëndrimi tolerant në suren “El-Rum” .....	65
Hixhreti i Pejgamberit a.s. - faqe e re e historisë .....	70
1. Orvatja për përsosje shpirtërore dhe për përgatitje profesionale .....	71
2. Bashkimi/Vëllazërimi i njerëzve (myslimanë dhe jomyslimanë).....	73
Globalizmi - në dobi apo në dëm të njeriut.....	76
Agjërimi në islam dhe në fetë e tjera.....	86
Themelimi i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare (KOASH) dhe Kisha Ortodokse Greke .....	94
2. Aktivitetet për pavarësimin e KOSH-it.....	99
A. Shpallja e autoqefalitetit të KOSH në Amerikë dhe gjendja e saj në shtetet e tjera .....	101
B. Aksioni për pavarësimin e KOSH - it në Shqipëri .....	105
Krishterimi 2000, pse? .....	108
Kisha Ortodokse Maqedonase (KOM), Bibla dhe paqja .....	116
Uniteti i Kishës është uniteti i lirë i njeriut .....	117
KOM-i bën mobilizimin e klerit fetar ortodoks .....	119
KOM-i duhet të japë provimin para Jezu Krishtit dhe Biblës .....	123
Vendi (Maqedonia) u takon atyre që mendojnë edhe për të tjerët .....	125
PJESA II .....	131

Një vështrim historik dhe etimologjik i termit nasara në Kur'an .....	133
1. Spekulime të ndryshme lidhur me termin nasara .....	133
2. Lëvizjet dhe rrymat historike lidhur me termin nasara .....	136
a. Herezia dhe heterodoksia hebraike .....	136
b. Shkolla heterodokse e nasurajve .....	139
c. Nadhirinjtë dhe nasurajtë .....	141
d. Hz. Isai dhe rryma e nasuraizmit .....	146
d. Përfundim .....	156
Ungjilli i Bernabës .....	158
Disa njohuri themelore rreth Ungjillit të Bernabës .....	160
Pse të krishterët nuk e pranojnë Ungjillin e Bernabës ? .....	163
Lajmet dhe shenjat e qarta në Ungjillin e Bernabës .....	167
Suprimimi i tri ndryshimeve .....	171
Isai në Kur'an .....	175
Hebraizmi dhe krishterimi sipas islamit .....	188
Tri dimensionet e temës .....	188
a. Njeriu ose dimension i universal .....	189
b. Dimension i traditës semite .....	192
c. Dimension i hebrenjve dhe i të krishterëve .....	194
Feja në Izrael .....	198



## Parathënie

Fakti që ne jetojmë në Gadishullin Ballkanik, gjegjësisht në Evropën Juglindore, në një vend përplot labirinte politike, kurse fetarisht në një vend sinkretik, ku nevoja për dialog, tolerancë, bashkëjetesë, mirëkuptim është shumë e madhe, më dha shkas që t'i hedh në letër disa mendime të mia modeste për këtë fushë.

Në Gadishullin Ballkanik, jetojnë njerëz të nacionaliteteve të ndryshme, prej më modestëve, të cilët asnjëherë nuk kanë pasur ndër mend të zhdukin, të vrasin apo të mposhtin të tjerët, siç janë shqiptarët, boshnjakët, turqit, gjegjësisht myslimanët, por edhe nga ata që po të kenë mundësi, (gjë kjo e cila u pa në Kroaci, Bosnjë, Kosovë, Maqedoni etj.), janë të gatshëm të luajnë çdo rol që mund të jetë kundër vlerave njerëzore, siç janë sllavët, gjegjësisht kisha ortodokse. Në gadishull jetojnë edhe njerëz të feve të ndryshme, si myslimanë, ortodoksë, katolikë. Një herë e një kohë (1054) në këtë vend njerëzit janë vrarë pse nuk kanë qenë me Lindjen apo me Perëndimin, që sidomos pse nuk kanë qenë me ortodoksët apo me katolikët.

Që të shërohen nga sëmundja e dominimit, diskriminimit, intolerancës ballkanasit duhet të pinë ujë nga oqeani i dialogut dhe i tolerancës. Unë shpresoj që kjo përmbledhje e shkrimeve të mia modeste të jetë, të paktën një pikëz e këtij oqeani.



Përmbledhja “*Dialogu obligim hyjnor*” përbëhet prej dy pjesësh. Në të parën botohen shkrime origjinale, kurse në të dytën përkthime nga anglishtja dhe turqishtja. Shumica e temave të përfshira në këtë përmbledhje, tani me ndonjë ndërhyrje të vogël, janë botuar më herët, disa në revistën VEPRRA, disa në revistën DITURIA ISLAME dhe të tjerat në gazetën FAKTI.

Lexuesit dua t’i them se do ta mirëpres çdo kritikë të tij.  
Suksesi vjen vetëm prej Allahut Fuqiplotë!

*Korrik 2003,  
Tetovë*

# PJESA I

## Dialogu - nevojë e përhershme

Historia, sipas një sentence, është histori e fjalës, që do të thotë se është fjala ajo që tregon historinë, që transmeton ngjarjet historike. Përveç në të kuptuarit e njerëzve mes tyre – fëmija me prindin, vëllai me vëllanë, vëllai me motrën, udhëheqësi me të udhëhequrin, skllavopronari me skllavin, Zoti me krijesën e Tij - fjala ka luajtur një rol të rëndësishëm (ende e luan dhe do ta luaj në të ardhmen) edhe në të dialoguarit për çështje të ndryshme mes njerëzve. Gjithashtu sipas një thënie filozofike, historia nuk është gjë tjetër veçse një dialog dramatik ndërmjet Zotit dhe punës së Tij - botës, historisë, ose e njërës dhe tjetrës që, në të shumtën e herës janë të prezantuara përmes avokatit, përfaqësuesit apo bashkëpunëtorit të tyre kryesor - njeriut.<sup>1</sup>

Përveç kësaj dialogu ka edhe dimensione të tjera, siç është dialogimi me vetveten dhe me universin. Kjo kuptohet nga shprehja filozofike se filozofia është bisedë e shpirtit me vetveten, ose “çdo bisedë filozofike është bisedë me vetveten”.<sup>2</sup> Meqë kjo është një bisedë e qëllimshme dhe me një detyrë të caktuar, atëherë çdo gjë që diskutohet duhet gradualisht të dalë haptazi (si material, si kontekst dhe si pozicion), kështu që “bota e jashtme” pak nga pak të internalizohet apo të shndërrohet në “botë të

---

<sup>1</sup> Ferid Muhiq, *Jazikot na filozofijata*, Shkup: Kultura 1995, f. 100.

<sup>2</sup> Po aty, f.144.

brendshme”. Kjo arrihet atëherë kur bota e jashtme dhe ajo që është në dialogim me të, të fillojë të flas. Në këtë drejtim, aftësia imanente për dialogimin e universit nuk bën asnjë përjashtim, as që pranon ndonjë kategori tabu. Ndërkaq me tabu më tepër kuptohet “diçka që ende nuk është në radhë (të diskutohet)”, sesa diçka që “asnjëherë dhe në asnjë rrethanë nuk do të vijë në radhë”.<sup>3</sup>

Në anën tjetër, përveç këtij aspekti të përgjithshëm të kuptimit të dialogut, kohëve të fundit sikur, kur këtë fjalë e ndëgjojmë apo e lexojmë në ndonjë shkrim, sikur kuptojmë një dialog ndërcivilizimesh apo një dialog ndërfaqetar. Por, para se të kalojmë në analizimin e çështjes në aspektin islam dhe të krishterë, të shohim se çfarë kuptojmë me fjalën dialog.

Fjala dialog do të thotë bisedë reciproke (e dyanshme) e dy apo më tepër individëve. Ndërsa në aspektin më të gjerë, fjala dialog do të thotë bisedë dhe kompromis që arrihet ndërmjet njerëzve që u takojnë kulturave dhe kombeve të ndryshme, në bazë të parimeve të qytetërimit. Dialogu në fushën e fesë nënkupton që ithtarët e grupeve (fraksioneve) të ndryshme të një feje, apo ithtarët e feve të ndryshme, të jenë ndërmjet tyre tolerantë, të butë, të afërt, të mos e detyrojnë njëri tjetrin të pranojë besimin apo mendimin e tyre me forcë, por, të diskutojnë dhe të bashkëpunojnë në zgjidhjen e problemeve të përbashkëta.<sup>4</sup> Apo siç e ka thënë një dijetar i njohur mysliman në një fjalim<sup>5</sup>, dialogu nënkupton respekt të ndërsjellë (*Dialogue needs mutual respects*).

---

<sup>3</sup> Po aty, f.143.

<sup>4</sup> Abdurrahman Küçük, ‘Musliman - Hristiyan Diyaloguna Genel Bir Bakış’, *Asrı-mızda Hristiyan - Müsliman Münasebetleri*, Tartışmalı İlmi Toplantılar Dizisi, Stamboll: Ensar 1993, f. 45; Shih për më gjerësisht, Hans Kung, *Christianity and World Religions*, New York: Orbis Books, (pa datë), f. 2-8.

<sup>5</sup> Fjalim i mbajtur nga S. H. Nasr në simpoziumin me titull *Dialogue among Civilizations - Dialogu mes Civilizimeve*, të organizuar nga SH.B. Logos - A, Shkup 2000.



Për ta trajtuar çështjen e dialogut në aspektin islam, le të shohim një herë se ç'na thotë Kur'ani në lidhje me të:

*“Thuaj (o i dërguari): O ithtarë të librit (Tevrat e Inxhil), ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: Të mos adhurojmë, pos Allahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos konsiderojmë njëri - tjetrin zotër pos Allahut! E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: Dëshmoni pra, se ne jemi myslimanë (besuam një Zot)!”.* (Ali Imran, 3/64)

Në komentimin e këtij ajeti kur'anor komentuesi i njohur i Kur'anit, Elmalılı M. Hamdi Yazır, thotë se, çdo mosmarrëveshje a kundërshtim zhduket vetëm me anë të marrëveshjes (mithak) dhe ndërgjegjes së vërtetë në respektimin e vetëm një Zoti, e që është Allahu xh.sh.. Kështu që në atë rast nuk mund të mbizotërojë mendimi i asnjërit, përveç fjalës së Allahut. Përveç Allahut të mos pranojmë Zot tjetër siç bëjnë të Krishterët, të cilët Isain e pranojnë si Zot. Por, Isain ta pranojmë vetëm si rob dhe i dërguar i Allahut. Gjithashtu edhe papët, mbretërit apo udhëheqësit e tjerë t'i pranojmë si të tillë. Çdo njërin prej tyre ta pranojmë në bazë të adhurimit të tij ndaj Allahut. Kur Ehli Kitabët (Ithtarët e Librave) e kanë pyetur Pejgamberin a.s., ai iu është përgjigjur: “A nuk u besoni fjalëve të Papës dhe fjalëve të të tjerëve vetëm se ato fjalë janë të tyre? Ai pranim pra s'është gjë tjetër veçse pranimi i tyre si Zot”.<sup>6</sup>

Gjithashtu në një ajet tjetër të Kur'ani Kerimit thuhet:

*“Ithtarët e librit mos i polemizoni ndryshe (kur i thirrni në fenë tuaj) vetëm ashtu si është më së miri, përveç atyre që janë mizorë u thoni: Ne i besuam asaj që na u zbrit*

---

<sup>6</sup> Elmalılı M. Hamdi Yazır, *Hak Dini Kur'an Dili*, v.2, Stamboll: Çelik-Şura, (pa datë), f. 348



*neve dhe që u zbriti juve dhe se Zoti ynë dhe Zoti juaj është një, dhe se ne i jemi dorëzuar Atij". (Ankebutë, 29/46)*

Në një ajet tjetër Allahu xh.sh., përveç mirëkuptimit, kërkon që, edhe nëse të tjerët e kanë tepruar ndaj nesh, të mos e teprojmë edhe ne ndaj tyre, me një fjalë, si në shumë ajete të tjera edhe në këtë ajet Allahu xh.sh. kërkon që të parapëlqejmë rrugën e tolerancës për dialog të ndërsjellë:

*"O ju që besuat! Mos i shkelni simbolet e Allahut, as muajin e shenjtë (mos lejoni luftën), as kurbanin (mos e pengoni), as atë me qafore (të caktuar për kurban), as (mos pengoni) ata që duke kërkuar begati nga Zoti i tyre dhe kënaqësinë e Tij, i janë drejtuar (për vizitë) shtëpisë së shenjtë (Qabes). E kur të hiqni ihramin, atëherë gjahtoni. Urrejtja kundër një populli, që ju pati penguar nga xhamia e shenjtë, të mos ju shtyjë të jeni të padrejtë kundër tij. Ndihmohuni ndërmjet jush me të mira dhe në të mbara, e mosni në mëkate e në armiqësi. Kini dro dënimit të Allahut, se me të vërtetë Allahu është ndëshkues i fortë". (Maide, 5/2)*

Njëri prej momenteve me rëndësi për të të kuptuar preferimin e dialogut nga Allahu xh.sh. është edhe dërgimi i peygamberëve nga ana e Tij. Peygamberët Allahu xh.sh. i ka dërguar që t'i transmetojnë apo mësojnë të vërtetën njerëzimit. Po, bile edhe kur peygamberi i Tij është refuzuar, torturuar, është vënë në tallje, gurëzuar, vrarë apo masakruar, Ai ka dërguar peygamber tjetër, ose peygamberin e torturuar nga kundërshtarët e Tij e urdhëron që të shkojë të takohet përsëri me ata kundërshtarë. Është shumë me rëndësi të përmendet rasti i Musait a.s. me Faraonin, të cilin Kur'ani e përmend si shembull për ata që e lexojnë dhe dëshirojnë të marrin mësim prej tij. Musai a.s., nga torturat e Faraonit, detyrohet të largohet nga ai vend. Por procesi nuk përfundon me kaq. Pas një kohe Musain a.s. Allahu xh.sh. e urdhëron të shkojë përsëri te Faraoni dhe t'i bëjë thirrje të kalojë në fenë e Allahut xh.sh.. Është me rëndësi se Musai nuk urdhërohet

që të hakmerret ndaj Faraonit me po atë sjelljen e tij. Por nga Musai kërkohet që t'i drejtohet atij me një sjellje tolerante, me fjalë të buta dhe të ëmbla, e ndoshta ai do të pendohet për gabimin që është duke bërë:

*“Shkoni që të dy te Faraoni, se ai vërtet e ka tepruar. Atij i thoni fjalë të buta, ndoshta ai mendohet a frikësohet.”* (Ta ha, 20/43 - 44)

Gjithashtu rëndësinë që i jep Kur'ani preferencës së dialogut, mirësjelljes dhe marrëveshjes, e paraqesin edhe ajetet që bëjnë fjalë për misionin e Muhamedit a.s. si peygamber i Allahut xh.sh.:

*“Ti këshillo - ti je vetëm këshillues. Ti nuk je ndaj tyre detyruar.”* (Gashije, 88/21 - 22)

Në komentimin e këtij ajeti tregohet se Pejgamberi a.s., edhe pse torturohej dhe mundohej pa masë nga mushrikët (politeistët e Mekës), ishte i zemëruar dhe i pikëlluar për mosbesimin e tyre. Por Allahu xh.sh. e ngushëllonte dhe i jepte përkrahje në çdo moment. Në komentimin e këtij ajeti thuhet, ndër të tjera, që Allahu xh.sh. i bën të ditur Pejgamberit a.s. se ai është këshillues dhe se detyra e tij nuk është veçse këshillimi, dhe ai nuk është i obliguar assesi t'i detyrojë me forcë që të besojnë. Atij i thuhet, ti vazhdo të kryesh misionin tënd si këshillues, ndërsa ata që nuk besojnë do ta marrin dënimin e tyre nga Allahu xh.sh.<sup>7</sup>

Ndër të tjera, janë edhe këto ajete:

*“Ne dimë më së miri çka thonë ata, e ti ndaj tyre nuk je ndonjë dhunues, ti këshilloje me këtë Kur'an atë që i ka frikë kërcënimit Tim.”* (Kaf, 50/45)

*“I dërguari nuk ka tjetër obligim veçse të kumtojë (shpalljen); Allahu di ç'publikoni dhe ç'mbani fshehtë.”* (Maide, 5/99)

---

<sup>7</sup> Süleyman Ateş, *Yüce Kur'an'ın Çağdaş Tefsiri*, v.10, Bajezid - Stamboll: Yeni Ufuklar Neşriyat (pa datë), f.448 - 449.



Por edhe atëherë kur Allahu xh.sh. kërkon nga të gjithë myslimanët që ta propagandojnë fenë e Tij, porosit që ata atë detyrë ta kryejnë në mënyrë më të bukur:

*“Ti (Muhamed) bëj thirrje për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundë-shtarët) me atë mënyrë që është më e mira. Zoti yt është Ai që e di më së miri atë që është larguar nga rruga e Tij dhe Ai di më së miri për të udhëzuarit.” (Nahl, 16/125)*

*“Ti të keqen ktheje me të mirë. Ne e dimë më së miri atë që shpifën ata.” (Mu`minun, 23/96)*

Të gjitha këto ajete tregojnë dëshirën e Allahut xh.sh. që njeriut t'ia bëjë me dije se me dhunë, terror, përdhunim, plaçkitje, mashtrime, spiunime, vrasje etj. nuk mund të arrihet asgjë dhe se vetëm me tolerancë, dialog, mirëkuptim, respektim reciprok mund të arrihet jetë e lumtur, e barabartë, pa vrasje, pa masakrime dhe pa mashtrime.

Në lidhje me dialogun ndërnjerëzor, ndërqytetëruar apo ndërfaqetarak në Kur'anin a.sh. gjinden ajete të shumta, të cilat i drejtohen problematikës në fjalë nga kënde të ndryshme, por ne në këtë rast do të mjaftohemi vetëm me këto që i përmendëm më lart.

Por, edhe nëse i kthehemi burimit të dytë islam, Sunetit të Muhamedit a.s., nuk do të hasim në diçka të kundërt me atë që u përmend në Kur'an. Prandaj, sa për ilustrim, do të përmendim një thënie të Pejgamberit (s.a.v.s), në të cilët thuhet:

*“Atij të cilit i mungon butësia i mungojnë të gjitha të mirat”, ose “Ai që është i ndaluar nga butësia, është i ndaluar nga të gjitha të mirat”. (Transmeton Muslimi)<sup>8</sup>*

Edhe historia islame pas Muhamedit a.s. është e mbushur përplotë me raste apo ngjarje historike të cilat tregojnë për mënyrën tolerante, për rezultatin e dialogut

---

<sup>8</sup> Imam Neveviu, *Rijadus - Salihin*, Hadithi 643.

dhe për butësinë e reflektuar në jetën e përditshme të myslimanëve, qoftë mes muslimanëve, qoftë ndërmjet tyre dhe ithtarëve të feve tjera. Sa për ilustrim këtu do të cekim vetëm një prej rasteve të shumta që përmenden nëpër libra të ndryshëm të historisë apo të fushave të ndryshme islame. Shkrimtari dhe sociologu i njohur i botës aktuale islame, Ali Bulaç, autor i shumë librave, në veprën e tij me titull “**Bir Aydın Sapması**” (Devijimi i një intelektual), transmeton një ngjarje nga Mufaddal Ibn Omeri, i cili këtë e tregon në librin e tij “Tevhid - i Mufaddal”: Një ditë si e fala namazin në Mesxhidi Nebvij, thotë Mufaddali, u ula dhe fillova të mendoj. Aty afër meje erdhi dhe u ul një heretik. Më pas erdhi edhe një heretik tjetër dhe që të dy filluan të bisedonin rreth fesë. Biseda e tyre, thotë Mufaddali, ishte kryekëput mohimi i ekzistencës së Allahut xh.sh., Pejgamberin a.s. ata nuk e pranonin si resul, por si njeri të rëndomtë, pejgamberin e quanin magjistar, ata nuk pranonin as Allahun, as Shpalljen e as Kijametin. I shqetësuar dhe i demoralizaur shumë nga kjo që dëgjoji, Muffadali shkoi me të shpejtë te imami i tij. Mirëpo, imami as u ngut t’i burgoste ata e as i fyu, por iu drejtua Mufaddalit duke i thënë: Unë ty do të armatos me armën e diturisë, që ti, kur të takohesh edhe një herë me ta të jesh në gjendje t’ua mbyllësh gojën.<sup>9</sup>

Nëse i hedhim një sy historisë më të hershme të të krishterëve, do të ballafaqohemi menjëherë me luftërat e kryqëzatave, spastrimin etnik në Spanjë në fund të shek. e XV etj., veprime këto që tregojnë të kundërtën e dialogut. Ndarja definitive e Kishës në atë Lindore dhe Perëndimore<sup>10</sup> më 1054 dhe dalja në shesh e Martin Luthe-

<sup>9</sup> Ali Bulaç, *Bir Aydın Sapması*, Stamboll:IZ 1995, f.32.

<sup>10</sup> Şinasi Gündüz, *Din ve İnanç Sözlüğü*, Ankara: Vadi 1998, f.334.



rit dhe e protestantizmit,<sup>11</sup> tregojnë edhe një herë se në vokabularin e tyre nuk ka ekzistuar fare fjala dialog, në aspektin kuptimor.

Në fillimin e shek. XX. fillon të paraqitet lëvizja ekumenike. Fjala ekumen (*oikoumene*) ka kuptimin botë e banuar, botë e tërë. Me shprehjen Lëvizja ekumenike kuptojmë aktivitetet e bëra për bashkimin e të krishterëve të ndarë në shumë grupe. Një rast me rëndësi në historinë e krishterimit, që tregon për një lëvizje të tillë, është momenti kur ortodoksët bashkë me protestantët vendosin të formojnë “Këshillin ekumenik të kishave” në vitin 1948. Në anën tjetër, katolikët, në Koncilin II të Vatikanit, të filluar më 1962, kanë diskutuar dhe në fund kanë marrë vendim për dialog me pjesëtarët e fraksioneve të tjera krishtere. Ndërsa ajo që e bën më interesant këtë koncil katolik është vendimi i tij për dialog me myslimanët, gjë e cila nuk ka ekzistuar më parë në analet e të krishterëve.<sup>12</sup> Përmendja e këtij koncili katolik është me rëndësi për arsye se Kisha Katolike deri në vitin 1959 ka qenë rreptësisht kundër Lëvizjes ekumenike. Koncepti për bashkimin e Kishës Katolike, me dallim nga ortodoksët dhe protestantët, ka qenë rikthim ndaj Kishës Katolike Romake, e cila është apostolike, e shenjtë dhe e vetme. Përpyekjet e Kishës Protestante për themelimin e Lëvizjes ekumenike kanë qenë më të hershme. Kështu, që më 1910, në Edinburg organizohet një konferencë, ku marrin pjesë shumë përfaqësues nga Azia dhe Afrika. Pas Luftës së Parë Botërore përfaqësuesi i komitetit të formuar në këtë Kongres (1920) shkon te papa në Romë, për të kërkuar që në të të marrë

---

<sup>11</sup> Po aty, f.312

<sup>12</sup> Petar Čebić, *Ekumenizam i vjerska tolerancija u Jugoslaviji*, Beograd: NIRO Mladost 1988, f.45; Ahmet Hikmet Eroğlu, ‘Ökümenik Hareketin Ortaya Çıkışı’, *Dinler Tarihi Araştırmaları I.*, Ankara: Dinler Tarihi Derneği 1998, f.223 - 225.



pjesë edhe përfaqësuesi katolik. Por, këtë papa e refuzon me ashpërsi. Gjithashtu, duke mos mbetur me kaq, më 1928, papa e nxjerr një qarkore me të cilën përjashton çdo bashkim jashtë Kishës Katolike dhe ndalon pjesmarrjen e katolikëve në çfarëdo lloj veprimi në lidhje me ekumenizmin.<sup>13</sup>

Kohëve të fundit bëhen tubime, tribuna, simpoziume të shumta në lidhje me dialogun ndër fetar. Por, vallë këto tubime janë të sukseshme? Apo bëhen sa për sy e faqe? Mos vallë kanë ndonjë qëllim apo prapavijë propagandistike ekstremiste? Kjo lëvizje ekziston dekada me radhë, por rezultat, një herë për një herë, nuk është duke treguar. A thua ku qëndron problemi? Dijetarët janë përqëndruar mbi këtë problematikë dhe si përfundim shfaqin dyshimin që kanë për realizimin e një dialogu të tillë ndër fetar.

Kohët e fundit koncepti modern ka një dyshim se mos vallë dialogu, në aktivitetet e misionit, ekziston si një metodë e re për realizimin e aspiratave të cilat nuk kanë pasur mundësi t'i realizojnë në një formë apo mënyrë tjetër. Ky koncept bazohet në disa arsye:

1 - Arsye e parë dhe më kryesore është vendimi i marrë në Koncilin II, të Vatikanit (1962 - 4). Në këtë Koncil është diskutuar, ndër të tjera, edhe për ata që nuk janë të krishterë, bile njëri prej sesioneve të Koncilit është titulluar "Kisha dhe ata që nuk janë të krishterë". Në historinë e krishterimit, myslimanët janë përmendur për herë të parë në këtë Koncil. Por myslimanët nuk janë përmendur ashtu si e mendojnë ata vetveten, por, si duket, sa për sy e faqe. Myslimanët janë cekur vetëm si realitet, por nuk është përmendur, islami si një prej feve të vërteta, një nga fetë të cilat sot bota katolike i pranon si

---

<sup>13</sup> Eroğlu, *Ökümenik Hareketin Ortaya Çıkışı*, f.232.

të vërteta, Muhamedi si pejgamber i vërtetë, Kur'ani si shpallje e vërtetë e Allahut xh. sh.<sup>14</sup>

2 - Një arsye tjetër që i vë në dyshim aktivitetet e dialogut të Kishës Katolike është aktivizimi në të i individëve të cilët dikur kanë qenë pjesëtarë apo drejtues të organizatave misionare. Për shembull, kryetar i Sekretariatit për fetë jashtë krishterimit është zgjedhur kardinali Pignedoli, i cili më parë ka qenë sekretar i Organizatës për krishterimin e popujve. Ndërsa, kryetar i sektorit për islamin dhe i Sekretariatit është zgjedhur Fr. Couq, i cili ka qenë anëtarë i shoqërisë misionare afrikane.<sup>15</sup> Këtu mund të përmendim edhe aktivitetet që sot bëhen për krishterimin e popullatës, aktivitet ky që bëhet në emër të dialogut. Sa për ilustrim mund të përmendim rastin e Indonezisë, ku brenda një viti numri i të krishterëve rritet prej 1,19 % në 12%,<sup>16</sup> apo rasti misionar i katolikëve apo i ortodoksëve në Shqipëri, për të cilin Koço Danaj, duke folur për ndryshimin e emrave dhe të fesë së shqiptarëve, thotë se, “të përdorësh kërcënimin e urisë si mjet për të ndryshuar fenë apo emrin është përsëri më tepër se shovinizëm, është inkvizicionizëm”.<sup>17</sup>

3 - Arsyeja e tretë është se dialogu pranohet si një formë e re e misionit. Taylor, në një shkrim të tij në revistën *Islamo - Christiana*, këtë çështje e thekson shumë qartë: “...aktivitetet misionare në mesin e myslimanëve tregojnë rëndësinë e dialogut. Këtu “dialogu” nuk është një alternativë e misionit, por, në bazë të kushteve, është vetë mision.”<sup>18</sup>

---

<sup>14</sup> Ekrem Sarıkcıoğlu, *Başlangıçtan Günümüze Dinler Tarihi*, İsparta 2000, f.392.

<sup>15</sup> Günay Tümer dhe Abdurrahman Küçük, *Dinler Tarihi*, Ankara: Ocak 1993, f.413.

<sup>16</sup> Po aty, f.413.

<sup>17</sup> Koço Danaj, *Totalitarizmi në marrëdhëniet ndërkombëtare*, (pa vend botimi), sh.b. Java 1996, f.122.

<sup>18</sup> Tümer dhe Küçük, f.413.



Tani mund të përfundojmë se dialogu ndërfaqetar nuk duron qëllime politike apo interne, por kërkon që të dominojë atmosfera e sinqeritetit dhe e seriozitetit. Gjithashtu nuk pranon që të ketë prapavijë propagandistike apo misionare dhe, nëse eventualisht ekzistojnë gjëra të tilla, kërkon që ato të eliminohen. Dialogu mundëson që çdo fe të paraqitet ashtu siç është dhe ndalon që fetë, për t'iu përshtatur njëra tjetrës, të komentohen jashtë mundësive dhe rregullave të saj komentuese. Pra çdo gjë të paraqitet ashtu si është dhe nga të tjerët të pranohet ashtu si është. Si përfundim mund të themi se kjo është metodë e Kur'ani Kerimit: *“Ju keni fenë tuaj, kurse unë kam fenë time” (Kafirun 109/6).*

Gjithashtu, në tubimet e dialogut çdo fe duhet të paraqitet me besimin, ibadetin, urdhëresat dhe ndalimet dhe me parimet e saj kryesore etike. Duhet të caktohen pikat e përbashkëta dhe dallimet që çdo kush të pajtohet me to. Në asnjë mënyrë nuk duhet të poshtërohet ndonjëra prej tyre, as të kërkohet plotësimi i ndërsjellë. Por, nëse vetë pjesëtarët e një feje e shohin të arsyeshme që të përsosin fenë e tyre, nëse e kanë të mangët, atëherë mund ta bëjnë këtë. Ndërsa kërkesa që fetë të plotësohen me njëra tjetrën, siç përmend W.M. Watt në librin e tij **“Modern Dünja'da İslam Vahyi”** (Shpallja islame në botën moderne),<sup>19</sup> nuk është asgjë tjetër përveç se një iluzion që s'mund të realizohet kurrë. Por mendimi i Watt - it se në një dialog me myslimanët, të krishterët duhet të mos i pranojnë mendimet se Muhamedi a.s. është mashtrues apo diç tjetër,<sup>20</sup> është një mendim i thënë me vend.

Dialogu, po kështu, nuk duhet të kufizohet me fjalët “tolerancë” apo “dashuri”, por të jetë i realizueshëm

---

<sup>19</sup> W.M. Watt, *Modern Dünja'da İslam Vahyi*, Ankara: Hülbe Yayınları 1982, f.170.

<sup>20</sup> Po aty, f.166.

edhe në organizata të ndryshme fetare, në jetën e përditshme të bëhet ndihmesë e dyanshme. Më e rëndësishmja është që pjesëtarët e çdo feje, para se të hynë në dialog me pjesëtarët e fesë tjetër, duhet të hyjnë në dialog me grupet apo fraksionet e ndryshme të fesë së cilës i takojnë. Dialogu duhet të bëhet në kushte të barabarta dhe në punimet e tij duhet të marrin pjesë ekspertë apo profesionalistë të lëmit përkatës.<sup>21</sup>

Si përfundim mund të themi se dialogu është i dobishëm dhe nevojë e përhershme, kur ai përdoret për të arritur sukses në qëllimet e paraqitura në dialog, por, kur në prapavijë qëndron misioni apo propaganda, atëherë, ai jo vetëm që është i porealizueshëm, por, është edhe shumë i dëmshëm për fetë dhe për njerëzimin në pëgjithësi.

---

<sup>21</sup> Tümer dhe Küçük, f.416 - 417.

## Etika islame - e pandrysheshme dhe autentike

Etika apo morali islam është çështje kryesore të cilën e synojnë Kur'ani dhe Suneti i Pejgamberit a.s. Pra, Kur'ani dhe Suneti janë, në të njëjtën kohë, edhe burimet kryesore të etikës islame. Islami dallon nga fetë dhe ideologjitë e tjera në të kuptuarit e etikës. Njëri prej elementeve më të rëndësishme që e bën etikën islame të dallueshme nga të tjerat është mbështetja e saj në burime të vërteta hyjnore apo në *vahj* (shpallje), të cilat nuk kanë pësuar dhe nuk do të pësojnë ndryshime. Kjo do të thotë se etika islame ka një bazament autentik dhe hyjnor, i cili nuk është prezent në të kuptuarit e etikës tek fetë dhe ideologjitë e tjera.

Në histori kanë lindur ideologji, ide, fe, fraksione - medhhebe, bindje të ndryshme, të cilat janë mbështetur në burimet që i kanë pranuar si bazë të mendimit të tyre. Por, të gjitha këto kanë qenë të privuara nga karakteri universal i konceptit të etikës, sepse botëkuptimi i tyre ka qenë i kufizuar brenda sferës nacionale apo shkencore – siç është rasti me etikën realiste dhe imanentiste të Aristotelit<sup>22</sup>, rreptësinë etike dhe kritikën kundër etikës hedoniste të Kantit<sup>23</sup>, o brenda kufijve të një ideologjie, feje, caqet e së cilës kanë qenë të ngushtuara nga të kup-

---

<sup>22</sup> Vuko Paviçević, *Bazat e Etikës*, Prishtinë: Rilindja 1981, f.353.

<sup>23</sup> Po aty, f.420 - 424.



tuarit e kufizuar të njeriut. Si shembull mund të përmendim hebraizmin, krishterimin, sabiizmin etj.

Të tria këto, edhe pse në Kur'an përmenden si fe, nuk e kanë universalitetin e islamit, për arsye se librat e tyre hyjnorë nuk ekzistojnë në origjinal kështu që, duke pësuar ndryshime radikale, janë shkruar më vonë nga dora e njeriut. Pra, është e qartë se një gjë që thuhet apo shkruhet nga njeriu mbetet e kufizuar brenda botës njerëzore, që është relative dhe mbetet gjithashtu e kufizuar brenda kapacitetit dhe aftësive të të kuptuarit të po atij njeriu. Edhe ungjijtë (inxhilët) nuk janë të shkruar në kohën e Hz. Isait e as që janë shpallur si libra, por ata, sipas një supozimi, janë shkruar përafërsisht nga fundi i shek. I të erës sonë (v. 80), e sidomos Ungjilli i Gjonit, Ungjilli i Katërt sipas renditjes, është shkruar në shek. e II të erës sonë. Kjo do të thotë se ata nuk janë as të korigjuar e as të porositur nga Hz. Isai.<sup>24</sup> Ndërkaq ungjijve që sot gjenden në duart e ithtarëve të tyre, legjitimiteti u është dhënë në shek. IV, kur me porosinë e perandorit Konstantin, më vitin 325, në qytetin Nike, mbahet Koncili i Parë në historinë e krishterimit edhe vihen themelet e para të kredosë së krishterë.<sup>25</sup> Në këtë koncil si libra të shenjtë dhe hyjnorë pranohen vetëm katër prej tyre, ndërsa të tjerët shpallen të jashtëligjshëm. Katër ungjijtë e pranuar si të ligjshëm janë Ungjilli i Mateut, Ungjilli i Markut, Ungjilli i Llukës dhe Ungjilli i Gjonit.<sup>26</sup> Por, këtu është me rëndësi të përmendet Ungjilli i Bernabës, i cili, edhe pse është prej ungjijve të parë, ndoshta edhe më origjinali, i shkruar pas Hz. Isait, nuk është pranuar si i ligjshëm nga Kisha. Ky Ungjill përmban shumë të dhëna në lidhje me ardhjen e Pejgamberit të

---

<sup>24</sup> Şinasi Gündüz, *Din ve İnanç Sözlüğü*, Ankara: Vadi 1998, f.190.

<sup>25</sup> Po aty, f. 201.

<sup>26</sup> Rahmetullah İbn Halil er - Rahman el - Hindi, *İdharul'hakk*, Bejrut: Daru el - Kutubil' Alemi (date nuk ka), Liban, f.40.

fundit Muhamedit a.s.<sup>27</sup> Një gjë tjetër që e privon krishterimin nga burimet universale dhe karakteri hyjnor është vetë përmbajtja e librave që merren si fjalë e shenjtë, sepse në fakt, në aspektin kuptimor, ajo nuk paraqet ndonjë universalitet. Për shembull, kur lexojmë Biblën, sidomos ngjarjen e kryqëzimit të Jezu Krishtit, do të hasim në të dhënat: “Rreth orës nëntë, Jezusi tha me zë të lartë: ”Eli Eli lama sabaktani?”. Domethënë: “Perëndia im, Perëndia im, përse më ke braktisur?”.<sup>28</sup> Ose: “Në mëngjes, kur po kthehej në qytet e mori uria. Dhe gjatë rrugës pa një fik dhe iu afrua, por nuk gjeti asgjë përveç gjetheve; dhe i tha:”Mos u lidhtë më kurrë fryt prej teje përjetë!”. Dhe fiku u tha menjëherë”.<sup>29</sup> Të gjitha këta shembuj, dhe shumë të tjerë si këta që gjenden në të, tregojnë se nuk kemi të bëjmë me një libër hyjnor, për arsye se ata tregojnë për dhembjen që e ndien njeriu dhe që nuk ka të bëjë me Zotin. Me një fjalë njeriun e paraqet si Zot dhe, në anën tjetër, kur tregon për Zotin, sikur tregon për njeriun. Pra nga këto thënie nuk kuptohet nëse flitet për Zotin apo për njeriun. Libri hyjnor nuk duhet të ketë paradokse të këtilla. Ndërsa thënia tjetër tregon se si mallkohet një pemë që nuk ka bërë kokrra, veprim ky që nuk i ngjan aspak Zotit. Pra e gjithë kjo tregon për mungesën e universalitetit të librit për të cilin supozohet se është i shenjtë.

Edhe me burimet hyjnore të hebraizmit kemi po të njëjtën gjë. Libri i tyre hyjnorë është Torahu (Teurati), i cili, sipas besimit hebre, është libër i shpallur i Mosiut (hz. Musait). Por, në bazë të studimeve të bëra në lidhje me Torahun, konstatohet se ky tekst është shkruar nga një numër i madh dijetarësh të periudhave të ndryshme të historisë,

---

<sup>27</sup> Ebu'l - A'la El - Mewdudi, *Tarih Boyunca Tevhid Mücadelesi ve Hz. Peygamber'in Hayatı*, v.2, Stamboll: Pınar 1992.

<sup>28</sup> *Mateu*, 27:46

<sup>29</sup> Şaban Kuzgun, *Dört İncil, Farklılıkları ve Çelişkileri*, Ankara 1996, f. 131. *Shih*, *Mateu*, 21:18,19.



dhe se në vete përmban edhe shumë gjëra që kanë të bëjnë me traditat e kohës në të cilën është shkruar. Këtij teksti në traditën hebraike i thuhet edhe “Torah i shkruar”.<sup>30</sup> Ai ekziston që në kohën e Ezdrasit. Në Dhiatën e vjetër thuhet kështu: “Ky Ezdras vinte nga Babilonia. Ishte një shkruar kompetent i ligjit të Moisiut, të dhënë nga Zoti, Perëndia i Izraelit”.<sup>31</sup> Gjithashtu në literaturën hebraike Ezdras quhet edhe “babai i hebraizmit”, “Moisiu i dytë” apo “sistematizuesi dhe themeluesi i vërtetë i hebraizmit”.<sup>32</sup> Burim kryesor i hebraizmit quhet edhe “Torahu i transmetuar gojarisht”. Ky lloj i Torës është përmbledhje e përgatitur në shek. II, të erës sonë nga Rabbi Judah. Dhe kështu, nga kjo përmbledhje, formohet Mishna, komentimi i të cilës quhet Gemara. Më vonë, nga studimet që i janë bërë Torës gojore dhe Gemarës del në shesh koleksioni shumë i rëndësishëm i Torës me emrin Talmud.<sup>33</sup> Gjithë sa thamë dëshmon se këta nuk janë libra origjinalë hyjnorë, por të shkruar dhe të përpiluar më vonë nga dora e njeriut.

Rasti i njëjtë është edhe me sabiitët. Libra themelore të shenjta të sabiitëve quhen Ginza, Drashia dhe Jahja dhe Qolasta.<sup>34</sup> Për Ginza - në thuhet se është një përmbledhje e përgatitur në shek. III, të erës sonë.<sup>35</sup>

Ndërkaq islami është krejtësisht diçka tjetër nga e gjithë ajo që u tha më lart. Pra, islami është fe e bazuar në fjalën e Allahut xh.sh.. Kjo kuptohet edhe nga vetë emri i fesë. Fjala islam rrjedhë prej rrënjës *seleme - teslimu* në arabisht, që do të thotë nënshtrim, përrulje. Ndërsa në aspektin

---

<sup>30</sup> Gündüz, f. 371.

<sup>31</sup> Ezdras, 7:6.

<sup>32</sup> Gündüz, f.124.

<sup>33</sup> Gündüz, f.371.

<sup>34</sup> Şinasi Gündüz, *Sabiiler - Sön Gnostikler*, Ankara, tetor 1995, f.155 - 157.

<sup>35</sup> Gündüz, *Din ve İnanç Sözlüğü*, f.142.

terminologjik fjala islam do të thotë nënshtrim vetëm Allahut xh.sh. dhe të gjitha porosive të Tij.<sup>36</sup>

Kjo që thamë në lidhje me islamin kuptohet nga Kur'ani Kerimi i cili nuk ka pësuar dhe nuk do të pësojë ndryshime në të ardhmen. Këtë edhe vetë Allahu xh.sh. e thekson shumë qartë dhe thuktë në Kur'anin famëlartë.

*“Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij” (Hixhr, 9).*

Si fjalë e Allahut xh.sh. Kur'ani është burimi kryesor i etikës apo moralit - ahlakut islam. Kur'ani nuk paraqet një mendim të njeriut, të kufizuar në kohë dhe në periudhë të caktuar. Ai paraqet fjalën e Zotit, që vazhdon për çdo kohë, për çdo periudhë dhe për çdo popull, pa marrë parasysh përkatësinë nacionale, gjininë, racën, shtetin apo kontinentin ku njeriu gjendet.

Para se të kalojmë në sqarimin e etikës universale islame nga pikëpamja e Kur'anit, të shohim se si ai e paraqet vetveten si universal.

Së pari Kur'ani thotë se kjo është fjalë e Allahut xh.sh.:

*“Ne e zbritëm atë Kur'an arabisht, ashtu që ta kuptoni” (Jusuf, 3)*

*“Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij” (Hixhr, 9).*

Kur'ani thekson po kështu se edhe feja të cilën e predikon është universale, e pa kufizuar në kohë dhe në vend. Por ai tregon se islami është fe e Allahut, që ju është detyruar edhe popujve të mëparshëm, që edhe ata të mund ta jetojnë:

*“Kjo fe është juaja dhe është e vetmja fe (e shpallur), kurse Unë jam Zoti juaj, pra më adhuroni vetëm Mua”. (Enbija, 92)<sup>37</sup>*

---

<sup>36</sup> Po aty, f.196.

<sup>37</sup> Më gjerësisht shih, *Shura*,13; *Ali Imran*, 18; *Huxhurat*,13; *El - Anaf*,158.

Kur'ani është fjalë e Allahut xh.sh., që do të thotë se është një mrekulli mbinatyrore. Jo vetëm se nuk ka ndryshime, por ai nuk mund të barazohet me asgjë tjetër:

*“Thuaj: “Sikur të ishte deti ngjyrë për t’i shkruar fjalët e Zotit tim, deti (uji i tij) do të shterej para se të përfundojnë fjalët e Zotit tim, e edhe sikur të sillnin shtesë edhe një si ai (deti)”. (Kehf,109)*

Kur'ani mrekullinë e tij e paraqet në çdo pikëpamje, qoftë në aspektin kuptimor, stilistik, gjuhësor, qoftë në aspektin këshillues dhe udhëzues. Në lidhje më këtë, prof. dr. Ahmet Smajloviq thotë: Gjuha e Kur'anit është e pakrahasueshme në mundësinë e të shprehurit në bazë të stilit dhe të strukturës. Për këtë arsye është i pamundshëm përkthimi i plotë dhe fjalë për fjalë i Kur'anit në çfarëdo gjuhe tjetër. Çdo përpjekje e deritashme në këtë plan, në të vërtetë nuk paraqet veçse mundimin njerëzor për prezantimin e përkthimit të Kur'anit.<sup>38</sup>

Një realitet tjetër i pamohueshëm është edhe fakti se në histori janë bërë përpjekje të mëdha për të shkruar një Kur'an si ky, ose të paktën të bëhet ndonjë përmirësim apo shtesë e tij. Por, realizimi ka qenë i pamundshëm. Ai ka qenë i pamundshëm ngaqë Kur'ani është me të vërtetë fjalë e Allahut. Përndryshe, ai do të pëson-te fatin e librave të tjerë të shpallur më parë. Njëri prej atyre që janë munduar të shkruajnë Kur'an është Nadr Ibn Harith. Ai është krenuar përpara kurejshitëve se mund të shkruajë një Kur'an si ky:

*“Vez - zari’ati zer’a, vel - habizati hubza, vet - tabihati tubha, vel - lakimati lukma”* (Pasha atë që mbjell farën, atë që pjek bukën, atë që gatuan ushqimin, atë që përgatit llokmën - kafshatën).<sup>39</sup>

---

<sup>38</sup> Enes Karic, *Hermeneutika Kur’ana*, Zagreb: Hrvatsko filozofsko društvo 1990, f. 84.

<sup>39</sup> Süleyman Ateş, *İslam’a İtirazlar ve Kur’an - i Kerim’den Cevaplar*, Ankara,



Pra, siç shihet, kjo është një çmenduri dhe një mund që ka përfunduar pa sukses, sepse ky autor ka mbetur me këto fjalë dhe nuk ka mundur të thotë diçka më tepër; ai veçse është munduar të bëjë një kopjim të stilit kur'anor dhe ka shprehur diçka sipërfaqësisht. Kritikant e tjera që i janë bërë Kur'anit janë të llojeve të ndryshme, por të gjitha pa rezultat. Është e njohur edhe fjala e Goldziherit, që thotë se, feja e peygamberit arab është një përmbledhje e elemteve të mësuara nga hebraizmi dhe krishterimi.<sup>40</sup> Por këtyre gjërave - për ata që kanë logjik dhe mendojnë me një kokë të shëndoshë dhe pavarësisht nga ideologjitë e ndryshme – Kur'ani iu jep një përgjigje të merituar:

*“A nuk e përfillin ata (me vëmendje) Kur'anin? Sikur të ishte prej dikujt tjetër, përveç prej Allahut, do të gjenin në te shumë kundërthënie.” (Nisa, 82)*

Po të ishte e vërtetë fjala e Goldziherit, atëherë Kur'ani nuk do të përmbante diç tjetër përveç asaj që gjendet në Tevrat dhe Inxhil. Por, në fakt Kur'ani përmban gjëra që Tevratit dhe Inxhilit nuk i njohin dhe janë shumë larg tyre, ndaj në disa raste, ia kanë “lakminë”. Sipas mendimit tim, në vend që të thuhet Kur'ani është kopje e Tevratit dhe Inxhilit, më mirë do të ishte të thuhet se Tevratit dhe Inxhilit, apo Bibla e sotme, kanë pësuar dhe vazhdojnë të pësojnë ndryshime rrënjësore me qëllim që ta tregojnë veten si libër i përsosur, siç është Kur'ani famëlartë. Por, nuk ia kanë dalë mbanë.

Nëse, pra, njeriu mendon pak më thellë, do të shohë se po të ishte Kur'ani përmbledhje e elemteve të hebraizmit dhe krishterimit, ai do të pësonte, mu si ata, ndryshime radikale. Ekzistenca e Kur'anit në formën bu-

---

1966, 1971, f.171.

<sup>40</sup> Po aty, f.174.

rimore edhe në kohën tonë është njëri prej argumenteve që flet për origjinalitetin e tij.

Në islam përveç Kur'anit është Suneti, që si punë, vepër, fjalë dhe pëlqim i Muhamedit a.s. merret si burimi i dytë në të cilin bazohet morali - etika islame. Vetë dërgimi i Pejgamberit a.s. nga ana e Allahut xh.sh. si pejgamber për të gjithë popujt tregon se edhe suneti i tij është universal:

*“Thuaj (Muhamed): “O ju njerëz! Unë jam i Dërguari i Allahut te të gjithë ju”. (Araf,158)*

*“Vërtetë, ti je në një shkallë të lartë të moralit!” (Kalem, 4).*

*“Thuaj: “Nëse e doni Allahun, atëherë ejani pas meje që Allahu t’ju dojë, t’ju falë mëkatet tuaja, se Allahu është që falë shumë, mëshiron shumë”. (Ali Imran, 31)*

Ndërsa tani mund t’i kthehemi çështjes - cili është morali - etika universale të cilën e rekomandon Kur’ani dhe Suneti i Muhamedit a.s..

Ahlaku - etika, të cilën e rekomandon Kur’ani, parim kryesor ka besimin në Allahun dhe adhurimin e Tij nga ana e njeriut. Besimi në Allahun, i cili e përbën esencën e etikës islame, ka edhe ai një karakter të përgjithshëm. Pa dallim feje, race, gjinie, kombësie apo ideologjie, të gjithë njerëzve u bën thirrje që të besojnë në Allahun xh.sh., Një, të Vetëm dhe të Pashoq:

*“Vërtet, ata që besuan, ata që ishin jehudi, krishterët, sabejët (kishin lëshuar fenë e adhuronin engjëjt), kush besoi prej tyre (sinqerisht) Allahun, dhe botën tjetër dhe bëri vepra të mira ata e kanë shpërblimin te Zoti i tyre. Për ta nuk ka frikë as nuk kanë përse të pikëllohen (pasiqë besuan Allahun, librat, të dërguarit në mesin e të cilëve edhe Muhammedin). (Bakara,62)*

*“Thuaj (o i dërguar): “Në qoftë se etërit tuaj, djemtë tuaj, vëllezërit tuaj, bashkëshortet tuaja, farefisi juaj, pasuria që e fituat, tregtia që frikoheni se do të dështojë, vend-*



*banimet me të cilat jeni të kënaqur, (të gjitha këto) janë më të dashura për ju se Allahu, se i dërguari i Tij dhe se lufta për në rrugën e Tij, atëherë, pritni deri sa Allahu të vijë me dënimin e Tij, me të vërtetë Allahu nuk vë në rrugën e drejtë njerëzit e prishur". (Teube, 24)*

*"Dhe adhuroje Zotin tënd deri të të vijë ty e vërteta (vdekja)". (Hixh, 99)*

Kur Allahu xh. sh. tregon për qëllimin e krijimit të njeriut, ai gjithashtu thotë se nuk e kam krijuar për tjetër vetëm se të më adhurojë (Dharijat, 56). Në anën tjetër adhurimin - ubudijetin e njeriut e rezulton me devotshmëri - takvallëk. Kështu që qoftë kur tregon për Kur'anin si udhëzues, qoftë kur urdhëron adhurimin e Allahut<sup>41</sup>, thotë se është udhëzues për të devotshmit - muttekitë<sup>42</sup>.

Besimin - imanin e njeriut Allahu xh.sh. e pranon si të vërtetë atëherë kur ai besim reflektohet apo manifestohet në jetën e përditshme të tij, dhe një manifestim të tillë e quan takvallëk - devotshmëri. Pra, nëse do ta paraqitnim pak më ndryshe këtë që e thamë më lart do të shpreheshim kështu:

Besim (iman) --- adhurim (ubudijet) --- devotshmëri (takva) --- moral/etikë e përsosur në aspektin kur'anor.<sup>43</sup>

Ndërsa etika universale në Sunet paraqitet në këtë formë:

Transmetohet nga Ebu Hurejreja r.a. se ka thënë: Është pyetur i Dërguari i Allahut, se çka i shpie më së shumti njerëzit në xhenet, dhe ai është përgjigjur: Devotshmëria ndaj Allahut dhe karakteri i mirë. Pastaj është

---

<sup>41</sup> *Bakara*, 183.

<sup>42</sup> *Bakara*, 2.

<sup>43</sup> Kurse në filozofi fazat nëpër të cilat kalon individi apo shoqëria derisa ai apo ajo të bëhet e moralshme janë: informacioni/njohuria, vetëdija, pranimi, aksioni, vlerësimi, përforcimi dhe në fund ndryshimi. (Ferid Muhliq - Zlatko Zhoglev, *Mislenje vo akcija*, Manastir: Fakulteti Pedagogjik 2002, f. 258 - 259.

pyetur se çka i shpie më së shumti njerëzit në xhehenem, dhe ka thënë: Goja dhe organet seksuale.<sup>44</sup>

Transmetohet nga Aisheja r.a. se ka thënë: E ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut s.a.v.s. duke thënë: Vërtet besimtari me karakter të mirë arrinë shkallën e atij që agjëron dhe që falë namazin vazhdimisht.<sup>45</sup>

Edhe në një hadith tjetër tregohet një rast: “Pejgamberit a.s. Xhebraili i thotë: të kam sjellë mekarim - u ahlakun. Çfarë është ajo, thotë Pejgamberi a.s.? Xhebraili a.s. thotë:

- t’ia falësh atij që të ka bërë padrejtësi,
- t’i japësh atij që nuk të jep,
- t’i shkosh atij që nuk të vjen,
- mos t’ia kthesh fyerjen atij që të fyen,
- ti bësh mirë atij që të bën keq.<sup>46</sup>

Pejgamberi a.s. thotë: Në peshojën e besimtarit/mu’minit ditën e gjykimit gjëja më e rëndë do të jetë ahlaku/etika e mirë. Allahu e dënon atë që nuk ka edukatë në të folurit.<sup>47</sup>

“Njeriu me ahlak të mirë arrin në shkallën e atij që falë namaz dhe agjëron”.<sup>48</sup>

Pejgamberi a.s., po ashtu, ka thënë: “A doni t’ju tregoj për atë që e dua më shumë dhe ditën e kiametit do të jetë më afër meje? Ata i thanë po, o i Dërguari i Allahut. “Ai i cili ka ahlak më të mirë dhe ai i cili bashkëjeton me njerëzit”.

---

<sup>44</sup> Imam Neveviu, *Rijadus - Salihin*, përkth. Miftar Ajdini, Qemal Morina dhe Nexhat Ibrahim, Shkup: Logos A 1996, f. 224.

<sup>45</sup> Neveviu, vep. e cit. f. 225.

<sup>46</sup> Süleyman Ateş, *Büyük İslam İlmihali*, Yeni Ufuklar Neşriyat, Stamboll f. 513.

<sup>47</sup> Po aty, f.514.

<sup>48</sup> Po aty.



## **Si mund të bëhet njeriu i ahlakshëm – i moralshëm sipas konceptit islam?**

Si u pa më lart, islami ka një qëndrim universal dhe etikën - moralin nuk e përkufizon e as që e kushtëzon me ndonjë individ apo tempull të caktuar. Ai nuk i jep të drejtë asnjë populli të jetë mbi një popull tjetër, as një klase mbi një klasë tjetër. Kështu që njeriu është plotësisht i lirë të besojë, ti bëjë punët të cilat do t'i mundësojnë të bëhet i ahlakshëm. Sipas islamit nuk ka ndërmjetësues ndërmjet njeriut dhe Allahut. Në islam nuk ka as Jezu Krisht e as priftërinj. Nuk ka as edhe shtresa të caktuara të shoqërisë të cilat nuk mund të tejkalohen, siç është sistemi kast dhe karma në induizëm. Kjo ngaqë në islam ligjvënës dhe autoritet i vetëm dhe i pavarur është Allahu xh.sh, kurse në krishterim (katolicizëm) papa është autoritet i pagabueshëm i cili mund të ndryshojë, shtojë, përmirësojë apo plotësojë disa parime fetare.

Papa ka fituar cilësinë inocenti, cilësinë e të pagabueshmit, dhe bëhet i pagabueshëm dhe i pakapshëm nga çdo lloj mëkati... Deri në shek. XIV papa ka qenë vetëm prijës (kardinal) i Romës, por prej atëherë pushteti i tij përgjithësohet. Autorizimet e veta ai i merr drejtpërsëdrejti nga Zoti, kurse kardinalët këto autorizime i marrin prej apostujve, veçanërisht prej Pjetrit, pronarit të cilësisë që “lidh dhe zgjidh”. Këto fakte i sigurojnë papës të drejtën dhe fuqinë e vendosjes në tokë, dhe këtë ai e bën në emër të Jezusit/Isait. Papa ka autorizime të përcaktimit të parimeve të fesë dhe besimit, kurse në Koncilin e Parë të Vatikanit, të mbajtur më 1870, karakteristika e tij e të pagabueshmit, është konfirmuar zyrtarisht dhe është marrë vendim i prerë se të komentuarit e tij të fesë “është detyrim për të

gjithë besimtarët”.<sup>49</sup> Kjo do të thotë se i krishteri katolik për të besuar apo për të bërë mirë, e për të mos bërë keq varet krejtësisht prej qëndrimeve të Papës. Me një fjalë ai mund të bëhet i mirë, apo besimtar, vetëm nëse papa i jep “vizë”. Islami një gjë të tillë e quan politeizëm - shirk. Pra, në islam ndërmjetësimi është rreptësisht i ndaluar.

Islami nuk pranon asnjë mënyrë të ndarjes në shtresa siç është rasti me sistemin *cast* në induizëm. Shoqëria, sipas induizmit, ndahet në katër grupe kryesore. Grupin *brabmanë* e përbëjnë liderët fetarë dhe të diturit, grupin *kshatria* - princat dhe luftëtarët, *vaishja* - tregëtarët dhe të pasurit dhe *sudra* - bujqit dhe punëtorët. Sipas këtij sistemi, asnjë grup nuk mund të kalojë në grupin tjetër, por patjetër të pajtohet me fatin e vet. Por ka një parim etik, që quhet sistemi *karma*, sipas të cilit njeriu që këtë botë e shrytëzon për punë të mira, ka mundësi që, pas vdekjes, të trupëzohet në një shkallë - grup më të mirë ose të ndodhë e kundërta.<sup>50</sup>

Sikurse kemi përmendur më lart, etika universale mbështetës të saj e ka vetëm Allahun xh.sh. Kjo kuptohet edhe nga kaptina e shkurtër, por me domethënie të madhe, e cila ngërthen në vete pothuajse gjithë atë çka synon Kur’ani:

*“Pasha kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri - tjetrin t’i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri - tjetrin të jenë të durueshëm.”*<sup>51</sup>

Pra, mund të themi se njeriu është besimtar i vërtetë mu atëherë kur i jepet rasti t’i përdorë të gjitha mundësitë për të vjedhur, e nuk vjedh, kur ka mundësi të gënjejë e nuk gënjen, kur ka mundësi të mashtrojë, të tradhtojë apo të bëjë ndonjë gjë të amoralshe, ndërsa ai nuk mashtron, nuk tradhton e as nuk bën veprime të pamoralshe.

---

<sup>49</sup> Ali Bulaç, *Islami dhe demokracia*, Logos-A, Shkup, 1998, f. 134.

<sup>50</sup> Gündüz, *Din ve İnanç Sözlüğü*, f. 215.

<sup>51</sup> *Asr*, 1 - 3.



Në kohën në të cilën jetojmë jemi dëshmitarë se kultura dhe civilizimi që nuk posedojnë shpirtëroren, hyjnoren apo i kanë ndërprerë lidhjet me spiritualitetin, janë kultura materialiste, pragmatiste apo kultura të interesit. Dhe në vend që të jetë e kundërta, etika e kulturës është vetëm një etikë interesi. Por kultura që tregohet e moralshme vetëm atëherë kur ka dobi ekonomike dhe politike, ajo është në esencë, e privuar nga hyjnorja. Por nëse e shohim atë vetëm shkarazi, siç shohim diçka konkrete, atëherë nuk mund të kuptojmë mungesën e brendshme hyjnore të asaj kulture, për arsye se na mashtron ana e jashtme e saj. Përkundrazi ne duhet ta shohim atë me një sy kritik (spiritual) dhe duke e pasur në mendje ardhmërinë tonë.

Qytetërimi bashkëkohor, ashtu siç është zhvilluar në Perëndim që nga Renesanca, është një eksperiment i dështuar. Qytetërimi bashkëkohor ka dështuar pikërisht për shkak se premisat mbi të cilat është mbështetur ishin false, sepse ai është mbështetur mbi konceptin njerëzor, që përjashton atë që është më qenësore për gjendjen njerëzore. Kriza e thellë shpirtërore po i than gjithnjë e më shumë rrënjët e shpirtit të tij dhe një ditë doli sheshit përmes krizës së ambientit fizik.<sup>52</sup>

Këtu i jepet rëndësi mjedisit, për arsye se, ndotja e ambientit nuk është gjë tjetër pos pas - efekt i ndotjes së shpirtit të njeriut, gjë që lindi në çastin kur njeriu i perëndimit vendosi të luajë rolin e Hyjnisë mbi sipërfaqen e tokës dhe privoi dimensionin trancedental nga jeta e tij.<sup>53</sup>

Këtë Rene Guenon e përshkruan kështu: Në të vërtetë, individualizmi është shkaku vendimtar i dekadencës së tashme të Perëndimit. Ai siguron, si të thuash, forcën tërheqëse për zhvillimin ekskluziv të më të voglave mundësi të njerëzimit, të atyre që nuk kërkojnë ndërhyrjen e asnjë elementi

---

<sup>52</sup> Sejjit H. Nasr, *İslam ve Modern İnsanın Çıkması*, İnsan Yayınları, Stamboll, 1984, f.29 - 30.

<sup>53</sup> Po aty, f. 30.

mbinjerëzor për t'ua mundësuar të zgjerohen. Individualizmi qëndron pikërisht në polin kundruall gjithë spiritualitetit dhe intelektualitetit të vërtetë.<sup>54</sup>

Si përfundim mund të themi se, bota sot nuk vuan për teknikë, modernitet, armë, maqineri të zhvilluar, por për ahlak - moral, për vahj - shpallje, për shpirt, me një fjalë njeriu modern vuan për fe origjinale.

---

<sup>54</sup> Rene Guenon, *Kriza e botës bashkëkohore*, Drita e jetës, Gjilan 1997 f. 96.



## Njeriu dhe mijëvjeçari i ri

Ndër fenomenet që njeriu nuk mund t'i kontrollojë, apo të paktën nuk ka mundësi të ndërhyjë në përshpejtimin apo ngadalësimin e tij, është fenomeni “kohë”. Ne të gjithë jemi dëshmitarë të asaj se çdonjëri nga ne e tregon kohën me tri fjalë, me “dje, sot dhe nesër”. Pra, nëse ne do të shpreheshim pak më lirshëm, do të fitonim të drejtën të thoshim se me fjalën “dje” në historinë e njerëzimit do të kuptonim mijëvjeçarin e parë, me fjalën “sot” – të dytin, ndërsa me fjalën “nesër” do të kuptonim mijëvjeçarin e tretë. Nga kjo kuptojmë se për të ekzistuar koha “sot” dhe “nesër” duhet të ekzistojë koha “dje”. Në aspektin matematikor, nëse fillojmë të numërojmë patjetër duhet të fillojmë prej numrit 1, 2, 3.....10, nuk mund të numërojmë 2, 4, 1, 7, 3, 10 etj. Me këtë dua të them se fillimi i mileniumit të tretë apo shekullit XXI, nuk është një kohë e re që fillon me një Adem të ri dhe Hava të re, por është vazhdim i shekullit XX, që do të thotë se edhe shekulli XXI fillon përplot Habila dhe Kabila.

Pra, të nderuar lexues, nëpër gazeta, revista dhe libra të ndryshëm lexojmë se shekulli XXI po fillon me një lulezim teknologjik, me një përparim shkencor; se ky do të jetë shekulli i kompjutorit, i internetit etj.

Mirëpo, me rëndësi është të dihet se edhe ky shekull, apo edhe ky mijëvjeçar është mijëvjeçari i njeriut, që do të thotë se njeriu është krijesa më e përsosur e krijuar nga Allahu xh.sh., dhe ai duhet të ngrihet në shkallën e

nevojshme dhe në këtë milenium. Është e vërtetë se progresi teknologjik, kompjutorik, progresi industrial në botën moderne është në nivel, por, ç'është me rëndësi, se ky nivel nuk shihet në qetësinë dhe kënaqësinë e njeriut. Përse njeriu, krahas të gjitha këtyre të arriturave, ndihet i pakënaqur? Sepse bota e sotme nuk vuan nga aspekti teknologjik, industrial, por nga vakuumi shpirtëror, nga mungesa e bazamentit të fortë etik. Dhe prandaj njeriu e gjen vetveten në mes të krimeve, vetëvrasjeve, korrupsionit etj. Sipas shkencëtarit amerikan R. Oppenheimer (shpikësi i bombës hidrogjenike amerikane), brenda 40 vjetëve të fundit njeriu bëri një përparim teknik dhe material më të madh se në 40 shekujt e kaluar.”<sup>55</sup>

Por a do të thotë kjo se edhe jeta e njeriut ka ndryshuar po aq, apo është e kundërta? Në vendin më të pasur të botës, në ShBA, veprat e rrezikshme penale në periudhën 1960 - 1970 janë gati 14 herë më të mëdha se shtimi i popullsisë. Në Kongresin VII Ndërkombëtar të Krimnologëve në Beograd (shtator 1973) u konstatua njëzërit se çasti i tanishëm në botë karakterizohet nga “rritja marramendëse e kriminalitetit në të gjitha meridianet”. Në një raport të Sekretarit Gjeneral të OKB thuhet: “...Përkundër progresit material, jeta njerëzore s’ka qenë kurrë më e pasigurt se sot...”<sup>56</sup>

Psikiatri i njohur, profesori Blanchar, thotë se ideologjia sunduese ndrydh gjithnjë e më tepër personalitetin, e orienton njeriun nga puna automatike sipas formulës: gjumi - metroja - puna, që i garanton një farë standardi, por, e privon nga përjetimet dhe emocionet... Shumica e tyre ndjejnë nevojën instinktive të ikin nga vetvetja dhe të përjetojnë diçka tjetër sipërfaqësisht. Kjo nevojë u shpërdor përmes porno filmave.<sup>57</sup>

---

<sup>55</sup> Alija Izetbegović, *Islam između Istoka i Zapada*, Sarajevë, 1990, f.73.

<sup>56</sup> Po aty, f.75.

<sup>57</sup> Po aty, f.76.

Përveç elementeve apo dukurive negative të sipërme, mund të përmendim edhe rritjen marramendëse të numrit të vetëvrasjeve. Kjo dukuri është pjesë përbërëse e civilizimit modern, me të cilin krenohemi se ia fillojmë mileniumit të ri. Ç'është më e keqja, këtë dukuri dhe të ngjashmet me të i hasim te shtetet që quhen më të avancuara, si Suedia, Franca, Anglia, Gjermania, ShBA - të....etj.

Rekordin dëshpërues të numrit të vetëvrasjeve, të të dehurve dhe të të sëmurëve mendorë e mban Suedia, shteti që zë vendin e parë në shkallën botërore të të ardhurave kombëtare, të shkrim - leximit, të punësimit dhe të sigurimit social. Më 1967 u shënuan 1702 raste të vetëvrasjes, 9% më shumë se më 1966 dhe 30% më shumë se më 1960. Organizata Botërore e Shëndetësisë në Gjenevë shpalli më 1968 rang - listën e vendeve sipas numrit të vetëvrasjeve. Atë vit tetë vendet e para i mbanin: Republika Federale e Gjermanisë, Austria, Kanada, Danimarka, Finlanda, Hungaria, Suedia dhe Zvicra. Në këto tetë vende vetëvrasja është shkaku i tretë i vdekjes së njerëzve prej 15 deri 45 vjeç (pas sëmundjeve të zemrës dhe të kancerit). Në raportin e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për vitin 1970 pohohet preras se kjo dukuri shtrihet "krahas me industrializimin, procesin e urbanizimit dhe zvogëlimin e anëtarëve të familjes".<sup>58</sup>

Krahas dobive, nga përparimi teknologjik i shekullit XX, kemi edhe shumë dëme të mëdha. Në vitin 1985 janë harxhuar vetëm për armatim 700 miliardë dollarë. Bomba atomike e hedhur në Hiroshimë është shumë më e vogël në krahasim me bombat e reja atomike. Ajo bombë ka pasur forcë të mbysë për një minutë 70.000 persona, ndërsa sot ka mundësi të mbysë 70 miliardë njerëz. Kjo do të thotë se ajo është në gjendje të shkatërrtojë një popullsi 12 herë më të madhe se kjo që është.

---

<sup>58</sup> Po aty, f.81.



Për herë të parë pas tre milionë vjetësh të epopesë njerëzore, thotë Garaudy, është bërë e mundshme teknikisht që të zhduket çdo gjurmë e jetës në Tokë. Dhe, ç'është më e habitshmja, një gjë e tillë quhet "paqe", "baraspeshë e frikës" në mes dy blloqeve, të Lindjes dhe Perëndimit.<sup>59</sup>

Nga e gjithë kjo që u tha më lart kuptohet se në aspektin e respektimit të njeriut shekulli i kaluar ka qenë nën nivelin e duhur. Në plan të parë kanë qenë droga, alkooli, amoraliteti, vrasja, vetëvrasja, përdhunimi, korrupsioni etj. Këtë dukuri negative e shohim edhe sot, në shekullin/mileniumin e ri. Psh., droga dhe alkooli janë problem numër një në shoqëri. Vrasjet, masakrat, përdhunimet, mosrespektimi i njeriut kanë qenë shumë të përhapura. Njeriu nuk është respektuar as sa një kafshë, siç është rasti në Palestinë, Bosnjë, Kosovë, Çeçeni etj. Këto dukuri sikur tregojnë "parapërgatitjen" e njeriut modern për shekullin e kompjutorit, internetit, përparimit shkencor, përparimit teknologjik etj.

Dr. Murad Hofmann në librin e tij "*Islami si alternativë*" tregon për një simpozium, të mbajtur me rastin e njëzetepesëvjetorit të punës së Qendrës Islame në Aachen, më 17 mars 1989. Tema e simpoziumit, në të cilin kanë marrë pjesë myslimanët gjermanë si Ahmed von Denfferi, Harun Behri dhe Axel Köhleri, ka qenë "*Islami dhe çështja e mjedisit natyror*". Në këtë simpozium, sipas autorit në fjalë, janë miratuar disa konkluzë. Kriza aktuale ekologjike është pranuar si rezultat i të pafeve. Njeriut pafe e shpall veten zot të pakufijshëm dhe fillon t'i kënaqë pasionet e tij hedoniste dhe konsumuese. Si rrugëzgjdhje e vetme për të dalë nga kjo krizë konsiderohet islami, duke i përmendur disa ajete Kur'anore (si, *En'am*, 165, 141, 38; *A'raf*, 56; *El - Vaki'a*, 68 - 70), që ka-

---

<sup>59</sup> Roger Garaudy, *Živi islam*, Sarajevë, 1990, f.22.



në të bëjnë me vlerën dhe rëndësinë që islami ia jep njeriut dhe mjedisit në përgjithësi.<sup>60</sup>

R. Garaudy përmend rastin e marrëdhënieve në mes Veriut dhe Jugut. Sipas autorit në fjalë, një pjesë e botës jeton si kolonizuese e një pjesë tjetër si koloni. Një pjesë e botës jeton në lulëzim, ndërsa pjesa tjetër mundohet të mbi-jetojë me një uri të padurueshme, siç është rasti me botën tjetër të pazhvilluar, ku, sipas autorit, nga uria kanë vdekur 80 milionë njerëz. Borxhi i Botës së Tretë rritet dita me ditë, ndërsa dallimi në mes tyre është dhe më i madh. Veriu gjithnjë pasurohet, ndërsa Jugu vazhdon ende të varfërohet.<sup>61</sup>

Një faktor me rëndësi, që ka lindur në të kaluarën dhe vazhdon edhe sot, është individualizmi. Ai kënaq aspiratat individuale, ndërsa aspiratat shoqërore nuk përfillen fare. Edhe renesanca dhe humanizmi lindën kinse për shpëtimin e njeriut, por bashkë me ta lindi edhe kapitalizmi dhe kolonializmi, me çka që shoqëria ka pësuar shumë dhe, ç'është më e keqja ende vazhdon të pësojë.<sup>62</sup>

Ndërkaq, në aspektin fetar, apo, me fjalë tjera, në aspektin islam, bota është botë, pa marrë parasysh nëse ajo është moderne apo primitive, e shekullit I...VI... XIX... XX apo XXI. Sepse, bazament të saj feja ka Absoluten, pra ka Allahun xh.sh.. Ndërsa bota është relative. E relativja i nënshtrohet gjithmonë të Pandryshueshmes apo Absolutes. Duke qenë kështu, atëherë kuptohet që feja është e përshtatshme për çdo kohë, sepse është e bazuar në Absoluten, që është e pakohë. E nga kjo kuptojmë që bota, për të mos i përsëritur të njëjtat gabime apo mëkate edhe në mileniumin e ri, duhet që bazament të ahlakut, etikës, moralit, karakterit apo sistem të jetës

---

<sup>60</sup> Murad Hofmann, *Islami si alternativë*, (përkth. Agim Abazi), Shkup 2000, f.138 - 141.

<sup>61</sup> Garaudy, f.22 - 23.

<sup>62</sup> Po aty, f.23.

të zgjedhë atë që është e bazuar në të Pandryshueshmen, në Absoluten, apo në fenë origjinale. Fe origjinale në këtë rast është feja, e cila kërkon nënshtrimin e plotë Allahut xh.sh.. E pra, fe e vetme që ka baza të shëndosha hyjnore dhe që kërkon nënshtrim të plotë Allahut është feja që posedon librin e vet hyjnor të pashtrembëruar dhe të pandryshuar, siç është rasti me Kur'anin. Ndërkaq elementet në të cilat bazohet jeta fetare apo etika fetare janë besimi në Allahun, në botën e ardhshme, në pejgamberët dhe veprimi sipas porosive të Allahut xh.sh..<sup>63</sup>

Në lidhje me pyetjen se ç'duhet bërë në këto momente të paqartësisë, të kaosit etik - moral, të baticave dhe të zbaticave të amoralitetit, dijetarët myslimanë japin zgjidhje të ndryshme. Njëra prej mënyrave si rrugëdalje nga kjo katastrofë etike është nevoja që njeriu së pari të pranojë Hakikatin/Realitetin (Allahun), pastaj atë ta mbajë në mend gjithmonë. Si zgjidhje e tretë propozohet që njeriu të braktisë çdo gjë që është në kundërshtim me Hakikatin apo me bindjen e Hakikatit. Dhe së fundi, propozohet që të bëhet çdo gjë që kërkon Hakikati.<sup>64</sup>

Kjo metodë preferohet edhe nga Kur'ani Kerimi, i cili në kapitullin *Asr*, tregon të njëjtën mënyrë të shpëtimit të njerëzve:

*“Pasha kohën. Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri - tjetrin t'i përmbahen së vërtetës dhe që këshillojnë njëri tjetrin të jenë të durueshëm”.*<sup>65</sup>

Gjithashtu edhe në suren et - Tinë tregohet e njëjta gjë:

*“Përveç atyre që besuan dhe bënë vepra të mira; ata kanë shpërblim të pandërprerë”.*<sup>66</sup>

---

<sup>63</sup> Shih, Kur'an, *Bakara* 62, 92; *Maide* 110, 69; *Ali Imran* 84.

<sup>64</sup> Frithjof Schuon, *Bir Mesaj, Kutsahn Peşinde*, (ed.) Katherine O'brien dhe Sejjid H.Nasr, Stamboll, 1995, f.23.

<sup>65</sup> *El-Asr*, 1 - 3.

<sup>66</sup> *Et - Tinë*, 6.

Pra, këtu mund të thuhet se, ndonëse sot flitet më tepër për një përparim kulturor, shkencor, teknik, teknologjik, kompjutorik, ky nuk është përparimi i vetëm të cilin duhet ta ketë njeriu, dhe se përparim më i rëndësishëm, me të cilin do të ekzistojnë edhe përparimet në fushat e lartpërmendura, është avancimi në aspektin e vlerësimit të njeriut si njeri, qëllim ky, për të cilin ai është krijuar nga Krijuesi i tij.

Si përfundim do të kisha porositur që, nëse dëshirojmë të jemi më të përparuar në cilindo aspekt të jetës sonë, së pari duhet të përparojmë në respektimin dhe vlerësimin e poseduesit dhe dirigjuesit të shkencës, teknologjisë, kompjutorit, internetit, kulturës etj., pra të njeriut, krijesës më të përsosur që ka krijuar Allahu xh.sh.. Vetëm në këtë formë njeriu do të luante rolin të cilin ia ka dhënë Krijuesi i tij.



## Islami dhe toleranca

*“Rruga jonë është e mbushur me gjemba, po ideali është aq i lartë sa ia vlen të ecësh edhe mbi gjemba.”*  
(Naim Frashëri)

Bisedat dhe diskutimet për lirinë e njeriut janë sot një realitet i pamohueshëm. Përveç shkrimeve të shumta në gazeta dhe revista në gjuhë të ndryshme, për lirinë e mendimit, lirinë e bindjes politike, lirinë e përcaktimit fetar hasim edhe vepra shkencore. E megjithatë, kjo nuk mjafton; këto tema diskutohen edhe në simpoziume, tubime, tribuna dhe programe të ndryshme televizive.

Kur flasim për lirinë e njeriut jemi të vetëdijshtë se kjo është një shprehje me kuptim shumë të gjerë. Ajo ngërthen lirinë e të shprehurit, lirinë e bindjes politike, lirinë e përcaktimit fetar etj. Çdonjëra nga këto përbën një çështje më vete. Por ne, duke mos u zhytur në çdonjërin nga këto, në vazhden e këtij shkrimi do të përcaktohem në mënyrë të përgjithshme për tolerancën/qëndrimet e myslimanëve ndaj të tjerëve dhe anasjelltas.

Një nga shprehjet e rëndomta dhe të zakonshme që sot përdoret edhe nga liderët e politikës botërore është toleranca ndërkonfesionale apo ndërnacionale. Kjo shprehje përdoret me të madhe edhe në Ballkan. Në të shumtën e rasteve përdoret edhe në vende ku shqiptarët jetojnë me shumicë.

Por, para se t'i hyjmë çështjes në fjalë, le të shohim se çfarë kuptojmë me shprehjen *tolerancë*. Kjo është një fjalë latine (*tolere*) që do të thotë *durim, durueshmëri, durim ndaj mendimeve të të tjerëve, zemërbutësi, marrja në konsideratë e të tjerëve*.<sup>67</sup>

Në literaturën islame për tolerancën përdoret në arabisht fjala *tesamuh*, ndërsa në turqisht fjala *hosgörü* (hoshgory). Sipas disa dijetarëve myslimanë, këto dy shprehje, edhe pse në të shumtën e rasteve përkthehen si tolerancë, kanë kuptim më të gjerë dhe më gjithëpërfshirës. Për shembull, Husejin Batuhan dhe Xhemil Meriç fjalën *tesamuh* (musamaha, hosgörü) nuk e përkthejnë tolerancë, për arsye se, sipas tyre fjala tolerancë në vete nuk ngërthen një koekzistencë të gjerë, një respekt reciprok apo të jetuarit bashkë.<sup>68</sup>

Disa dijetarë të tjerë myslimanë, duke diskutuar për tolerancën, thonë se kjo shprehje ka kuptimin të pranosh diçka edhe kur ajo nuk të shkon për qejfi, apo edhe kur nuk të pëlqen. Edhe pse ke të bësh me një çështje që nuk e dëshiron, si për shembull, ke një komshi, një mik apo një shok, apo kushtet bëjnë që të jetosh me ndonjë pjesëtar të ndonjë besimi, ideologjie, bindjeje tjetër nga ajo për të cilën je përcaktuar ti, je i detyruar që atë ta pranosh ashtu si është. Pra, kemi të bëjmë me një mundim të vetvetes. Ndërsa toleranca islame (*tesamuh, hosgörü*) është diçka tjetër. Sipas tolerancës islame njeriu nuk e detyron vetveten, por e pranon realitetin dhe pajtohet me të. Për shembull, kur islami i lejon një myslimani të martohet me Ehl - i Kitab (ihtarë e librave të shenjtë) ai nuk e bën këtë që myslimani ta ndiejë veten të munduar, se s'ka ç'të bëjë tjetër, se patjetër duhet të pajtohet me këtë realitet. Por, myslimanit islami ia mundëson që këtë gjë ta pranojë me

---

<sup>67</sup> Ljubo Mikunović, *Sovremen Leksikon*, Shkup, 1990.

<sup>68</sup> İlber Ortaylı, *Tolerans ve Tesamuh, Osmanlı'da Hosgörü*, Stamboll, 2000, f.21.

bindje e pa detyrim, duke menduar se kjo është nga ithtaret e librave dhe ai pajtohet me bindjen dhe besimin e saj. Pra, në tolerancën islame nuk ka dhunë (*ikrah*).<sup>69</sup>

Ndërkaq, po ta vështrojmë islamin, do të shohim se ai asnjëherë nuk ka ndërhyrë në parimet esenciale të ndonjë feje e as që do t'i lejohet të ndërhyjë ndonjëherë në të ardhmen; asnjëherë nuk ka themeluar ndonjë organizatë inkuizicioni dhe asnjëherë nuk ka pasur për qëllim të ndërrojë me forcë fenë e ndonjë njeriu apo të ndonjë populli. Edhe pse islami arriti një reputacion të madh në botë, ai nuk e detyroi askënd të besojë në parimet e tij.

Islami nuk veproi kështu, sepse kjo fe nuk bazohej në racën e ndonjë populli, siç është rasti me hebraizmin dhe induizmin, as që ishte e themeluar nga një individ, siç është rasti me budizmin dhe krishterimin,<sup>70</sup> por burim kryesor kishte (e ka edhe sot dhe do ta ketë edhe në të ardhmen) fjalën e pakrijuar të Allahut xh.sh., Kur'anin Famëlartë. Ndërsa, Kur'ani dhe dhuna, Kur'ani dhe detyrimi janë në kundërshtim, janë dy pole të kundërta të realitetit botëror. Këtë e shohim në ajetet kur'anore në të cilat Allahu xh.sh. thotë:

*“Nuk ka dhunë në fe...” (Bakare, 256)*

*“O ju që besuat, hyni në islamizmin e tërësishtëm (fi's - silmi - në paqe), e mos ndiqni rrugën e Djallit, sepse ai është armik i juaj i hapët”, (Bakare, 208).*

Këto dy ajete dhe ajete të tjera që gjenden në Kur'an na tregojnë se islami është kategorikisht kundër dhunës dhe se në mënyrë kategorike urdhëron për paqe. Kjo kuptohet nga fjala *silm* që përmendet në ajetin e lartpërmendur e që do të thotë paqe, respekt, rrënjë prej së cilës rrjedh dhe fjala islam, që do të thotë nënshtrim Allahut.<sup>71</sup>

---

<sup>69</sup> Mehmet Aydın, *Hoşgörünün İslami Temelleri, Osmanlı'da Hoşgörü*, f.45.

<sup>70</sup> M. Abdel Haleem, *Tolerance in Islam, The Islamic Quarterly*, v. XLII, nr. II, The Islamic Cultural Centre, London, 1998, f.89 - 98.

<sup>71</sup> Serdar Mutçali, *Arapça - Türkçe Sözlük*, Stamboll, 1995.



Në histori ka shumë fjalë të shkruara, qoftë më herët qoftë më vonë, për qëndrimet tolerante të Muhamedit a.s. ndaj myslimanëve të tjerëve. Kuptohet se të gjitha këto fjalë bazohen në praktikën e Muhamedit a.s., që parim të vetin kryesor ka pasur Kur'anin dhe Hadithin e tij. Kështu në hadithet e Pejgamberit a.s. thuhet:

*“Ai i cili e mundon një hebre apo një të krishterë ditën e gjykimit mua do të më gjejë si paditës.”* Apo hadithi tjetër, *“çdokush që pa të drejtë e mundon një grup jomyslimanësh, unë jam armiku i tij. Ndërsa unë kujt i bëhem armik ai edhe ditën e gjykimit do të jetë armik me mua”*.<sup>72</sup>

Tolerancën islame ndaj të tjerëve një dijetar (Çanlild) e shpreh në formë tjetër, dhe thotë:

*“Sikur arabët, turqit dhe myslimanët e tjerë të përdorin metodën që e përdor sot Perëndimi ndaj myslimanëve, nuk do të ekzistonte asnjë i krishterë në Lindje”*.<sup>73</sup>

Komandantëve të tij ushtarakë që i ka dërguar në luftë Muhamedi a.s. ua ka ndaluar të rrënojnë shtëpi, ndërtesa të tjera që nevojiten për plotësimin e nevojave shoqërore, ai ka ndaluar të prishen kisha, sinagoga dhe tempuj të tjerë. Përveç që ka ndaluar të vriten fëmijë, pleq, njerëz të pafajshëm, ai ka ndaluar të vriten edhe priftërinj dhe rabinë, sepse, sipas botëkuptimit islam ata janë njerëz që luten.

Në qytet - shtetin që e ka formuar Pejgamberi a.s. dhe në marrëveshjen që është bërë për atë shtet kanë marrë pjesë edhe myslimanët, edhe hebrenjtë, edhe politeistët arabë, bile edhe ata pak të krishterë që kanë jetuar në ato vende. Këtë e vërteton edhe kushtetuta e Muhamedit a.s. - *Vesika e Medines*, e cila u përgatit nga ai dhe shokët e tij në kohën kur ai u shpërngul nga Meka në Medinë. Në këtë kushtetutë, krahas pjesës më të madhe

---

<sup>72</sup> Musa S. Şahin, *Fener Patrikhanesi ve Türkiye*, Stamboll, 1996, s. 39.

<sup>73</sup> Süleyman Ateş, *Büyük İslam İlmihali*, Stamboll, Yeni Ufuk Neşriyat, f. 538.

që ka të bëjë me Ehli Kitabët (Ithtarët e librave), gjenden edhe disa përcaktime, si: hebrenjtë, që do të na nënshtrohen neve, do të fitojnë, pa kurrfarë padrejtësie, të drejtën e ndihmës dhe të barazisë; hebrenjtë Benu Avf me besimtarët (myslimanët) janë një *ummet* (popull). Hebrenjve u takon feja e tyre, ndërsa besimtarëve (myslimanëve) feja e tyre; askush nuk mund të bëjë krim ndaj aleatëve; ata që do të strehohen tek hebrenjtë (*bitane*), do të konsiderohen si vetë hebrenjtë. Të gjithë këta shembuj flasin në mënyrë importante dhe flagrante për tolerancën e pakrahasueshme të Muhamedit a.s..<sup>74</sup>

Edhe Hulefa Rashidinët kanë qëndrime me rëndësi që ia vlejnë të merren si shembull për njerëzimin në përgjithësi. Si shembull mund të përmendim Ebu Bekrin, i cili në një fjalim të mbajtur para ushtarëve të tij, thotë: “Popullin mos e torturoni! Ata mos i dëmtoni për kot. Të jeni të drejtë dhe të mirë në sjellje; suksesi të jetë dobia juaj. Kur të ballafaqoheni me armikun, sulmoheni ashpër. Nëse fitoni në luftë mos i vritni fëmijët dhe gratë. Kurseni arat dhe shtëpitë. Nëse bëni ndonjë marrëveshje, përmbajuni të gjitha parimeve. Në tokat krishtere do të takoheni me njerëz fetarë të cilët i shërbejnë Zotit nëpër kisha dhe manastire. Ata mos i mundoni. Mos i prishni kishat dhe manastiret e tyre.” Edhe qëndrimet e Omerit (r.a.), me rastin e çlirimit të Jerusalemit, tregojnë për tolerancën/qëndrimet pozitive të myslimanëve ndaj të tjerëve. Trimi mbrojtës i Jerusalemit patriku Sofranus, pas 4 muaj rrethimi pranoi ta lëshojë qytetin, por me kusht që të vinte vetë Omeri. Kur erdhi Omeri, të gjithë pritnin me afsh qëndrimin e tij. Duke iu drejtuar popullit, Omeri tha: “Jini të sigurt; për drejtimin e qytetit do të formohet një rregull; pasuria dhe njerëzit janë të ga-

---

<sup>74</sup> Osman Güner, *Resulullah'ın Ehl - i Kitap'la Mithasebetleri*, Ankara, 1997, f.252 - 257.



rantuar; kishat dhe vendet e shenjta do të respektohen. Pas kësaj Omeri shëtiti qytetin dhe kur arriti te kisha më e madhe patriku i tha: urdhëroni faluni. Mirëpo Omeri tha: Kisha në të cilën do të falem unë bëhet myslimane, prandaj nuk dua që të krishterëve t'ua marr kishën e tyre duke falur namaz. Dhe kështu nuk pranoi që të falej në atë kishë.” Ndërsa më 1099 kryqtarët, si e okupuan Jerusalemin, bënë të kundërtën e Omerit. Prifti Rajmond d'Agiles tregon për vrasjen e dhjetë mijë myslimanëve në xhaminë e Omerit: Në tempullin e peygamberit Sulejman është derdhur aq gjak saqë trupat e njerëzve kanë notuar në të; kanë notuar në gjak duart, krahët e tyre të prerë. Këto duar dhe këto këmbë nuk dihej të cilit njeri ishin. Edhe vetë ushtarët që e kanë bërë këtë gjenocid kanë përballuar me vështirësi tymin që ka dalë nga ky vend.<sup>75</sup>

Si shembull të mirë mund të përmendim edhe Anadollin, Andaluzinë, Azinë, Evropën, Afrikën, e sidomos Gadishullin Ballkanik. Edhe në këto vende islami ka depërtuar me bindje e jo me luftë, forcë a dhunë. Një shembull me rëndësi është edhe pranimi i islamit nga ana e shqiptarëve.

Edhe Perandoria Osmane, që është faza e fundit e Shtetit Islam të formuar nga Muhamedi a.s., është një shembull par excellence dhe pa presedent për tolerancën fetare që e ka rrezatuar në vendet ku ajo ka qenë presente. Shembujt në lidhje me këtë aspekt në Perandorinë Osmane janë të shumtë. Mund të përmendim rastin kur sulltan Mehmet Fatihu II e ka çliruar Stambollin dhe i ka thirrur edhe myslimanët, edhe hebrenjtë, edhe ermenët të vijnë dhe të vendosen në Stamboll.<sup>76</sup>

Në kohën e sulltan Muratit II, më 1394, hebrenjtë të përzënë nga ana e mbretit të Francës Charles VI, kanë

---

<sup>75</sup> Po aty, f.44 - 45.

<sup>76</sup> Ahmet Hikmet Eroğlu, *Osmanlı Devleti'nde Yahudiler*, Ankara, 1997, f.59.



qenë të shpërngulurit e parë që janë strehuar në Shtetin Osman.<sup>77</sup>

Në vitin 1577, sipas një regjistrimi të bërë asokohe, në Stamboll ka pasur 485 xhami, dhe 743 kisha.<sup>78</sup>

Të krishterëve ortodoksë sulltan Mehmet Fatihu II u ka njohur aq të drejta sa ato më shumë i ka gëzuar patriku sesa veziri (ministri) i padishahut (sulltanit).

Në lidhje me sulltan Fatihun tregohet kjo anekdotë:

“Mbreti serb Brankoviç dërgon dy delegacione, njërin për te mbreti i Hungarisë Hunyadi, tjetrin për te sulltani Mehmet Fatihu II. Të dyja delegacionet kanë pasur të njëjtin mision. Misioni i tyre ka qenë që të pyesin mbretin dhe sulltanin se, në qoftë se Serbia u nënshtrohet atyre, çka do t’i ofrojë asaj ajo?

Mbreti hungarez përgjigjet kështu: “Të gjitha kishat ortodokse që ekzistojnë në Serbi do t’i prish dhe në vendin e tyre do të ndërtoj kisha katolike”.

Ndërsa sulltan Fatihu përgjigjet kështu: “Do të lejoj që afër çdo xhamie të ndërtohet një kishë ortodokse dhe do të mundësoj që në Serbi çdokush të besojë në fenë të cilën dëshiron që ta besojë”.<sup>79</sup>

Nga e gjithë kjo shihet se, islami dhe myslimanët në vend të dhunës kanë preferuar dhe rekomanduar gjithmonë paqen, në vend të forcës kanë preferuar dhe rekomanduar tolerancën, në vend të detyrimit kanë përdorur metodën e bindjes.

Edhe shqiptarët myslimanë, pavarësisht se në të shumtën e rasteve Evropa e krishterë<sup>80</sup> apo ortodoksët

---

<sup>77</sup> Po aty, f.61.

<sup>78</sup> Şahin, f.95.

<sup>79</sup> Po aty, f.93.

<sup>80</sup> Mark Krasniqi, *Toleranca fetare mes muslimanëve dhe katolikëve në Kosovë, Feja, Kultura dhe Tradita Islame ndër Shqiptarët*, simpozium ndërkombëtar, Prishtinë, 15, 16, 17 Tetor 1992, organizator: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 1995, f.206.

helenë<sup>81</sup> i kanë quajtur turq, kanë manifestuar ndaj të tjerëve këso qëndrime tolerante, këso qëndrime të mirësisë dhe të mirëkuptimit.

Në botëkuptimin fetar të shqiptarëve myslimanë nuk kanë gjetur vend asnjëherë dhuna as fjalët që nënçmojnë të tjerët, as fjalët të cilat ia nënçmojnë fenë tjetrit apo ato që do t'u bënin thirrje të tjerëve ta pranonin islamin në mënyrë globale. Asnjëherë shqiptarëve jomyslimanë shqiptarët myslimanë nuk u janë drejtuar me fjalët, "Lëreni krishterimin dhe e pranoni islamin, apo, ju patjetër do të bëheni myslimanë", siç kanë bërë katolikët dhe protestantët.<sup>82</sup>

Bile edhe shqiptarët myslimanë nuk e kanë pranuar islamin me dhunë. Po të ishte e vërtetë teoria se shqiptarët e kanë pranuar islamin me dhunë, atëherë do të parashtronim pyetjen se pse vallë vetëm shqiptarët u detyruan, e ç'u bë me bullgarët, grekët, sllavët etj., apo me popujt e tjerë që jetonin në atë kohë në Gadishullin Ballkanik? Pse edhe këta popuj nuk u detyruan, mos vallë osmanët i njihnin më herët shqiptarët, pra para se të takoheshin me bullgarët e grekët ata u takuan me shqiptarët, apo pozita gjeografike nuk e mundëson një gjë të tillë? Mos vallë realiteti është krejtësisht ndryshe, e këto që thuhet s'kanë veçse qëllime propagandistike? Mos dhashtë Zoti që këto të jenë të frymëzuara nga mendësia e inkuizicionit!

Por, të kërkojmë në këtë kohë moderne që, për shkak të gjendjes ekonomike, apo urisë, të ndërrohet besimi, apo ky ndërrim të kompensohet me artikuj ushqimorë (siç ndodh në Shqipëri), është një vetëdije e ulët e karakterit njerëzor që tregon dominimin e një egoizmi ek-

---

<sup>81</sup> Qani Nesimi, *Arnavut Ortodoks Kilisesi*, temë magistrature e pabotuar, Samsun, 2000, f.29.

<sup>82</sup> Shih, Mexhid Yveysi, *E ardhmja religjioze e Kosovës*, revista *Frymëzimi*, Gjakovë 2000, f. 23.



strem. Këtë e ilustron shumë bukur Koço Danaj, i cili ndër tjera, thotë: "...shqiptarët janë një popull ku shumica është myslimane. Dhe pas këtij "zbulimi", flitet për kulturën, traditat, lashtësinë. Ky shovinizëm fetar që ushtrohet mbi shqiptarët e quan normale dhe civilizuese ndërrimin e fesë, kalimin e myslimanit në të krishterë, gjë që ndodh sot në Shqipëri, për arsye ekonomike, për të gjetur dhe siguruar një punë në Greqi, për të mbajtur gjallë familjen. Ky është barbarizëm dhe jo civilizim. Të përdorësh kërcënimin e urisë si mjet për të ndryshuar fenë apo emrin, është më shumë se shovinizëm, është inkvizicionizëm."<sup>83</sup>

Nga ana e myslimanëve shqiptarë nuk është kërkuar asnjëherë që shqiptarët të arabizohen apo të turqizohen<sup>84</sup>, ngaqë kjo është në kundërshtim me parimet kryesore islame. I tillë është rasti me shqiptarët filogrekë të Shqipërisë. Ekzistimin e një ndjenje të tillë sot e vërteton edhe prezenca e kryetarit të KAOSH - it, Anastas Janullatos, me origjinë, gjuhë dhe shtetësi greke, i cili, sipas Statutit të KAOSH - it, është antikanonik.<sup>85</sup>

Në lidhje me këtë çështje, që ka ekzistuar që në kohët më të hershme, Sami Frashëri, thotë: "E dyta është kisha; të shpëtohenë shqiptarët nga xgjedha e priftërisë së greqet, të bullgarëvet e të serbëvet e të kenë kishën e

---

<sup>83</sup> Koço Danaj, *Totalitarizmi në marrëdhëniet ndërkombëtare*, Tiranë, 1996, f.121 - 122.

<sup>84</sup> Ndërsa ajo që thuhet nga evropianët se shqiptarët muslimanë janë turq, nuk është asgjë tjetër vetëm se një shpifje e pabazë. Kurse në historinë islame asnjëherë nuk ka pasur perandori islame që mund të quhet me një emër të ndonjë nacionaliteti. Pra, as shteti i pejgamberit (a.s.), as ai i hulefai rashidinëve, as ai i emevitëve, as ai i abasitëve e as ai i osmanëve nuk kanë qenë shtete nacionale arabe apo turke, por, shtete të formuara në bazë të parimeve universale fetare islame. Prandaj është shumë gabim që të thuhet Perandoria Arabe apo Perandoria Turke, kur dihet se ky mendim është thënë vetëm për të minimizuar qëllimin dhe idealin e Shtetit Islam.

<sup>85</sup> Nesimi, vep. e cit., f.56 - 58.



tyre me priftër shqipëtarë e me ungjill shqip; se Krishti s'ish as grek as shqah.”<sup>86</sup>

Për këtë Roberto Moroco dela Roka, në librin e tij **“Feja dhe Kombësia në Shqipëri 1920 - 1944”**, thotë: “Që nga koha e ndarjes së Perandorisë Romake në perëndimore dhe lindore, kufijtë në mes Lindjes dhe Perëndimit e ndanin mes për mes Shqipërinë: kjo ndarje vazhdoi në mesjetë dhe për shkak të sistemit konservator të mileteve...Nga ana tjetër fetë u kanë lejuar shqiptarëve identitetin e vet kombëtar, sepse, jashtë fesë kishte shumë pak elemente që do t'u jepnin mundësi të dalloheshin nga serbët ose bullgarët, në mënyrë të atillë që të ndalohej asimilimi. Islamizimi i shqiptarëve ka qenë një pritë kundër presionit sllav, ashtu sikurse më parë, pranimi i katolicizmit kishte qenë një mbështetje kundër greqizimit të favorizuar nga ortodoksia bizantine”.<sup>87</sup>

Ndërkaq për tolerancën ndërjetare të shqiptarëve shprehet edhe Vuk Karaxhiqi. Ai, kur dëshiron t'i këshillojë serbët thotë: “Pse ne serbët kemi urrejtje kaq të madhe ndërjetare, sa atë që nuk është i fesë sonë e quajmë të huaj dhe armik. Pse nuk marrim shembull gjermanët apo hungarezët, ku si katoliku gjerman, si protestani gjerman, veten e quajnë gjerman, dhe të tillë e konsiderojnë njëri - tjetrin. E njëjta gjë ndodh edhe me hungarezët. Po ne, serbët, rastin më të mirë që të marrim shembull e kemi te fqinjët tanë arbanasët (shqiptarët), të cilët u përkasin të tri feve (myslimane, katolike, ortodokse). Arbanasët jo vetëm që e konsiderojnë njëri - tjetrin bashkëkombës...”<sup>88</sup>

---

<sup>86</sup> Sami Frashëri, *Shqipëria çka qenë çështë e çdo të bëhetë*, *Vepra - 2*, Tiranë, 1988, f.67.

<sup>87</sup> Roberto Moroco dela Roka, *Feja dhe Kombësia në Shqipëri 1920 - 1944*, Tiranë, 1994, f.9.

<sup>88</sup> Myslim Hotova, *Toleranca burim i hapësirës ekumenike dhe artit ekumenik në Ballkan*, Tiranë, 1996, f.29.

Deri tani diskutuam, pak a shumë për tolerancën e myslimanëve, për qëndrimin e tyre ndaj të tjerëve. Tani le të themi disa fjalë për tolerancën/qëndrimin e të tjerëve ndaj myslimanëve.

Po t'i hedhim një sy fjalorit ditor që të tjerët përdorin për myslimanët do të shohim se ai përmban fjalë fyese, nënçmuese. Ai i quan me fjalët popull i prapambetur, terroristë, fundamentalistë, vrasës, shkatërrimtarë. A thua këtë e thonë për shkak se islami a myslimanët janë të tillë (ajo që përmendëm më lart vërteton të kundërtën), apo mos vallë dëshirojnë që me këto shprehje të fshehin qëllimin e tyre asimilues, shovinist, inkuizicionues etj?

Duke e analizuar gjendjen aktuale të myslimanëve dhe duke parë qëndrimet e të tjerëve ndaj myslimanëve, profesori i nderuar, Muhamed Hamidullahi, thotë:

“Në botën e sotme Perëndimore, që, jo vetëm dje, por edhe sot vepron në kundërshtim me Kartën e të Drejtave të Njeriut dhe teorinë e ngjashme, pakicat myslimane do të ishin të kënaqura edhe me statusin që e kanë pasur dhimmitë<sup>89</sup> në periudhën e sundimit të myslimanëve, por këtë ende nuk mund ta gjejnë”.<sup>90</sup>

Ne, të nderuar lexues, po të shikojmë rreth e përqark pa gjyzlykë, do të mund të shohim një realitet tjetër, të cilin nuk mund ta shohim me “syze”. O sot o kurrë flitet për lirinë e mendimit, tolerancën fetare, barazinë, të drejtën njerëzore... Këto fjalë i dëgjojmë shumë, disa prej tyre, bile, janë nxënë përmendsh nga shumë njerëz, të cilët ndoshta nuk kanë ndonjë prije për t'u marrë me to. Por, realiteti, gjithnjë duke u parë pa gjyzlykë, është krejtësisht tjetër. Realiteti na tregon se dikush na bën thirrje të bëhemi protestanë, dikush tjetër na

---

<sup>89</sup> Fjala *dhimmi* ka kuptimin marrëveshje, sigurim dhe dhënie fjalë. Ndërsa kuptimi terminologjik i fjalës në literaturën e jurisprudencës është: në bazë të marrëveshjes të fitosh të drejtën e nënshtetësisë në Shtetin Islam. Shih, Güner, vep. e cit., f.166.

<sup>90</sup> Suat Yıldırım, *Mevcut Kaynaklarına Göre Hıristiyanlık*, Izmir, 1996, f.363.

fton të bëhemi të krishterë/katolikë, një tjetër kërkon që të largohemi nga ky vend se qenkemi ardhacakë (që s'është aspak e vërtetë), ndërkohë që mbi Sahat Kullë (në Manastir dhe në Prilep) vihen kryqe, në kala të Tetovës duan të vënë një kryq, i cili i tejkalon normat e praktikimit të besimit krishterë, prishen shumë xhami pa anjëfarë shkak, apo edhe më keq – prishen xhami dhe në vend të tyre ndërtohen kisha (në Ohër, Shtip) etj. Në anën tjetër, dy liderët me renome botërore, patriku dhe papa, janë njerëz që pothuajse në çdo fjalim të tyre përmendin tolerancën, ndërkohë që papa, kur dëshiron të shkojë në Greqi, pritet me fjalët antikrisht, djall etj.

Unë mendoj se do të ishte shumë më e vlefshme që në vend të fjalëve, bisedave, simpoziumeve, tribunave, paneleve dhe shkrimeve të shumta për tolerancën, të manifestojmë të paktën një sjellje konkrete në këtë drejtim. Ndërkaq, fjalën time dua ta përfundoj me një shprehje të shkrimtarit dhe sociologut të njohur të botës islame, Ali Bulaç, i cili thotë se dhuna, shtypja, kërcënimi, asimilimi dhe burgimi nuk janë mjete të cilat i preferon karakteri islam.<sup>91</sup>

---

<sup>91</sup> Ali Bulaç, *Bir Aydın Sapması*, Stamboll, 1995, f.32.



## Liria e njeriut dhe besimi në Allahun xh.sh.

Kur dimë se liria, respekti, robëria, dhuna...etj. kanë të bëjnë me njeriun, atëherë është e qartë se të gjitha këto janë të vjetra sa edhe vetë njeriu. Duke qenë se njeriu i parë, gjegjësisht besimtari i parë, Ademi, është munduar me anë të besimit të tij që të realizojë lirinë, respektin ndaj njeriut dhe është munduar të ndalojë edhe dhunën, robërinë e njeriut etj., atëherë është fare e qartë se liria e njeriut dhe besimi në Allahun kanë ekzistuar që në kohën e njeriut të parë. Këtë e vërteton ngjarja e zhvilluar mes dy djemve të Ademit, e cila përmendet në Kur'an.<sup>92</sup> Por, para se t'i kthehemi çështjes së kuptimit të lirisë dhe lidhshmërisë së saj me besimin në Allahun, le t'u hedhim një vështrim disa mendimeve të dijetarëve se ç'është liria dhe ajo që mund të quhet liria si një problem psikologjik.

Lirinë Schopenhaueri e ndan në liri fizike, liri intelektuale dhe liri morale. Liria fizike, sipas Schopenhauerit, paraqet mungesën e pengesave materiale të çfarëdo lloji, për shembull, qiell i lirë, shikim i lirë, vend i lirë etj. Ky term në mendjen tonë përdoret si kallëzues për gjallesat të cilat mendojnë se lëvizjet e tyre burojnë prej dëshirës së tyre. Sipas kuptimit fizik të termit liri, kafshët dhe njerëzit do të llogariten të lirë atëherë kur do të mund të bëjnë çdo gjë sipas dëshirës së tyre të lirë, kur

---

<sup>92</sup> Maide, 27 - 31.

nuk do të mund t'i pengojnë as prangat, as rregullat e komunikacionit, as burgjet, as paralizimi, as vdekja etj.

Lirinë intelektuale, Schopenhaueri e paraqet vetëm si përpunim të termave të shpjeguar më herët.

Ndërkaq, liria morale, sipas autorit në fjalë, përkundër lirisë fizike e cila është mungesë e pengesave materiale, paraqet mungesën e pengesave motivuese sikurse janë kërcënimet, premtimet, rreziqet etj.<sup>93</sup>

Erich Fromm, në librin e tij "*Arratisje nga liria*", kur diskuton për lirinë si një problem psikologjik, thotë se, pavarësisht nga përmbysjet e shumta që ka përjetuar liria, ajo i ka fituar betejat. Në këto beteja shumë njerëz kanë mbetur me bindjen se të vdisje në luftën kundër shtypjes ishte më mirë sesa të jetoje pa liri. Kjo vdekje ishte pohimi më i lartë i individualitetit të tyre. Ai poash-tu vazhdon duke thënë: "Njeriu e përmbysi sundimin e natyrës duke u bërë sundimtari i saj, e përmbysi sundimin e kishës dhe sundimin e shtetit absolutist. Përmbysja e sundimit të jashtëm dukej kusht i domosdoshëm dhe i mjaftueshëm për të arritur qëllimin e dëshiruar, lirinë e individit". Sipas autorit në fjalë, edhe historia moderne evropiane dhe amerikane bazohet në përpjekjen për ta çliruar lirinë nga zinxhirët politikë, ekonomikë dhe shpirtërorë, që i kanë lidhur njerëzit.<sup>94</sup>

Ndërkaq, disa dijetarë, të quajtur edhe deterministë mekanikë ose metafizikë, ndjenjën e lirisë së njeriut, gjegjësisht lirinë e vullnetit e shohin si iluzion. Njëri nga deterministët metafizikë ose mekanikë është edhe Baruh Spinoza, i cili për lirinë e vullnetit zhvillon dy vëzhgime, vëzhgimin psikologjik dhe ontologjik. Vëzhgimi psikologjik i Spinozës për lirinë e vullnetit bazohet në pohimin e tij se besimi i njerëzve se janë të lirë, se posedojnë vullnet të lirë, bazohet

---

<sup>93</sup> Artur Schopenhauer, *Etika*, Shkup 1998, f.47 - 49.

<sup>94</sup> Erich Fromm, *Arratisje nga liria*, botoi Phoenix 1998, f.13.

në një të metë të meditimit për veprimet në të cilat njerëzit mendojnë se janë të lirë. Njerëzit, thotë Spinoza, kanë ndjenjën dhe bindjen se dëshirojnë diçka të lirë për shkak se nuk mendojnë për shkaqet objektive që i nxisin dhe i determinojnë të dëshirojnë atë që dëshirojnë dhe të punojnë atë që punojnë. Për shembull, fëmija mendon se lakmon lirisht qumështin, i inatosuri mendon se dëshiron lirisht hakmarrjen, kurse njeriu frikacak se dëshiron lirisht ikjen. Kështu që, thotë Spinoza, vetë përvoja, poaq qartë sikurse arsyeja, i mëson njerëzit të mendojnë se janë të lirë vetëm për shkak se janë të vetëdijshtëm për veprimet e tyre, kurse nuk i dinë shkaqet nga të cilat përcaktohen ato.<sup>95</sup> Spinoza krahason pozitën e njeriut, që beson se është i lirë, kur diçka punon, me pozitën e gurit që bie. Guri që bie beson se është në mënyrë të përsosur i lirë dhe se nuk ka shkak tjetër përveç vullnetit të tij vetjak, i cili bën që ky të qëndrojë në lëvizjen e tij. E njëjta gjë ndodh edhe me njeriun, i cili mendon se është i lirë, apo kjo është, sipas Spinozës, liria njerëzore për të cilën njerëzit janë aq shumë krenarë.<sup>96</sup>

Vëzhgimi ontologjik i Spinozës për lirinë e vullnetit qëndron në faktin se kjo liri, po të ekzistonte, do të ishte në kundërshtim me ligjin e kauzalitetit që sundon kudo në botë, kështu që, njeriut do t'i pranohej liria e vullnetit. Ndërkaq, kjo do të thotë që njeriu të jetë një lloj i veçantë shteti në shtetin e natyrës, edhe pse ai është vetëm një pjesë e saj.<sup>97</sup>

Thënë shkurt, filozofia e Spinozës paraqet një determinizëm të ashpër, ngaqë, sipas tij, në botë çdo gjë ndodh sipas caktimit të Zotit, kurse jashtë dëshirës së Tij nuk ndodhë asgjë. Në natyrë çdo gjë ekziston detyrimisht dhe lëviz në mënyrë të caktuar. Prandaj nuk ka diçka të mundshme. Nëse

<sup>95</sup> Vuko Paviqeviq, *Bazat e etikës*, Prishtinë 1981, f.95 - 95.

<sup>96</sup> Vep. e cit., f.96.

<sup>97</sup> Vep. e cit., f.97.



themi se ka diçka të mundshme, atëherë kjo rrjedh prej mangësisë sonë në dituri. Ndërkaq njeri i lirë është vetëm ai që punon sipas rregullave të logjikës së tij, gjegjësisht ai që e mohon rregullin e Zotin.<sup>98</sup>

Sipas mendimit ekzistencialist, njeriu është i dënuar të jetë i lirë. Njeriu çdo gjë bën sipas projektit të vet. Kështu që, kur zgjedh projektin e vetvetes, ai zgjedh veten. Në fakt liria ime nuk mund të kufizohet me diçka tjetër, përpos me kufijtë e saj. Me një fjalë ne nuk jemi të lirë që ta pengojmë vetveten tonë të jemi të lirë.<sup>99</sup>

Ndërkaq, sipas krishterimit, liria e njeriut buron nga marrëdhëniet e njeriut me shpëtimin eskatologjik. Sipas botë-kuptimit të krishterë, për t'u quajtur i lirë, njeriu duhet të kalojë nëpër tri faza: çlirimi nga mëkati, çlirimi nga ligji dhe çlirimi nga vdekja. Çlirimi nga mëkati realizohet duke i shërbyer krishterimit. Çlirimi nga ligji - fjala është për Ligjin e Musait - realizohet duke u pagëzuar, pasi liria e të krishterit është në Jezu Krishtin. Ndërkaq, dëshira më e madhe është çlirimi prej vdekjes. Sipas Palit dhe krishterimit, kjo botë nuk është me rëndësi, ngase është e keqe dhe veçse kalimtare për në botën e ardhshme. Në këtë botë njeriu duhet të punojë vetëm për të fituar botën e ardhshme të amshueshme, kur Jezu Krishti do të formojë mbretërinë qiellore.<sup>100</sup>

Kurse Martin Lutheri, themeluesi i protestantizmit, kur diskuton për shpëtimin e njeriut, nuk beson ai aspak se për të mund të ndikojë vullneti i lirë i njeriut, por njeriun e paraqet si diçka të krijuar asisoj që ai, me sjelljet dhe me mundimet e tij njerëzore, nuk ka mundësi të bëjë ndonjë ndryshim në shpëtimin e vet. E realizueshme është vetëm ajo që është e shkruar dhe njeriu mund vetëm t'i besojë.<sup>101</sup>

---

<sup>98</sup> Necati Öner, *Insan Hürriyeti*, Ankara 1995, f.41 - 42.

<sup>99</sup> Vep. e cit., f.47.

<sup>100</sup> Shih, Branko Boshnjak, *Filozofija i kršćanstvo*, Zagreb 1946 - 1966, f.291 - 194.

<sup>101</sup> Shih, Hakan Olgun, *Luther ve Reform, Katolizm'e Protesto*, Ankara 2001, f.118 - 121.

Ndërsa, në historinë islame janë zhvilluar mendime të ndryshme për lirinë e njeriut. Si më të rëndësishëm nga këto mund të numërojmë mendimin e kelamistëve, të cilët pan-dehin se njeriu zotëron liri të plotë vullneti dhe është krijues i punës së vet, gjë të cilën e mbrojnë *mu'tezilitët*. Ndërkaq, sipas fraksionit *xheberit*, njeriu nuk ka asnjëfarë lirie veprimi, vullneti apo mendimi, por ai është sikur gjethi, të cilin e mbart era. Kurse mendimi i përgjithshëm dhe më i pranuar është mendimi i *Ehl - i Sunetit*, ku bëjnë pjesë shkolla esh'arite dhe ajo maturidite. Sipas Ehl - i Sunetit njeriu është i lirë, por është i pamohueshëm fakti se njeriu në ahiret do të jetë përgjegjës për punët dhe veprimet e tij. Vetëm se, çdo gjë, para se njeriu të veprojë, Allahu xh. sh. e di. Dhe për shkak se i di të gjitha Ai është edhe përcaktuesi i atyre punëve apo veprimeve.<sup>102</sup>

Meqë në islam të gjitha mendimet e thëna në lidhje me lirinë e njeriut janë të bazuara në Kur'anin a.sh. dhe Sunetin e Pejgamberit a.s., është e qartë se as Kur'ani e as Suneti nuk e bllokojnë njeriun, por as e lënë atë të lirë, autonom nga Zoti. Pra, Zoti dhe njeriu janë dy realitete të pamohueshme. Zoti as nuk ia merr të drejtën njeriut po as nuk e lejon atë të mendojë të uzurpojë "të drejtën e Zotit". Në këtë rast, pra, kemi të bëjmë me lirinë e kufizuar të njeriut dhe lirinë e pakufizuar dhe absolute të Allahut, në të cilën liria e kufizuar e njeriut është brenda lirisë së pakufizuar të Allahut. Kjo është kështu për arsye se edhe dituria, edhe mundësitë, edhe liria e njeriut janë të kufizuara. Meqë njeriu nuk mund të përfshijë as me dituri as me mundësi diturinë dhe mundësinë absolute, edhe liria e kufizuar e njeriut nuk mund të përfshijë apo të ngërthejë në vete lirinë absolute apo lirinë e pakufizuar të Allahut.

---

<sup>102</sup> Shih, Mehmet S. Aydın, *Din Felsefesi*, Ankara 1994, f.160; Omer Ozsoy dhe İlhami Güler, *Konularına Göre KUR'AN*, Ankara 1997, f.383.



Këtu si shembull mund të përmendim çështjen e krijimit. Allahu krijon, por krijimi i Tij është krijim prej hiçit (*ex nihilo*), siç është rasti i krijimit të botës, i krijimit të njeriut të parë etj. Nëse themi kushtimisht, se edhe njeriu krijon, atëherë ky krijim dallon nga krijimi i parë, sepse ky në fakt, nuk është krijim, por bërje, ndreqje, siç është rasti me ndërtimin e ndërtesave, apo rregullimin e një mobiljeje etj., gjëra këto lënda kryesore e të cilave ekziston, kurse Allahu është krijuesi i lëndës së parë. Për shembull, njeriu ndërton një ndërtesë, por është Allahu krijuesi i materies prej së cilës janë bërë mjetet për ndërtimin e ndërtesës.<sup>103</sup> Edhe klonimi, që kohëve të fundit ka marrë përmasa të mëdha, nuk është krijim prej hiçit, por “krijim” prej lëndës të cilën e ka Krijuar Allahu. Nëse kjo kuptohet kështu, atëherë nuk mund të ketë kundërshtime mes këtyre dy shprehjeve. Në bazë të kësaj që përmendëm më lart duam të themi se edhe liria e njeriut është e njëjtë, siç është rasti me krijimin, në relacion me lirinë absolute të Allahut. Kjo kuptohet edhe nga shumë ajete kur’anore, siç janë ajetet 151 - 152 e sures En’am, ku Allahu xh.sh, thotë:

*“Thuaj: Ejani t’ju lexoj që me të vërtetë ju ndaloi Zoti juaj: të mos i shoqëroni Atij asnjë send, të silleni mirë me prindërit, të mos i mbytni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, sepse Ne ju ushqejmë juve dhe ata, të mos u afroheni mëkateve të hapta apo të fshehta, mos e mbytni njeriun sepse mbytjen e tij e ndaloi Allahu, përpos kur është me vend. Këto janë porositë e Tij, kështu që të mendoni thellë”. “Mos ju afroni pasurisë së jetimit derisa ai të arrijë pjekurinë, (mund t’i afroheni) vetëm në mënyrën më të mirë, zbatoni me drejtësi masën dhe peshojën. Ne nuk ngarkojmë asnjë njeri përtej mundësive të tij. Kur të flitni (të dëshmoni), duhet të jeni të drejtë edhe nëse është çështja për (kundër) të afërmit, dhe zotimin e dhënë Allahut plotësojeni. Këto janë me çka Ai ju porositë kështu që të përkujtoni.”*

<sup>103</sup> Öner, vep. e cit., f.63 - 64.



Apo ajeti:

*“Kush bën mirë, ai e ka për vete, e kush bën keq, ai vepron kundër vetes, e Zoti yt nuk bën padrejtë ndaj robërve.”*<sup>104</sup>

Nga këto ajete dhe ajete të tjera të Kur'anit kuptohet se njeriu nuk është robot, por ai ka një vullnet të lirë. Ka të drejtë të besojë ose të mos besojë. Por, kjo liri e njeriut nuk duhet të kuptohet si një liri e pakufizuar. Kjo kuptohet edhe nga vetë porositë që Allahu ia bën njeriut, duke e këshilluar për adhurim, respektim, ibadet, drejtësi etj.

Si përfundim mund të themi se njeriu, sipas islamit, është i lirë të veprojë në botën e tij. Për këtë dhe për çdo punë të vet ai është përgjegjës përpara Allahut. Kështu pra njeriu është i detyruar të zgjedhë o të mirën, Allahun, o të keqen, shejtanin. Ky është një realitet të cilit njeriu s'mund t'i shmanget. Për shembull, njeriu nuk mund të thotë se nuk lind, nuk ç'mendem, nuk vdes etj. Pra kjo tregon se jashtë mundësive të njeriut ekzistojnë mundësi të tjera më të mëdha, të cilave njeriu është i detyruar t'u nënshtrohet. Por, është me rëndësi të përmendet se njeriu nuk është Zot e as krijues, por është krijesë. Dhe si krijesë ai do të ndihet më i lirë kur t'i nënshtrohet Krijuesit. Që njeriu t'i nënshtrohet absolute, gjegjësisht Zotit, ai duhet të jetë i lirë në botën e tij relative. Por, kur njeriu i nënshtrohet edhe relatives, atëherë, duke qenë se prej absolute nuk mund të shpëtojë, të drejtën e tij për të qenë i lirë në veprim ai e përkufizon edhe në aspektin relativ. Islami nuk pranon as determinizmin e as pavarësimin ekstrem të njeriut. Në këtë formë, me anë të besimit në Allahun, njeriu e zotëron edhe lirinë e mendimit, edhe lirinë e veprimit. Apo me fjalë të tjera, është besimi në Allahun ai që njeriut ia mundëson lirinë e mendimit dhe të veprimit më të përsosur dhe më komplet.

---

<sup>104</sup> *Fussilet*, 46.

## Qëndrimi tolerant në suren “Er-Rum”

*“Të pëlqen apo jo, frika i bën njerëzit t’i hidhen njëri-tjetrit në krahë. Sapo ajo të zhduket, zhduket edhe nevoja e bashkëpunimit të ngushtë.”*

(Lordi Kerrington)

### I.

Sado të flitet apo të shkruhet sot për tolerancën, ajo nuk mund ta marrë përsëri pamjen e vetë të nevojshme, sepse toleranca është një çështje praktike dhe se ana e saj logjike pa anën praktike, do të ishte një ushqim i thatë. Nëse do të bëhej një krahasim se kush është më tolerant, atëherë do të kishim vërejtur se më tolerant se Krijuesi nuk ka dhe nuk ka pasur asnjë njeri askund, as sot e as në të kaluarën, bile nuk do të mund të ketë edhe në të ardhmen, edhe pse njeriu është krijesa e Tij më e bukur. Krijuesi këtë e ka shprehur në shumë raste, ndër të cilat më i parë mund të numërohet krijimi i çdo gjëje për njeriun dhe dhënia mundësi njeriut për të jetuar i lirë, për të vepruar sipas dëshirës së tij, gjegjësisht ta besojë apo ta mohojë, ta pranojë apo ta refuzojë Zotin. Njeriut Ai gjithashtu, i dërgoi peygamber, shpallje dhe i ndihmoi në forma të tjera të ndryshme. Të gjitha këto, krijesat e Zotit, rregullat apo parimet e Tij, shpërblimet apo dënimet e Tij, janë për të mirën e njeriut, gjegjësisht për shpëtimin e tij. Edhe pse njeriu e shan, e fyen, e mohon, i bën kufër Atij, Ai përsëri pret pendimin e njeriut dhe i ofron mundësi të reja për t’u kthyer drejt Tij. Për argumenti-

min e kësaj teorie mund të përmendim dërgimin e shumë peygamberëve nga ana e Tij. Kështu që, kur një peygamber mohohej, apo kur pas vdekjes së tij njerëzit largoheshin nga rruga e Zotit, Ai përsëri, në vend që të hidhërohej (përveç kur njerëzit talleshin apo e tepronin në pabesi), t'i fyente, u dërgonte peygamberë të tjerë. Dhe kështu kjo gjendje zgjati deri në dërgimin e Muhamedit a.s., me ardhjen e të cilit si peygamber i fundit, ky proces i profetizmit mori fund. Por, duke marrë fund procesi i profetizmit nuk mori fund edhe mëshira e Zotit ndaj njerëzve, gjegjësisht qëndrimi i Tij tolerant ndaj krijesave të Tij. Por ai qëndrim i Tij vazhdon, në një anë me ekzistimin e Kur'anit si fjalë e Tij e pandryshueshme, kurse në anën tjetër me faktin që të gjithë njerëzve u ka dhënë mundësi të ushqehen, të sundojnë apo të veprojnë të lirë, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre fetare apo ideologjike.

*“E kur të vijnë ty ata që i besojnë ajetet tona, thuaju: Selamun alejkum, Zoti juaj ia ngjeshi vetes mëshirën. Kush bën prej jush ndonjë të keqe pa dije, e mandej pas asaj (të keqe) pendohet dhe përmirësohet, s'ka dyshim se Allahu është që falë shumë dhe është Mëshirues.”<sup>105</sup>*

Por, vlen të theksohet se, në të kaluarën ka pasur raste kur ky qëndrim tolerant i Zotit është paraqitur si i cinguar, gjë që ka ndodhur si rezultat i kalimit të njeriut në “pozitën e Zotit”, gjegjësisht me përvetësimin e kompetencave të Zotit nga ana e njeriut, siç është rasti me Kishën Katolike në Evropë, që rezulton me shekullarizëm apo rasti me fetë primitive etj. Këtë e themi për arsye se teorema e shkullarizmit përmban tri pohime të ndryshme:

- Në shoqërinë moderne lëmenjtë e kësaj bote shkëputen nga kontrolli i normave dhe i institucioneve fetare, për ç'arsye edhe nuk mund më të ketë kisha shtetërore,

---

<sup>105</sup> Kur'an, En'am - 54.



- Si pasojë e Revolucionit Industrial ndodh një rru-  
dhje e tretje e praktikave fetare në qarqe të gjera të  
popullsisë,

- Feja është çështje private e individit.<sup>106</sup>

## II.

Kjo, pra, është rezultat i qëndrimeve jotolerante të  
njeriut të shprehura kundër parimeve hyjnore, gjegjësisht  
kundër dëshirës së Zotit. Kurse Zoti xh. sh. gjithmonë e  
ka shprehur tolerancën e Tij, të cilën ia ka mësuar edhe  
njeriut. Një gjë e këtillë shihet në shumë ajete të Kur'anit  
famëlartë, e sidomos në suren "Rum", në të cilën Allahu  
i Gjithëdijshtëm, thotë:

*"Elif, Lamë, Mimë. Bizantinët (rumët) u mundën, në  
tokë më afër (tokës së arabëve), po pas disfatës së tyre, ata  
do të ngadhnjejnë, brenda pak viteve. Çështja është vendim  
i Allahut, fillim e mbarim (për disfatë dhe për fitore). E atë  
ditë (kur do të fitojnë bizantinët) besimtarët do të gëzohen,  
për ndihmën e Allahut. Ai ndihmon atë që do dhe Ai është i  
gjithëfuqishëm, mëshirues."* (er - Rum, 1 - 5).

Këto ajete Kur'anore, edhe pse kanë të bëjnë me një seg-  
ment të tolerancës që Zoti ia mëson njeriut, prekin një mo-  
ment historik, një luftë që ka ndodhur ndërmjet persianëve, të  
cilët kanë qenë idhujtarë, dhe bizantinëve, të cilët kanë qenë  
ithtarë të librit/ehli kitabë, gjegjësisht të krishterë. Ndërkaq,  
Kur'ani tregon se persianët në të ardhmen do të pësojnë, kur-  
se bizantinët do të fitojnë. Sipas historianit anglez Gibbon, as-  
kush nuk kishte mundësi as të ëndërronte se tetë vjetë pas pa-  
ralajmërimit të humbjes së persianëve do të ndodhte që të fi-  
tonin bizantinët.<sup>107</sup> Por, kjo ishte një mu'xhize e Allahut xh.  
sh. e cila tregon se, edhe pse në fillim kjo luftë përfundon  
me humbjen e bizantinëve, dhe persianët më 611 marrin

---

<sup>106</sup> Urs Altermatt, *Etnonacionalizmi në Evropë*, Tiranë: Phoenix 2002, f. 109.

<sup>107</sup> Ebu'l A'la el-Mevdudi, *Teshimu'l Kur'an*, v. 4, Stamboll: İnsan Yayınları  
1995, f. 275.

Antakinë, më 614 Jerusalemin, më 619 Egjiptin, kurse më 617 avarët arrijnë deri para Stambollit (Konstantinopojës së atëhershme)<sup>108</sup>, në fund përsëri fitimtarë do të jenë ithtarët e librit, gjegjësisht bizantinët.

*Esbab-i nuzuli* (shkaku i zbritjes/shpalljes) i këtij ajeti Kur'anor është rasti mes Ebu Bekrit r. dhe kurejshitit Ubejj Ibn Halef, i cili iu drejtua Ebu Bekrit duke i thënë se, Muhamedi mendon se brenda disa vjetësh bizantinët do të dominojnë mbi persianët e, nëse është ashtu, eja të vëmë bast. Ndërkaq gjatë kësaj kohe të gjithë mushrikët (politeistët) mendonin se pasi humbën bizantinët, të cilët ishin të krishterë - ehli kitab, do të humbin edhe myslimanët si ehli kitab. Prandaj Kur'ani u del zot ithtarëve të librit, gjegjësisht bizantinëve. Ebu Bekri e pranoi propozimin e Ubejj Ibn Halefit dhe kërkoi: Nëse brenda tre vjetësh dominojnë bizantinët, ti do të m'i dhurosh 10 deve të reja, nëse jo, do t'i dhurojë unë. Pas kësaj Ebu Bekri vjen te Pejgamberi a.s. dhe i tregon për rastin. Muhamedi a.s. i tha: Shko dhe rrite numrin e deveve në 100, kurse kohën zgjate deri në 9 vjet, sepse fjala *bida'* ka kuptimin prej 3 deri në 9 vjet. Ky rast ka ndodhur në kohën para se bixhozi të bëhet haram. Pas kësaj ndodhi ashtu siç pretendoi Allahu xh. sh. dhe humbën persianët, gjegjësisht idhujtarët. Në realitet, mbreti bizantin, Herakleiosi, mblodhi ushtrinë dhe persianët i nxori prej matanë Eufratit, më 623 hyri në Azerbajxhan, më 624 - 625 hyri në Armeni, kurse më 627 në Gjeorgji dhe Mesopotami. Sipas disa mendimeve, kjo ngjarje përkon me kohën kur ka ndodhur Lufta e Bedrit. Ka mendime se ky rast përkon me ngjarjen e Hudejbisë, por kjo historikisht nuk qëndron. Mu në kohën kur persianët dominuan, Ubejj Ibn Halefi kishte vdekur, kurse pasardhësit e tij bënë pagesën sipas marrëveshjes me Ebu Bekrin. Ebu Bekri r., si i mori 100 devet, ia

---

<sup>108</sup> Süleyman Ateş, *Yüce Kur'anın Çağdaş Tefsiri*, v. 7, Yeni Ufuklar, f. 7; Mevdudi, *Tefhimu'l Kur'an*, v. 4, f. 274 - 275.



dërgoi Pejgamberit a.s., i cili urdhëroi që të gjitha ato të jepen sadaka.<sup>109</sup>

### III.

Ky rast, në fakt, paralajmëroi humbjen që do ta pësonin në të ardhmen vetë politeistët e Mekës, si idhujtarë, nga ana e ehli kitabëve, përkatësisht nga ana e myslimanëve. Këso qëndrimesh mund të hasim nëpër sure të shumta të Kur'anit famëlartë. Vetëm se, në Kur'an nuk mund të hasen qëndrime si *“Një grup njerëzish si individë, klasa dhe kombe sundojnë me njerëz të tjerë, disa janë më të privilegjuar në krabasim me të tjerët”*, apo *“Njeriu i bardhë dhe misioni i tij, ose njeriu i zi dhe misioni i tij”*, *“Populli i zgjedhur”*, ose *“Perëndimi dhe të tjerët”* (West and Rest - Huntington) të cilët përjetohen sot në vende të ndryshem të zhvilluara të botës, ose të paktën, siç pretendohet të jetohet në të ardhmen në këto vende.<sup>110</sup>

### IV.

Si përfundim mund të themi se islami, duke i shprehur mendimet e tij për jodhunën, tolerancën, mirëkuptimin, faljen, respektin ndaj të tjerëve, na bën me dije se ai, as sot as gjatë historisë, nuk ka qenë asnjëherë për diskriminim, dhunë, veçim të vetvetes, hiperbolizim të vetvetes, siç është rasti me idhujtarët, gjë që shprehet në ajetet e para të sures Rum, as që ka qenë shkak për lindjen e laicizmit apo të shekullarizmit në Evropë, edhe pse janë myslimanët ata që pësojnë më tepër nga ky shekullarizëm. Kurse, sa i takon terrorizmit, prë të cilën e fajësojnë islamin, ai as që është përmendur në konceptin islam. Kjo i ngjan atij rrenacakut, i cili u thotë të tjerëve *“mos gënjeni”*, duke menduar *“të të them unë sa s'më ke thënë ti”*.

---

<sup>109</sup> Ateş, *Yüce Kur'anin Çağdas Tefsiri*, f. 7 - 8.

<sup>110</sup> Ahmet Davutoglu, *Vetëpërceptimet e qytetërimeve*, Shkup: Logos - A 2002, f. 70.



## Hixhreti i Pejgamberit a.s. - faqe e re e historisë

*“Thuaj: ‘O ithtarë të Librit, ejani të biem në një fjalë të përbashkët edhe për ne edhe për ju; që të mos adhurojmë tjetër përveç Allahut, asnjë send të mos ia bëjmë shok dhe mos trajtojmë njëri - tjetrin si zotër në vend të Allahut. E nëse ata kthejnë kryet anash, thoni: Dëshmojeni se ne njëmend jemi myslimanë”!* (Ali Imran, 64)

Koha në të cilën jemi duke jetuar është përplot me ngjarje, raste e fenomene që na e kanë lodhur syrin, veshin dhe mendjen dhe që s’kanë gjë për njeriun (lirinë apo të drejtën e të shprehurit lirshëm). Çështë më e keqja, njeriu ende nuk ka shpresë se do të arrijë momentin e çlodhjes. Ky presion psikik, kjo torturë morale/njerëzore shihet në mungesën e një integrimi të nevojshëm, gjegjësisht të dobishëm, të një bashkimi mbarënjerëzor, të një respekti reciprok dhe kështu me radhë.

Hixhreti (shpërngulja) i Pejgamberit a.s., që u realizua në pjesën e parë të shekullit VII të e.s., ishte hapi i parë dhe shumë i rëndësishëm në këtë drejtim, gjegjësisht në arritjen e një integrimi dhe të një bashkimi mbarënjerëzor, për zhvillimin e ndjenjës njerëzore, si dhe për realizimin e respektit reciprok ndërnjerëzor, pa marrë parasysh racën, gjininë, gjuhën, po bile pa marrë parasysh edhe bindjen e tyre fetare.

Hapat e parë të Pejgamberit a.s. në këtë drejtim ishin themelimi i *xhamisë* së parë në Kuba, i *suffasë* brenda në xhami dhe *bashkimi* i tërë njerëzimit. Pra, me fjalë të tjera, qëllimi i tij i fundit ishte ngritja e nivelit shpirtëror tek njerëzit, përgatitja profesionale dhe zhvillimi i ndjenjës për një jetë të përbashkët, integrale mes tyre.

## 1. Orvatja për përsosje shpirtërore dhe për përgatitje profesionale

Me të arritur në periferi të Medines, në vendin e quajtur Kuba, Pejgamberi a.s., me t'u vendosur në shtëpinë e Benu Amr Ibn Afit, menjëherë ndërtoi xhaminë e parë në historinë e myslimanëve. Për ndërtimin e kësaj xhamie kanë ndihmuar edhe vetë Muhamedi a.s., Ebu Bekri r., Omeri r. etj,<sup>111</sup> ndërtim ky që flet edhe për fillimin e realizimit të idealit për të cilin është krijuar njeriu, ideal për të cilin Allahu xh.sh., në Kur'an, thotë:

*"Ve ma halektu 'l - xhinne ve 'l - i'nse illa li ja'budun"* (Dharijat, 56) (Kurse exhinët dhe njerëzit nuk i kam krijuar për tjetër veçse të më adhurojnë).

Ky, gjithashtu, është qëllimi i dërgimit të pejgamberëve, i shpalljes së vahjit (i shpalljeve që u janë dërguar pejgamberëve të ndryshëm): si për shembull, Kur'ani i është shpallur Muhamedit a.s., Tivrati Musait a.s., Inxhili Isait a.s. dhe Zeburi Davudit a.s. Përveç kësaj, janë edhe fletushkat (suhufet) e Ibrahimit a.s., të Musait a.s. etj.<sup>112</sup>

---

<sup>111</sup> Muhammed Hamidullah, *Muhammed a.s. - Život*, v.1, Sarajevë: el - Kalem 1990, f.165.

<sup>112</sup> *Kur'an, Nisa: 163; A'la: 18 - 19.*

Pas kësaj Pejgamberi hyn në Medinë dhe atje vendoset në shtëpinë e Ebu Ejjubit (i cili do të vritet në rrethimin që do t'i bëhet Konstantinopojës/Stambollit pas vdekjes së Pejgamberit a.s.). Në qytetin e Medinës/Jethribit ndërtoi xhaminë, brenda së cilës edhe një vend studimi të quajtur *suffa*. Në këtë qendër studimi, të cilën mund ta quajmë edhe si universiteti i parë në historinë e njerëzimit, u vunë bazat e qytet - shtetit të Medinës. Këtu, në këtë mesxhid, filloi formimi i një botëkuptimi të ri diplomatik, organizimi ushtarak, që do të kontribuojë për lirinë dhe të drejtën e njeriut. Këtu fillon edhe paraqitja e shkencave, si tefsiri, hadithi, fikhu, etika etj. Pra, për ngritjen e vetëdijes njerëzore vetë Kur'ani dhe Muhamedi a.s. kanë shprehur fjalët më të mira dhe joshëse në këtë aspekt:

*“Lexo, në emër të Zotit tënd i cili të ka krijuar. Krijoi njeriun prej një rrëcke. Lexo! Se është Fisnik Zoti yt, i Cili e mësoi me pendë; e mësoi njeriun çka nuk e kishte ditur.”* (Alak, 1-5)

*“Në krijimin e qiejve dhe të tokës, edhe në ndërrimin e natës e të ditës ka me të vërtetë argumente për ata që kanë mend.”* (Ali Imran, 190)

Kurse Pejgamberi a.s., në lidhje me këtë çështje, shprehet kështu:

*“ç’ka në qiell dhe në tokë kërkojnë falje te Allahu për të diturin?”*

*“I dituri është nga krijesat tokësore, të cilit Allahu i beson”*

*“Dijetarët janë trashëgues të pejgamberëve”<sup>113</sup>*

---

<sup>113</sup> Imam Gazali, *Ihjaw ‘Ulumi’d - Din*, v.1, Stamboll: Bedir 1974, f.15 - 17.



## **2. Bashkimi/Vëllazërimi i njerëzve (myslimanë dhe jomyslimanë)**

Përveç asaj që u përmend më lart, në Medinë Muhamedi a.s. mori edhe një hap me rëndësi, e ky është bashkimi/vëllazërimi i banorëve të Medinës, myslimanë dhe jomyslimanë. Ky vëllazërim, mbështetje të fortë gjen në fjalët Kur'anore, se njeriu më i mirë te Zoti është ai që është më i devotshëm, në fjalët e Pejgamberit se nuk është besimtarë ai nga i cili nuk janë të sigurt të tjerët, por edhe në Kushtetutën e parë të myslimanëve, të krijuar nga ana e Muhamedit a.s. në Medinë. Kjo kushtetutë ngërthen në vete detyrimet e myslimanëve ndaj njëri-tjetrit dhe detyrimet reciproke të myslimanëve dhe jomyslimanëve.

Po t'i hedhnim një sy kësaj kushtetute do të shikonim se, në pika të shkurtra, marrëdhëniet ndërmjet myslimanëve janë rregulluar në mënyrë perfekte.

Së pari, thuhet se, ky dokument është i proklamuar nga ana e Muhamedit a.s., të Dërguarit të Allahut, për të gjithë besimtarët dhe myslimanët, qofshin ata me origjinë kurejshite apo medinasë, dhe për pasuesit, shoqëruarit dhe për ata që luftojnë bashkë me ta. Pastaj dokumenti tregon se ata janë një popull - ummet. Muhaxhirët dhe ensarët, çdo njëri do të kujdeset për veten e vet duke zbatuar drejtësinë; besimtarët nuk kanë të drejtë të lënë anash asnjë të varfër; dhuna të jetë armike e besimtarëve dhe dhunuesit të mos kenë aspak përkrahje nga ata; të gjithë së bashku do ta luftojnë të keqen edhe nëse rrjedh nga fëmijët e tyre; besimtari nuk guxon të mbysë besimtarin për shkak të jobesimtarit; myslimani nuk guxon të lidhë paqe pa lejen e vëllait të vet apo kundër vëllait të vet; besimtarët duhet t'ia falin njëri tjetrit apo të

shpaguhen me njëri - tjetrin; garanca e Allahut është e njëjtë për të gjithë; hebrenjt që na respektojnë do të kenë ndihmën tonë; pabesimtari nuk guxon të nxitet kundër besimtarit; ai që mbyt besimtarin do të mbytet, e nëse i falet është tjetër gjë; të gjithë besimtarët duhet të ngrihen kundër atij që është kundër besimtarëve; myslimani nuk guxon ta përkrahë atë që sjell risi në fe; dhe nëse nuk keni zjdhje për diçka, atëherë drejtohuni Allahut dhe Pejgamberit të Tij.<sup>114</sup>

Në lidhje me raportet e myslimanëve dhe të ithtarëve të librave, gjegjësisht hebrenjve, në kushtetutën e lartpërmendur mësojmë se hebrenjtë që do të na nënshtrohen neve, do të fitojnë pa asnjëfarë padrejtësie, të drejtën e ndihmës dhe të barazisë; hebrenjtë Benu Auf janë një ummet me besimtarët. Hebrenjve u takon feja e tyre, ndërsa besimtarëve feja e tyre; askush nuk mund të bëjë krim kundër aleatëve; ata që do të strehohen te hebrenjtë (*bitane*), do të merren si ata; aleatët duhet të kenë kujdes nga intrigat reciproke; duhet të ndihmohen në rast rreziku; Medina mbrohet me kontratë; kjo kontratë nuk e mbron tiranin apo fajtorin; në rast mosmarrëveshjeje t'i drejtohen Allahut dhe Pejgamberit të Tij.<sup>115</sup>

Nga këto pak fjalë që u thanë më lart në lidhje me qëndrimin e myslimanëve, gjegjësisht qëndrimin e Muhamedit a.s. ndaj të tjerëve, konkretisht ndaj hebrenjve, të elaboruar në kushtetutën e parë të myslimanëve, po madje edhe të parën në botë, kuptojmë se veprimtaria e Muhamedit a.s., pas shpërnguljes në Medinë, ka qenë e bazuar kryekëput në respektin reciprok dhe në tolerancën për të cilën ka nevojë edhe bota moderne. Kjo shi-

---

<sup>114</sup> Safijjurrâhman El - Mubarekfuri, *Nektari i vulosur i xhennetit*, Shkup: Urtësia 1997, f.194 - 195.

<sup>115</sup> Osman Güner, *Resulullah'ın Ehl - i Kitab'la Münasebetleri*, Ankara: Fecr 1997, f.252 - 260.

het edhe nga vetë kuptimi i shprehjes tolerancë dhe shprehjeve të ngjashme, që përdoren në gjuhë të tjera. Kështu fjala tolerancë (*tolere*) ka kuptimin *durim, durueshmëri, durim ndaj mendimeve të të tjerëve, zemërbutësi, marrja parasysb e të tjerëve*.<sup>116</sup> Kurse fjalët *tesamuh* dhe *hoshgoru*, që përdoren në vend të fjalës tolerancë në literaturën islame, kanë kuptim më gjithëpërfshirës. Kështu ato kanë kuptimin e një koekzistence të gjerë, të një respekti reciprok dhe të të qëndruarit dhe të të jetuarit bashkë. Në tolerancën islame nuk parashihet që njeriu të detyrojë vetveten, por, të pranojë dhe të pajtohet, në mënyrë që të jetë i kënaqur me rrethin ku jeton.<sup>117</sup> Pra, jo të jetë tolerant sepse nuk ka mundësi ta mbysë tjetrin, por të jetë tolerant sepse edhe tjetri ka të drejtë të jetojë. Pra, thënë shkurt, myslimani nuk duhet të keqtrajtojë vetveten (pasi dhuna/ikrah është e ndaluar në islam), por, ai e ka për detyrim të tregojë në çdo moment njerëzi, personalitet, moral dhe vetëdije të lartë.

Në fund mund të themi se, ashtu sikundër Pejgamberi a.s. ka qenë i suksesshëm në kohën kur ai ka jetuar, edhe sot bota mund të jetë e suksesshme në aksionin e saj për dialog, tolerancë, por ama duhet pasur parasysb një kusht shumë me rëndësi, për të cilin Muhamedi a.s. është kujdesur shumë, - sinqeritetin në aksion.

<sup>116</sup> Ljubo Mikunović, *Sovremen Leksikon*, Shkup, 1990.

<sup>117</sup> Më gjerësisht shih, Qani Nesimi, *Islami dhe toleranca, Dituria Islame*, Nr. 134 - 5: gusht - shtator, Prishtinë: Bashkësia Islame e Kosovës, 2001.



## Globalizmi - në dobi apo në dëm të njeriut

*“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat), e Allahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë”.*  
(Huxhurat, 13)

Historia e njerëzimit, e bazuar në burimet dhe të dhënat më të lashta historike, siç është Kur’ani, Bibla, Libri i të Vdekurve në Egjipt, arkeologjia dhe disa tekste të zbuluara si ato të Tag Hammadit, Kumranit etj., na mësojnë se gjatë historisë njeriu, nëpërmjet të të dërguarve/pejgamberëve, apo nëpërmjet të meditimit, ka qenë gjithmonë në dialog me Krijuesin e vet, gjegjësisht me Zotin, dhe se ka përjetuar momente të llojllojta të ndryshimit, zhvillimit, përmirësimit apo të keqësimit të gjendjes së tij. Për t’i shprehur këto gjendje apo faza nëpër të cilat ka kaluar njeriu, përdoren shprehjet si primitiv, modern, agresiv, tiran, i drejtë, i prapambetur, i avancuar, pagan, monoteist etj. Por, këto shprehje s’janë veçse rezultat i punës, i veprës së njeriut. Ndërkaq, njeriut Zoti gjithmonë ia ka bërë me dije se gjithçka që është krijuar është krijuar për të dhe ai është i obliguar ta përdorë vetëm për të mirën e vet, për të mirën e rrethit ku jeton dhe për të mirën e mbarë njerëzimit, gjë që njëherësh ka qenë edhe vullneti i Zotit. Por, kur njeriu shprehet kundër këtij vullneti atëherë ai bie ndesh me dëshirën e Zo-

tit. Kjo përplasje e dëshirës së krijesës me të Krijuesit daton nga koha kur Djalli/shejtani i mallkuar, refuzoi i pari që të çonte në vend urdhrin e Zotit, duke thënë se është më i mirë se njeriu. Këtu lind edhe ideja e ndarjeve “unë” apo “ne” dhe “të tjerët”, ose “unë” apo “ne” të përparuarit, më të mirët, të zgjedhurit dhe “ata”, të prapambeturit, më të këqinjët, të cilët janë të dorës së dytë.<sup>118</sup> Kjo teori ka marrë më vonë forma të ndryshme, siç është rasti me grekët e vjetër të cilët me të njëjtin kuptim është përdorur fjala *barbaros* - i huaji, gjegjësisht njeriu i egër, i pakulturuar etj.<sup>119</sup> Edhe Huntington-i, në librin e tij “*Clash of Civilization*” (Përplasje qytetërimesh), përmend fjalën e njohur të tij *West and Rest* (Perëndimi dhe të tjerët), gjegjësisht “ne” dhe “ata”, apo ne të përparuarit dhe ata të prapambeturit. Sipas këtij përjashtimi kategorik, thelbi dhe përmbajtja e “të tjerëve” paraqesin një ndërrueshmëri (vlerë jokonstante) pasive, kurse ato të “Perëndimit” një variabël absolut dhe aktiv. Për këtë arsye, pa dhënë një propozicion të përgjithshëm në lidhje me “Perëndimin”, është i pamundshëm përkufizimi i “të tjerëve”.<sup>120</sup> Kjo është një teori e cila edhe sot mbizotëron në botë, qoftë në aspektin politik, kulturor, fetar apo ekonomik. Mendoj se, edhe në rastin e globalizmit kemi të bëjmë me të njëjtën teori. Por para së gjithash le të shohim ç’është dhe çfarë kuptojmë me fjalën globalizëm, gjegjësisht çfarë dëshirohet të shprehet me anë të globalizmit.

<sup>118</sup> Shih, Edward Said, *Oryantalizëm - Somurgëciligjin Keşif Kolu*, Stamboll: Pınar 1991, f. 191.

<sup>119</sup> Ky koncept shpreh përjashtimin kategorik të qytetërimeve të tjera, që në mendimin perëndimor në përgjithësi dhe në mendësinë politike në veçanti ka luajtur shekuj me radhë një rol të rëndësishëm. Shih, Qani Nesimi, *Arnavut Ortodoks Kilisesi*, temë magistrature e pabotuar, Samsun 2000, f. 21; Ahmet Davutogllu, *Vetëperceptimet e qytetërimeve*, Shkup: LogosA 2002, f. 37.

<sup>120</sup> Davutogllu, f. 37.



Fjala “*globalizëm*” (globalization), është njëra nga më të përdorurat që nga vitet 1980 e këndej. Shprehja “*fshati global*” u bë e njohur me botimin e veprës së M. McLuhan - it *Understanding Media/Të kuptuarit e Medias* (Routledge, London 1964), në të cilën autori flet për zvogëlimin e botës sonë, si rezultat i zhvillimit teknologjik dhe mediatic. Ndërkaq globalizmi, me kuptimin që përdoret sot është një term i ri, edhe pse një pjesë e elementeve dhe e fenomeneve që ai i simbolizon janë të vjetra sa edhe vetë historia e njerëzimit. Ky term është i lidhur ngushtë edhe me termat “*univerzalizëm*”, “*modernizëm*” dhe terma të tjerë të ngjashëm.<sup>121</sup>

Edhe pse globalizmi është një term për të cilin është shumë vështirë të jepet një përkufizim i saktë, “*efradini xhami’ agyarini mani*”, që do të thotë përkufizimi i dhënë t’i përfshijë të gjitha elementet përbërëse të tij e të përjashtojë të gjitha elementet që nuk i takojnë, prapëseprapë dijetarët dhe shkenctarët janë munduar të japin përkufizime dhe përshkrime të ndryshme të tij. Kështu, kur të shikohet në aspektin e përgjithshëm, globalizmi paraqet një proces ekonomik, një kapital, një shërbim që i tejkalon kufijtë e mundësive teknologjike dhe shkencore dhe një proces mjaft të përzier, të ngatërruar, të tollovitur, me batica dhe zbatica, ndonjëherë edhe kontradiktor, rezultatet e të cilit, pozitive apo negative, nuk mund të përkufizohen plotësisht. Krahas shumë mundësive të reja që na i ofron, ky zhvillim na sjon qindra probleme me të cilat duhet të ballafaqohemi.<sup>122</sup>

Ata që globalizmin e vlerësojnë si një zhvillim pozitiv, i përfshijnë parimet kryesore të tij në termat shekullarizëm, demokraci liberale, ekonomi e lirë dhe shtet li-

---

<sup>121</sup> Mehmet Aydın, “Küreselleşmeye Genel Bir Bakış”, *Küreselleşme*, Stamboll: Ufuk Kitapları 2002, f. 11 - 12.

<sup>122</sup> Ibid, f. 12 - 13.



gjor e kushtetues. Kurse disa të tjerë mundohen ta shprehin të njëjtën gjë duke u nisur nga një trini në aspektin ligjor - e vlerësojnë si një revolucion “për të drejtat e njeriut”, në aspektin politik – si një demokraci liberale, ndërkaq në aspektin ekonomik - si një ekonomi të lirë dhe me një rivalitet në prodhim.<sup>123</sup>

Pra, me globalizmin duhet të kuptojmë synimin për transformimin e botës në një ekonomi të vetme, në një politikë të tërësishme dhe të përbashkët dhe në një jetë etike në të cilën njeriu, pa marrë parasysh vendin, do të ndihet i lirë për të menduar, vepruar dhe besuar, duke e realizuar këtë mbi bazën e një kulture, tradite dhe besimi të caktuar. Pas këtyre, mendoj unë, fshihet një kolonizim i ri, gjegjësisht një planifikim strategjik. Këtë globalizmi mundohet ta arrijë me përhapjen e informacionit në çdo skaj të botës, me zhdukjen graduale të kufijve për lëvizje të lirë të transportit të prodhimeve, shërbimeve, individëve, mendimeve, të dhënave, parave, veshjeve, sjelljeve, etikës, kulturës etj.

Globalizmi synon dy fakte shumë me rëndësi. Së pari, ai mëton që të mbizotërojë në tërë botën me pikëpamje politike, ekonomike dhe sociale. Së dyti, globalizmi mëton ta zgjerojë ndikimin, varësinë dhe lidhjen reciproke brenda dhe ndërmjet shteteve dhe shoqërive në tërë botën. Varësia reciproke, e cila rritet bashkë me globalizmin, vazhdon pandërprerë që jetën e çdonjërit ta bëjë edhe më të varur prej vendimeve dhe lajmeve që vijnë nga largësi aq të mëdha sa njeriu nuk ka mundësi tjetër si t’i marrë. Në fillimin e shekullit XXI deri edhe shtetet më të përparuara dhe më të fuqishme ishin të detyruara të ballafaqoheshin me varësinë reciproke. Shtetet nacionale, që janë shtete me kufij të caktuar, u detyruan të ballafaqohen me ndikimin pa kufij të teknologjisë së

---

<sup>123</sup> Ibid, f. 13.

komunikimit, të qarkullimit të banorëve, të acarimeve dhe të konflikteve rajonale, shoqatave/organizatave multinacionale dhe të problemeve të tjera ekonomike.<sup>124</sup>

Një përkufizim tjetër në lidhje me globalizmin vijon si më poshtë:

Globalizmi është një term i përgjithshëm që shpreh ndërvarësinë në rritje të shoqërisë botërore. Do të ishte gabim, thotë Anthony Giddens, që globalizmi të konsiderohej thjesht si një proces i forcimit të unitetit botëror. Globalizmi i marrëdhënieve sociale duhet kuptuar, para së gjithash, si një risistemim i kohës dhe i hapësirës në jetën sociale. Me fjalë të tjera, jeta jonë është gjithnjë e më tepër nën ndikimin e ngjarjeve që ndodhin mjaft larg prej kuadrit social ku ne kryejmë veprimtaritë e përgjithshme. Me gjithë zhvillimin e sotëm të vrullshëm, globalizmi nuk është kurrësi një proces krejt i ri. Ai daton që prej dy ose tre shekujsh më parë kur filloi të shtrihej ndikimi perëndimor në botë, gjegjësisht kur filloi kolonizimi i botës nga ana e perëndimit.<sup>125</sup>

Kemi edhe definicione të tjera të bëra në lidhje me globalizmin. Sipas Roland Robertson - it, globalizëm do të thotë ngushtim i botës dhe rritje e vetëdijes se ajo është një tërësi. Kurse Malcolm Waters - i shprehet kështu: globalizmi është një proces i zhdukjes së kufijve gjeografikë në rregullimin shoqëror dhe kulturor.<sup>126</sup>

Ndërkaq prof. dr. Mehmet Aydın - i, një intelektual i botës islame i rangut botëror, globalizmit i bën një akses tredimensional: ekonomik, politik e juridik dhe kulturor. Në globalizëm, thotë prof. Aydın, procesi ekonomik është njëri nga proceset kryesore, ngaqë ky sjell me vete

---

<sup>124</sup> Mustafa Erdoğan, *Siyaset Ve Hukuk Perspektifinden Küreselleşme, Küreselleşme*, f. 28

<sup>125</sup> Anthony Giddens, *Sociologjia*, Tiranë: Çabej, Tetor 1997, f. 495.

<sup>126</sup> Süleyman Hayri Bolay, *Küreselleşme Ve Millî Kültürlex, Küreselleşme*, f. 57.



edhe një background të zhvilluar informacioni dhe një teknologji të lartë. Procesi ekonomik i globalizmit, që mëton një ekonomi pa kufij dhe një jetë ekonomike mbinacionale, ndikon si rrjedhojë në tërë jetën shoqërore. Pretendimet kryesore të atyre që kundërshtojnë globalizmin, sipas prof. Aydınit, janë me sa vijon:

- Globalizmi ndjek një rrugë diktatoriale të një lloji kapitali dhe të patronëve, të cilët fitimin e shohin si vlerë kryesore, harxhimin si një ibadet kurse njerëzit i marrin si klientë/myshterinj.

- Globalizmi, bashkë me dobësimin e konceptit të një shteti të përparuar social, dobëson edhe ndjenjën e përgjegjësisë sociale.

- Lojën e tyre aktorët e globalizmit ekonomik duan ta bëjnë aq të madhe, sa nuk kanë kohë të mendojnë se çfarë do t'i sjellë shoqërisë së gjerë njerëzore kjo lojë.

- Pretendohet se globalizimi është një proces të cilit nuk mund t'i dilet përpara. Nëse ky pretendim është i vërtetë, atëherë nuk ka zgjidhje tjetër përveçse çdonjëri t'i përulet këtij sistemi. Kjo do të thotë se njeriu nuk ka të drejtën e fjalës dhe të vetëvendosjes, përndryshe ballafaqohet me kërcënimin “mos kundërshtoni, se ju shkelim”.

- Ekonomia e globalizuar, sipas disa teologëve, përgatit një shekullarizëm të dëmshëm për ndjenjën fetare dhe moralin, sepse forca shpirtërore, në këtë rast, është e bllokuar. Nuk duhet haruar që veprimet globale mund të krijojnë edhe plagë të mëdha etike.

Çdo sistem ekonomik parasheh edhe një rregull politik të përshtatshëm për vete. Për shembull, ekonomia e lirë bën të nevojshme një strukturë politike liberale apo neo-liberale. Një kritikë që i bëhet këtij lloj procesi të globalizimit është në lidhje me dobësimin gradual që i bën ai fuqisë së shtetit kombëtar. Por, prof. Aydın thotë se shtetet nacionale nuk kanë pse të frikësohen nga globalizmi.



Ndërkaq, acarimet që do të lindin në fushën sociale dhe politike duhet pranuar si normale, sepse kjo gjendje është një fazë e historisë së njerëzimit. Si në çdo fazë, ashtu edhe në këtë ekzistojnë vështirësi, acarime, rënie shpirtërore, zhgënjime, shpresa të papëlqyeshme fare. Kurse globalizmi në vete, nuk është as satanik as hyjnor.<sup>127</sup>

Dimensioni i tretë është dimensionin kulturor, sipas të cilit globalizmi shpie drejt formimit të një “kulture botërore”, gjegjësisht të një “kulture globale”. Veçse, këtu nuk globalizohen kulturat botërore, por kultura të caktuara, proces ky që përfundon jo me një pluralizëm kulturor, por me një hegjemonizëm kulturor, apo me shfaqjen e një lloj imperializmi kulturor.<sup>128</sup>

Një çështje tjetër serioze në lidhje me globalizimin ka të bëjë me çështjen – nëse vërtet globalizmi është globalizëm, apo është glocalizëm, që do të thotë globalizim i lokalizmit?

Për të përkufizuar fuqinë e globalizimit dhe të lokalizimit, Erik Swyngedouw - i sajoi një term mjaft magjepsës, *glocalizmin*. Ai mëton se globalizimi dhe lokalizimi nuk janë dy procese; për më tepër, ata e formësojnë njëri tjetrin (mutually constitutive). Edhe Strassoldo - ja i ka shprehur mendimet e tij në lidhje me idenë e globalizimit dhe të lokalizimit. Ai thotë se globalizimi dhe lokalizimi bashkëveprojnë në shkatërrimin e shtetit kombëtar.<sup>129</sup> Aktorët e fuqishëm të fushës politike dhe socio-kulturore, si rrugë të vetme për t’ia dalë në krye zhvillimit teknik dhe ekonomik synojnë në aspektin e globalizimit globalizimin e asaj që është lokale.

Një ndikim tjetër me rëndësi i globalizimit, që shpreh edhe një dobësi të këtij procesi, është politizimi

---

<sup>127</sup> Aydın, f. 13 - 20; M. A. Muqtedir Han, “‘Global’ Siyasette Kimlik İnşası”, *Globalleşme Bir Aldatmaca Mi?*, Stamboll: Inkilab, Mars 2002, f. 94.

<sup>128</sup> Aydın, f. 22.

<sup>129</sup> Han, f. 102 - 103.

dhe shpërthimi i disa subjektivizmave/e disa egove të cilave ua mundëson të zotërojnë ndjenjën e “të qenit ndryshe/diç tjetër” apo “të ngritjes së vetvetes”, ndjenjë kjo e cila njeriun e tillë e detyron të kërkojë respekt nga të tjerët dhe ta mendoj veten me një statut të veçantë dhe krejtësisht ndryshe nga të tjerët.<sup>130</sup>

Në procesin e globalizimit, me dashje apo pa dashje, bën pjesë edhe feja, apo, kushtimisht thënë, edhe tri fetë e mëdha, të quajtura fetë e Ibrahimit a.s., për të cilat Turner thotë se ato janë të detyruara të bëjnë pjesë në proceset e globalizimit. Porse, për momentin, bashkimi i feve globale është pothuajse i pamundur. Bile edhe bashkëpunimi ndërmjet tyre duket i pamundur. Një argument i gjallë për këtë është shembulli i Palestinës. Lëre bashkimin e feve të ndryshme, për momentin i pamundur është jo vetëm bashkimi i feve të ndryshme, por edhe bashkimi/globalizimi i fraksioneve brenda një feje.<sup>131</sup>

Nëse do të bënim një krahasim, ndërmjet globalizmit dhe islamit, apo në qoftë se globalizmit do t'i bënim një vështrim në aspektin islam, atëherë do të thoshim me sa vijon:

- Islami si fe origjinale, hyjnore dhe universale nuk njih “ne” dhe “ata”, gjegjësisht qendër - periferi, një vend të vetëm (single place), apo vetëm Lindje ose vetëm Perëndim, siç është rasti me kulturën dominuese në procesin e globalizimit, sipas së cilës, Perëndimi dhe Amerika Veriore janë qendra e botës, kurse të gjitha rajonet e tjera paraqesin periferinë e kësaj fuqie kryesore. Por, islami thotë: “*Të Allahut janë edhe Lindja, edhe Perëndimi; ngado që të kthehemi atje është ana e Allahut.*” (Bakare, 115). Qendra e kozmologjisë

---

<sup>130</sup> Ali Yaşar Sarıbay, “Küreselleşme, Postmodern Uluslaşma Ve İslam”, *Küreselleşme, Sivil Toplum Ve İslam*, (ed.) E. Fuat Keyman dhe A. Yaşar Sarıbay, Vadi Yayınları, pa datë, f. 24.

<sup>131</sup> Bryen S. Turner, *Orientalism, Postmodernism and Globalism*, London and New York, 1994, f. 77 - 78.



shpirtërore është sistemi i besimit dhe i vlerave kolektive, të cilat nuk njohin kurrfarë kufiri material ose gjeografik.<sup>132</sup> Këtu mund të përmendet rasti i Tarik Ibn Zijadit i cili kur kaloi në tokat e Spanjës, i dogji anijet, sepse ishte i bindur se nuk kishte shkelur në tokë të huaj meqë e gjithë toka është e Allahut, falja e Hz. Omerit në shkallët e kishës e jo brenda saj. Është me rëndësi të theksohet sidomos fakti që myslimanët, kudo që kanë shkuar, nuk e kanë shkatërruar kulturën vendëse, as e kanë plaçkitur, por atë vend e kanë ndihmuar, e kanë rrizhvuilluar dhe aty kanë mbjellë një traditë të mirë.

Një aspekt tjetër i vëzhgimit kritik islamik për globalizmin është përparësia që ky i fundit u jep disa individëve ndaj të tjerëve. Islami mohon teorinë se, një grup njerëzish apo individësh, klasa apo kombe duhet të sundojnë me njerëzit e tjerë, se janë më të privilegjuar në krahasim me të tjerët. Ai mohon, po kështu misionin e njeriut të bardhë, popullin e zgjedhur, siç është me hebraizmin, krishterimin, në sistemin e kastave në induizëm etj. Së këtejmi, bie poshtë edhe teoria e globalizimit të ekonomisë, politikës dhe kulturës lokale. Në Kur'an thuhet:

*“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s’ka dyshim se tek Allahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat), e Allahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë”.* (Huxhurat, 13)

Duke mos qenë i gatshëm të pajtohet me një sistem siç është laicizmi<sup>133</sup> (edhe një dobësi e globalizmit), islami dëshiron që për momentin të mbrojë botën nga një plagë etike që ende kullon gjak, dhe të pengojë hapjen e plagëve të reja të asaj kategorie në të ardhmen. Allahu xh. sh., thotë:

---

<sup>132</sup> Davutogllu, f. 52.

<sup>133</sup> Më gjerësisht për laicizmin shih, Urs Altermatt, *Etnonacionalizmi në Evropë*, Tiranë: Phoenix 2002, f. 109.



*“O ju që besuat, s’ka dyshim se vera, bixhozi, idhujt, hedhja e shigjetës (për fall) janë vepra të ndyta nga shejtani. Pra, largohuni prej tyre që të jeni të shpëtuar. Shejtani nuk dëshiron tjetër, përveç se nëpërmjet verës dhe bixhozit të hedhë armiqësi mes jush, t’ju pengojë nga të përmendurit Zotin dhe t’ju largojë nga namazi. Pra, a po i jepni fund (alkoolit e bixhozit)?” (Maide, 90 - 91)*

*“... kush e mbyt një njeri (pa të drejtë), pa pasë mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa pasë bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si t’i kishte mbytur të gjithë njerëzit. E kush e ngjall (bëhet shkak që ai të jetë i gjallë) është si t’i kishte ngjallur (shpëtuar) të gjithë njerëzit...” (Maide, 32).*

Ndërkaq sa për fenë globale, gjegjësisht globalizimin e “feve qiellore”, e ka kërkuar islami këtë që në fillim, jo që një fe të dominojë mbi tjetrën, por që çdo fe t’i kthehet burimit të vet, për të arritur kështu në origjinën e vërtetë, që ka qenë fe e vërtetë e hz. Ibrahimit. Prandaj, në një ajet Kur’anor, thuhet:

*“Thuaj (o i dërguar): “O ithtarë të librit (Tevrat e Inxhil), ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: Të mos adhurojmë, pos Allahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos konsiderojmë njërit - tjetrin zotër pos Allahut!” E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: “Dëshmoni pra, se ne jemi myslimanë (besuam një Zot)” (Ali Imran, 64).*

Në fund, duke qenë se titulli i këtij shkrimi modest është “Globalizmi - në dobi apo në dëm të njeriut”, do të kisha theksuar se, me sa duket dhe me sa shohim, dëmi i procesit të quajtur globalizëm apo glocalizëm është duke rënduar, por shpresojmë që ai do të marrë të mbarën drejt dobisë njerëzore. Tani për tani nuk mund të shohim simptome të tilla. Prandaj, do ta kisha përmbyllur me fjalën popullore, e cila flet për situatën aktuale më shumë sesa një shkrim shumë më i gjatë se ky:

*“Katundi që duket s’do kallauz!”.*

## Agjërimi në islam dhe në fetë e tjera

*“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm”.* (Bakara, 183)

Agjërimi është një urë shpirtërore që e lidh krijesën me Krijuesin, pra njeriun me Zotin. Kjo lidhshmëri nuk është e re; ajo daton që me krijimin e njeriut të parë dhe ka vazhduar në mënyrë permanente edhe te popujt e mëvonshëm, gjë të cilën e vërteton edhe dërgimi i një numri të madh të peygamberëve nga ana e Allahu xh.sh. Kur kemi parasysh se agjërimi është çështje parësore e një besimi, që zë vend në pesë kushtet themelore të islamit dhe se, gjithashtu, është çështje thelbësore edhe e feve të tjera në përgjithësi, qofshin ato fe të shpallura, nacionale apo primitive, atëherë këtë e kuptojmë edhe si argument të fortë për të vërtetuar ekzistimin e agjërimit edhe te popujt para Muhamedit a.s. Këtë e vërteton edhe vetë Kur’ani Kerimi: *“... agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush...”*. (Bakara, 183). Këtë e vërteton edhe ajeti tjetër Kur’anor, i cili tregon për agjërimin e Musait a.s., kur ai, para se të pranonte shpalljen u obligua nga ana e Zotit të agjëronte tridhjetë net e pastaj atë e plotësoi edhe me dhjetë net të tjera: *“Dhe ne i caktuam Musait tridhjetë net (afatin për shpallje), dhe ato i plotësuam edhe me dhjetë dhe kështu u mbush afati për takim me Zotin e tij në katërdhjetë net...”* (A’raf, 142).



Në lidhje me ajetin e parë bëhet një komentim: agjërimi u është bërë obligim, farz juve sikundër që u është bërë peygamberëve dhe ummeteve para jush. Mos mendoni se agjërimi është i vështirë vetëm për ju, por ai është një ligj hyjnor që praktikohet që prej shumë kohësh. Njerëzit kanë shumë nevojë të edukohen me agjërim dhe në momentin e praktikimit të tij kanë dobi të panumërta.<sup>134</sup>

Ndërkaq, në lidhje me ajetin e dytë, bëhen disa shpjegime, sipas të cilave, Musai, duke qenë ende në Egjipt, i ka premtuar popullit të vet (Bijve të Izraelit) se, kur Allahu do ta shkatërroj armikun (Faraonin), atyre nga ana e Allahut do t'u dërgohet një libër sqarues, me të cilin nuk do të humbin dhe nuk do të devijojnë. Kur Faraoni u shkatërrua, Musai e kërkoi nga Zoti librin e premtuar. Si fazë përgatitore për të pranuar shpalljen, Musain Zoti e urdhëroi të agjëronte tridhjetë ditët/netët e muajt Dhul Kade. Ndërkaq, Musai, me t'i mbushur tridhjetë ditë, e prishi agjërimin, me mendje se, duke qenë agjërueshëm, do t'i vinte erë gojës së tij. Për këtë Allahu i shpalli duke i thënë se aroma e gojës së agjëruesit për Mua është më e mirë se era e mishkut (miskut). Dhe kështu Musain e urdhëroi që t'i shtonte edhe dhjetë ditë/net të muajit Dhul Hixhe.<sup>135</sup>

Në lidhje me përdorimin e shprehjes “*lejleten*” (net) në ajetin e lartpërmendur, komentuesit janë të mendimit se muaji fillon me natën dhe duke llogaritur dyzet net plotësohet ajo që porositet të realizojë Musai. Shpalljet janë realizuar edhe ato natën, kurse suksesi i plotë është arritur rreth mëngjesit. Kështu, sikur numri dyzet, në brengën e Musait, paraqet një natë të tërë, kurse shtimi i dhjetë ditë-

---

<sup>134</sup> Elmalılı M. Hamdi Yazır, *Hak Dini Kur'an Dili*, V. 5, Stamboll, f.493.

<sup>135</sup> Muhammed Ali es - Sabuni, *Safet et - Tefasir*, V. 1, Dersaadet, Stamboll, f. 469.



ve të agjërimit paraqet kohën e përfundimit të natës, kohë gjatë së cilës Musai ka biseduar me Allahun.<sup>136</sup>

Përveç këtyre që i përmendëm më sipër, si argument për ekzistimin e agjërimit është edhe agjërimi i pejgamberëve të mëparshëm. Nuhi a.s. ka agjëruar tërë vitin, Davudi a.s. ka agjëruar një ditë po e një ditë jo, Ibrahimimi a.s. ka agjëruar tri ditët e para të çdo muaji, kurse Isai a.s. ka agjëruar dyzet ditë.<sup>137</sup> Kështu që, nëse do t'u hudhnim një vështrim feve që sot ende ekzistojnë, bile edhe feve për të cilat besohet se nuk kanë më gjurmë, do të shihnim se adhurimi, gjegjësisht agjërimi, haset në pjesën më të madhe të tyre. Në budizëm agjërimi zë një vend të rëndësishëm; sipas themeluesit të budizmit, Budhhas, nuk duhet as të lidhemi me botën e as ta braktisim atë. Metoda të vetme për të arritur qëllimin e shprehur më lart Budhha zgjedh agjërimin një herë në çdo dy muaj dhe gjatë këtij agjërimi të bëhet rrëfimi i mëkateve të bëra. Sipas tij, pengesë për arritjen e shpëtimit të përhershëm, gjegjësisht për arritjen në Nirvana, janë dëshirat/epshet. Ndërkaq shpëtimi mund të arrihet vetëm me braktisjen e dëshirave dhe kjo arrihet me anë të agjërimit.<sup>138</sup>

Edhe në fetë indiane në Azinë Jugore, agjërimi pranohet si një mjet i rreptë edukimi. Në brahmanizëm është traditë agjërimi i ditës së 11 - të dhe 12 - të të muajve të tyre lokalë. Kurse, në xhajnizëm agjërohet 40 ditë. Ndërkaq, themeluesi i xhajnizmit, Mahavira, për të torturuar veten dhe për të arritur në shkallët më të larta shpirtërore, nuk ka ngrënë mish dhe vezë. Ai ka qenë gjithmonë me dietë, kurse, siç transmetohet, deri në vdekje ka agjëruar. Edhe në hinduizëm agjërimi përdoret për të edukuar shpirtin. Agjërimi është, para se gjithash, një lloj diete dhe

---

<sup>136</sup> Yazır, vep. e cit., V.4, f.45 - 6.

<sup>137</sup> Veysel Uysal, *Psikolojik Açıdan Oruç*, Ankara 1994, f. 3 - 4.

<sup>138</sup> Uysal, vep. e cit., f.5.

realizohet në ditët e adhurimit, kurse disa ditë agjërojnë vetëm gratë. Ndërkaq, në maniheizëm agjërimi bëhet për t'iu lutur Diellit dhe Hënës se ata dërgojnë dritë. Ndër të tjera, agjërimin e hasim edhe te fetë evropiane dhe amerikane, kurse në taoizëm agjërimi luan rolin e mbrojtjes prej fitnes dhe turbullirave në kohët kaotike.<sup>139</sup>

Agjërimi është më i theksuar në fetë të cilat quhen qiellore dhe të shpallura, gjegjësisht në fetë, simpatizuesit e të cilave Kur'ani i quan Ehl - i Kitab, ku bëjnë pjesë: sabiizmi, hebraizmi, krishterimi. Por, aspekti final i agjërimi gjendet në islam.

**Agjërimi në sabiizëm;** në traditën sabiite agjërimi, zë një vend të rëndësishëm, por ai nuk është në formën e largimit prej ushqimeve dhe pijeve dhe prej marrëdhënieve seksuale. Agjërimi vlerësohet si largim prej mëkateve dhe së keqes. Në librin hyjnor të sabiitëve, në *Ginza*, rekomandohet mbajtja e agjërimit të madh, që realizohet në këtë formë: *agjërim me sy*, që nënkupton mosshikimin e të keqes dhe së ndaluarës, *agjërim me veshë*, që nënkupton mosdëgjimin e së ndaluarës, *agjërim me gojë*, që nënkupton mospërdorimin e rrenës, *agjërim me zemër*, që nënkupton largim prej mendimeve dhe qëllimeve të këqija, *agjërim me dorë*, që nënkupton mosbërjen e krimeve dhe mosvjedhjen, *agjërim me gjunjë*, që nënkupton mospërlje përpara Djallit dhe *agjërim me trup*, që nënkupton largimin prej gruas me të cilën nuk je i martuar.<sup>140</sup>

Përveç kësaj sabiitët e kohës së sotme - edhe pse lejojnë librat e tyre hyjnorë - agjërojnë duke mos ngrënë mish në disa ditë të caktuara të vitit.<sup>141</sup>

---

<sup>139</sup> Vep. e cit., f.4 - 5; Şinasi Gündüz, *Din ve İnanç Sözlüğü*, f.295.

<sup>140</sup> *Ginza*, f.18, cituar sipas Şinasi Gündüz, *Sabiiler Son Gnostikler*, Ankara 1995, f.163.

<sup>141</sup> Gündüz, *Sabiiler Son Gnostikler*, f.163.



**Agjërimi në hebraizëm;** Agjërimi në *Dhiatën e vjetër* (Tevrat) është prezent dhe urdhëron që të agjërohen disa ditë. Agjërimi i obliguar në këto ditë është për ta shuar epshin, në disa raste, siç thuhet, është për vuajtje dhe në disa raste bëhet për t'iu afruar Zotit.<sup>142</sup> Dhiata e vjetër tregon gjithashtu se Musai ka qëndruar dyzet ditë dhe dyzet net në kodrën Sina: „*Kështu Moisiu mbeti aty me Zotin dyzet ditë dhe dyzet net; nuk hëngri bukë as piu ujë. Dhe Zoti shkroi mbi pllakat fjalët e besëlidhjes, dhjetë urdhërimet*“, (Eksodi 34/28). „*Kështu Moisiu hyri në mes të resë dhe u ngjit në mal; dhe Moisiu mbeti në mal dyzet ditë dhe dyzet net*“, (Eksodi 24/18). Në vende të ndryshme të Arabisë hebrenjtë agjërojnë duke mos ngrënë asgjë pas jacie. Ata agjërojnë edhe për të përkujtuar zemërimin për periudhën babilonase (syrgjynosja e tyre në Babil). Agjërimi mbahej edhe kur ndokujt i ndodhte ndonjë problem apo kur ndonjëri dëshironte të bëhej magjistar. Këto agjërime në hebraizëm me gjithë dallimet që kanë arrijnë në 25 ditë. Përveç këtyre ditëve ka edhe agjërime lokale, të cilat mbahen për të përkujtuar brengat e tyre. Hebrenjtë kanë edhe ditë agjërimi, kur nuk hahet mishi dhe nuk pihet alkooli. Sidomos agjërimi i dhëndrit në ditën e martesës ishte një gjë e zakonshme.<sup>143</sup>

Nëse do të numëronim momentet me rëndësi historike për të cilat praktikohet agjërimi në hebraizëm do të kishim veçuar: rrethimin e Jerusalemit, okupimin e Jerusalemit, shkatërrimin e tempullit, vrasjen e mbretit Gedalja dhe 13 ditë Adar.<sup>144</sup>

Adhurimi më i madh është dita e agjërimit e quajtur *Yom - Kippur*, që fillon më 19 prill. Agjërimi mbahet që

<sup>142</sup> *Dhiata e vjetër, Eksodi 34/18; Psalmet 35/13, 69/10, 109/24; Danieli 9/3.*

<sup>143</sup> Uysal, f.6 - 7.

<sup>144</sup> Ekrem Sarıkçıoğlu, *Başlangıçtan Günümüze Dinler Tarihi*, Isparta 2000, f.249.



nga mosha dymbëdhjetë vjeç e një muaj. Ky agjërim fillon në mbrëmje dhe zgjat deri të nesërmen në mbrëmje, kohë kjo që arrin deri në 25 orë.<sup>145</sup>

**Agjërimi në krishterim;** Edhe pse jo aq i qartë - meqë dallojnë qëndrimet e Kishës Ortodokse, Kishës Katolike dhe Kishës Protestante - agjërimi në krishterim është urdhri i tretë i Kishës. Në krishterim agjërimi dhe dieta (perhizi) janë të njëjta dhe ato mbahen për të torturuar trupin në kohë të caktuar, për t'i shuar aspiratat epshore dhe për të përjetuar që në këtë botë dënimin për disa mëkate të bëra. Përgjegjësia për agjërim fillon në moshën 21 vjeçare dhe vazhdon deri në moshën 60 vjeçare. Moshë për dietën është 14 vjeçare.<sup>146</sup> Edhe në *Dhiatën e re* për agjërimitin përmenden fjalë lavdëruese dhe gjithashtu atij i jepet një rëndësi e veçantë.<sup>147</sup> Në Kishën Katolike, gjë të cilën nuk e përkrah Kisha Protestante, ka dy lloje agjërimesh: Euharist - agjërimi i falenderimit dhe Eklesiastik - agjërimi i kishës. Edhe i pagëzuari edhe pagëzori agjërojnë një apo dy ditë. Dietën Kisha Katolike e urdhëron për dy arsye: 1. për realizimin e Pendimit dhe 2. për të praktikuar dyzet ditët të cilat i ka agjëruar Jezu Krishti (Isai a.s.) para se t'ia fillonte misionit të tij. Dieta e Madhe (Careme) te latinët zgjat 6 javë, kurse te grekët 7 javë. Agjërimi dhe dieta në krishterim, në disa raste, bëhen bashkë e në disa raste ndaras dhe gjatë këtyre ditëve, në të shumtën e rasteve, nuk përdoret mishi, qumështi dhe gjalpi. Në shek. III janë bërë diskutime të ashpra për përcaktimin e ditëve të agjërimit. E megjithatë, nuk kanë mundur të arrijnë në një përfundim se kur do

---

<sup>145</sup> Uysal, f.6.

<sup>146</sup> Uysal, f.7 - 8.

<sup>147</sup> *Dhiata e re*, Mateu 4/1 - 3, 6/16 - 19, 9/4; Marku 2/19; Luka 5/33 - 38.

të mbarojë agjërimi, me këngën e gjelit, apo me zbardhjen e agimit.<sup>148</sup>

Ndërkaq, në Kishën Ortodokse ka katër periudha agjërimi në vit:

**Agjërimi i Madh (Lent)**, i cili fillon 7 javë para Pashkëve (Easter),

**Agjërimi i apostujve**, i cili fillon të hënën, 8 ditë pas Pentecost dhe përfundon më 28 qershor,

**Agjërimi në rast të marrjes së ndonjë posti**, i cili zgjat dy javë, prej 1 - 14 gusht, dhe

**Agjërimi për Krishtjindje**, i cili zgjat dyzet ditë, prej 15 nëntorit e deri më 24 dhjetor.

Përveç këtyre periudhave kryesore, janë edhe agjërimi çdo të mërkure dhe të premteje, kurse në disa manastire edhe ditën e hënë. Gjithashtu agjërohet dita e ekzaltimit të kryqit, dita e prerjes së kokës së Gjon Pagëzorit (Jahja s.a.) dhe agjërimi për hir të Epifaniusit. Gjatë këtyre ditëve nuk është i ndaluar vetëm mishi, por edhe peshku dhe të gjitha produktet e kafshëve, vera dhe yndyra.<sup>149</sup>

E gjithë kjo që përmendëm më lart tregon për prezencën e agjërimin në mesin e njerëzve që në fillim të historisë së njerëzimit. Ajo tregon, po kështu, dy gjëra me rëndësi. Së pari, se njeriut Allahu xh.sh. ia ka mësuar në vazhdimësi, prej fillimit e deri më sot, rregullat e besimit, gjegjësisht, në rastin konkret, të agjërimin. Së dyti, njerëzit janë munduar gjatë historisë ta shtrembërojnë besimin e vërtetë dhe si rezultat janë mënyrat e ndryshme të interpretimit të agjërimin. E megjithatë, një gjë është realitet i pamohueshëm - njeriu nuk ka pasur mundësi asnjëherë ta zëvendësojë agjërimin me diç tjetër, por, gjithmonë është rrotulluar rreth tij.

---

<sup>148</sup> Uysal, f.8 - 9.

<sup>149</sup> Timothy Ware, *The Orthodox Church*, 1963 New York, f.306.

Çështje me rëndësi është edhe ardhja e Pejgamberit të fundit, Muhamedit a.s. Edhe pse agjërimi i muajit të Ramazanit është bërë farz në vitin 624, apo në vitin II të hixhrit, Muhamedi a.s. ka agjëruar edhe para se agjërimi t'i bëhet obligim dhe i ka urdhëruar sahabet që edhe ata të agjërojnë. Sipas transmetimeve, Pejgamberi a.s. ka agjëruar ditën e dhjetë të muajit Muharrem, ditë e cila përkon historikisht me agjërimin e Nuhit a.s., i cili ka agjëruar për hir të Tufanit. Muhamedi a.s. ka agjëruar edhe tri ditë në fillim të çdo muaji, që përkon me agjërimin e Ibrahimit a.s.

Duke përfunduar mund të themi se edhe ajeti 183 i sures Bakara: “... *agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush,...*”, por edhe vetë praktika e Pejgamberit a.s. dëshmojnë se islami dhe rregullat e tij janë një vazhdimësi e shpalljes së Allahut xh.sh., se islami nuk është assesi një fe e re dhe se rregullat e tij nuk janë rregulla të reja, të shpikura më vonë, porse ato paraqesin aspektin e tyre të përsosur.



## Themelimi i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare (KOASH) dhe Kisha Ortodokse Greke

Përhapja e krishterimit, historia e të cilit fillon me Jezu Krishtin (Isain)<sup>150</sup>, në Illyrricum të Ballkanit, ku jetonin shqiptarët, sipas burimeve të tij, ka filluar që në shekullin e parë, në kohën e apostujve.<sup>151</sup> Ekzistencën e krishterimit në këto troje e argumenton udhëtimi i Palit në Illyrricum<sup>152</sup> dhe prezenca e shën Astit si peshkop i Dyrrahiumit, njërit nga tre peshkopët të cilët i përmend historiani i njohur, Farlati, në shkrimin e tij “*Illyrricum Sacrum*”.<sup>153</sup> Supozohet se krishterimi në Shqipëri është

---

<sup>150</sup> Fjalët krishterim, Jezu (Jisu) Krisht apo kishë kanë lindur shumë më vonë sesa pretendohet, pasi në fillim kanë qenë të njohur vetëm ithtarët e Isait, ashtu sikur i përmend Zoti në Kur'an. Ndërkaq fjalët e lartëpërmendura fillojnë të përdoren vetëm nga fundi i shekullit I, të e.s. (Shih, Şinasi Gündüz, *Din ve İnanç Sözlüğü*, Vadi Yayınları, Ankara 1998, f. 169.

<sup>151</sup> Zef Mirdita, *Gjashtë shekujt e parë të krishtenizmit në trevat iliro - shqiptare, krishterimi ndër shqiptarë, simpozium ndërkombëtar Tiranë 16 - 19 Nëntor 1999*, Shkodër: Phoenix 2000, f. 37 - 39; Gjergji Gusho, *Mbi përhapjen e krishterimit dhe të kishave në rrethin e Pogradecit*, Pogradec: D.I.J.A., Pogradec 2000, f. 12.

<sup>152</sup> *Vëprat e apostujve*, 16: 12, 17: 1; *I. Timoteu*, 4: 10; Gjithashtu shih, Arhi-episkop Mihail, *Nasheto Sveto Pravoslavie*, Shkup: Makedonska Pravoslavna Crkva 1996, f. 6; Roberto Moroco dela Roka, *Kombësia dhe feja në Shqipëri 1920 - 1944*, Tiranë: Elena Gjika 1994, f. 45; Edwin E. Jacques, *Shqiptarët I - Populli shqiptar nga lashtësia deri në vitin 1912*, Stamboll: Kartë e Pendë 1996, f. 209; Dhimitër Beduli, *Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë gjer në vitin 1944*, Tiranë: Kisha Ortodokse Shqiptare 1992, f. 5 - 6.

<sup>153</sup> Beduli, *ibid*, f. 7; Jacques, *ibid*, f. 213; Këtu dua të theksoj se, edhe pse të

përhapur jo nga Lindja por nga Perëndimi, pikërisht përmes - qytetit Salona.<sup>154</sup> Disa mbrojnë mendimin se krishterimi në këto vende është përhapur nëpërmjet të ushtarëve romakë me origjinë shqiptare, të cilët kanë qenë mbrojtës të ndërtesave mbretërore të Perandorisë Romake, të quajtur *praetorium*.<sup>155</sup>

Pas ndarjes së Perandorisë Romake në lindore dhe në perëndimore, Kisha e Illyrricumit ka mbetur nën sundimin e Kishës Perëndimore (Romake) dhe përparësia, që më parë i jepej Selanikut, tashmë i kaloi Romës.<sup>156</sup>

Gjithnjë sipas burimeve krishtere, një element tjetër që argumenton ekzistencën e krishterimit në Ballkan, gjegjësisht në Shqipëri që në shekullin e parë, janë nënshkrimet e 13 peshkopëve, të cilët kanë marrë pjesë në Koncilin e Nikesë. Tregohet se në mesin e peshkopëve që kanë marrë pjesë në këtë koncil kanë qenë edhe peshkopi i Shkupit, i Stobit dhe i Korfuzit. Meqë qytetet që u përmendën gjenden në Illyrricum, apo në rajonin e Epirit, ky shënim flet për ekzistencën e krishterimit në këto troje. Sipas historianit Hernack, qendra të krishterimit në Shqipëri në vitin 325 mund të numërohen Nikopoja, Buthratumi (Butrinti) dhe Korkyra.<sup>157</sup>

Edhe pse pjesa lindore e Illyrricumit në vitin 379 politikisht lidhet me Konstantinopolisin (Stambollin), kisha e

---

gjitha burimet që kam mundur t'i shikoj, tregojnë për prezencën e Krishterimit në trojet ballkanike, por, vetëm se këto burime nuk vërtetojnë se të gjithë ballkanasit kanë qenë të krishterë. Kjo do të thotë se, mendimi se të gjithë shqiptarët kanë qenë të krishterë, e më vonë me fuqi e kanë pranuar islamin, është jo i realt dhe gabim.

<sup>154</sup> Millan Shufflay, *Historija e shqiptarëve të veriut: Serbët dhe Shqiptarët*, Prishtinë: Rilindja 1968, f. 178; Jacques, f. 214.

<sup>155</sup> Jacques, f. 209.

<sup>156</sup> Sherif Delvina, *Pa pavarësi fetare nuk ka pavarësi kombëtare*, Tiranë 1998, f. 146 - 147.

<sup>157</sup> Qani Nesimi, *Arnavut Ortodoks Kilisesi*, (temë megjistrature e pabotuar), Samsun 2000, f. 22.



Illyrricumit vazhdon të mbetet me Kishën Romake. Por, Perandori Bizantin Leo III (732), me një vendim të nxjerrë nga ana e tij, i shkëputi të gjitha kishat e Illyrricumit nga Kisha Romake dhe i bashkoi me Kishën Lindore (Bizantine). Kështu, kishat në Illyricum, që nga shek. VIII, vazhdojnë të veprojnë nën patronatin e Kishës Lindore. Vetëm se, deri në këtë kohë, gjegjësisht prej shek. IV e deri në shek VIII, Illyricumi ka qenë zonë ku kundërshtoheshin, vriteshin, luftonin Roma dhe Konstantinopolisi, gjegjësisht Kisha Lindore dhe ajo Perëndimore.<sup>158</sup>

Kisha Perëndimore nuk u pajtua asnjëherë që kishat e Illyrricumit të mbeteshin nën Kishën Lindore dhe, kështu, ajo u mundua që këtë rajon ta merrte përsëri nën mbrojtjen e vet. Në këtë drejtim mund të përmendet papa Adrini I. (772 - 795), i cili, kur mori pjesë në Koncilin e Dytë të Nikesë, që njihet si Sinodi VII Ekumenik i Shenjtë, kërkoi nga patriku i Konstantinopolisit, Tarasi, që ta merrte Illyrricum, por nuk pati sukses. Papës Nikolasi I (858 - 867) që ishte më i ashpër në kërkimin e realizmit të kësaj dëshire të tyre, patriku Foti iu përgjigj duke i thënë: “Është zakon i vjetër që të drejtat kishtarë të ndryshohen pas atyre politike dhe administrative”. Kështu Illyricumi edhe më tej mbeti fetarisht nën Konstantinopolisin. Në një koncil të mbajtur (879 - 880), në kohën e patrikut Foti I, u ritheksua edhe një herë se kishat në Illyricum janë të lidhura me Kishën Lindore. Krahas të gjitha këtyre dështimeve, Kisha Romake, nuk hoqi dorë asnjëherë nga përpjekjet për marrjen e këtyre kishave nën mbrojtjen e vet. Ajo e vazhdoi prezencën e

---

<sup>158</sup> Delvina, f. 147; Beduli, f. 8 - 9; Francis Dvornik, *Konciller Tarihi: İznik'ten II Vatikan'a*, Ankara: Türk Tarih Kurumu 1990, f. 24; N. P. Alban, “Fener Patrikanesi ve Ortodoks Arnavutlar”, *Kemalism Dergisi*, n. 34, Maj 1965, f. 19; Nerkez Smajlagiq, *Leksikon Islama*, Ljubljana: Mladinska Kniga 1990, f. 27.



saj në Shqipëri me anë të Mitropolisë së Raguzës dhe Mitropolisë së Tivarit.<sup>159</sup>

Në mesin e peshkopatave (Thesulia, Bosna, Rashka, Trubunia, Bullgaria) të lidhura me Kryepeshkopatën e Ohrit<sup>160</sup>, që u themelua më 870, ishin edhe peshkopatat shqiptare. Pra, përveç peshkopatës së Dyrrahiumit, të gjitha peshkopatat e tjera shqiptare u lidhën me të.<sup>161</sup> Edhe pse Peshkopata e Dyrrahiumit mbeti një kohë e pavarur, përsëri, më 1289, u detyrua të lidhej me Kryepeshkopatën e Ohrit.<sup>162</sup> Disa thonë se edhe arbëreshët (shqiptarët katolikë) e asaj kohë kanë qenë të lidhur me Ohrin, gjegjësisht me Kishën Lindore.<sup>163</sup>

Kisha Ortodokse Shqiptare (KOSH) deri në vitet 1766 - 1767 vazhdoi të jetë nën patronatin e Kryepeshkopatës së Ohrit, në të cilën merrnin pjesë edhe sllavët dhe vllahët. Kurse më vonë, Kryepeshkopata e Ohrit dhe ajo e Pejës, me marrjen e autonomies, u lidhën me Patrikanën e Fanarit. Dhe kështu, edhe KOSH e gjeti veten nën Patrikanën e Fanarit.<sup>164</sup>

Njëri nga shkaqet e mbylljes së Kryepeshkopatës së Ohrit dhe të Pejës dhe lidhjes së tyre me Patrikanën e Fanarit është gjendja në Ballkan nën administrimin osman dhe njohja e Patrikanës nga ana e Perandorisë Osmane si qendër e ortodoksëve në përgjithësi. Disa shkrimtarë shqiptarë ortodoksë tregojnë se administrimi osman në rajon për krishterimin në përgjithësi, gjegjësisht për ortodoksizmin në veçanti, ka qenë shumë i dëmshëm. Për shembull, sipas Dhimitër Bedulit, njërit prej ideologëve të

---

<sup>159</sup> Beduli, f. 9.

<sup>160</sup> Jacques, f. 232.

<sup>161</sup> Mihail, f. 32; Jovan Belçovski, *Ohridska Arhiepiskopija*, Shkup 1997, f. 91 - 92; Beduli, f. 10.

<sup>162</sup> Beduli, f. 10.

<sup>163</sup> Delvina, f. 149

<sup>164</sup> Ibid, f. 12 - 13 dhe 149.

KOSH, në këtë kohë, gjegjësisht në kohën e Perandorisë Osmane, një numër i madh i shqiptarëve jomyslimanë e kanë braktisur vendin e tyre dhe kanë ikur në Greqi dhe në Itali. Sipas tij, kjo situatë për krishterimin në Shqipëri ka qenë një humbje e madhe.<sup>165</sup>

Mendimi i Dhimitër Bedulit se ardhja e islamit, apo ardhja e “Fesë së Re”, siç e quan ai islamin, ishte një rrezik i madh për krishterimin, është shumë gabim, sepse dihet që edhe në kohën e Muhamedit (paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të), edhe më vonë, në kohën e Shtetit Osman, të krishterët në përgjithësi dhe ortodoksët, sidomos Patrikana e Fanarit në veçanti, kanë pasur një përparësi të veçantë. Kështu, që nga ditët e para të krijimit të Shtetit Osman, të gjithë pjesëtarët e feve të tjera, e sidomos ortodoksët, kanë pasur një liri të plotë fetare.<sup>166</sup> Për këtë arsye, pretendimi se ardhja e islamit ka qenë një dëm për ortodoksët, nuk e reflekton të vërtetën. Ndërkaq, për ortodoksët Shteti Osman ka qenë një mburojë që ata i ka mbrojtur nga shkrirja në katolikë, duke e ditur se atëherë propaganda katolike e papës me të madhe është interesuar për shndërrimin e kishave ortodokse në Ballkan në kisha katolike, propagandë kjo për të cilën janë vrarë edhe një numër i madh njerëzish të pafajshëm, siç është rasti me shqiptarët, pasi kanë ndodhur gjeografikisht në mes.<sup>167</sup>

KOSH deri në shek. XX ka qenë nën Patrikanën e Fanarit, kurse më vonë, me ndikimin e elementeve etnike e ka aktualizuar dëshirën e saj për pavarësim. Është

---

<sup>165</sup>Beduli, f. 11 - 12.

<sup>166</sup>Muhamet Pirraku, “Roli i Islamit në integrimin e Shqipërisë etnike dhe të kombit shqiptar”, *Feja, kultura dhe tradita islame ndër shqiptarët, simpozium ndërkombëtar i mbajtur në Prishtinë më 15, 16, 17 tetor 1992*, Prishtinë: Bashkësia Islame e Kosovës 1995, f. 44; Surejja M. Shahin, *Fener Patrikhanesi ve Tūrkiye*, Stamboll: Otuken 1996, f. 52 - 57.

<sup>167</sup>Kasem Biçoku, *Falangat që rrezikojnë kombin shqiptar*, Tiranë 1999, f. 67.

formuar një lidhje mes pavarësisë së KOSH - it dhe vetëdijes etnike dhe pavarësisë politike. Në këtë formë merr hov edhe nacionalizmi i KOSH - it dhe kështu del në shesh për herë të parë mendimi për realizimin e ceremonive kishtare në gjuhën shqipe.<sup>168</sup>

## Aktivitetet për pavarësimin e KOSH-it

Lëvizjet për pavarësim politik në Gadishullin Ballkanik, kanë filluar në shek. XIX dhe kanë vazhduar edhe në shek. XX, pas shkatërrimit të Shtetit Osman. Si rezultat i këtyre lëvizjeve për pavarësim në Ballkan u formua një numër i madh shtetesh të reja. Natyrisht, një shtet që fiton apo e gëzon pavarësinë e tij, duhet që edhe në aspektin fetar të jetë i pavarur. Kjo është kështu sa i takon Kishës Ortodokse, meqë ajo është e nacionalizuar kudo në botë, ndërsa Kisha Katolike dhe Bashkësia Islame nuk janë të nacionalizuara. Së këtejmi, disa popuj, si serbët, bullgarët etj., kishin fituar pavarësinë nacionale edhe fetare, kurse shqiptarët ortodoksë, që jetonin në një shtet të pavarur politikisht, ishin fetarisht ende nën Patrikanën e Fanarit, gjegjësisht nën Kishën Ortodokse Greke, pasi kjo e fundit ishte zotëruese edhe në Fanar.

Aktivitetin e tyre për pavarësi shqiptarët ortodoksë e filluan jashtë Shqipërisë – në Amerikë, Rumanë dhe në Bullgari. Arsyeja kryesore e fillimit të një aktiviteti kaq të rëndësishëm jashtë atdheut konsiston në faktin që, në atë kohë (fillimi i shek. XX), në Shqipëri ishte shumë e fortë propaganda ortodokse greke dhe ajo progreke. Kjo propagandë dirigjohej derjtpërsëdrejti nga Patrikana e

---

<sup>168</sup> Beduli, f. 13.



Fanarit në Stamboll. Patrikana ishte nën ndikimin e ideologjisë heleniste dhe punonte në përputhje me qëllimet e saj. Pra, qëllimet dhe ndjenjat e tyre nacionaliste dhe ekspansioniste grekët i shprehnin nëpërmjet të ortodoksizmit. Ata mundoheshin t'i greqizonin shqiptarët me anë të mitropolitëve dhe peshkopëve grekë dhe me anë të shkollave greke. Prandaj priftërinjtë ortodoksë grekë, në vend që popullit vendës t'ia mësonin fenë, ia mësonin gjuhën dhe kulturën greke.<sup>169</sup> Këtu qëndron shkaku kryesor i luftës së ashpër ndërmjet shqiptarëve dhe grekëve. Sidomos çështjet si ajo e *Vorio Epirit*<sup>170</sup>, e kanë tendosur edhe më tepër gjendjen politike ndërmjet shqiptarëve dhe grekëve. Grekët e kanë tepruar kaq shumë sa që edhe shqiptarët ortodoksë kanë filluar ti marrin për grekë.<sup>171</sup>

Grekët, sidomos Kisha Ortodokse Greke, u mundua me mish e me shpirt ta vazhdonte politikën e helenizimit të shqiptarëve. Kjo politikë e grekëve ka filluar që nga vdekja e mbretit bizantin Vasili II (viti 1025). Pas vdekjes së Vasilit II merr fund qëndrimi tolerant i shtetit ndaj Kryepeshkopatës së Ohrit dhe fillon procesi i greqizimit/helenizimit.<sup>172</sup>

Shqiptarët janë një popull, për helenizimin e të cilit politika greke ka derdhur shumë mund. Ata që iu nën-

---

<sup>169</sup> Për këtë Samiu, kur flet për qëllimin e shqiptarëve, thotë se e para është mbrojtja territoriale e Shqipërisë, kurse e dyta është pavarësimi i Kishës Ortodokse Shqiptare:

*E dyta është kisha; të shpëtohenë shqiptarët nga xyjedha e priftërisë së greqet, të bullgarët e të serbëve e të kenë kishën' e tyre me priftër shqiptarë e me ungjill shqip; se Krishti s'ish as grek as shqah.* (Sami Frashëri, *Shqipëria ç'ka qenë ç'është e ç'do të bëhetë*, *Veptra - 2*, Tiranë: Instituti Historik 1988, f. 67.

<sup>170</sup> *Vorio Epiri*, të cilin Greqia me politikën e saj ekspansioniste dëshiron ta uzurpojë, përbën pjesën e Jugut të Shqipërisë

<sup>171</sup> Kaliopi Naska, *Kongresi Themeltar i Kishës Ortodokse Autoqefale në Berat, 70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare, simpozium Tiranë 19 shtator 1992*, Tiranë: Instituti Historik 1993, f. 10; Sherif Delvina, *Tentativë e pasuksesshme dhunë fetare, Rreth përhapjes së Islamit ndër shqiptarët*, (ed. Muhiddin Ahmeti), Shkodër 1997, f. 57; Moroco dela Roka, f. 47 - 48..

<sup>172</sup> Mihail, f. 32.

shtruan politikës helenizuese të Fanarit, më vonë, në shek. XIX, u ndeshën me terrorizmin nacional grek, i cili të gjithë popujt ortodoksë i quante grekë. Sipas politikës së Athinës, e cila nga fillimi i shek. XIX u nda nga politika globale osmane, Shqipëria Jugore llogaritej pjesë e Greqisë për shkak se populli i këtij rajoni, në një pjesë, ishte me përkatësi fetare ortodokse. Për më tepër, politika ekstreme greke siç kemi theksuar më lart, të gjithë shqiptarët ortodoksë i merrote për grekë. Shkollat greke në Shqipëri furnizoheshin me plan programe, me kuadro dhe me libra shkollorë të shtetit të ri helen. Historia dhe letërsia që mësohej nëpër këto shkolla ishin përplot urrejtje kundër myslimanëve, gjegjësisht kundër shqiptarëve myslimanë. Politika ortodokse greke vetëm shqiptarët myslimanë i merrote për shqiptarë, duke i quajtur “*turkoalvano*” (shqiptarë turq). Ndërkaq, ekzistencës së shqiptarëve katolikë në veriun e Shqipërisë, duke qenë këta shumë larg kufirit me Greqinë, politika ortodokse greke nuk i jepte shumë rëndësi.<sup>173</sup>

Nëse do të shprehemi shkurtimisht, shkaku i fillimit të aktivitetit për pavarësimin e KOSH - it jashtë atdheut nga ana e shqiptarëve ortodoksë, është startimi i procesit të ortodoksizimit/helenizimit në shek. XIX dhe XX.<sup>174</sup>

## **A. Shpallja e autoqefalitetit të KOSH në Amerikë dhe gjendja e saj në shtetet e tjera**

KOSH - in shqiptarët, gjegjësisht shqiptarët e diasporës, e formuan për herë të parë në Amerikë. Liturgjia

---

<sup>173</sup> Moroco dela Roka, f. 47 - 48.

<sup>174</sup> Kasem Biçoku, *Falangat që rrezikojnë kombin shqiptar*, *Gazeta Albania*, 15 Nëntor 1998, f. 7; Ramiz Zekaj, *Politika antifetare dhe pasojat e saj mbi kulturën islame gjatë shek. XX*, *Revista Ftesa*, n. 4, Tetor 1999, f. 11 - 13.



e parë në gjuhën shqipe u realizua më 22 mars 1908 në qytetin e Bostonit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shkakku kryesor i këtij zhvillimi në Amerikë është shpallja për heretik e një të riu shqiptar ortodoks nga ana e kishës greke, me pretekst se është “shqiptar nationalist”, vdekur në Hadson më 1907, dhe refuzimi i realizimit të ceremonisë fetare për të vdekurin në fjalë nga ana e klerikëve ortodoksë grekë. Për këtë arsye shqiptarët morën hov për një rekonstrukcion fetar dhe për përgatitjen e priftërinjve shqiptarë. Pas një kohe të shkurtër, peshkopi rus në Nju Jork, Platoni emëroi klerikun shqiptar Fan Stilian Noli për prift. Noli, i cili më 8 mars 1908 u shpall peshkop, u dërgua, me vendimin e Sinodit të Kishës Ruse, në Boston si prift. Më 22 të të njëjtit muaj, ditën e diel, në Knight Hall të Bostonit mbahet ceremonia/rituali i parë fetar në gjuhën shqipe. Këtë ritual shqiptarët e pritën me një gëzim të veçantë. Në të njëjtën ditë në Foenix Hall të Bostonit u themelua edhe kisha e parë shqiptare e quajtur *Kisha e Shën Gjergjit*. Nga kjo kohë, Fan Noli, i cili ishte zgjedhur si prift i ri, me shkrimet dhe përkthimet e bëra në gjuhën shqipe nga ana e tij, ndihmoi mjaft në zhvillimin dhe në përparimin e Kishës Ortodokse Shqiptare.<sup>175</sup>

Noli, i cili u emërua prift në kishën e formuar në Boston e vazhdoi aktivitetin e tij duke përkthyer libra fetarë dhe duke i vizituar shqiptarët e Shqipërisë dhe të diasporës gjatë viteve 1913 - 1914. Në muajin tetor të viti 1918 në Nju Jork, kryepeshkopi rus Aleksandri e shpalli Nolin arkimandrit. Më vonë, më 28 - 29 shkurt të vitit 1919, në mbledhjen e të gjithë laikëve dhe të klerikëve shqiptarë në Amerikë, të mbajtur në Boston, ku morën pjesë edhe priftërinj nga Bullgaria, Rusia, Rumania dhe nga Siria, Noli u shpall kandidat për (krye) peshkop të

---

<sup>175</sup> Moroco dela Roka, f. 49; Beduli, f. 17 - 18.



KOSH - it. Por, që një njeri të shpallet peshkop duhet të emërohet nga ndonjë kryepeshkop tjetër. Në këtë rast u mendua që emërimi i Nolit për peshkop të bëhet nga ana e kryepeshkopit rus, Aleksandrit. Por meqë për shkak të lidhjeve të dobëta kjo dëshirë nuk mundi të realizohej. Noli, jashtë traditës së kishës, vendosi të vetëshpallej për (krye)peshkop. Në mbledhjen e dytë gjenerale të mbajtur më 26 korrik të të njëjtit vit, pavarësia e KOSH - it në Amerikë tashmë ishte shpallur, kurse Noli ishte zgjedhur për kryepeshkop të KOSH - it. Shkrimet, përkthimet si dhe predikimet e Nolit në mesin e shqiptarëve, krahas luftës politike në atë kohë, bënë përgatitje edhe për një reformim fetar (ortodoks) në Shqipëri. Ky rizgjim shpirtëror, që filloi në Amerikë, ndikoi edhe në Shqipëri, ku u krijua një mbështetje shumë e fortë për luftën që bëhej për të drejtën e KOSH - it.<sup>176</sup>

Lëvizja e shqiptarëve ortodoksë të diasporës për pavarësinë e kishës, vazhdoi edhe jashtë Amerikës, në Rusi dhe në Rumani. Për shembull, Harallamb Kristo Koçi me origjinë shqiptare, i cili kishte mbaruar Seminarin Odesa dhe ishte regjistruar në Universitetin e Peterburgut, pas vizitës në Epir, Maqedoni dhe në Shqipëri më 1894, u mundua përmes mediave ruse të ngrinte zërin, në njërën anë për pavarësimin politik të Shqipërisë, kurse në anën tjetër për ekzistimin e një kishe ortodokse shqiptare dhe për një patrik të pavarur shqiptar. Kështu që, më 1907 në Bukuresht të Rumanisë, pas një përpjekjeje shumë të madhe, u caktua një kishë ortodokse shqiptare ku ritualet, ceremonitë dhe predikimet fetare do të mund të bëheshin në gjuhën shqipe. Harallamb Callamani nga Berati, i cili nga ana e Patrikanës së Fanarit ishte emëruar për prift në kishën greke të quajtur Brailas, u thirr që të shërbente si prift në kishën shqiptare në

---

<sup>176</sup> Beduli, f. 17 - 19.

Bukuresht. Këtë thirrje të shqiptarëve Callamani e pranoi me gjithë zemër. Kur prifti arriti në Bukuresht, ai kërkoi menjëherë që administratorët e qytetit t'u jepnin shqiptarëve ortodoksë një kishë. Kështu, mitropoliti i Bukureshtit u dhuroi shqiptarëve ortodoksë një vend qendror, të quajtur Shën Gjergji, vend ky i bukur dhe historik. Callamani, bëri në këtë kishë për herë të parë një ceremoni fetare në gjuhën shqipe, me anë të shkrimeve dhe përkthimeve të bëra nga Noli.<sup>177</sup>

Disa shqiptarë ortodoksë në Shqipëri, nën ndikimin e autoriteteve të Athinës dhe të Fanarit, u munduan t'i pengonin këto lëvizje reformuese, por nuk ia dolën të shqiptarët e diasporës në Amerikë, Rumani, Egjipt etj. Diaspora ishte më e përshtatshme për organizime të këtilla. Por, këto veprime në Shqipëri ishin shumë të vështira, sepse feja dhe kultura greke kishin depërtuar thellë në besimin dhe në kulturën ortodokse në Shqipëri. Buri mi kryesor i kësaj politike asimiluese fetare ishte Fanari, i cili vepronte nën ndikimin e politikës fetare ekspansioniste greke. Patrikanës së Fanarit, që ishte pengesa kryesore e pavarësisë kombëtare të shumë popujve, duhej t'i nënshtroheshin të gjitha kishat ortodokse, përfshirë këtu edhe KOSH - i. Patriotët shqiptarë ortodoksë të diasporës bashkë me shqiptarët e tjerë patriotë (myslimanët dhe katolikët), të cilët punonin për pavarësinë e Shqipërisë dhe mbronin mendimin se, për pavarësimin e shtetit ishte i nevojshëm edhe pavarësimi në aspektin fetar, u morën vesh se rrugë e vetme e shpëtimit nga ndikimi i politikës greke ishte pavarësia e KOSH - it.<sup>178</sup>

Në anën tjetër, Patrikana e Fanarit nuk ishte vetëm kundër shqiptarëve dhe popujve të tjerë të Ballkanit, ajo ishte

---

<sup>177</sup> Beduli, f. 19 - 20.

<sup>178</sup> Moroco dela Roka, f. 48 - 49.



dhe kundër tërë Perëndimit, prandaj mbillte urrejtje dhe armiqësi të bashkëfetarët e vet kundër gjithë të tjerëve.<sup>179</sup>

Fillimisht këtë qëndrim të Patrikanës së Fanarit, autoritetet kishtare në Shqipëri nuk e morën me seriozitet. Por, status quo - ja nisi të ndryshonte me kthimin e shqiptarëve ortodoksë nga diaspora dhe me këmbënguljen e tyre që ritualet fetare të kryhen në gjuhën shqipe. Pas kësaj filluan të merren masa kundër atyre që i shpërndanin librat dhe përkthimet e Nolit në popull dhe kundër atyre që dëshironin ta lexonin Biblën në gjuhën shqipe. Për shembull, u morën masa për ata që ishin kundër Kishës Ortodokse Greke të mos bëhej ceremoni fetare dhe që këto botëkuptime të mos pranoheshin në administrimin e kishës. Por, të gjitha këto masa nuk ia dolën të ndalin lëvizjen për pavarësi; përkundrazi, ajo u forcua edhe më tepër.<sup>180</sup>

## **B. Aksioni për pavarësimin e KOSH - it në Shqipëri**

Vatra e parë e përhapjes së mendimit të Nolit për pavarësimin e KOSH - it në Shqipëri ishte qyteti i Korçës. Korça ishte qyteti më i përshtatshëm për lëvizjen e pavarësisë së kishës, me vetë faktin që ishte qendra e ortodoksëve në Shqipëri. Prej vitit 1914 e deri më 1922, Noli dhe shokët e tij kishin vazhduar edhe në Shqipëri lëvizjen për pavarësimin e kishës. Aktiviteti për pavarësi mori hovin më të madh sidomos në vitet 1921 - 1922, duke qenë se kjo kohë, në aspektin politik, ishte koha më e përshtatshme. Në Konferencën e mbajtur në Londër, më 1921, u mor vendim që kufijtë shqiptaro - serbë të mos ndërroreshin dhe se ishte e domosdoshme të respektoheshin vendimet e Protokollit të Firencës të 17

---

<sup>179</sup> Delvina, *Tentativë e pasuksesshme dhunë fetare*, f. 151.

<sup>180</sup> Beduli, f. 20 - 21.



dhjetorit 1913. Ky ishte një faktor shumë me rëndësi për pavarësimin e KOSH - it. Një çështje tjetër me rëndësi, që duhet të përmendet këtu, është vendimi i Qeverisë Shqiptare, se në Shqipëri nuk mund të bëhet kryepeshkop një i huaj. Qyteti i parë për realizimin e këtij vendimi, që i dha lëvizjes për pavarësim një motivacion të madh, u zgjodh, po kështu, Korça.<sup>181</sup>

Në fund të këtyre përpjekjeve disa kisha ortodokse kishin kaluar në duart e shqiptarëve ortodoksë, si p.sh. kishat në Vlorë dhe në Pogradec, kisha e Shën Gjergjit në Korçë, në të cilat ceremonitë, ritualet dhe predikimet fetare bëheshin në gjuhën shqipe. Gradualisht çështja e pavarësimin të kishës doli në rendin e parë dhe lindi ideja për themelimin e kishës ortodokse shqiptare (si autoqefale). Këto kisha të pavarura ortodokse shqiptare e penguan shumë depërtimin e politikës greke në politikën shqiptare dhe në jetën ortodokse në Shqipëri.<sup>182</sup> Noli bashkë me priftërinjtë e tjerë, si Vasil Marku dhe Vangjel Çamçe, u dhanë përkrahje të madhe atyre që punonin për pavarësimin e shtetit dhe të kishës, për realizimin e këtyre aspiratave me sukses. Sikundër është theksuar edhe në gazetën "*Posta e Korçës*", ardhja e Nolit ndikoi për rizgjimimin e popullit ortodoks të Korçës nga një gjumë i thellë, i cili iu ishte imponuar atyre me anë të propagandave të ndryshme të realizuar në emër të Jisu<sup>183</sup> Krishtit.<sup>184</sup>

Më 21 nëntor 1923, në Katedralën Shën Gjergji të qytetit të Korçës, Fan Noli u shenjtërua/pagëzua nga ana e priftërinjve Jerotheu dhe Kristofori. Noli, të njëjtën ditë, u zgjodh edhe mitropolit i Durrësit (Dyrrahiumit), i cili ishte qendra e shqiptarëve ortodoksë, kurse

---

<sup>181</sup> Naska, f. 11.

<sup>182</sup> Ibid.

<sup>183</sup> Shqiptarët ortodoksë përdorin fjalën Jisu, kurse shqiptarët katolikë fjalën Jezu.

<sup>184</sup> Ibid.

më vonë do të luajë rolin e kryeqytetit të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Pas këtyre ngjarjeve Noli mori titullin, “*Mitropoliti i Durrësit, i Gorës dhe i Shpatit, kryepeshkop dhe ekzark i Illyricumit, detit perëndimor dhe i tërë Shqipërisë*”.<sup>185</sup>

Shpallja në këtë mënyrë e autoqefalitetit të KOSH-it, kishte edhe avantazhe të ndryshme politike për Tiranën zyrtare. Sepse, me këto zhvillime, u zhduk edhe ndikimi grek në jetën ditore politike të shtetit. Shpallja ishte edhe një grusht kundër ambicieve greke për okupimin e Shqipërisë Jugore. Pas kësaj, disa peshkopë grekë dhe disa persona që njiheshin si filogrekë, për shkak të qëndrimeve të tyre kundër popullit shqiptar, më 1921 u përzuënë nga Shqipëria.<sup>186</sup>

Mund të themi se ata që hodhën hapat e parë për pavarësimin e KOSH-it dhe që me përpjekjet e tyre që më herët përgatitën rrethanat në të cilat Noli mund të realizonte këtë pavarësi të kishës janë: Ieronomah Kosti (1800) nga Berati, Theodor Haxhi Filipi (Dhaskal Todri) (1803) nga Elbasani, Naum Veqilharxhi (1845) nga Bredha e Vithkuqit, Grigor Argjirokastriti (1824) peshkop në Eube, Kostandin Kristoforidhi (1860 - 1895) nga Elbasani dhe Papa Kristo Negovani (1875 - 1905), që njihëj edhe si trim i shqiptarëve ortodoksë.<sup>187</sup>

---

<sup>185</sup> Delvina, *Tentativë e pasuksesshme dhunë fetare*, f. 4.

<sup>186</sup> Moroco dela Roka, f. 52.

<sup>187</sup> Beduli, f. 13 - 15.

## Krishterimi 2000, pse?\*

*“E gjithë Evropa mesjetare hiqte “dhimbjet e rritjes” dhe toleranca fetare s’është veçse një shpikje e ditëve tona.”*

(Edith Durham, **Brenga e Ballkanit**, Tiranë: Naum Veqilharxhi 1998, f.11)

Ditëve tona po dëgjojmë se në vendet myslimane dhe evropiane, po bile edhe në mjedise më të ngushta, si ato shqiptare, po mbahen simpoziume me karakter të përgjithshëm, e në veçanti me karakter fetar. Vëmendje zgjojnë sidomos simpoziumet në lidhje me krishterimin. Ndërkaq, këto simpoziume për krishterimin njihen më tepër me emrin „Krishterimi 2000“, apo „2000 vjetori i krishterimit“ etj. Me këto shprehje synohet të tregohet para auditoriumit shqiptar se kur ka lindur krishterimi dhe sa i lashtë është ai (bile, sipas disa intelektualëve shqiptarë, edhe si fe më e vjetër e shqiptarëve). Nërkaq, me rëndësi është që në mesin e këtyre rreshtave të kuptohet edhe ajo që fshihet, apo, me një fjalë, ajo që dëshirohet të tregohet, që është synimi kryesor i organizatorëve. Ky emërtim i simpoziumeve përdoret vetëm si mjet për t’ia arritur qëllimit të caktuar, e qëllim i caktuar në këtë rast është të vihen në dijeni të tjerët, e në veçanti shqiptarët, se krishterimi është fe e vjetër, „më e vjetër“ se islami, fe e vetme „origjinale“, e sidomos fe „origjinale“ e shqipta-

---

\* Teksti është shkruar në fillim të vitit 2001



rëve. Por, përveç kësaj, bëhet propagandë se kjo fe është fe e tolerancës, e paqes, e respektimit... etj. Megjithatë, që të jemi më të qartë për sa duam të themi, le t'i kthehemi historikut të shkurtër të krishterimit.

Po të pyesim një njeri të thjeshtë se kur ka lindur krishterimi, ai, me siguri, do të na thotë se ka lindur në shekullin e parë. Kështu mendojnë edhe shumica e të krishterëve. Ndërkaq edhe pse Jezu Krishti ka lindur dhe ka jetuar në fillim të shekullit I, (ne myslimanët e njohim si peygamber të Allahut i quajtur Isai a.s.)<sup>188</sup>, faktet historike tregojnë se Jezusi nuk e ka përhapur krishterimin, madje as që ka ekzistuar termi krishterim në kohën e tij. Ndërkaq, ithtarët e Isait janë quajtur jesuanë (isevitë), nasurajë etj.<sup>189</sup> Në anën tjetër edhe dokumentet që na flasin për Jezusin/Isain dhe për krishterimin, ndër të cilat vendin kryesor e zë Dhjata e re, nuk datojnë nga koha e Jezusit/Isait. Historikisht Dhjata e re ka filluar të shkruhet në vitet 30 - 35 pas kryqëzimit të Krishtit. Dhe Bibla (Dhjata e re) është bërë pas vdekjes së Krishtit dhe të apostujve të tij. Pas vdekjes së shumë apostujve, disa të krishterë, duke grumbulluar të dhënat në lidhje me Jezusin fillojnë përgatitjen e librit që në të ardhmen do të bëhet burim numër një i besimit të krishterë. Me këtë rast janë bërë manipulime të mëdha. Howard Kee, në lidhje me të, thotë: „Historianët e kësaj kohe nuk janë mjaftuar vetëm me transmetimin e ngjarjeve historike, por ata janë munduar që lexuesve të asaj kohe, kur janë shkruar ato, t'ua përshtatin atë që ta kuptojnë më mirë“<sup>190</sup>. Kjo tregon se Bibla aktuale nuk është libër origjinal hyjnor, porse në të ekzistojnë edhe shumë shtesa

---

<sup>188</sup> Muhammad Ata ur - Rahim, *Jesus, A Prophet of Islam*, London 1980/1981, f.19 - 40.

<sup>189</sup> Nesimi, *Arnavut Ortodoks Kilisesi*, f. 1 - 2.

<sup>190</sup> Mahmut Aydın, *Yahudi Bir Peygamberden Gentile Tanriya: İsan'ın Tanrısallaştırılma Süreci*, *İslamiyat*, V.3, Nr.4, tetor - dhjetor 2000, Ankara, f.49 - 52.

njerëzore. Ndoshta këto shtojca, në të shumtën e rasteve janë dominante. Është me rëndësi të ceket se origjinali i Biblës, të cilën e kemi ne sot, nuk është në gjuhën arameje, gjuhë në të cilën ka folur Jezusi, por në greqisht. Kjo e vë në dyshim origjinalitetin dhe autenticitetin e vetë librit, e lëre më aspektin e tij hyjnor.<sup>191</sup>

Një problem tjetër me rëndësi, që ka ekzistuar në atë kohë e paqartë sot e kësaj dite është çështja e kristologjisë, e cila duhet të shpjegojë nëse Jezusi është Bir i Zotit (Son of God), Krisht (Christ) apo është Bir i Njerëzisë (Son of Man). Këtu me rëndësi është të përmendet edhe ajo që quhet teotokos dhe antropokos. Teotokos do të thotë se Maria/Merjemeja ka lindur Zot (Jezusin zot), pra është nëna e Zotit, kurse antropokos do të thotë se Maria është nëna e njeriut (Jezusit njeri). Këto janë çështje të cilat edhe atëherë, por edhe sot, diskutohen me të madhe, e megjithatë, ende nuk janë sqaruar. Njeriu që i ka diskutuar më tepër këto çështje në krishterim dhe i cili me mendimet e tij është bërë shtylla kryesore në këtë besim, dhe është shpikësi i shumë çështjeve në krishterim, është Shën Pali (Paulus). Emri i këtij është aq me rëndësi për krishterimin sa që është bërë shumë diskutabile se kush është epiqendër e kësaj feje, Jezusi apo Pali? Kjo nxirret nga dy fjalët e Palit, me të cilat në një anë u thotë ithtarëve të vet: „*Bëhuni pra imitues të Perëndisë, si bij shumë të dashur, edhe ecni në dashuri, sikurse edhe Krishti na deshi dhe u dha veten e tij për ne, si ofert e flijim Perëndisë, si një parfum erëmirë*“ (Efesianëve, 5:1 - 2), kurse në anën tjetër i thërret njerëzit të bëhen si ai, gjegjësisht t'i ndjekin mendimet dhe rrugën e tij: „*Më imitoni mua, ashtu si unë jam imitues i Krishtit. Dhe unë po ju lavdëroj, vëllezër, që më kujtoni në të gjitha gjërat dhe i zbatoni porositë ashtu siç ua kam transmetuar*“ (I. Korintasve, 11:1 - 2), „*Ato gjëra që keni mësuar, marrë dhe dëgjuar nga*

---

<sup>191</sup> Mahmut Aydın, *Monologdan Diyaloga*, Ankara: Ankara Okulu 2001., f.53.



*mua dhe patë në mua, i bëni, dhe Perëndia i paqes do të jetë me ju“ (Filipianët, 4:9).<sup>192</sup>*

Pas gjithë kësaj, në vitin 52 të e.s., për shkak të mosmarrëveshjeve që ndodhin mes tyre, sidomos mes ithtarëve të Palit dhe ithtarëve të Isait ne krye me Jakobin, u mbajt mbledhja e parë e apostujve në Jerusalem. Por, në këtë kohë ende nuk ekzistonte Bibla; ajo doli në shesh shumë më vonë. Krishterimi mori hovin e madh në momentin kur mbreti i Perandorisë Romake me një ferman, të quajtur „Fermani i Milanos“, e shpalli krishterimin fe zyrtare. Më vonë erdhi Koncili i Nikesë (më 325), i cili ka qenë iniciativë e Konstantinit, mbretit të Perandorisë Romake. Në këtë koncil është diskutuar esenca e Jezusit. Sipas Ariusit, prift në Aleksandri, Biri (Jezusi) është *i ngjashëm* me Atin (Zotin), kurse Athanasiusi, prift në Stamboll, mbron mendimin se Biri është *i njëjtë* me Atin. Dhe në këtë koncil legjitimitet fiton mendimi i Athanasiusit, ndërsa Ariusi shpallet heretik. Pas këtyre koncileve mbahen dhe shumë koncile të tjera, më kryesorë ndër të cilët janë shtatë të parët, mbajtur deri në vitin 787. Këto janë koncilet të cilat Kisha Ortodokse i pranon si të vetëm dhe legjitim. Ndërkaq, Kisha Katolike vazhdon me koncilet e saj. Si koncile të fundit të Kishës Katolike njihen dy koncilet e Vatikanit, i pari i mbajtur më 1869 - 1870 dhe i dyti më 1962 - 1965.<sup>193</sup>

Është me rëndësi të ceket se kisha, përveç këtyre mosmarrëveshjeve që ka përjetuar ajo, për të ruajtur unin e saj, ka krijuar edhe vetë probleme, duke vrarë e duke masakruar njerëz. Këtu si shembull mund të përmendim Donatusin, gjegjësisht donatizmin, të themeluar

---

<sup>192</sup> Më gjerësisht shih, Şinasi Gündüz, *Pavlus, Hiristiynahğin Mimari*, Ankara: Ankara Okulu 2001, f.249 - 251.

<sup>193</sup> Shih, Francis Dvornik, *The Ecumenical Councils*, New York: Hawrthon Books 1961.



në fillim të shek. IV nga ana e Donatusit dhe mendimin që mbronte se Isai është njeri dhe peygamber. Por, kjo lëvizje u shua nga ana e Kishës së Palit duke bërë një gjenocid të paparë deri atëherë.<sup>194</sup> Rasti është i njëjtë edhe me Jan Hus - in (1372 - 1415), njërin prej reformistëve të krishterë. Sipas tij, duhej të ndryshonte etika, jeta dhe forma e të menduarit e priftërinjve. Dhe për këtë u dënua nga kisha dhe u dogj si heretik.<sup>195</sup> Si raste të ngjashme mund të përmenden edhe qëndrimet e kishës ndaj mendimeve të Nikolla Kopernikut, Gjordano Brunos dhe të Galile Galileut.

Në historinë e kishës është një rast shumë me rëndësi për t'u përmendur, një plagë e pashërueshme më tani, e quajtur Skizma e Madhe (1054). Kjo quhet skizma/ndarja e madhe sepse edhe përpara kësaj ka ndodhur një ndarje dhe ajo ka qenë ndarja ndërmjet *diofizitëve* (rrymë kristologjike që pretendon se në Jezu Krishtin ekzistojnë dy natyra, ajo njerëzore dhe ajo hyjnore, të pandara dhe të papërziara) dhe *monofizitëve* (rrymë kristologjike që pretendon se në Jezu Krishtin ekziston vetëm natyra hyjnore, kurse njerëzorja është zhdukur në hyjnore). Kjo ndarje e madhe (*the great schism*) është bërë për shumë arsye, kryesisht fetare. Njëra prej arsyeve fetare është arsyeja e quajtur *filioque* (edhe i biri), që do të thotë, Shpirti i Shenjtë ka dalë prej Atit edhe prej të Birit (ka edhe shumë arsye të tjera, të cilat nuk e shoh të arsyeshme të përmenden këtu). Ky është besimi i Kishës Katolike, ndërsa Kisha Ortodokse e mohon një gjë të tillë dhe thotë se Shpirti i Shenjtë ka dalë vetëm prej Atit. Për këtë ndodhi të dy kishat, edhe Lindorja edhe Perëndimorja, kanë shpallur njëra tjetrën heretike, gjegjësisht pa fe apo jo të krishterë. Kjo armiqësi ekziston

---

<sup>194</sup> Gündüz, *Din ve İnanç Sözlüğü*, f.100.

<sup>195</sup> Vep. e cit., f.175.

edhe sot e kësaj dite.<sup>196</sup> Ndërkaq, pason edhe ndarja e tretë, e njohur në historinë e krishterimit si lindja e protestantizmit, themelues i të cilit është prifti Marthin Luther - i. E gjithë kjo ka lindur për shkak se dikush ka dashur që fenë ta mbajë vetëm për të mbrojtur karrierën e tij personale apo për të bërë biznes personal.<sup>197</sup>

Është e rëndësishme të përmenden edhe kryqëzatat të organizuara nga Kisha Katolike. Kryqëzatat kanë filluar nga fundi i shek. XI, me luftën e parë të organizuar nga papa Urbani II, më 1095. Ky ka qenë momenti kur armiqësia mes myslimanëve dhe të krishterëve ka arritur kulminacionin. Gjurmët e kësaj armiqësie, të krijuar nga ana e Kishës Katolike, shihen edhe në ditët e sotme. Numri i këtyre luftërave, të bëra kundër myslimanëve, me qëllim të marrjes së Jerusalemit, ka arritur deri në tetë. Qëllimi final i tyre ka qenë fetar. Ushtarët e krishterë kanë besuar plotësisht se luftën kundër myslimanëve dhe, gjithashtu, vrasjen e tyre e bëjnë si obligim fetar. Së këtejmi ata kanë besuar se sa më shumë myslimanë që të vrasin aq më shumë sevap dhe shpëtim do të arrijnë, për të rezultuar në fund me xhenetin. Dihet se vetëm gjatë dy ditëve nga dora e kryqtarëve janë vrarë 40.000 myslimanë.<sup>198</sup>

E tash le t'i kthehemi temës për të cilën e paraqitëm këtë historik të shkurtër të krishterimit. Për momentin mund të pyesim - pse këto simpoziume për krishterimin dhe pse ato të quhen "*Krishterimi 2000*", apo "*2000 vjetori i krishterimit*"?

Nëse puna është që krishterimi të tregohet fe e tolerancës, e mirëkuptimit, e paqes etj., kisha, pavarësisht nëse fjala është për Kishën Katolike apo Ortodokse, du-

---

<sup>196</sup> Timothy Ware, *The Orthodox Church*, New York: Penguin Books 1963, f.51 - 81.

<sup>197</sup> Për këtë më gjerësisht shih, Hakan Olgun, *Luther ve Reform, Katolisizm'i Protesto*.

<sup>198</sup> Mahmut, vep. e cit. f. 44 - 47.



het së pari të përmirësoj gabimet e saj historike, duke kërkuar falje dhe duke mos i përsëritur të njëjtat veprime, qofshin ato haptazi, misionerike apo fshehurazi, misionerike, pra duke folur për dialogun kurse, në fakt, duke pasur për qëllim misionerizmin. Pa u pajtuar të dy kishat njëra me tjetrën çdo gjë është falso. Por, përveç kësaj, ajo duhet të caktojë dhe të bëjë të qartë qëndrimin e saj ndaj feve të tjera, sidomos ndaj myslimanëve. Në Koncilin e Dytë të Vatikanit Kisha Katolike, për herë të parë në historinë e vet, merr disa qëndrime ndaj mysilmanëve, gjë që është për t'u përgëzuar, por mbetet edhe shumë për t'u bërë në lidhje me këtë çështje. Bile, aty, krahas faktit se flitet për disa parime islame, ajo mundohet të mbrojë katolikocentrizmin dhe, duke dashur të flasë për dialogun, mundohet të realizojë aspektin misionerik të Kishës Katolike, gjë e cila, në vend t'i zgjidhë, i ngatërron edhe më shumë.<sup>199</sup> Ndërkaq, Kisha Ortodokse, përveç bisedave të shumta të cilat nuk kanë ndonjë peshë juridike dhe fetare për përmirësimin e kësaj status quo - je, nuk ka bërë asnjë lëvizje në drejtim të zgjidhjes së kësaj çështjeje.

Ndërsa thënia, se shqiptarët kanë fe të tyre origjinale apo më të lashtë krishterimin, nuk është aspak e vërtetë, sepse krishterimi e ka gjenezën në shekullin e parë të erës sonë, ndërsa si fe e formuar daton prej shekullit të katërt të kësaj ere. Ndërkaq, shqiptarët datojnë shumë më herët se krishterimi. Thënia se Katolicizmi është fe e parë e shqiptarëve është kaq më qesharake se e para, sepse para se gjithash ka qëllim propagandistik. Dihet se katolicizmi del për së pari herë në shesh në vitin 1054 të e.s. Por, me këtë rast, ata që zgjedhin katolicizmin për fe të parë dhe origjinale të shqiptarëve, do t'i kisha pyetur se cila ka qenë feja e shqiptarëve para katolicizmit dhe,

---

<sup>199</sup> Vep. e. cit., f.111 - 112



ata që për fe të parë dhe origjinale të shqiptarëve marrin krishterimin, do t'i kisha pyetur nëse shqiptarët apo krishterimi është më i vjetër (A nuk ka lindur krishterimi mijëra vjet pas shqiptarëve?)<sup>200</sup> Por, disa intelektualë shqiptarë, të cilët për shqiptarët e parapëlqejnë katolicizmin, do t'i kisha pyetur pse nuk e marrin maniheizmin si fe origjinale, kur dihet se para krishterimit fe dominante në Evropë ka qenë ai<sup>201</sup>. Apo, nëse në të ardhmen ndodh që katolicizmi/krishterimi (pasi feja është një dukuri subjektive e njeriut dhe nuk mund t'i imponohet atij) të ndërrohet me një besim tjetër, atëherë çfarë do të ndodh me fenë “e parë” dhe “origjinale” të shqiptarëve?

Nëse krishterimi dëshiron të zërë vendin e vet në mesin e feve të tjera, atëherë ai duhet të mësojë nga gabimet e bëra më parë, që ato të mos përsëriten më dhe të lërë misionerizmin dhe të kap dialogun me seriozitet. Përndryshe, rruga e kundërt e dëmton edhe atë si fe. Respekt ndaj të gjithë atyre që merren ose tentojnë të merren me dialog serioz.

---

<sup>200</sup> Edwin E. Jacque, *Shqiptarët I*. Stamboll: Yeni Yaşam 1996, f.3 - 39.

<sup>201</sup> Gündüz, vep. e cit., f.245.

## **Kisha Ortodokse Maqedonase (KOM), Bibla dhe paqja\***

Kur dëgjon të flitet për ndonjë fe, pa marrë parasysh se për cilën fe bëhet fjalë, çdo njeri përfytyron menjëherë në kokën e tij të mirën, të bukurën, paqen, mirësjelljen, tolerancën, respektin, lidhshmërinë e njeriut me Absoluten etj., por assesi të kundërtën, qoftë ajo islami pavarësisht nëse biseda ka të bëjë me, krishterimin, hebraizmin, budizmin, maniheizmin apo me ndonjë fe tjetër. Kjo është kështu për arsye se çdo fe mundohet që, në saje të besimit, të shpëtojë njeriun në këtë botë ose në botën e ardhshme apo edhe në këtë botë edhe në botën e ardhshme. Madje mundohet që shpëtimin e njeriut ta realizojë me anë të besimit në Allahun e Plotëfuqishëm, siç është tek myslimanët, me anë të besimit në Jezu Krishtin, siç është te të krishterët, apo me anë të Jahvesë, Nirvanasë, Brahmasë etj.

---

\* Teksti është shkruar në kohën (2001) kur pushteti maqedonas luftonte me shqiptarët, të cilët kërkonin të drejtat e tyre

## Uniteti i Kishës është uniteti i lirë i njeriut

Realitetin e pamohueshëm, të cekur më sipër, se njeriu kur mendon për fenë e përfytyron menjëherë të mirën, tolerancën, lidhshmërinë e njeriut me Absoluten etj., mund ta kuptojmë një nga aspektet e shumta të feve të ndryshme, por, ne këtu do të mundohemi që atë ta kuptojmë nga vetë kuptimi i termit kishë. Nga literatura e krishterimit do të shohim se me fjalën *kishë* kuptojmë: asamblenë e popullit të zgjedhur të Perëndisë, të thirrur për të mbajtur fjalën e Tij dhe për të realizuar punën dhe vullnetin e Tij në botë dhe në mbretërinë qiellore. Kisha në Shkrimin e Shenjtë quhet “Trupi i Krishtit”, “Tempulli i Perëndisë së Gjallë”, “Shtylla dhe Mburoja e së Vërtetës”. Sipas mësimit ortodoks të krishterë, uniteti i kishës është uniteti i lirë i njeriut në të vërtetën dhe në dashurinë e Perëndisë. Brenda unitetit të kishës, njeriu është njeri i vërtetë, është ai për çfarë u krijua të jetë dhe mund të rritet në jetën hyjnore në kungim me Perëndinë, me anë të Krishtit dhe Shpirtit të Shenjtë. (Protopresviter Thomas Hopko, *Besimi Orthodoks - Doktrina*, v.1, botoi KOASH, Tiranë 1997).

Për ta pasur më të qartë atë që do ta themi më poshtë është e nevojshme të shohim çfarë thotë Bibla për paqen, tolerancën, mirrësjelljen, dashurinë, respektin etj.

Është me rëndësi që, në fillim, të përmendet përsëritja biblike *Shalom* (Salom), e cila është një fjalë hebraike dhe ka kuptimin: paqe, mirëkuptim, përsëritje, gëzim, shpëtim, pastrim/i pa prekur, i përsosur, jetë e përsosur, përparim shpirtëror dhe material, bekim dhe paqe, mirësi dhe marrëdhënie të mira mes njerëzve: në familje, në kurorëzim dhe mes njerëzve e Zotit. Po kështu është me rëndësi të përmendet edhe fjala greke



*irini* që ka kuptimin paqe ose prehje/qetësi. (Protogjakon Ratomir Grozdanoski, “Bibliska Programa za Mir”, *Godishen Zbornik 3.*, botoi Fakulteti Teologjik “Sveti Kliment Ohridski”, Shkup 1997).

Përveç këtyre shprehjeve në lidhje me paqen, në Bibël përmenden edhe shumë shprehje të tjera. Këtu, ndër të tjera, është me rëndësi të përmendet porosia e Shën Palit drejtuar kolosianëve: “Paqja që ju jep Mesia, të caktojë mendimin dhe veprimin tuaj” (Letër kolosianëve, 3,15).

Zoti, Dhiatën e vjetër të Librit të Shenjtë e quan “Mbrotjtës të paqes” (Libri 4 - të i Moisiut, 25,12; 6,24 - 26), ndërsa këtë mbrojtje e ka realizuar Zoti Shpëtimtar Jezu Krishti i cili është “Princi (Mbreti) i paqes” (Libri i Isaijas, 9,6). Edhe kuptimi i emrit Solomon (Sulejman), do të thotë “njeri i paqes” (Libri i 3 - të. i Mbretërisë, 4,21,24 - 25).

Në Dhiatën e re Jezu Krishti paraqitet si “Zoti i paqes” (Letër romakëve, 15,33; 16,20), dhe se “Paqja është formuar me gjakun e Tij në kryq” (Letër kolosianëve, 1,20). Edhe vetë Jezu Krishti thotë: “Ju lë paqe, ju dhuroj paqen Time” (Gjoni, 14,27). Mund të përkujtojmë po kështu se “Shkrimi i Shenjtë është porosi për dashuri dhe paqe” (Mateu, 28,19).

Nga gjithë sa u përmend më lart, (edhe pse cekëm vetëm një pjesë të asaj që thuhet dhe shkruhet në lidhje me këtë çështje) kuptojmë se në burimet krishtere kemi të bëjmë me paqen, lirinë e njeriut, bashkimin e njeriut me të vërtetën etj. Nëse është kështu, atëherë nga lindi, më herët, ortodoksizimi/sllavizimi dhe ortodoksizimi/helenizimi i popullatës në Ballkan, gjegjësisht i shqiptarëve, sepse këta e pësuan më shumë nga kjo politikë sllavo - ortodokse në Ballkan? E gjithë kjo mund të themi se ka lindur nga egoizmi ekstrem dhe nga dëshira ekspansioniste sllavo - ortodokse, që ka pasur dhe që

edhe sot e ka për qëllim zhdukjen dhe shfarosjen e çdo gjëje që nuk është sllave - ortodokse. Kjo do të thotë se ata, ndër të tjera, kanë thyer edhe rregullat e fesë së tyre.

Këtë ndjenjë të nacionalizmit të vrazhdë e shohim edhe sot në Maqedoni. Por, për më tepër na habit qëndrimi përkrahës i këtij nacionalizmi ekstrem, i dëshirës asimiluese dhe aspiratave për prishjen e çdo gjëje që nuk është sllavo - maqedono - ortodokse, e Kishës Ortodokse Maqedonase (KOM).

Këtë qëndrim të KOM - it, që është në kundërshtim me burimet kryesore në të cilat bazohet besimi i saj, e vërtetojnë shumë fakte të gjalla këtu, në truallin e myslimanëve në Republikën e Maqedonisë. Këtu mund të përmendim shndërrimin e xhamisë në kishë në Shtip, vënien e kryqeve mbi sahat kullat në Manastir dhe Prilep, rrënimin e xhamisë në Ohër, dëshirën për të vënë në vende të ndryshme kryqe me madhësi jo normale, me të cilën nuk do të pajtohej ndoshta edhe vetë Krishti, apo konkretisht dëshirën e vendosjes së kryqit voluminoz në Kala të Tetovës, i cili nuk kishte qëllim fetar, por thjesht për të paraqitur këtë vend si një vend të ortodoksizuar sllavo - maqedonas. Përveç këtyre ka edhe shumë e shumë raste të tjera për të cilat nëse do të dëshironim t'i përmendim të gjitha, do të duhej të shkruhej një libër më vete, bile në disa vëllime.

## **KOM-i bën mobilizimin e klerit fetar ortodoks**

Edhe në këto ditë të krizës, KOM jo vetëm që nuk ka marrë masa për t'u përkujdesur për njeriun në përgjithësi, janë në veçanti, ashtu si e porosit Bibla, por ajo



edhe vetë, ka marrë pjesë nëse jo drejtpërsëdrejti në mënyrë indirekte në kryerjen e veprave që janë në kundërshtim me fjalën e Jezu Krishtit. Për herë të parë KOM - i e bëri këtë kur u gëzua pa masë për regjistrimin e saj në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë si fe zyrtare e kësaj Republike. Në këto çaste ajo nuk u interesua aspak se gjysmën e këtij shteti e përbëjnë myslimanët dhe se edhe këta meritojnë të bëhen hesap në këtë shtet. Por edhe në kohën e fundit, kur duhet të veprohet për zbutjen e jo për acarimin e mëtejshëm të situatës, KOM ka vepruar negativisht. Megjithëse të gjithë krerët e komuniteteve fetare në Maqedoni shkuan në Zvicër dhe atje nënshkruan marrëveshjen për paqe, KOM - i, me t'u kthyer nga Zvicra, ngul këmbë përsëri për mosndryshimin e Kushtetutës, që është gjeneratori i krizës në Maqedoni, që do të thotë se KOM ende vazhdon të jetë për destabilizimin e Maqedonisë. Këtë e vërteton edhe fakti se KOM bën mobilizimin e klerit fetar ortodoks, si dhe deklarata se katër klerikë ortodoksë i kanë zhveshur uniformat e tyre fetare dhe janë përgatitur për luftë kundër "terroristëve". Këtu është me rëndësi të përmendet edhe ajo se mitropoliti i Prespës dhe i Pellagonisë Petri (Petar), në bashkëpunim me organizatën humanitare "Samarjanin" nga Manastiri kanë formuar fond të posaçëm për "fëmijë të tretë" (fond za treto dete), nga i cili do të përfitojnë familjet që në vitin 2001 u ka lindur apo në të ardhmen do t'u lind fëmijë i tretë. Dhe kjo bëhet vetëm për ata që i takojnë nacionalitetit maqedonas. Ku është, pra, ajo paqe, njerëzi, barazi apo e vërtetë e Biblës, së cilës ai si prift obligohet t'i besojë. Çfarë logjike është kjo, që në njërën anë, siç është rasti në Manastir, digjen dyqanet, prishen shtëpitë, vriten dhe keqtrajtohen njerëzit apo dëbohen nga trojet e tyre shekullore, kurse në anën tjetër një pjesë e popullatës nxitet që të ketë fëmijën e tretë?!!



Në gazetën “Utrinski Vesnik” (e martë 22 maj 2001), hasim një shkrim të titulluar “*Koranski Misl*” (Mendime Kur’anore) të shkrimtarit dhe diplomatit Trajan Petrovski. Shkrimin e tij autori në fjalë e fillon me ajetin Kur’anor “Të mbysësh një njeri është sikur të mbysësh tërë njerëzimin”, ndërsa tekstin e përfundon me ajetin “çdo popull do të thirret sipas librit të vet”. Ajo që më tërheq vëmendjen, bile edhe më habit, është fakti se autori, kur dëshiron të na këshillojë neve (shqiptarëve myslimanë) dhe të na tregojë ç’është “njerëzia”, si shembull, për veprime pozitive, përmend patrikun e Patrikanës së Fanarit, Bartolomeosin dhe patrikun e Kishës Ortodokse Serbe, Pavlin. Më habitën fjalët e Pavlit, që i transmeton autori, se “asnjë interes nacional nuk u jep të drejtë serbëve që krimin t’i përgjigjen me krim”, apo “...as që do të pranojë një Serbi të Madhe ose të Vogël e cila do të formohet duke u bazuar në krimin...”. Por Pavli asnjëherë nuk është deklaruar haptazi kundër gjenocidit dhe spastrimit etnik që u realizua vite me radhë mbi shqiptarët e Kosovës. Asnjëherë nuk e pa të udhës të bëjë të paktën një kritikë të vetme në këtë drejtim. Se nga transmetohen dhe ku bazohen këto citate e di vetëm autori. Nuk mund ta kuptoj se si i kupton këto fjalë të Pavlit autori. A thua këto mendime nuk e vlerësojnë si krim vrasjen e shqiptarëve, prishjen e shtëpive të njerëzve të pafajshëm dhe të xhamivë të ndryshme? Apo mos është diçka njerëzore ndërtimi i kishës në mes të Prishtinës (afër Bibliotekës Universitare) dhe kërkesa që shqiptarët të pranojnë serbo - ortodoksizmin (gjë të cilën e ka kërkuar policia serbe nga shqiptarët kur ata janë keqtrajtuar, plaçkitur apo dëbuar nga vatrat e tyre shekullore - viti 1999)? Apo mos zotërisë i duket normale dhe jo krim që shqiptarët myslimanë fajësohen nga ana e sllavo - serbëve për “fundamentalizëm islam”, gjë që nuk ka qenë dhe nuk është as-

pak e vërtetë? Pra është me rëndësi që të përkufizohet se çfarë kuptohet këtu me fjalën krim. Nëse mendohet se është krim shqiptarët të kërkojnë të drejtën e tyre për të jetuar si njerëz, atëherë fjalët e Pavlit thonë një realitet asimilues. Por, nëse fjala krim ka për qëllim të tregojë vrasjen e njerëzve të pafajshëm, përzënien e njerëzve nga shtëpitë e tyre dhe prishjen e shtëpive të tyre etj., atëherë duhet të merret parasysh fakti se këta që bëjnë krime nuk janë shqiptarët, sepse janë këta ata që vriten, të cilëve u prishen shtëpitë etj. Por, autori duhet të përcaktohet nëse është për kuptimin e parë (që është në kundërshtim me Biblën) apo është për kuptimin e dytë të fjalës krim.

Si shembull të dytë, z. Trajan Petrovski e merr Bartolomeosin. Këtu do ta kisha lutur z. Trajan, nëse ka mundësi të na tregojë të paktën një rast të vetëm që Bartolomeosi me kolegët apo me bashkëpunëtorët e tij të ketë thënë qoftë një fjalë të mirë për shqiptarët (apo myslimanët në përgjithësi), apo mos kanë bërë ndonjë kërkesë ose ndonjë punë konkrete në zgjidhjen e kërkesave të shqiptarëve (apo të ndonjë populli tjetër në botë që nuk i gëzon të drejtat e tij elementare) në Kosovë dhe Maqedoni, meqë këta kanë pasur lidhje direkte me ortodoksët e këtij rajoni dhe kështu t'i realizojnë fjalët paqe dhe barazi të Biblës, së cilës i besojnë.

Autori i tekstit në fjalë na fajëson neve (që na quan arnautë) se nuk e kemi ngritur zërin kundër këtyre, sipas autorit, bandave të errëta në Maqedoni. Por unë do të pyetja se kush ishte ai që e dëgjoji zërin e tyre (bandavë) që kur kërkonin shkollë, hanin dajakun e vriteshin, që rriheshin e keqtrajtoheshin nga policia me faj e pa faj? Për ato "banda" që kanë dalë në mal le të kujdesen ata të cilët i kanë detyruar të dalin në mal (viti 2001), e të mos kërkohet dikund tjetër ajo që ekziston te vetë përgjegjësit e gjendjes aktuale.



## KOM-i duhet të japë provimin para Jezu Krishtit dhe Biblës

Autorit të këtij teksti të gazetës, i cili i citon dy ajetet kur'anore që i përmenda më lart, dua t'i përkujtoj se në Kur'an ka edhe një ajet tjetër, që thotë: *“a urdhëroni njerëzit që të bëjnë mirë e veten tuaj e haroni”* (Kur'an, sure Bekare 44), apo, nëse do të ishim më të lirë në përkthimin e këtij ajeti, *“a ju shitni mend të tjerëve e për vete nuk keni”*.

Në këtë kohë, kur më tepër se kurrë flitet për tolerancën apo për dialogun ndër fetar, ndërkulturor, ndër njerëzor apo ndërnacional, është shumë jonjerëzore dhe jofetare të veprohet kundër kësaj tolerance apo këtij dialogu. Kohëve të fundit këtë është duke e përjetuar edhe vetë KOM, i cili ende nuk pranohet si kishë autoqefale nga kishat e tjera ortodokse, si nga Kisha Serbe apo Patrikana e Fanarit. Fakti që shqiptarëve në këto troje nuk u lejohej të shkollohen (rasti i UT - së, i shqiptarëve në Manastir, Prilep, Resnjë), nuk u lejohej të ndërtojnë xhami (po bile në disa raste edhe ato që janë prishen), punësimi i tyre i kufizuar, rrahja, keqtrajtimi, prishja e shtëpive vetëm e vetëm që nuk janë të nacionalitetit maqedonas apo nuk i takojnë besimit ortodoks, nuk është as njerëzor, as fetar po, bile, as që përkon me atë që quhet dialog ndër fetar, ndërnacional, ndërkulturor apo ndër njerëzor. Bashkësisë Islame në Maqedoni nuk i është kthyer asgjë nga vakëfet që i janë uzurpuar nga regjimi komunist. Ndërsa KOM - it, jo vetëm që i janë kthyer disa troje që ajo i ka pasur më herrët si pronë, por i janë dhuruar edhe troje dhe objekte që janë pronë e popullit në përgjithësi (si hotelet në Strugë). Në disa raste ajo ka uzurpuar edhe vendin e xhamisë, ku ka ndërtuar kishë (rasti evident në Ohër). Prandaj nëse KOM dëshiron të



mos ketë një bindje paradoksale dhe të japë provimin para Jezu Krishtit dhe Biblës, në fjalët dhe sjelljet e saj duhet të reflektohet paqja, mirësjellja, toleranca, dialogu, dashuria ndaj njeriut dhe ndaj Zotit.

Këtë shkrim dua ta përfundoj me një shprehje të Librit të Shenjtë, ku, ndër të tjera, thuhet:

*“Trajtoni njerëzit ashtu siç doni që edhe ju t’ju trajtojnë - kjo është gjithçka që kërkon Perëndia në Ligj dhe në librat e profetëve.”* (Mateu, 7,12).

## Vendi (Maqedonia) u takon atyre që mendojnë edhe për të tjerët\*

*“Udhëheqësia e drejtë dhe e vërtetë nuk është ajo e cila qytetarët i bënë që të ndihen të lirë, por, ajo e cila qytetarët i bënë të ndihen të nevojshëm, gjegjësisht të domosdoshëm.”(Ferid Muhiq, Logos i Hierarbija, f.12)*

Maqedonia është një shtet i vogël dhe shumëngjyresh, qoftë në aspektin kulturor, ideologjik e fetar, qoftë në aspektin ekonomik, shoqëror e politik. Në aspektin kulturor, ideologjik dhe fetar Maqedonia, krahas besimeve dhe ideologjive të tjera, dominohet nga krishterimi (ortodoksizmi) dhe islami. Ndërkaq, në aspektin ekonomik, shoqëror dhe politik ky shtet i vogël është mes një sistemi monist, të cilin krerët aktualë politikë dhe intelektualë maqedonas e duan dhe përpiqen me mish e me shpirt ta ruajnë, dhe një sistemi demokratik, i cili vjen në Maqedoni mysafir dhe dëshiron të qëndrojë net të tëra me “zor”, apo ndoshta edhe të bëhet vendës. Por, krahas kësaj llojlojshmërie, “aga” në këtë vend, sidomos gjatë dhjetë vjetëve të fundit, është (le të themi ishte, gjë të cilën maqedonasit nuk dëshirojnë që ta kuptojnë) populli maqedonas. Kjo pozitë e detyron këtë popull të vendosë (nëse dëshiron të jetë i shëndoshë) që, në “sti-

---

\* Teksti është shkruar në vitin 2001, kur në Maqedoni luftonin shqiptarët me pushtetin maqedonas.

nën e dimrit”, kur bën shumë ftohtë, të veshë tesha më të trasha, tesha dimërore, e kur bën nxehtë, në “stinën e verës”, të veshë teshat verore, pra të kuptojë se në cilën kohë gjendet dhe se çfarë temperature politike dominon në atë kohë. Mua më duket se disa liderë maqedonas, meqë në këtë shtet të vogël kanë ardhur vetëm “verës” (pra këtë vend gjithmonë e kanë paramenduar vetëm të nxehtë si një sistem të përshtatshëm vetëm për ata), e tani, në kohën e “dimrit”, mërdhijnë, por nuk e dinë pse. A thua nuk kujtohen fare se kanë harruar “t’i veshin rrobat e dimrit”? Sa mirë do të ishte të shikonin pak veten! Çdo gjë do të ishte e qartë! E megjithatë, kjo nuk më brengos shumë, sepse ky është një mendësi ballkanike. Njeriu i këtij rajoni ballkanik nuk i thotë mjekut më ndihmo, por më jep këtë ilaç, se më ka bërë mirë, paçka se sëmundjet janë të llojllojshme.

Për fat të keq, këtu, në këtë shtet të vogël, ne kemi të bëjmë me një grup njerëzish, liderë të nacionalitetit maqedonas (them një grup, sepse nuk besoj të gjithë maqedonasit të mendojnë si ata) të cilët, edhe pse të urretur, e hudhin bukën që e kanë për vete, edhe pse mërdhijnë nga të ftohtët, thyejnë dritaret e shtëpisë ku banojnë vetë, edhe pse dinë të ngasin makinën e dëmtojnë çelësin e saj, me një fjalë me njerëz që vrasin veten me dorën e vet. Këtë e bëjnë sepse nuk dëshirojnë ta shohin tjetrin të ngopur me bukë, të ngrohur kur bën ftohtë, ta shohin duke ngarë makinën, ta shohin në këmbë. Kjo i ngjan mu atij kallëzimi për Djallin kur ky një ditë vendos t’i bëjë një vizitë Faraonit. Kur Djalli arrin te dera dhe troket, Faraoni pyet se kush është? Ky i përgjigjet duke i thënë se, ti që e ke shpallur veten zot duhet të dish se kush është te dera. Dhe në fund Faraoni e kupton se është Djalli, ia hap derën dhe pasi futen të dy brenda ia fillojnë bisedës. Temë kryesore e bisedës kanë qenë të bërat e Faraonit dhe të bërat e Djallit. Në fund, si rezultat del se



Faraoni dhe Djalli janë dy krijesa që kanë bërë më shumë të këqija se të gjithë njerëzit të tjerë. Faraoni e pyet Djallin nëse ka ndonjë njeri më të keq se unë dhe ti? Po, i thotë Djalli. Habitet Faraoni. E kush na qenka pra ky njeri, na trego, thotë Faraoni. Djalli thotë se, që dyzet vjet kam një shokë dhe gjithmonë ia kam realizuar një dëshirë. Por, një ditë kërkoi që t'ia realizojë një dëshirë, për të cilën unë nuk isha që të realizohej. E ç'ishte ajo dëshira e tij? thotë Faraoni. Një komshi i tij kishte një lopë. Komshiu i tij çdo ditë e kulloste lopën dhe merrte qumësht prej saj. Ndërsa ky shoku im, thotë Djalli, u bë lakmues ndaj komshiut të vet dhe kërkoi nga unë që t'ia zhduk ose t'ia marrë lopën. Mirëpo unë, thotë Djalli, i thashë se nuk kam mundësi që t'ia marr lopën e as t'ia zhduk, por kam mundësi që ty të të jap një, tri, shtatë lopë. Kurse shoku im, thotë Djalli, nuk u pajtua të ketë tri apo shtatë lopë, por vetëm e vetëm që komshiu i tij të mos e kishte atë të vetmen lopë që e kishte. Pra, është i gatshëm të flijojë edhe veten, që si e si t'ia realizojë aspiratat e tij gjakpirëse dhe shkatërruese. E kështu pra edhe ne, së pari, kemi të bëjmë me një mendësi të Kishës Ortodokse Maqedonase, e cila mban nën sqetullat e saj njerëz klerikë që e deklarojnë veten liderë shpirtërorë të trimave të ashtuquajtur "llavovi" (luanë), "vollci" (ujq) etj. apo bën shenjtërimin e tyre (duke u shpërndarë pllaka), kinse ata kanë qenë mbrojtësit e Maqedonisë. Pra, kanë qenë "mbrojtës" që shtëpiat e shqiptarëve të mos mbeten pa u prishur, që shqiptarët të mos mbeten pa u vrarë, me një fjalë që çdo gjë shqiptare të shkatërrohet dhe të bëhet pastrimi i Maqedonisë nga këta "elemente negative" të shoqërisë. Së dyti, kemi të bëjmë me një aparaturë udhëheqëse të shtetit e cila për të prishur një xhami e prish edhe kishën e vet, apo për të vrarë një shqiptar i vret edhe disa njerëz të palës së vet, ose për t'i nxjerrë të tjerët fajtorë e prish shtëpinë, hotelin e vet etj. Pra, pajtohet që edhe vetë të dëmtohet, vetëm e vetëm që tjetri të mos fitojë gjë. Mentalitet ky i ulët, shumë i ulët, një mentalitet

që nuk e pranon edhe vet Satani. Po ashtu mentalitet ky me të cilin habitet edhe Faraoni. Këtu nuk mund të kaloj pa e përmendur këndvështrimin e një sociologu për politikën. Sociologu shkruan se një herë një nxënësi mësuesi i kërkon që kur të shkojë në shtëpi të kërkojë prej prindërve të tij t'ia mësojnë se ç'është politika. Kur nxënësi vjen në shtëpi e pyet babanë për atë se ç'është politika dhe ai thotë se nuk kemi aq kohë për të shpjeguar se ç'është politika, por, le të themi se unë (babai) jam kryetari i shtetit, nëna jote është qeveria, ti je shtresa intelektuale, foshnja është e ardhmja jonë, kurse kjo shërbyeseja është klasa punëtore. Dhe këtu babai thotë se shpjegimin do ta vazhdojë nesër. Bien të fle në. Natën vonë, dëgjohet të qarët e një fëmije. Nxënësi çohet të shohë se çka ngjarë. Kur sheh foshnjën si qan, vëren se ajo e ka kryer nevojën e madhe dhe i vjen era nga larg. Ndërkaq, babanë e sheh duke fjetur me shërbyesen, nënën e gjen duke gërritur pandërprerë. Kthehet përsëri te shtrati i vet dhe bie të flejë. Kur çohet në mëngjes, babai e thërret dhe i thotë eja djali im të të tregoj se ç'është politika. Jo, babai im, i thotë djali, politikën e mësova. Po, ç'është politika, pra? i thotë babai. Djali (nxënësi) thotë, kryetari e shtyp klasën punëtore, qeveria (nëna) gjendet në gjumë, intelektualët (nxënësi) shëtisin lart poshtë, kurse e ardhmja (foshnja) është mbuluar nga ndytësia e i vjen era nga larg. Kjo është politika, baba.

Pra, kur shohim sjelljet dhe qëndrimet e disa liderëve politikë maqedonas dhe të disa prijësve fetarë të kishës, nuk mund të mos i quajmë të vërtetë këta shembuj.

Dua të theksoj se me shembujt e lartshënuar nuk dëshiroj të jem pesimist apo të shpreh pesimizëm, as të formoj bindje pesimiste te të tjerët, sepse Zoti, edhe njeriut më të keq nuk ia humb shpresën për të jetuar sipas rregullave të Tij dhe që në botën e ardhshme (ahiret) të jetë fituesi i shpërblimit të Zotit, qoftë edhe t'i ketë bërë gabimet më të mëdha në këtë botë.



Ndërkaq, periudhat e pakënaqësisë sociale, në esence, janë pakënaqësi ndaj udhëheqjes e jo ndaj institucionit. Edhe kjo që ndodhi në Maqedoni nuk ishte kundër shtetit maqedonas por kundër udhëheqjes dhe udhëheqësve të saj, apo kundër metodologjisë së saj udhëheqëse. Prandaj profesori, Ferid Muhiq, thotë se, muzikantët mund të protestojnë kundër dirigjentit, por kjo nuk do të thotë se ata janë kundër dirigjimit; aktorët mund të jenë kundër regjisorit, por kjo nuk do të thotë se ata duan që shfaqja të bëhet pa regjisor. (Ferid Muhiq, *Logos i Hierarhija*, f.9).

Në fakt, njeriu mendon për veten atëherë kur mendon edhe për të tjerët, kështu që duke menduar për të tjerët, ai mendon edhe për veten e tij. Ndërkaq nëse mendon vetëm për veten e tij e nuk mendon edhe për të tjerët, atëherë, mund të them se, ai nuk mendon as për vetveten. Këtë e ilustron më bukur shembulli i bletës dhe mushkonjës. Një herë dialogojnë bleta dhe mushkonja. Mushkonja e tall bletën duke i thënë se ti moj bletë je budallaqe. Sepse, ti punon shumë, fluturon lule më lule, por, për të tjerët, jo për veten tënde. Kurse unë, thotë mushkonja, atë që e kafshoj e ha vetë. E bleta ia kthen duke i thënë se, unë me të vërtetë punoj për të tjerët, por ata mua më ushqejnë dhe më respektojnë, bile më mbajnë në shtëpitë e tyre. Kurse ti, moj mushkonjë, vërtet që atë që e kafshon e han vetë, por, ama gjithmonë je e kapluar nga stresi i ikjes, sepse në çdo moment të kanoset rreziku i vdekjes.

Pra, të nderuar bashkështetas maqedonasë, nëse dëshironi të mendoni për veten tuaj, gjë që, pa dyshim, ju konvenon më tepër, atëherë duhet së pari të mendoni për të tjerët, sepse vetëm në këtë mënyrë mund ta realizoni mendimin për veten tuaj.





# **PJESA II**





# Një vështrim historik dhe etimologjik i termit *nasara* në Kur'an

*Doc. Dr. Şinasi Gündüz\**

Termi *nasara* në suret e Kur'anit përdoret shpeshherë si emër i një grupi të caktuar fetarësh. Ky term është përdorur në formën e shumësit të çrregullt dhe ka kuptimin “nasranijtë” (ata që ndihmojnë). Njëjësi i këtij termi – nasranijen përmendet vetëm në një vend, si në Kur'an.<sup>202</sup>

## 1. Spekulime të ndryshme lidhur me termin *nasara*

S'ka dyshim se termi *nasara* në Kur'ani Kerim është një emër i përgjithshëm për të krishterët. Janë në radhë të parë perëndimorët që mëtojnë se ky term është për ithtarët e Kishës Lindore, ndërsa për grekët dhe për të krishterët e tjerë perëndimorë, në periudhën e mëvonshme,

---

\* Teksti është marrë nga vepra *Mitoloji ile İnanç Arasında* (Mes Mitologjisë dhe besimit) e Doc. Dr. Şinasi Gyndyzit.

\* Doc. Dr. Şinasi Gündüz, është ligjërues i Historisë së feve në Fakultetin Teologjik pranë Univesitetit 19 Maji (19 Mayıs Üniversitesi İlahiyat Fakültesi) në Samsun të Turqisë.

<sup>202</sup> Shih, Kur'an 3/67.

është përdorur termi *rum*.<sup>203</sup> Në këtë punim nuk do të thellohem në specifikat e *nasara* - së në Kur'an. Por, do të përqendrohemi vetëm në vlerësimin historik dhe etimologjik të këtij termi kur'anor për të krishterët.

Lidhur me gjenezën e termit *nasara* dijetarët myslimanë kanë paraqitur dy qëndrime të ndryshme. Një grup dijetarësh myslimanë, duke e ndërlidhur këtë term me rrënjën e foljes *nasara - jensuru* në arabishte, supozojnë se të krishterët janë quajtur me këtë emër për shkak të ndihmës dhe solidaritetit reciprok (të shumëllojshëm) mes tyre. Sipas kësaj, *nasara* ka kuptimin “ata që ndihmojnë” ose “ata që ndihmojnë njëri - tjetrin”.<sup>204</sup> Si argument për mendimet e tyre këta marrin ajetin që përmendet në suren “Ali Imran, 3/52” dhe “Saff, 61/14” {”...*men ensari ilallah? Kale'l - havarijjune nabnu ensarullah*“, “Kush janë ndihmësit e mi në rrugën e Allahut?” Apostujt thanë: “Ne jemi ndihmësit e Allahut”}. Sipas këtyre dijetarëve, emërtimi i apostujve - ithtarë të hz. Isait me termin *ensar* në këto ajete, vërteton teorinë e tyre. Ndërsa grupi tjetër i dijetarëve islamë si, Ibn Abbasi, Katadeja dhe Ibn Xhurejxhi mbrojnë mendimin se termi *nasara* në Kur'an është nxjerrë nga emri i qytetit Nazareth (Nazara), që gjendet në zonën e Palestinës e që është i lidhur ngushtë me hz. Isain.<sup>205</sup>

Disa shkencëtarë perëndimorë vënë në dukje ngjashmërinë ndërmjet termit arab *nasara* dhe termit në siri-

---

<sup>203</sup> Shih, Tritton, A.S. J.H. Kramers, *Nasara, Islam Ansiklopedisi*, v. 9, f. 77.

<sup>204</sup> Taberi, *Xhamiu'l - Bejan na Te'vil Aji'l - Kur'an*, Egjipt (1954) v.1, f. 317; Ibn Kethir, *Tefsiru'l - Kur'ani'l - Adhim*, Bejrut (1984), v. 1, f. 103.

<sup>205</sup> Taberi, op. cit. v. 1, f. 317; Ibn Kethir, op. cit., v. 1, f. 103. Posaçërisht për *nasara* shiko: Ibn Mandhur, *Lisanu'l - Arab*, Bejrut (Jo); v. 3, f. 647 - 48. Përveç kësaj në një punim të përmendur më parë, kemi theksuar mundësinë e lidhjes ndërmjet emrit të qytetit Nazareth dhe emrit Nasara. Krahaso, Gyndyz, Sh. *Një studim dhe një vlerësim mbi identitetin e sabiitëve në Kur'an*, Simpoziumi I për studime të historisë së feve në Turqi, Samsun (1992), f. 47.

anishte (asuriane - syrianic) *nasraja* dhe *nasranaja*.<sup>206</sup> Në sirianishte *nasranaja* do të thotë krishterim (krahaso me *nasranijje* në arabishte).<sup>207</sup>

Përdorimi kur'anor i termit *nasara* për të krishterët tregon se ky term në periudhën kur është shpallur Kur'an, është përdorur si një emër arab për ta. Grupet Kur'an, i emërton sipas përdorimit asokohe (p.sh. për zoroastrianët - mexhus, për mandenët - sabiun dhe për çifutët - jehud ose hadu). Në fakt, shoqëria arabe, kur në Kur'an përdorej një term i huaj ose një term të cilin ajo nuk ishte mësuar ta përdorte kundërvijë me pyetjen - ç'është kjo? Një kundërshtim i ngjajshëm është bërë edhe për përdorimin e emrit *Rahman*.<sup>208</sup> Ndërkaq, arabët nuk e kanë kundërshtuar përdorimin e emrit *nasara* në Kur'an. Ky është një argument se termi është përdorur nga arabët edhe në periudhën para Kur'anit. Prandaj, është gabim që, duke u nisur nga shprehjet të cilat kanë lidhje me rrënjën e foljes *nasara* – *jensuru*, të përdorur në Kur'an, të jepet shpjegimi etimologjik se ky term buron nga arabishtja. Në të vërtetë, ky term, përveç në arabishte, me trajtën *nasraja* dhe *nasranaja*, të nxjerrë prej së parës, në tekstet e sirianishtes ky emër do të thotë krishterim dhe të krishterë.

---

<sup>206</sup> Shih, Tritton, A. S., J. H. Kramers, op. cit. f. 77.

<sup>207</sup> Brockelmann, C., *Syriac Dictionary*, 2nd ed., s. 212; Drower, E. S., R. Macuch, *A. Mandaic Dictionary*, Oxford 1963, s. 285.

<sup>208</sup> Shih, Furkan, 50 – 60.



## **2. Lëvizjet dhe rrymat historike lidhur me termin nasara**

Termi *nasara*, si emrat e tjerë për grupet të ndryshme që përmendim në Kur'an, ka të bëjë me krishterimin dhe, më përafërsisht, me formimin dhe me periudhën e parë historike të krishterimit. Për të thënë diçka për gjeenezën e termit *nasara*, së pari duhet të studiohen disa çështje (medhhebet, shkollat dhe personalitetet) që mund të kenë lidhje me këtë emër në zonën e Arabisë Veriore dhe në zonën Palestinë - Jordan, vende këto që kanë të bëjnë me formimin e krishterimit dhe veprimtarinë e Jezu Krishtit.

### **a. Herezia dhe heterodoksia hebraike**

Qysh para erës sonë, në këtë zonë hasim një grup njerëzish dhe një sërë lëvizjesh që kanë të bëjnë me termin *nasara*. Në periudhën para hz. Isait, qoftë në zonën Palestinë-Jordan, qoftë përreth tyre, ekzistonin shkolla të ndryshme hebraike, që mbronin mendime dhe vizione të kundërta. Këto shkolla në hebraizëm përmbledhen në dy grupe kryesore. Grupi i parë përfshin fraksionet që e vazhdojnë traditën ortodokse hebraike me qendër në Jerusalem. Fraksionet e këtij grupi, me gjithë dallimet ndërmjet tyre, e përfaqësojnë mendimin qendror hebraik. Dy shkollat hebraike, saddukijtë dhe farisijtë, janë dy fraksionet kryesore brenda konceptit qendror hebraik të cilat kanë dashur që hebrenjtë - që janë në pozitën e ithtarëve të vërtetë - t'i asimilojnë në kulturën helene, prandaj tempullin e Jerusalemit e kanë kthyer në tempull të Zeusit, dhe grupi tjetër është ai që është formuar pas

revolucionit Makkabi, që është bërë kundër Antiochus Epiphanes - it IV (p.e.s. 175 – 164), përndjekësit të ashpër kundër hebrenjve.<sup>209</sup>

Grupet e ndryshme, të vogla dhe të mëdha, përbënin grupin e dytë kryesor që ishte kundër hebraizmit ortodoks dhe përfaqëson mendimin zyrtar hebraik, qoftë në zonën Palestinë–Jordan, apo në vende të tjera në periudhën para Isait. Këto fraksione, që nuk bënë pjesë në hebraizmin qendror, kishin dy forma të ndryshme. Njëra prej tyre ishte shkolla dhe drejtimi hebraik heretik. Zona Palestinë–Jordan, është një zonë gjeografike në të cilën gjatë historisë janë përzier dhe janë bashkuar shumë kultura. Në periudha të ndryshme historike kjo zonë përveç që ka qenë nën qeverisjen e popullit të vet, ka qenë edhe nën sundimin e grekëve, romakëve, egjiptianëve, babilonasve dhe asurëve. Kjo gjendje në këtë zonë herë - herë ka bërë shumë ndikim në kulturën hebreje, ndaj ka shkaktuar zhvillimin e disa shkollave jashtë mendimit hebraik ortodoks, i cili, me gjithë intensitetin (terrorit) dhe presionin e jashtëm, nuk ka toleruar kompensimin e vlerave kulturore dhe futjen e elementeve të ndryshme të kulturave të huaja në besimin dhe adhurimet hebraike. Në periudha të ndryshme hebrenjtë kanë përjetuar disa shpërngulje dhe syrgjynosje; në disa raste, prej invadimeve të ndryshme të huaja, ndërsa në disa raste të tjera nën presionin e forcave të huaja. Për këtë arsye, një pjesë e hebrenjëve janë shpërngulur që nga periudha më e hershme në Siri, Babiloni (si qendër më kryesore), Egjipt, në anë të ndryshme të Anadollit dhe, më në fund, janë shpërndarë nëpër qendra të ndryshme vendbanimi në këto vende. Disa nga këta hebrenj të diasporës në

---

<sup>209</sup> Shih, Bright, *A History of Israel*, f. 463. vazh.; Fohrer, G. *History of Israelite religion*, përk. D. E. Green, Londër 1981, f. 369; Baron, *A social and Political history of the Jews*, v. 2, f. 35 – 38.



atdheun e tyre të ri përjetuan gradualisht përvojë të sinkretizmit fetar. Elementet kulturore të tyre, sistemin e mendimit dhe besimit të tyre, siç ngjau edhe me samirinjtë, ata i përzierën me elementet vendëse. Këta filluan të besonin se zoti i tyre (Jahve–Jehova) pak a shumë është identik me zotin vendës i cili qëndronte në krye të panteonit të shoqërisë në të cilën jetonin ata (hebrenjtë), dhe që filloi t’u bënte vend kulteve të zotit në sistemin e besimit të tij. Sipas mendimit të këtij grupi hebraik, “ekzistenca më e lartë të quhet Jupiter, Zeus, Adonai, Ammon apo Pappaeus” të adhurohet si i tillë, nuk është aspak me rëndësi.<sup>210</sup> Megjithatë, në mesin e hebrenjve të cilët u ndikuan prej kulturave të huaja në zonën Palestinë–Jordan, dhe në mesin e hebrenjëve të diasporës, u formuan në një proces historik shumë shkolla heretike në kundërshtim me besimin ortodoks hebraik. Disa prej këtyre janë, p.sh. samirinjtë, të cilët përbëjnë një strukturë të re të kombinuar nga kultura mezopotomike dhe siriane me atë hebraike<sup>211</sup>.

Grupi i dytë, që është jashtë mendimit qendror hebraik, përfshin drejtimit heterodokse hebraike. Këto janë shkolla që dolën në shesh si kundërshtarë të hebraizmit ortodoks në zonën Palestinë–Jordan. Lëvizjet e ndryshme baptiste (Hemerobaptists) dhe essenijtë, që janë pronarë të teksteve Kumran, të cilat, me t’u zbuluar patën jehonë në tërë botën, janë disa shkolla të cilat bëjnë pjesë në këtë grup. Edhe shkollat heterodokse hebraike, sikurse fraksionet heretike hebraike, kanë dalë në shesh si kundërshtarë të mendimit qendror (zyrtar) hebraik; vetëm se këto kanë dallime të rëndësishme prej grupeve heretike hebraike. Para se gjithash, këto janë më ortodokse dhe më konservatore se hebrenjtë qendrorë. Siç do të shohim më vonë,

---

<sup>210</sup> Baron, S. W., op. cit., v. 2, f. 23 vazhd.

<sup>211</sup> Shih, veprën e njëjtë, v. 2, f. 26 – 35.



nasurajtë, të cilët janë një nga shkollat heterodokse hebreje, hebraizmin zyrtar e shihnin shumë tolerant dhe elastik dhe pikërisht për këtë arsye formuan grupet e tyre jashtë grupit qendror hebraik. Ligjet këta i komentonin sipas nevojave të tyre. Kishin kalendarë të tyre fetarë dhe ndërmjet vete zbatonin një dicitlinë të ashpër sa u takon adhurimeve dhe besimit fetar.<sup>212</sup> Sidomos hebrenjtë heterodoksë, ndryshe nga hebrenjtë heretikë, në sistemet e tyre të adhurimit dhe të besimit, nuk i linin shumë hapësirë sinkretizmit fetar. D.m.th. ata ishin ashpërsisht kundër elementeve të huaja kulturore.

## **b. Shkolla heterodokse e nasurajve**

Me sa dimë prej burimeve të ndryshme, në periudhën para hz. Isait ka ekzistuar një shkollë heterodokse hebraike me emrin nasuraizëm (Nasoraeanism) në zonën Palestinë - Jordan. Shumë shënime për nasuraizmin gjenden në "Panurion - in" e Epiphanius - it, një nga etërit e kishës së shek. IV të e.s. Në veprën e Epiphanius - it theksohet se nasuraizmi është një shkollë hebraike, që ka ekzistuar që nga periudha para hz. Isait dhe duke folur gjerësisht për specifikat e tij mundohet ta kritikojë atë. Sipas shënimeve të Epiphanius - it, nasurajtë (Nasorion) kanë këto specifika:

Si komb (nacion) nasurajtë kanë qenë hebrenj dhe kanë jetuar sidomos në zonat e Gilead - it, Bashan - it dhe Transjordanisë.

Në besim dhe ibadet kanë qenë të lidhur (ngushtë) me mësimet hebraike. I kanë kundërshtuar disa çështje në lidhje me të bërët synet, të përshtaturit ndalimit të së shtunës (Sabbath) dhe të festuarit e ditës së shenjtë dhe festivaleve.

---

<sup>212</sup> Shih, Bright, J., op. cit., f. 465 - 66.

I pranojnë peygamberët që gjenden në Librin e Shenjtë (Bibël).

Njëra prej specifikave më të rëndësishme është se pranojnë që Musai ka marrë një grumbull urdhrash hyjnorë, por thonë se ata nuk janë Pentateoch (libri që gjendet në duart e tyre), siç pretendojnë hebrenjtë qendrorë.

Një specifikë tjetër e tyre është se konsiderojnë që librat në duart e hebrenjve qendrorë nuk janë libra të vërtetë hyjnorë, por janë të falsifikuar.

Së fundi, sipas fjalëve të Epiphanius - it, këta nuk presin kurban dhe nuk hanë mish.<sup>213</sup>

Epiphanius - i thotë se nasurajtë, sikundër osseanët, hemerobaptistët, herodianët dhe drejtimet e tjerë hebraike, pas okupimit të Jerusalemit nga perandori romak Titus, në shek. I të e.s. janë zhdukur dalëngadalë.<sup>214</sup> Por, shton ai, sado të paktë në numër, përsëri në shek. IV të e.s. në zonën e Thebaid - it të Epërm kanë jetuar disa nasurajë.<sup>215</sup>

Siç shihet, nasurajtë janë një grup që ekziston qysh nga periudha para hz. Isait. Në aspektin e përgjithshëm strukturor janë anëtarë të shoqërisë hebraike, ndërsa e kanë kundërshtuar hebraizmin zyrtar (qendror). Këta konsiderojnë se Pentateoch dhe librat e tjerë, që hebraizmi qendror i pranon, janë falso dhe nuk e pranojnë e as e mbrojnë mendimin se ata vetë janë ndjekës të Ligjit të Musait.

*Nsr*, që përbën rrënjën e termit *nasura* (Nasoraion), që u është dhënë si emër nasurajve, në hebraishte, që është një gjuhë nga grupi i gjuhëve aremeje, ka kuptimin “të mbrosh”, “të ruash” dhe “të vëzhgosh”.<sup>216</sup> Edhe njëvlerësia *nasaru* e këtij termi në gjuhën akade, që është

---

<sup>213</sup> Shih, Epiphanius, *The Panarion of Epiphanius of Salamis*, Book 1 (Sects, 1 – 46), përkth. F. Williams, Leiden 1987, f. 42 – 43.

<sup>214</sup> Vep. e cit., f. 47 - 48

<sup>215</sup> Vep. e cit., f. 50

<sup>216</sup> Shih, Osburn, W., *A Hebrew and English Lexicon*, Zanderman Publ. House, Michigan (originally publ. in London 1844), f. 172

një tjetër gjuhë nga gjuhët aremeje, ka kuptimin “të mbrosh”, “të vëzhgosh”. Kështu që shprehja *nasir piristi*, që përmendet shpesh në tekstet akade ka kuptimin “mbrojtësi i sekreteve”.<sup>217</sup> Ndërsa njëvlerësia e *n s r* në hebraishte, në aremeje është *n t r*, që ka kuptim të njëjtë. Në gjuhën mandene (gjuha e sabiitëve), një tjetër gjuhë nga gjuhët lindore aremeje, është termi *natra*, një nga emrat që u jepen kandidatëve për prift, të cilët dëgjojnë mësimet e shenjta nga Ganzibra (kryepriifti) apo priftërinjtë e tjerë dhe do të thotë “ai që i mbron mësimet e shenjta”, “kujdeset për ta”.<sup>218</sup> Ndërsa, së fundi, te një anëtare tjetër, që bën pjesë në grupin e gjuhëve aremeje, në arabishte, është termi *nadhara*, që korrespondon me këtë rrënjë.<sup>219</sup>

Së këtejmi, duke u nisur nga kuptimi i rrënjës së termit *nasura*, ai ka kuptimin “ata të cilët i mbrojnë dhe kujdesen për mësimet dhe urdhrat e shenjtë”. Kur kemi parasysh specifikat e lartpërmendura të nasurajve, kuptojmë se ata quhen nasuraj nga shkaku se, ata pretendojnë se në rajonin Palestinë - Jordan janë prej hebrenjve më të lidhur me rregullat fetare, kundërshtojnë fenë zyrtare në Jerusalem me preteks se është e deformuar dhe, posashtu, pretendojnë se janë të vetmit që e mbrojnë doktrinën e vërtetë të Musait.

### c. Nadhirinjtë dhe nasurajtë

Një term tjetër në traditën hebraike para krishterimit, që mund të ketë lidhje me termin *nasura*, është *nadhiri* (נאזירי). Ky term është emër që është përdorur për disa persona në shoqërinë hebraike, që nga periudha para syrgjynosjes.

<sup>217</sup> Shih, Zimmern, H., *Nazoräer*, ZDMG, 74, 1920, f. 433

<sup>218</sup> Shih, Segelberg, E., *Traša d - tâga d - Şişlam rabba*, in *Studia Mandaika*, ed. R. Macuch, Band I, Berlin – New York 1976, f. 176 - 78

<sup>219</sup> Shih, Ibn Mandhur, op. cit., v. 3, f. 664 vazhd.



*Ndhr* (n<sub>zr</sub>) në hebraishte përbën rrënjën e foljes së termit *nadhiri* (naziri), që ka kuptimin “të ndash, të sakrifikosh dhe të shugurosh vetveten.”<sup>220</sup> Termi, në kuptimin terminologjik do të thotë “ai i cili për Zotin e flijon vetveten.” Nadhirinjtë, vazhdojnë një mënyrë të posaçme të të jetuarit që dallon nga ajo e shoqërisë në të cilën jetojnë. Në kuptimin absolut këta nuk janë asketë. Është një specifikë e tyre që të mos i shkurtojnë flokët, gjë që tregon se ata janë shumë ngushtë të lidhur me ligjin, qëndrojnë larg çdo pijeje alkoolike (e lehtë apo e rëndë), nuk e prekin të vdekurin nga frika e ndotjes në aspektin fetar dhe qëndrojnë ndaras nga shoqëria në të cilën jetojnë<sup>221</sup>. Siç kuptohet prej shprehjeve të ndryshme në Bibël, ashtu siç kanë kaluar disa individë një periudhë të jetës në nadhiri, ka edhe të tillë (p.sh. si Samsoni dhe Samueli) të cilët jetën e tyre e kanë vazhduar në këtë mënyrë.<sup>222</sup>

Në periudhën pas syrgjynosjes, me rritjen e pesimizmit në shoqëri u shtua edhe numri i nadhirinjve. Gjon Pagëzori (hz. Jahjai), një bashkëkohës i hz. Isait, që nga lindja ka qenë nadhiri dhe për këtë në Bibël thuhet se ai ka qëndruar larg çdo pijeje alkoolike.<sup>223</sup>

A mund të ketë ndonjë lidhje ndërjmet nasurajve, të cilët janë drejtim heterodoks hebraik para hz. Isait dhe nadhirive, që bënin një jetë në formë të izoluar? Përgjigjja nga ana e etërve të Kishës ka qenë negative. P.sh., Epiphanius - i , në veprën e tij, i veçon dukshëm nadhirinjtë dhe nasurajtë.<sup>224</sup> Kurse shkencëtarët modernë pe-

<sup>220</sup> Osburn, W., op. cit., f. 163

<sup>221</sup> Në Dhjatën e re numrat juridikë në lidhje me nadhirinjtë gjenden në 6: 1 - 21. Shih sidomos, Davis, J.D., H.S.Gehman, *The Westminster Dictionary of the Bible*, The Westminster Press 1944, f. 421.

<sup>222</sup> Shih, Gjyqtarët 13 : 4 - 5; 16; 17; Samueli I - rë, 1; 11,28. Sidomos krahaso, Eksodi 20 : 25; Numrat 19 : 2; Ligji i Përtërirë 15 : 19.

<sup>223</sup> Lluka 1 : 15; sidomos shih, Epiphanius, op. cit., f. 116.

<sup>224</sup> Epiphanius, op. cit., f. 116

rëndimorë nuk janë përqendruar në këtë mundësi. Por, literatura sabiite, e cila është burim që përmbledh njohuri shumë të gjera në lidhje me Gjon Pagëzorin (hz. Jahjanë - John the Baptist), lë mundësinë se ndërmjet nasurajve para hz. Isait dhe nadhirinjve ka një lidhje. Sabiitët janë një grup që lindën brenda traditës hebraike, në zonën Palestinë-Jordan para krishterimit dhe që në shek. I të e.s. u detyruan të shpërnguleshin drejt Lindjes.<sup>225</sup> Sabiizmi ka lidhje shumë të ngushtë me hebraizmin. Sado që, të zënë vend në tekstet e shenjta sabiite shprehjet kundër hebrenjve dhe hebraizmit, ky ka një ndikim të qartë dhe të dukshëm mbi sistemin fetar sabiit. Edhe fjalët e disa librave të shenjta sabiite, se ata një kohë e kanë adhuruar Adon - in, zotin hebraik, janë argumente se sabiitët një kohë kanë qenë të varur prej mësimëve dhe besimit hebraik.<sup>226</sup> Krahas emrit manden vetveten sabiitët e kanë quajtur edhe *nasura* (nasurai). Po të hulumtohet literatura sabiite, do të kuptohet se emri *nasurai*, ashtu si *bhiri zidga* (të vërtetat e zgjedhura), është një emër i vjetër të cilin sabiitët e kanë përdorur për vetveten. Megjithatë, është një emër që ka ekzistuar para emrit manden.<sup>227</sup> Emri *nasurai* në literaturën fetare sabiite përdoret posaçërisht për paraardhësit e tyre. P.sh. në tekstet që flasin për historinë e periudhës së tyre të hershme, sabiitët gjithmonë janë përmendur me emrin *nasurai*.

“Dhe gjashtëdhjetë mijë nasura e lëshuan Simbolin e Shtatë dhe dolën në kodrinat e Medja - së, një vend në të cilin jemi të lirë nga dominimi i të gjithë racave të tjera. Rregulluan një tempull dhe deri në fund të jetës vazh-

<sup>225</sup> Për gjenezën dhe për historinë e hershme të sabiitëve shih, Gündüz, *The Knowledge of Life; The Origins and Early History of the Mandaeans and Their Relation to the Sabians of the Qur'an and to the Harranians*, Oxford University Press 1944.

<sup>226</sup> Shih, Haran Gawaita, ed. and përkth. E.S.Drower, Vatican City 1953, f. 3.

<sup>227</sup> Shih, Rudolph, K., *Gnosis*, f. 343.



duan me thirrjen e Jetës së Lartë dhe me fuqinë e Mbretit të Dritës së Lartë”.<sup>228</sup>

Edhe termi *nasaruta* (nasuraizëm dhe nasurallëk) në literaturën sabiite, që rrjedh prej këtij emri, përdoret si një term për sabiitët. “Arma jote është nasuraizmi (*nasaruta*), që është një fjalë e cila të ka ardhur (ty) prej Dritës”.<sup>229</sup> Figurat historike që janë përmendur në mesin e paraardhësve të tyre, sidomos Hibil - i, Shitil - i dhe Enush - i dhe personalitete të tjera shumë të rëndësishme, sabiitët i kanë përkujtuar me emrin e nasurajve.

“Ata, vëllezërit tanë, të cilët nuk i harrojnë dhuratat dhe lëmoshat, nasurajtë, që janë të plotë dhe të vërtetë, janë Hibil - i, Shitil - i dhe Enush - i”.<sup>230</sup>

Në sabiizëm Jahjai (Gjoni) ka një vend të posaçëm. Sipas sabiitëve, Jahjai është një prijës (udhërrëfyes) i dërguar në Tokë nga Fuqitë e Dritës nëpërmjet një lindjeje mbinaryrore dhe është që ua mëson nasurajve të tjerë adhurimet dhe mësimet e shenjta (hyjnore). “Këto janë dituritë dhe fjalët të cilat Jahjai, i biri i Zekirijasë (Ezekijasë), ua ka mësuar, sqaruar dhe lajmëruar nasurajve të drejtë dhe besimtarë”.<sup>231</sup> Jahjai është “pejgamber i së vërtetës” dhe “i dërguar hyjnor”, i pajisur me dituri sekrete.<sup>232</sup>

Termi *nasurai*, krahas përdorimit si emër i përgjithshëm për Jahjanë dhe për të gjithë sabiitët, në literaturën sabiite (dhe në shoqërinë e sotme moderne sabiite), në një kuptim specifik, përdoret edhe si emër i atyre që gjenden në mesin e sabiitëve dhe kanë njohuri sekrete. Në këtë kuptim termi *nasurai* është përdorur vetëm për klasën klerike dhe posaçërisht për ata të cilët në mesin e

---

<sup>228</sup> Haran Gawaita, f. 3. Sidomos shih, vep. e cit., f. 10 - 19

<sup>229</sup> Ginza, ed. and përkth. M. Lidzbarski, Göttingen 1925, f. 508.

<sup>230</sup> Vep. e cit., f. 424.

<sup>231</sup> Vep. e cit., f. 213.

<sup>232</sup> Shih, Haran Gawaita, f. 5; Ginza, f. 51; *Das Johannesbuch der Mandäer* (Draşa d Yahya), ed. përkth. M. Lidzbarski, Giessen, 1915, f. 75, vazhd.



klerikëve kanë njohuri sekrete. Por, termi, i cili përdoret për sabiitët e thjeshtë, është mandai.<sup>233</sup>

Sabiizmi ka mugulluar brenda rrymës heterodokse nasuraite, e cila në periudhën para hz. Isait, doli në skenë si reaksion ndaj hebraizmit qendror dhe, më vonë, me rritjen e kundërshtive mes tyre dhe hebrenjëve qendrorë të Jerusalemit, duke ikur nga torturat dhe përndjekjet, ata u shpërngulën drejt Lindjes. Sabiitët, në procesin e gjatë historik, të ndikuar nga kulturat e ndryshme fqinje, arritën në sistemin e sotëm të adhurimit dhe të fesë. Ndërkaq, elementet violente antihebraike të sabiizmit janë shtuar si rezultat i urrejtjes dhe mërisë kundër hebrenjëve qendrorë.<sup>234</sup>

Rëndësia e hz. Jahjasë (Gjonit) në traditën sabiite shihet nga përkufizimi i tij në sabiizëm si “i dërguar hyjnor” dhe “pejgamber i së vërtetës” dhe interesimi i madh për të. Përkufizimi i hz. Jahjasë nga ana e sabiitëve si njëri prej tyre, ose, në mënyrë më magjepsëse, si prijatar dhe udhërrëfyes i tyre, d.m.th. si një nasurai, sinjalizon lidhjen (marrëdhëniet) e hz. Jahjasë me shkollën heterodokse hebraike, d.m.th. me nasurajtë. Në fakt, nga burime të tjera mësojmë se hz. Jahja është rritur si një anëtar i shoqërisë hebraike, porse, duke kundërshtuar hebraizmin, është orvatur të formojë grupin e tij dhe, për çka ka pasur një reaksion të madh nga hebrenjtë qendrorë.<sup>235</sup> Së këtejmi, sado që nadhirizmi, si një sis-

---

<sup>233</sup> Shih, Drower, E.S., “The Mandaean To – Day” *The Hibbert Journal*, 37, 1938 - 39, f. 438.

<sup>234</sup> Shih, Gündüz, Ş., *The Knowledge of Life*, f. 55 - 124.

<sup>235</sup> Shih, Mateu 3 : 1 - 12; 11 : 2 - 15; 14 : 3 - 12 : Marku 1; 6; Lluka 3 : 1 - 18. Qoftë në inxhilet, qoftë në veprën e historianit hebraik Josephusit thuhet se hz. Jahja është burgosur, është torturuar dhe më në fund është vrarë nga udhëheqësi i zonës Herod, Antipas. Shih, Mateu 4 : 12; Marku 60 : 16 - 29; Lluka 3: 19 - 20; Wink, W. : “John the Baptist”, *The Encyclopedia of Religion*, ed., M. Eliade, v. 8, f. 112 - 14. Në lidhje me luftën që ka bërë (mundin që ka dhënë) hz. Jahja me hebrenjtë qendrorë, me formimin e

tem, të ketë ekzistuar shumë para nasuraizmit, rrymës heterodokse hebraike, përsëri mund të themi se disa nasurai, si hz. Jahja, para periudhës së hz. Isait, kanë bërë në të njëjtën kohë një jetë nadhirite; megjithatë, nadhirizmi është një mënyrë jetese e pranuar nga nasuraizmi. Në fakt, njohuritë, të cilat Epiphaniusi i jep lidhur me nasurajtë, në mesin e të cilave zënë vend cilësitë si të mos hanë mish, të jenë lidhur ngushtë me ligjin dhe çështjet e tjera fetare, tregojnë afërsinë e tyre me nadhirinjtë, të cilët bëjnë një jetë asketike.

#### **d. Hz. Isai dhe rryma e nasuraizmit**

Një personalitet tjetër i rëndësishëm i cili duhet të studiohet nga këndvështrimi i lëvizjes së nasuraizmit është hz. Isai, bashkëkohës i hz. Jahjasë. Edhe hz. Isai, sikurse hz. Jahjai, ka lindur dhe është rritur si një anëtar i shoqërisë hebraike, pas një kohe, ai e ka kundërshtuar traditën hebraike dhe ka filluar të formojë grupin e vet në bazë të mësimave të tij. Bëhet e ditur se hz. Isai i ka ndjekur një kohë mësimet e hz. Jahjasë, i cili ka qenë më i vjetër se ai dhe me dorën e tij është pagëzuar.<sup>236</sup> Marrëdhëniet ndërmjet grupit të hz. Jahjasë dhe grupit të hz. Isait kanë vazhduar edhe më vonë dhe disa persona, ithtarë të hz. Jahjasë, më vonë janë bërë ithtarë të hz. Isait. Për shembull, sipas njohurive që japin etërit e Kishës, si

---

shoqërisë së tij, me mësimet dhe në lidhje me largimin nga hebreizmi qendror që gjendet në shkrimet sllave në librin e historianit hebreik Josephusit, i cili ka jetuar në shek. 1, i titulluar *The Antiquities*, shih, Mead, G.R.S., *The Gnostic John the Baptist*, Londër 1924, f. 103 - 106.

<sup>236</sup> Shih, Mateu 3:13 - 16; Lluca 3:21. Sidomos shih, Bultmann, R., *Primitive Christianity in its Contemporary Settings*, tr. R. H. Fuller, Thames and Hudson 1983, f. 76. Për këtë temë në literaturën sabiute ka njohuri të thella. Shih, *Ginza*, f. 50 - 51.



Hyppolitus - i dhe Eusebius - i, Simoni (*Simon the Magus*), i cili ka qenë në mesin e komunitetit të parë të hz. Isait, i njohur si pagëzues, ka qenë një nxënës i hz. Jahjasë.<sup>237</sup>

Në ungjijtë kanonik si Ungjilli i Mateut dhe Ungjilli i Gjonit, në ungjijtë gnostikë, si Ungjilli i Filipit dhe Ungjilli i Egjiptianëve, në Apocryphon of Johannis dhe në tekstet e tjera, që i përkasin periudhës së hershme, si Veprat e Apostujve (*Acta*), hz. Isai dhe ithtarët e tij përmenden me një emër të ngjashëm me emrin *Nasura*. Hz. Isai në Dhjatën e re quhet *Nazoran*. “Ai do të quhet *Nazoran (Nazareas)*”.<sup>238</sup> “Jezusi nazareas (*nazora*), mbreti i Judenjve”.<sup>239</sup> Një pjesë e shkenctarëve perëndimorë supozojnë se termi *nazoran (nazareth)*, që përmendet në këto shënime, rrjedh prej emrit të qytetit *nazareth*, në të cilin hz. Isai është rritur dhe ka kuptimin “*Njeriu nga Nazareti*”.<sup>240</sup>

Përveç kësaj, Epiphaniusi, njëri prej etërve të Kishës, thotë se shkak i emërtimit të hz. Isait me këtë llaçap është rritja e tij në shtëpinë e Jusufit në qytetin Nazareth.<sup>241</sup> Por, shumë filologë, si p.sh. C.C. Torry dhe F.C. Burkitt dhe shumë teologë të krishterë e refuzojnë mendimin se ky term ka kuptimin “*Njeriu nga Nazarethi*” (dhe sidomos mënyra në të cilën kalon në Ungjillin e Mateut 2:23). Një pjesë e këtyre shkenctarëve pranojnë se termi ka të bëjë me rrënjën e foljes *n - dh - r* (të ndash, të flijosh, të premtosh) dhe me termin *nadhir*; ndërsa pjesa tjetër mundohen ta sqarojnë këtë me termin *nesher (neser)* (degë), ose me termin *nasar* (mbrojtës).<sup>242</sup>

---

<sup>237</sup> Shih, Drower, E. S., *The Secret Adam*, Oxford 1960, f. 89.

<sup>238</sup> Mateu 2:23. Sidomos shih, Veprat e apostujve 2:22.

<sup>239</sup> Gjoni 19:19.

<sup>240</sup> Shih, Thatcher, G.W., *Nazarene, Dictionary of the Bible*, ed. J. Haasting, v.3, f. 496.

<sup>241</sup> Epiphanius, op. cit., f.116.

<sup>242</sup> Shih, Bruce, F.F., *The Acts of the Apostles, The Greek Text with Introduction and Commentary*, Michigan 1984, f. 90.91; Drower, E.S. *The Secret Adam*, f.



Në Dhjatën e re në greqisht hz. Isai përmendet si *Nazareuos*, *Nazoraion* dhe *Nazoraios*,<sup>243</sup> ndërsa Isai, në Ungjillin e Egjiptianëve (The Gospel of the Egyptians) dhe në Zostrinos, tekste këto gnostike, të përkthyer nga greqishtja në gjuhën kopte, përmendet si “*Zesseus Mazareus (=Nazareus) Zessedekus*”.<sup>244</sup>

Gjuhët të cilat përbëjnë dialektet perëndimore aremeje, mbizotëronin në zonën Palestinë - Jordan në periudhën e hz. Isait. Në tekstet në ibranishte, një prej gjuhëve aremeje, hz. Isai emërtohet si *Nusri* (si për shembull në Talmud), kurse të krishterët quheshin *Nusrim*.<sup>245</sup> Në sirianishte, që është një anëtare tjetër e grupit të gjuhëve aremeje, krishterimi, siç e cekëm më parë, shprehet me emrin *nasranaja*. Në këtë rast mund të themi se *s* - ja e theksuar në termin *nasurai* (ose *nusri*) në hebraisht, në greqisht shqiptohet me formën *z* dhe se ky term, në literaturën e shkruar greke, mund të kishte kaluar në formën *nazoraios* (ose *nazora*). Por, në Ungjillin e Filipit (The Gospel of Philip), njëri prej ungjive gnostikë, në lidhje me kuptimin të cilin e shpreh emri *nazoran*, që i është dhënë hz. Isait, jepen këto shpjegime:

“*Nazoran* është njeriu i cili lajmëron për sekretet (gjërat e fshehta)”.<sup>246</sup>

“Emri i fundit është “*Mesih*” (Christ), i pari “*Isa*” (Jesus), i mesmi “*Nazoran*”. “*Mesih*” ka dy kuptime, edhe Mesih (Christ) edhe i Matur (i Peshuar)”.<sup>247</sup>

---

95 - 96, n.3; Thatcher, G.W. op. cit., f.496.

<sup>243</sup> Shih, Bruce, F.F., op. cit., f. 90 - 91.

<sup>244</sup> Krih, *The Gospel of the Egyptians*, përkth. A. Bohlig and F. Wisse in *The Nag Hammadi Library in English*, ed. J. M. Robinson, Leiden 1988, f. 217; Zostrinos, përkth., J.H. Sieber, in *The Nag Hammadi Library in English*, f. 416.

<sup>245</sup> Shih, Bruce, F.F., op. cit., f. 95 - 96, n.3.

<sup>246</sup> “The Gospel of Philip”, përkth., W.W., Isenberg, in *The Nag Hammadi Library in English*, f. 144.

<sup>247</sup> Vep. e cit., f. 147.

Bëhet e ditur se emri *Nazoran*, i cili në këto tekste i jepet hz. Isait do të thotë “ai i cili lajmëron të fshehtën” dhe “ai që është i vërtetë”. Dhe kjo sinjalizon se ky term është larg kuptimit Njeriu prej Nazarethi, që mëtohet t’i jepet atij (Isait) duke e barasvlerësuar atë me emrin e një qyteti dhe se ky term ka të bëjë me termin *Nasura* (ose *Nursi*), që ka kuptimin “ai që i mbron dhe përkujdeset për urdhrat fetarë (ose shkencat e fshehta).<sup>248</sup> Këtë e vërteton edhe përmendja e Isait në tekstet ibraneje (në literurën Hebraike) me emrin *Nusri*.

Emri *Nasura* (në formën Greke *Nazora*), që përdoret për hz. Isain, si emër për vetë atë dhe nxënësit e tij, është një emër i përdorur edhe nga hebrenjtë kundër veprimtarisë së hz. Isait. Për shembull, një shënim në Apocryphon of Johannes thotë:

“Dhe ajo ngjan një ditë kur Johni, vëllai i James - it, bijtë e Zebedee - së. Atje atij iu afrua një Ferisi me emrin Arimanius dhe i tha: Ku është zotëria juaj që po e ndiqni? Ai (Johni) tha: Ai shkoi nga ka ardhur. Ferisiu i tha: Ky *Nazoran* (*Nasurai*) ju ka mashtruar, jua ka mbushur mendjen me ashkla, jua ka thyer zemrat dhe ju ka kthyer nga tradita e baballarëve të tuaj”.<sup>249</sup>

Hebrenjtë nuk e thirrnin me këtë emër vetëm hz. Isain d.m.th., *Nasuraj* (*Nusrim*), por edhe pasuesit e tij:

“Në fakt ne këtë njeri (Shën Palin) e pranojmë (e dimë) si një intrigant, si konfuz në mesin e të gjithë heb-

<sup>248</sup> Nëse kemi parasysh se shkrimtari i Inxhilit të Filipit është i krishterë gnostik, do të kuptojmë se për ç’arsye shkrimtari nuk i jep termit *Nasura* (në Inxhil *Naazara*) kuptimin e vërtetë që në ibranishte do të thotë „të vëzhgosh, të mbrosh“, por i jep kuptimin „të jesh i vërtetë“ dhe „të lajmërosh të fshehtat“. Hz. Isain shkrimtari e sheh si shpëtimtar (redeemer) përplot me njohuri hyjnore (Gnosis), sekrete dhe të vërteta dhe për këtë termin *Nasura* e sqaron në mënyrë që të jetë sa më afër me të këtë cilësi të tij.

<sup>249</sup> Giversen, S., *Apocriphon of Johannis*, Copenhagen 1963, f. 47. Sidomos kth., Veprat e Apostujve 2:2; Gjoni 19:19 ; Epiphanius, op. cit., f. 117.



renjve në tokë (si turbullues) dhe si shef të fraksionit *nasura* (*nazoraion*).”<sup>250</sup>

Edhe Epiphaniusi shprehet se hz. Isai dhe pasuesit e tij në kohën më të hershme janë quajtur *nasuraj* (Epiphaniusi termin e përdor në formën në të cilën përmendet në Dhjatën e re, d.m.th. përdor formën *nazoraion*).<sup>251</sup>

Epiphaniusi thekson se ky emër nuk është përdorur nga pasuesit e hz. Isait, por, emri “Nxënësit e hz. Isait (apo Apostujtë)” atyre u është dhënë nga të tjerët. Epiphaniusi shton se, sado që pasuesit e hz. Isait nuk e kanë quajtur veten *Nasura*, ata nuk kanë reaguar kur janë quajtur nga të tjerët me këtë emër.<sup>252</sup>

Është e qartë se ka një lidhje në mes të të quajturit të hz. Isait dhe pasuesve të tij nga ana e hebrenjve si *Nasura* dhe rrymën si *nasurajzëm*, e cila në vete ngërthen edhe hz. Jahjanë edhe lëvizjen e sabiitëve, që ka ekzistuar qysh para hz. Isait dhe formimin e saj e ka vazhduar (edhe në kohën e z. Isait).

Siç kuptohet nga studimi ynë, rryma e *nasurajzmit* është një lëvizje që e përbënin njerëzit të cilët e kanë kundërshtuar konceptin zyrtar hebraik. Edhe lëvizja e hz. Isait synonte reformimin dhe kundërshtimin e konceptit zyrtar hebraik. Nga ky aspekt, ndërmjet lëvizjes së hz. Isait dhe rrymës së *nasurajzmit*, që ekzistonte që para hz. Isait, ka një paralelizëm. Qoftë hz. Isai, qoftë pasuesit e tij, ata ishin anëtarë të shoqërisë hebraike.

Siç kuptohet nga shënimet e ndryshme të Dhjatës së re, që i transmetuam më lart, lëvizjen e hz. Isait, hebrenjtë e vlerësonin brenda hebraizmit si një rrymë ekstremiste dhe si vazhdim të rrymës heterodokse të *nasurajzmit*, të cilën e kanë ditur që para hz. Isait.

---

<sup>250</sup> Veptrat e Apostujve, 24:5.

<sup>251</sup> Epiphanius, op. cit., f. 112.

<sup>252</sup> Vep. e cit., f. 117.



Përveç kësaj, është e njohur edhe lidhja në mes hz. Isait dhe hz. Jahjasë, i cili bënte pjesë në shkollën e *nasurajzmit*.

Shkaku që lëvizjen e hz. Isait hebrenjtë e vlerësonin si lëvizje të *nasurajzmit* heterodoks dhe që hz. Isain dhe pasuesit e tij i quanin *nasurajë*, do të kuptohet më mirë nëse merren parasysh specifikat e shoqërisë së parë të pasuesve të hz. Isait. Në tekstet e Dhjatës së re, e cila është shkruar duke u bazuar në doktrinën e Palit, bashkë me shprehjet që emërojnë hz. Isait dhe pasuesit e tij në kohën më të hershme, nga ana e hebrenjve si *nasurajë*, zënë vend njohuri objektive në lidhje me sistemin e mendimit dhe të besimit (shoqërisë) të parë të pasuesve të hz. Isait si dhe vlerësime të bazuara në doktrinën kishtare në periudhën pas Palit. Megjithatë, që nga shek. II pas erës sonë, (sipas shkrimtarëve të krishterë, të cilët përfaqësonin doktrinën e Kishës zyrtare) në veprat të cilat janë shkruar për të refuzuar fraksionet dhe shkollat e ndryshme (të tjera), që janë jashtë doktrinës zyrtare të Kishës, bëhet fjalë edhe për disa specifika të shoqërisë së periudhë së parë të hz. Isait.

Shkrimtarët Hippolytos, Tertullian, Eusebius, Epiphanius dhe Theodoret, në krye me atin e Kishës Irenaeus (130 - 200 pas erës sonë), që ka jetuar në shek. II pas erës sonë, flasin për një grup, i cili për shkak se ka dalë jashtë doktrinës së Palit, ka qenë i fajësuar për heretizëm nga Kisha zyrtare. Këta shkrimtarët e lartpërmendur i quajmë me emrin *Ebionitë*.<sup>253</sup> Në këto burime ebionitët përkufizohen si të lidhur plotësisht me ligjet hebraike, porse i pranojnë edhe mësimet e hz. Isait. Edhe pse për origjinën e termit ebionit, i cili për herë të parë është përdorur nga Irenaeusi dhe në hebraishte ka kuptimin “të varfërit”, janë shfaqur teori të

---

<sup>253</sup> Sih, Beveridge, W., *Ebionism, Encyclopedia of Religions and Ethics*, J. Hastings (ed.), v. 5, f. 139, vazhdon.

ndryshme,<sup>254</sup> dihet përfundimisht se ky emër është përdorur për shoqërinë e parë të hz. Isait, që ka ekzistuar para periudhës së tij (Palit). Nga shkrimtarë të krishterë të kohëve të mëvonshme, kjo shoqëri e parë, përveç me emrin ebionit, është quajtur edhe me emra të tjerë, emra këto që në disa raste, sikur janë për grupe që dallojnë nga njëri tjetri. Njëri prej këtyre emrave është termi *nasurajtë* (*nazura*). Një shembull është Epiphaniusi, i cili thekson se hz. Isai dhe pasuesit e tij janë quajtur nasuraj nga ana e hebrenjve. Në veprën e tij *nasurajtë* (*nazurajtë*) ai i paraqet ata si shkollorë *hebraiko-krishterë* dhe supozon se fraksioni ebionit është themeluar nga një person që ka qenë pasues i shkollës *nasura*.<sup>255</sup>

Karakteristikat themelore të shoqërisë së parë, të quajtur Ebionite, mund të radhiten kështu:

1. Edhe këta, sikur hz. Isai, gjenezën e kanë në shoqërinë hebraike.

2. Janë plotësisht të varur nga Ligji hebraik. I praktikojnë festivalet, festa e së Shtunës etj.

3. Me dallim nga hebrenjtë, ata besonin se hz. Isai është një peygamber dhe mesih dhe kundërshtonin mendimin për hyjnizimin (shenjtërimin) e hz. Isait, gjë që është sajuar më vonë nga ana e Palit.

4. Kishin marrëdhënie (lidhje) të afërta me Jakubin, vëllanë e hz. Isait.

5. Kishin Ungjillin e tyre të veçantë.

6. Në mesin e tyre kishte një grup që parapëlqente një jetë që kundërshton ngrënien e mishit dhe therjen kurban të kafshëve.<sup>256</sup>

---

<sup>254</sup> Krlh., Wilken, R.L., *Ebionites*, *Enciclopedia of Religions*, M. Eliade (ed.), v. 4, f. 576.

<sup>255</sup> Shih, Epiphanius, op. cit., f. 119 - 121. Mendimi i Epiphaniusit se ebionitët janë formuar nga një person me emrin Ebion, quhet i gabuar nga të gjithë studiuesit.

<sup>256</sup> Shih, Sarıçioğlu, E., *Baslangıçtan Günümüze Dinler Tarihi*, Stamboll 1983, f. 219, vazhdon; Wilken, R.L., op. cit., f. 576 - 577; Barclay, W., "Ebionites"



Sa mund të kuptohet nga shënimet e ndryshme të etërve të Kishës, ebionitët kanë ekzistuar në vende të ndryshme deri në shek. IV pas e.s.. Por, njohuritë për ta, për kohën e më vonshme janë shumë të pakta.<sup>257</sup>

Po të bëjmë një krahasim ndërmjet specifikave të ebionitëve, që përbënin shoqërinë e parë të hz. Isait dhe specifikave të shkollës të hebrenjve heterodoksë të *nasurajve*, që ekzistonin që nga periudha para hz. Isait, do të shohim një paralelizëm magjepsës. Kjo argumenton lidhjen e ngushtë në mes të hz. Isait dhe pasuesve të tij dhe rrymës heterodokse të *nasurajzmit*.

Përfaqësuesit e doktrinës së hebraizmit zyrtar, të mbështetur nga administratorët e huaj në vend, kanë kundërshtuar rreptësisht lëvizjen të cilën e kanë quajtur *nasurajzëm* dhe pasuesit e saj dhe, kohë mbas kohe, ua kanë përgatitur terrenin gjenocideve të mëdha. Më i rëndësishmi nga këto u realizua kundër sabiitëve (*nasurajtë - mandenët*), të cilët lindën në shkollën e nasurajzmit dhe kishin lidhje të ngushta me hz. Jahjanë.

Aty nga gjysma e parë e shek. I pas e.s. në Jerusalem dhe rrethina u ushtua një gjenocid kundër sabiitëve. Shumë sabiitë u vranë, ata që mbetën gjallë u detyruan të iknin, së pari drejt veriut e më vonë drejt jugut. Kjo ngjarje u bë shkak për saldimin urgjent të sabiitëve në kulturat e ndryshme të huaja dhe për largimin e tyre nga disa elemente të rëndësishme hebraike (të bërit synet dhe të praktikuarit e ndalesës së të Shtunës).

Në të njëjtën mënyrë të rreptë hebrenjtë kundërshtuan edhe hz. Jahjanë, hz. Isain dhe shoqërinë e tyre. Në ngjarjet që i hapën rrugë vrasjes së hz. Jahjasë, duke

---

in *A Dictionary of Christian Ethics*, ed., J. Macquarie, SCM Press Ltd. 1967, f. 95 - 96.

<sup>257</sup> Wilken, R.L., op. cit., f. 577. Këtu mund të mendohet për personat si Selman Farisiu, të cilët para se të bëhen ithtarë të hz. pejgamberit (Muhamedit a.s.), kanë qenë ithtarë të hz. Isait dhe kanë bërë një jetë të përafërt me islamin.



ia prerë kokën, dhe në orvatjet për zhdukjen e hz. Isait, duke e kryqëzuar atë dhe duke i ndjekur këmba këmbës pasuesit e tij, rol të rëndësishëm kanë luajtur kundërshtimet e forcave sunduese, të cilat kanë qenë të lidhura me traditën e hebraizmit zyrtarë, kundërshtime këto që janë formuar kundër rrymës heterodokse, të quajtur *nasuraizëm*.

Në Jerusalem dhe rrethina hebrenjtë nuk e quajtën hz. Isait dhe pasuesit e tij si *nasurajë* shumë kohë. Sipas fjalëve të Epiphaniusit, ata më vonë hebrenjtë i kanë quajtur *jesuanë* (*Jesaeaus*). Në lidhje me prejardhjen e këtij emri Epiphaniusi jep disa mundësi, por më e logjikshmja nga këto është se emri rrjedh prej vetë emrit të hz. Isait (*Jezus ose Jesu*) dhe se është përdorur për ata të cilët e pasojnë atë.<sup>258</sup> Në këtë rast *jesuanë* (*Yesuanlar*) ka kuptimin "Ithtarë të Isait" ose "Isevijtë" (*Isevitët*).

Epiphaniusi, thotë se shkrimtari hebraik Philo (Philo Judaeus v. 25 para e.s. - 40 pas e.s.), në librin e tij "*Jesuanët* (*Jessaeaus*)" jep njohuri për ceremonitë (ritet fetare), tempujt dhe specifikat e tjera të këtij grupi, që ka jetuar rreth kënetës Maraen. Epiphaniusi thekson se grupi për të cilin flet Philo, nuk është veçse një grup i krishterë.<sup>259</sup>

Ithtarët e hz Isait, në regjionin e Antakisë vetëm nga fundi i shek. I të e.s, kanë filluar të quhen "*Mesibitë*" (*Mesihiler*), që rrjedh prej fjalës *Mesib* (*Christ*), llagap ky që i vihet hz. Isait dhe ka kuptimin "*Të krishterët*" (*Christians*).<sup>260</sup>

Siç shihet, hz. Isanë dhe ithtarët e tij shoqëria hebraike i ka quajtur në fillim *nasura*, që është brenda rrymës së nasuraizmit; por më vonë janë quajtur me terma më të përshtatshëm për strukturën e lëvizjes, d.m.th. në fillim si *Jesuanë* (*Isevitët*) dhe më vonë si të krishterë (*Mesibitët*). Në tekste të ndryshme të Dhjatës së re këta tre ter-

---

<sup>258</sup> Epiphanius, op. cit., f. 112 - 113, 115.

<sup>259</sup> Vep. e cit., f. 115.

<sup>260</sup> Vep. Cit., f. 112, 115.

ma *Nasura*, *Isa* (*Jezus*) dhe *Mesih* (*Christ*) janë përdorur shpeshherë në kallëpi, si “*Jesaus - Nazaraus - Jessadekaus*” dhe “*Isa - Mesih*”, që i referohen hz. Isait.

Më në fund po i përmendim edhe *nasurajtë*, shkollë hebraiko - krishtere për të cilën bën fjalë Epiphaniusi në “*Panarion*” - in e tij. Sipas shkrimeve të Epiphaniusit, në shek. I pas e.s., në periudhën kur ithtarët e hz. Isait janë quajtur *jesuanë*, është formuar një shkollë të cilës i kanë thënë *nasuraj*. Këta njerëz ishin të lidhur ngushtë me traditën hebraike. Ata i bindeshin ligjit, bëheshin synet dhe i përmbaheshin ndalesës së të Shtunës. Porse, ndryshe nga hebrenjtë e tjerë, këta i besonin edhe hz. Isait. Sipas fjalëve të Epiphaniusit, këta pranonin se Isai është bir i Zotit. E megjithatë, mendimet se Isai është vetëm njeri apo që ka lindur nga Merjemeja (Maria) me anë të Shpirtit të Shenjtë, i kanë të ngatërruara. Në dallim nga hebrenjtë, këta e pranonin, krahas Dhjatës së re edhe Dhjatën e vjetër. Tërë Librin e Shenjtë e lexonin në ibransisht.<sup>261</sup> Epiphaniusi vë në dukje se ky grup ka jetuar edhe në kohën e tij (shek. IV pas e.s.) në vendet Bashan dhe Kokabe (Cocabe).<sup>262</sup>

Siç thamë më lart, sado që Epiphaniusi mundohet të tregojë se ebionitët dhe nasurajtë janë fraksione të ndryshme të krishtere, këta dy emra provojnë se janë të të njëjtit grup, d.m.th., të shoqërisë së parë të hz. Isait. Në fakt, çështjet të cilat i ka radhitur Epiphaniusi, si të qenët i lidhur me ligjet dhe traditën hebraike dhe të besuarit në hz. Isain janë prej specifikave më të qarta të ebionitëve. Sa i takon pranimin të nasurajve se hz. Isai është bir i Zotit, kjo specifikë mund të jetë e personave të cilët kanë thënë se janë pasues të këtij fraksioni dhe kanë jetuar në shek. IV pas e.s., në kohën kur ka jetuar Epiphaniusi.

---

<sup>261</sup> Vep. e cit., f. 115 - 117.

<sup>262</sup> Vep. e cit., f. 118.



Në lidhje me faktin pse ky grup e quan vetveten *nasura*, Epiphaniusi thotë se grupi nuk i ka pranuar emrat e *krishterë* dhe *jesuanë* të cilët u janë vënë ithtarëve të hz. Isait në saje të tij dhe në vend të këtyre emrave e kanë quajtur veten *nazora*, që është i barasvlershëm me emrin e vendit ku ka jetuar hz. Isai (*nazareth* ose *nazira*).<sup>263</sup> Ky mendim i Epiphaniusit qëndron paralelisht me mendimin për gjenezën e emrit *nasura*, i cili u është vënë hz. Isait dhe ithtarëve të tij nga ana e hebrenjve. Epiphaniusi supozon se në të dy rastet këta emra rrjedhin nga barasvlera e emrit të qytetit *Nazorath*. Por, sipas mendimit tim, ky emër, sikundër me emrin që i është vënë hz. Isait dhe ithtarëve të tij, nuk ka asnjëfarë lidhje as me qytetin *Nazareth*. Me fajësimin nga ana e hebrenjëve e hz. Isai dhe apostujt e tij janë *nasuraj* heterodoks, krahas asaj që ata janë quajtur *Nasuraj*, mund të jetë që shkolla Hebraiko - Krishtere vetëveten vetë mund ta kishin emruar me emrin *nazura* (*nasura*).

#### d. Përfundim

Këto që thamë mund t'i përmbledhim në sa vijon:

Sipas hebraizmit qendror, hz. Isai, nxënësit dhe ithtarët e tij të parë janë quajtur *nasuraj*, për arsye se kanë lidhje me shkollën e hebrenjve heterodoksë dhe me *nasurajtë*, të cilët, siç dihet, kanë jetuar më herët dhe gjenden jashtë konceptit të hebraizmit zyrtar. Por, më vonë, me zhvillimin e lëvizjes së hz. Isait, në vend që të quhen me këtë emër, quhen "*jesuanë*", që rrjedh prej Isa (është i njëvlershëm me emrin Isa) dhe më vonë me emrin "*të Krishterë*". Emrat *Jesuanë* dhe *i krishterë* nuk pëlqeheshin nga çdo ithtarë i hz. Isait. Përveç kësaj, një pjesë e tyre e pranoi

---

<sup>263</sup> Vep. e cit., f. 117.



emrin e parë, që u ishte vënë, d.m.th., emrin nasurajë, dhe kështu ata kanë vazhduar ta përdornin atë emër.

Emri nasuraj, që i ishte vënë hz. Isait dhe ithtarëve të tij nga ana e hebrenjve, u adoptua me disa mënyra të shprehurit të dialekteve të ndryshme në Mezopotomi dhe Gadishullin Arabik. Në tekstet në hebraisht të krishterët quhen *nusrim*, kurse në sirianisht përmenden si *nasranaje*. Ndërsa termi nasura në arabisht, që është një dialekt tjetër i aremejes, përdoret në formën *nasara*. Këtë term arabët e morën dhe e përdorën si emër për të gjithë të krishterët.

Kur'ani, i cili është shpallur në arabisht, kur flet për të krishterët, e përdor fjalën *nasara*, të cilin arabët e përdornin për ta. Termi *nasara* ka rrënjën e foljes *nasara - jensuru* në arabisht, ndërkaq me qytetin Nazarath në zonën e Palestinës nuk ka asnjë farë lidhjeje.

## Ungjilli i Bernabës\*

*Ebu'l-A'la el-Mevdudi*

S'ka dyshim se burime të besueshme dhe me vlerë për të fituar njohuri për Muhamedin a.s. nuk janë vetëm sihariqet e Isait, por, në të njëjtën kohë janë vetë jeta e Tij dhe katër ungjijtë legjitim të Kishës. Krahas tyre, burim me vlerë është Ungjilli i Bernabës, të cilin Kisha nuk e merr parasysh, për shkak se “përmbajtja e tij është e dyshimtë”. Është shumë interesante, se të krishterët kanë treguar zell shumë të madhë për ta fshehur këtë libër. Shekuj me radhë ai është mbajtur larg. Në shekullin e gjashtëmbëdhjetë, në bibliotekën e papa Sixtus - it gjendej një kopje e një përkthimi jo të rëndomtë latin dhe askujt nuk i lejohej që ta prekte. Vetëm në fillim të shekullit të tetëmdhjetë kjo kopje ra në dorën e të quajturit John Toland. Më pastaj, duke kaluar nëpër duar të ndryshme, në vitin 1738 arriti në bibliotekën e Perandorisë së Vjenës. Përkthimi anglisht i këtij Ungjilli u botua më 1907 nga shtëpia botuese Oxford - Clarendon. Por, me të dalë në shitje, vepra shkaktoi një shqetësim në botën e krishterë, ndërsa shumë prijës fetarë e përfaqësues të kishës i kaploi skepticizmi se përhapja e tepërt e librit në fjalë mund të bëhej shkak që feja e krishterë të humbej.

---

\* Teksti është marrë nga libri *Hazret Peygamber'in Hayati*, v. 1, Stamboll 1992, f. 113 - 124

Si pasojë, tirazhi i botuar u zhduk në mënyrë të fshehtë dhe të planifikuar. Nuk u bë e mundshme që përkthimi anglisht të botohej edhe një herë.

Në shekullin e tetëmbëdhjetë një botim i përkthyer nga latinishtja në spanjisht është hasur në biblioteka të ndryshme dhe në shitje. Këtë fakt e transmeton George Sell në përkthimin e tij anglisht të Kur'ani Kerimit. Por edhe ky përkthim është humbur. Për fat të keq, sot nuk gjendet askund një kopje e tij. Unë pata rastin të lexoj një kopje të përkthimit anglisht, të botuar në Oxford. Ungjillin e Bernabës e kam lexuar me kujdes. Sipas meje ky Ungjill, është një dhunti shumë e madhe për të krishterët dhe se ata, vetëm për shkak të fanatikëve dhe inatçinjve kanë mbetur më të varfër për këtë vlerë. Kudo që në literaturën e krishterë përmendej emri i tij, aty shënohej një kundërkomentim se fjala ishte për një Ungjill fals, prandaj është rekomanduar që të refuzohet. Disa prijës fetarë të krishterë të mangët nga shkenca kanë shkuar aq larg saqë kanë menduar se kjo është vepër e sajuar nga myslimanët. Kjo është një gënjeshtër e madhe dhe shkak i kësaj është fakti se në shumë vende në tekstin e këtij Ungjilli gjenden shënime të thukëta dhe të qarta për ardhjen e Muhamedit (a. s) në këtë botë.

Së pari, çdo njeri që e lexon, bindet në mënyrë të prerë se ai nuk është shkruar nga dora e myslimanit. Së dyti, po të ishte shkruar nga dora e një myslimani, myslimanët do ta njihnin shumë mirë dhe dijetarët myslimanë do ta theksonin shpesh dhe gjerë e gjatë veprat e tyre. Titullin e Ungjillit të Bernabës myslimanët asqë e kishin dëgjuar para se të përkthehej Kur'ani Kerimi në gjuhën angleze nga George Sell. Historianët, shkrimtarët, dhe fakihet që kanë qenë të informuar mirë me burimet e të krishterëve, si Taberiu, Jakupi, Mes'udi, Biruni, Ibn Hazmi, Ibn Tejmije dhe të tjerë, i përmendin katër ungjijtë



dhe krishterimin, por nuk kanë dhënë as edhe shenjën më të vogël për Ungjillin e Bernabës. Bibliografite më të besueshme dhe më të gjera të librave që gjenden në bibliotekat e shumta në botën islame janë të përgatitura nga Ibni Nedimi dhe Haxhi Halife (shih “El - Fihrist” dhe “Keshf edh - Dhunun”). Por as në këto nuk përmendet Ungjilli i Bernabës. Argumenti i tretë dhe më i forti për t’i shpallur të pabaza pretendimet e të krishterëve, madje që 75 vjet para ardhjes së Muhamedit a. s. në këtë botë, është përmendja e Ungjillit të Bernabës (*Evangelium Bernabe*) në listën e përgatitur “*Librat e gabuar dhe të kundërt me mendimin fetar*” në kohën e papa Gelasiusit I. A mund ta kishte shkruar në atë kohë ndonjë mysliman këtë Ungjill fals?

## **Disa njohuri themelore rreth Ungjillit të Bernabës**

Para se të fillojmë me myzhdet (sihariqet) dhe lajmet që gjenden në Ungjillin e Bernabës për ardhjen e Muhamedit a. s. si peygamber, së pari le të njoftohemi me këtë libër të cilin të krishterët nuk e kanë njohur mirë, ndërsa myslimanët nuk e kanë njohur fare, në mënyrë që ta kemi më të qartë rëndësinë, përmbajtjen dhe esencën e tij. Të qartë do të kemi sidomos arsyen që të krishterët e mbajtën larg këtë Ungjill. Është me rëndësi të dihet se asnjëri prej ungjijve, që në mënyrë të respektuar dhe legjitime zënë vend në Librin e Shenjtë, nuk është shkruar nga apostujt (shokët e Jezusit). Pastaj, asnjëri prej shkruesve të këtyre ungjijve nuk ka pretenduar se është bazuar në transmetimet e apostujve. Krahas këtyre përvetësimeve, nuk është shënuar burimi i asnjë shkrimi. Pra, nuk

dihet nëse vetë transmetuesi i ka dëgjuar fjalët, apo i ka parë ngjarjet. Në përgjigje të kësaj, shkruesi i Bernabës, thotë: *"Unë jam njëri nga dymbëdhjetë apostujt e parë të Mesias. Prej fillimit e deri në fund kam qenë me Mesian, ngjarjet që i kam parë me sytë e mi dhe fjalët që i kam dëgjuar vetë, i shkruaj në këtë libër"*. Nuk është vetëm kjo. Bernaba thotë edhe këtë: *"Mesia duke u shpërngulur nga kjo botë më ka urdhëruar që gënjeshtrove dhe thashethemeve që do të lindin për të, t'u jap fund duke ia shpjeguar botës të vërtetën"*.

Kush ishte Bernaba? Emri i këtij personi haset shpesh në *"Veprat e Apostujve"* të Librit të Shenjtë. Bernaba ka qenë pjesëtar i një familjeje çifute qipriote. Është e shënuar se ka dhënë kontribut të madh për përhapjen e krishterimit dhe për ndihmën që ua ka ofruar ihtarëve të Isait. Por, nuk është përcaktuar se kur e ka pranuar krishterimin. Në mesin e dymbëdhjetë apostujve të cilët përmenden në tre ungjijtë, emri i Bernabës nuk haset. Kështu që nuk është e qartë nëse shkruesi i këtij Ungjilli është ky apo ndonjë Bernabë tjetër. Nëse e krahasojmë listën e Mateut, të Markut dhe të Bernabës për apostujt, do të shohim se mes tyre vetëm dy emra janë të ndryshëm. I pari është Thomasi, në vend të të cilit Bernaba përdor emrin e vet, ndërsa i dyti është Shemun Kenani, në vend të të cilit Bernaba e shkruan emrin e Jakobit, birit të Jehudës (Juda). Ky emër ekziston edhe në Ungjillin e Llukës. Më vonë liderët dhe prijësit fetarë të krishterë, për ta shpëtuar veten nga Bernaba dhe Ungjilli i tij, ia kanë fshirë emrin dhe në vend të tij e kanë shkruar emrin e Thomasit.

Për të nderuarit dhe liderët e krishterë falsifikimet e këtilla për dobitë e tyre personale ishin më se normale. Një njeri i pavarur dhe me mendje të shëndoshë, që e lexon Ungjillin e Bernabës dhe pastaj e krahason atë me katër ungjijtë e Dhiatës së re do të konkludojë se ky është



të shumë më i mirë se të tjerët. Përjetimet dhe jeta e Jezusit në këtë Ungjill janë sqaruar më detajisht. Pikërisht siç vepron një njeri që i ka parë dhe i ka përjetuar ngjarjet. Rrëfimi i ngjarjeve në katër ungjijtë është bërë me ndërprerje dhe jo në lidhshmëri me njëra tjetrën, ndërsa në këtë të Bernabës ato janë më të kuptimta dhe më të drejta, e sidomos ngjarjet historike janë shënuar me një renditje më të kujdesshme.

Pastaj sugjerimet e Jezusit në këtë Ungjill, në krahasim me katër ungjijtë e tjerë, janë më të hollësishme, më të qarta dhe më të ndikueshme. Temat, si këshillat mbi monoteizmin, mohimin e politeizmit, cilësitë e Zotit të Lartësuar, esenca e adhurimit dhe morali i mirë janë shpjeguar në mënyrë më të logjikshme. Edhe shembulli më i vogël nga shembujt praktikë, të cilin e jep Jezusi për ta kuptuar më mirë temën dhe gjuhën të cilën e ka përdorur ai, e që gjendet në këtë Ungjill, është e pamundshme të gjendet në katër ungjijtë e tjerë. Nga kjo kuptohet se si Jezusi i ka këshilluar ithtarët dhe apostujt e vet. Njëherazi kuptohet edhe se çfarë metodash logjike ka përdorur ai. Një njeri që ka sadopak njohuri për gjuhën, metodën, natyrën dhe sjelljen e Jezusit, pasi ta lexojë këtë Ungjill, nxjerr përfundimin se ky nuk është fals ose i ndrequr nga ndokush. Nëse duhet ta themi të vërtetën, personaliteti dhe mësimet e Jezusit në Ungjillin e Bernabës, në krahasim me katër ungjijtë, dalin para nesh më të qarta dhe më të thukëta. Për më tepër, në këtë Ungjill nuk ekzistojnë kundërshtimet dhe të metat e dukshme që gjenden në katër ungjijtë.

Jeta dhe udhëzimet e Jezusit në Ungjillin e Bernabës përputhen plotësisht me jetën dhe udhëzimet e një profeti. Ai vetë përpara nesh del si peygamber dhe sjell prova për të gjithë peygamberët dhe librat e mëparshëm. Përveç profetizmit nuk ka rrugë tjetër për ta kuptuar të



vërtetën dhe ai që nuk i merr parasysh peygamberët nuk e merr parasysh as Allahun. Për Tevhidin - monoteizmin, profetizmin ky Ungjill thotë fjalë që përputhen me udhëzimet e të gjithë peygamberëve. Edhe për namazin, agjërimin dhe zeqatin udhëzon atë që është e duhur. Namazet të cilat shpesh cekën në Ungjillin e Bernabës në fakt janë namazet që i kanë të njohur edhe myslimanët, si namazi i sabahut, i drekës, i iqindisë, i akshamit, i jacisë dhe i tehexhudit. Posaçërisht bëhet e qartë se edhe para çdo namazi merret abdest. Jezusi/Isai në listën e peygamberëve i fut edhe Davudin dhe Sulejmanin. Ndërkaq, çifutët dhe të krishterët këta dy peygamberë i kanë nxjerrë prej listës së peygamberëve. Ai pranon edhe se Ismaili është *dhebib* (i bërë kurban për hir të Allahut), kështu që, një dijetar çifut, detyrohet ta pranojë këtë të vërtetë. Po ky dijetar thekson se çifutët, për dobi të tyre, mundohen që ta bindin çdo njërin se Ishaku ka qenë i bërë kurban.

Shkurt, sipas shënimeve të Ungjillit të Bernabës ligjëratat dhe këshillat e Jezusit për ahiretin, kijametin, xhenetin dhe xhehenemin pothuajse janë të njëjta me shpjegimet që bëhen në Kur'ani Kerim.

## **Pse të krishterët nuk e pranojnë Ungjillin e Bernabës ?**

Nëse e studiojmë çështjen pse të krishterët e kundërshtojnë kaq ashpër këtë Ungjill, do të shohim se shkak nuk janë vetëm shenjat e qarta të cilat i përmban ai për ardhjen e Muhamedit a. s., meqë të krishterët, në fakt, këtë Ungjill e kanë refuzuar që para lindjes së Muhamedit

a. s.. Në rreshtat e mëposhtëm do të mundohemi të sqarojmë shkakun e vërtetë të hidhërimit dhe të kundërshtimit të fortë të të krishterëve. Siç dihet, ithtarët e parë të Isait e njihnin atë vetëm si një peygamber dhe nuk u përmbaheshin pikë për pikë urdhrave të Tij. Këta - ithtarët e parë të Isait – kanë jetuar sipas ligjit çifut, d.m.th. në besimin dhe në ibadetet e tyre nuk kanë qenë të ndryshëm nga çifutët. Dallimi i vetëm ndërmjet të krishterëve të parë dhe çifutëve ka qenë ky: të krishterët e parë e pranojnë Jezusin si Mesia dhe i besojnë atij, kurse çifutët nuk e pranojnë atë si profet. Më vonë, Shën Pali, pasi e pranoi krishterimin, u mundua që romakët, grekët, çifutët, po bile edhe ata që nuk ishin çifut t'i bashkonte nën çatinë e krishterimit. Për këtë arsye themeloi një fraksion apo fe të re. Kjo fe e re, në aspektin e besimit dhe të principeve të besimit, ka qenë shumë më ndryshe nga feja të cilën është munduar ta përhapë Isai. Në të vërtetë, ky shenjtor asnjëherë nuk e ka parë Isain dhe nuk ka marrë këshilla nga ai. Sa kohë ka qenë gjallë Isai, po edhe disa vjet pas vdekjes, ai (Pali) ka qenë njëri prej kundërshtarëve të tij. Më vonë, si i krishterë, duke e themeluar fenë e re, ai ka vepruar sipas qejfit të vet, pa u bazuar në asnjë fjalë apo vepër të Isait; ai madje, ka vepruar të kundërtën – se qëndrimi i tij është inspirimi personal. Qëllimi kryesor i Palit në shpikjen e fesë së re është se kjo fe është e një cilësie që çdo popull i cili nuk është çifut padyshim se do të mund që ta pranojë atë. Përveç kësaj, deklaroi se një i krishterë është tërësisht i pavarur nga Ligji i Shenjtë hebraik. Ai nuk e pranon fare ndryshimin mes hallallit dhe haramit në ushqim dhe në pije. Edhe traditës së synetimit, e cila për joçifutët ishte shumë vështirë, i dha fund. Pali nxori edhe shumë teza të tjera të palogjikshme, siç është teza për superioritetin e Jezusit, se Jezusi është bir i Zotit dhe se me kryqëzimin e tij mori mbi vete dhe i lau të gjitha mëkatet e



bijëve të Ademit. Këto mendime dhe qëndrime për politeistët dhe për jobesimtarët ishin atraktive. Me këto ujdurma Shën Pali i magjeps ata dhe mundohet t'i nxit në fenë e re. Ithtarët e parë të Isait i kundërshtuan risitë dhe besimet e kota të këtij lloji.

Por ç'e do që mendimi satanik i Shën Palit ia hapi derën krishterimit dhe të gjithë ata që nuk ishin çifutë hynë me një hov të madh (në fenë e re)! Shumë të paktë në numër ishin ata që mundën esencialisht t'i përballonin kësaj torture. Edhe pastaj, deri në fund të shek. III të e. s., ka pasur shumë individë që e kanë mohuar shenjtërinë e Jezusit. Në fillim të shek. IV të e. s. këshilli i priftërinjëve, i mbledhur në Nike (325), mendimet dhe mejetimet e Shën Palit i ka pranuar si burime kryesore të krishterimit. Së këtejmi, edhe Perandoria Romake e pranoi krishterimin si fe zyrtare. Kjo ngjarje u përforcua me nxjerrjen e një ligji në kohën e perandorit Theodoseus. Pas këtij të gjitha veprat dhe dokumentet që ishin kundër besimit të Shën Palit u shpallën jolegjitime. Për herë të parë në vitin 367 të e. s., në përputhje me letrën e Athanasiusit, është përgatitur lista e veprave dhe e dokumenteve të respektuara dhe legjitime. Këtë listë e ka aprovuar Këshilli i mbledhur nën udhëheqjen e papës Damasius në vitin 382. Ndërkaq në fund të shek. V, papa Gelasius, krahas vërtetimit të kësaj liste, urdhëroi që të përgatitet edhe lista e dokumenteve dhe e veprave jolegjitime. Është interesant se për klasifikimin e veprave të lartpërmedura, nëse janë legjitim apo jo, kriter i vetëm kanë qenë besimi dhe parimet të cilat i ka përshtatur vetë Shën Pali dhe asnjëri prej të krishterëve apo etërve të kishës nuk ka marrë rrezikun në sy e të thotë nëse këto u përshtaten apo jo direktivave të Jezusit. Madje, në ungjijtë e përfshirë në përmbledhjet e veprave legjitime dhe valide nuk ka asçfarë shënimi për fjalët dhe veprat e Jezusit.



Merret vesh që Ungjilli i Bernabës është shënuar në fillim të listës së veprave jo legjitime dhe jo valide. Shkaku kryesor qëndronte te përmbajtja e tij, e cila ishte në kundërshtim me parimet dhe besimin fetar zyrtar, që mbretëronte asokohe. Autori i librit në fillim tregon arsyen pse ka marrë në dorë lapsin për ta shkruar këtë libër: *”Qëllimi i këtij libri është përmirësimi i mendimeve të atyre të cilët për t’iu përshtatur dredhive të shejtanit deklarojnë se Jezusi është biri i Zotit. Këta njerëz synetimin e meshkujve e pranojnë si të panevojshëm, ushqimet që janë haram i bëjnë hallall. Në mesin e atyre që e bëjnë këtë gabim gjendet edhe Shën Pali”*. Siç shpjegon Bernaba, edhe në gjallje të Jezusit ushtarët romakë politeistë, të cilët edhe pse i kanë parë mrekullitë e Isait, kanë thënë se ai është biri i Zotit, madje edhe kanë filluar të thonë se është Zot. Më vonë me këtë besim të gabuar janë infektuar edhe çifutët. Zhvillimet e mëpastajme Bernaba i transmeton kështu: *”Jezusi është demoralizuar shumë për zhvillimet e këtilla. Shumë herë, atyre që grumbulloheshin për rreth tij ua tërbiqte vërejtjen dhe i qortonte ashpër besimet e kota. Nxënësit e tij i dërgonte në zona të ndryshme. Këta nxënës, në saje të lutjeve të tij, mu si vet ai, i tregonin popullit disa mrekulli. Qëllimi i këtij demonstrimi (të mrekullive) është që të tregohet qartësisht se njeriu të cilit i bëhen të mundshme këto mrekulli nuk duhet të jetë Zot apo Bir i Zotit”*.

Pastaj Bernaba transmeton biseda të ndryshme të Jezusit në lidhje me këtë temë. Prej këtyre bisedave kuptohet qartë se sa ai ka qenë kundër besimeve të kota të përhapura në popull. Bernaba thotë se ishte shumë i brengosur për devijimin e popullit të Isait nga rruga e vërtetë. Ai e përgënjeshton ashpër sidomos besimin e përgjithshëm të Shën Palit për vdekjen në kryq të Jezusit dhe ngjarjet që i ka parë me sytë e tij i shpjegon në këtë mënyrë: *”Nxënësi Jebuda (Judah, Judas), duke marrë rryshfet prej një kryerabini erdhi për ta zënë Isain. Katër engjëj, me urdh-*

rin e Zotit, Isain e ngritën në qiell dhe zëri e fytyra e Jehudës u bë e njëjtë me të tij. Kështu që, i kryqëzuar nuk ishte Isai por vet Jehuda”. Kjo shprehje në Ungjillin e Bernabës, siç u pa, edhe pse i gërmon rrënjët e krishterimit, sjell prova bindëse për atë që thotë Kur’ani Kerimi. Nuk duhet habitur aspak se plot 115 vjet para zbritjes së Kur’anit këto shënime në Ungjillin e Bernabës ishin shkak që ky të shpallej jo legjitim nga ana e njerëzve të Kishës.

## Lajmet dhe shenjat e qarta në Ungjillin e Bernabës

Çështjet të cilat i cekëm shkurtimisht më lart, mjaftojnë për të pranuar se Ungjilli i Bernabës është më i besueshmi nga katër ungjijtë. Në këtë Ungjill fjala, vepra dhe biografia e Mesias është shpjeguar në përputhje me të vërtetën. Mjerisht, të krishterët e kanë humbur shansin që kredonë, parimet e besimit dhe direktivat e Jezusit t’i mësojnë apo t’i përmirsojnë me anë të këtij Ungjilli.

Pas këtyre shpjegimeve, mendojmë se mund t’i paraqesim këtu lajmet dhe shenjat që gjenden në Ungjillin e Bernabës për ardhjen e Pejgamberit (Muhamedit a.s.) të transmetuara nga goja e Jezusit/Isait. Në lajmet në fjalë për Muhamedin a.s. Isai ka përdorur ndonjëherë fjalën “Resulullah”, kurse ndonjëherë “Mesih”, ndonjëherë shprehjen “Ai i cili është i denjë për lavdërim”, ndonjëherë “Lailabe illa Allah Mubammedur – Rasulullah” (Allahu është një dhe Muhamedi është i dërguari i Tij). Aq të shumta janë shenjat që i ka thënë Isai për Hz. Muhamedin, sa për t’i sqaruar të gjitha ato do të nevojitej një libër më vete. Që t’i transmetojmë të gjitha këto është e pamund-



shme. Ne këtu do të transmetojmë vetëm disa lajme më të rëndësishme:

*“Profetët që Zoti i ka dërguar, numri i të cilëve është 124 mijë, kanë folur në mënyrë të komplikuar. Ndërsa pas meje do të vijë Drita e të gjithë profetëve dhe e të gjithë krijesave të shenjta, e cila do t’ua sqarojë dhe shpjegojë fjalët e profetëve. Për shkak se Ai është i Dërguari i Zotit”. (Kapitulli, 17).*

*“Farisijtë dhe Levitët i thanë Jezusit se, pasi që ti nuk je as Mesia, as Iljasi e as ndonjë i Dërguar tjetër, atëherë pse ligjëron dhe jep këshilla të reja dhe pse vetveten e paraqet më të madhë se Mesia. Jezu Krishti tha se, qëllimi i Zotit në paraqitjen e mrekullive përmes meje është që t’ju tregoj juve se ato që i bëj unë janë në përputhshmëri me dëshirën e Zotit. Përndryshe unë nuk e quaj vetveten më të madh se Ai (Mesia) për të cilin flas. Unë nuk jam në atë nivel, as që kam mundësi t’ia zgjidh lidhëzat e këpucëve apo rruazën e çorapëve të tij. Ai, Mesia, është krijuar para meje dhe ai do të vijë pas meje. Ai do t’i sjellë të vërtetat e fesë, të cilat nuk do të kenë fund”. (Kapitulli, 42).*

*“Ju them duke u betuar se çdo profet ka ardhur si shenjë e mëshirës së Zotit për një popull. Për këtë shkak direktivat e këtyre profetëve nuk kanë dalë jashtë komunitetit apo popullit të cilit i janë dërguar. Por me të ardhur i Dërguari i Zotit do t’ia jap atij në dorë vulën. Derisa të gjithë popujt e botës të cilët i kanë marrë direktivat e Tij, të ballafaqohen me paqen dhe me mëshirën (e Zotit). Ai do t’i sundojë pabesimtarët dhe idhujtarinë, ashtu do ta zhdukë nga sipërfaqja e tokës saqë shejtani nuk do të gjejë vrimë për të ikur” (pas këtyre rreshtave që vend një bisedë e gjatë e Jezusit me nxënësit e Tij. Në këtë bisedë Jezu Krishti shpjegon se profeti i ardhshëm do të jetë prej Bijve të Izraelit). (Kapitulli, 43).*

*“Juve për këtë arsye ju them se, Profeti është një kënaqësi për të gjitha krijesat e Zotit. Meqë ai është përplot me ndjenja të mira si të kuptuarit, të këshilluarit; me urtësi, fuqi, zell, dashuri. Ai është i armatosur me frymë të bujarisë, mëshirës, drejtësisë, devotshmërisë, të së vërtetës, mirësisë dhe të durimit. Atij, nga këto cilë-*



si i është dhënë tri herë më tepër në krahasim me krijesat tjera të cilat i ka krijuar Zoti. Ardhja tij në botë do të jetë një moment i shenjtë. Besoni se unë atë e kam parë dhe e kam nderuar. Ashtu sikur të gjithë profetët e tjerë që e kanë parë dhe e kanë dëgjuar atë. Zoti duke e parë shpirtin e tij i dhuroi profecinë atij. Edhe unë kur e pashë atë nga entuziazmi mu dridh shpirti dhe i thashë: “O Muhamed! Zoti të ndihmostë dhe mua Zoti të më bëjë të denjë që të mund të t’i lidh lidhëzat e panrofeleve tua. Në fakt nëse unë e arrij këtë do ta quaj veten një profet të madh dhe krijesë të shenjtë të Zotit “. (Kapitulli, 44 )

“(Pasi do të largohem nga këtu) Zemra juaj mos të rënkojë dhe ju mos u frikësoni. Sepse unë nuk jam krijuesi juaj. Krijuesi im dhe i juaji është Zoti dhe Ai do t’ju mbrojë. Sa për mua, unë tash jam duke e përgatitur terrenin për të Dërguarin e ardhshëm të Zotit, i cili do të sjell paqe dhe shpëtim...Andreasi tha : ”O mësues, na trego neve disa cilësi të qarta të tij që ta njohim atë.” Jezui Krishti tha: Ai nuk do të vijë në kohën tuaj, përkundrazi, ai do të vijë më vonë. Deri në atë kohë Ungjilli im ashtu do të jetë i falsifikuar, sa që në botë do të ketë vetëm 30 besimtarë. Atëherë Zoti do t’i dhimset bota dhe do të dërgojë të Dërguarin e vet. Mbi kokën e atij profeti do të ketë një re (mjegull). Në saje të kësaj mjegulle do të bëhet e qartë se është i afërt dhe i dashur i Zotit, dhe se përmes tij bota do të bëhet do të falet nga ana e Zotit. Ai do të vijë me një fuqi të madhe kundër pabesimtarëve dhe idhujtarinë do ta pastrojë nga sipërfaqja e tokës. Dhe unë nga kejo jam plotësisht i kënaqur dhe në fakt në saje të tij do të njihet dhe do të shenjtërohet Zoti ynë dhe se ai do t’ia shpjegojë të vërtetën botës. Veçanërisht, ai do të hakmerret ndaj atyre të cilët mua do të më mendojnë diç më tepër se njeri...Ai do të vijë ashtu me një të vërtetë sa që ajo do të jetë më e qartë dhe më e thukët se të gjitha të vërtetat të cilat i kanë sjellë të gjithë profetët.” (Kapitulli, 72)

“Në Kudus (Jerusalem) apo në tempullin e Sulejmanit është dhënë fjalë (betuar) për Zotin? Por besoni fjalët e mia se do të vijë një ditë ku mëshira e Zotit do të shpallet në një qytet tjetër. Pastaj në çdo vend do t’i bëhet ibadet Atij në mënyrë të vërtetë dhe në çdo vend Zoti me mëshirën e

*Tij do ti pranojë adhurimet e vërteta...Unë në të vërtetë jam dërguar si shpëtimtar për popullin e Izraelit. Por pas meje do të vijë Mesia, të cilin Zoti do ta dërgojë për tërë botën. Ai është ashtu një profet që Zoti e ka krijuar tërë botën vetëm për të. Atëherë në botë do të adhurohet vetëm Zoti dhe mëshira e Tij do të shpallet në çdo anë.” (Kapitulli, 83)*

*“(Mesia kryepristit i tha:) Betohem në Zotin, i cili është i gjallë dhe në duart e të cilit gjindet shpirti im. Unë nuk jam ai Mesia të cilin e presin bota. Zoti premtimin për këtë profet ia ka dhënë Ibrahimit, duke i thënë: “Nëpërmes gjeneratës suaj të gjithë popujt e botës në sipërfaqen e tokës do të fitojnë bollëk” (Lindje, 22:18). Pasi që Zoti të më ngrejë (lartësojë) mua nga kjo botë. Satani përsëri do të ngrejë kryet dhe ata të cilët nuk do të jenë besimtarë do të supozojnë se unë jam Zoti dhe Biri i Zotit. Për këtë shkak fjalët dhe direktivat e mia do të falsifikohen. Deri atëherë saqë nuk do të mbeten vetëm se 30 besimtarë. Atëherë Zotit do t’i dhimsset bota dhe do ta dërgojë profetin e Tij. Ai është një profet për të cilin është krijuar e tërë bota. Ai profet me tërë fuqinë e tij do të vijë nga jugu dhe do t’i zhdruk të gjithë idhujt bashkë me idhujtarët e tyre. Satanit do t’ia marrë udhëheqësinë dhe do ta sjellë mëshirën e Zotit për t’i shpëtuar ata të cilët i kanë besuar Atij. Ju lumtë atyre të cilët do ta dëgjojnë fjalën e Tij.” (Kapitulli,96)*

*“Kryepristi pyeti: “A do të vijë profet tjetër pas këtij profeti të Zotit? Mesia iu përgjigj: “Pas këtij kështu profet i vërtetë i dërguar nga ana e Zotit nuk do të vijë, por, do të vijnë shumë profetë të vrrejshëm. Unë për këtë jam shumë i brengosur. Për arsye se Djalli për shkak të vendimit të drejtë të Zotit, do të mundohet t’i nxjerrë në shesh. Dhe ata (pabesimtarët) do të fshihen pas perdes së Ungjillit tim.” (Kapitulli, 97)*

*“Kryefalshiu pyet: “Ky Mesia me çfarë emri do të thirret? Jezui Krishti tha: Emri i këtij Mesia do të jetë “I denjë për laudërim”. Respektivisht, kur Zoti e ka krijuar shpirtin e tij ia ka dhënë atë emër. Dhe atij i është bërë një trajtim i posaçëm. Zoti tha që: O Muhamed, prit se për ty do të krijoj xhenetin, botën dhe shumë gjëra të tjera, dhe të gjitha këto do të t’i jap ty dhuratë. Deri atëherë kur, atyre të cilët të urrejnë Ty t’u jepet bollëk dhe ata të cilët të mallkojnë Ty të mallkoohen. Unë kur do të të dërgoj ty në botë do të dërgoj si lajmërues i shpë-*



*timit. Fjalët e tua do të jenë të vërteta. Ashtu që toka dhe qielli do të zhduken por feja jote do të qëndrojë. Pasi është ashtu emri i tij është Muhamed.” (Kapitulli, 97)*

Bernaba tregon se Jezusi, duke u ligjëruar nxënësve të tij, u tha: “Njëri prej nxënësve të mi mua do të më shesë te armiku për 30 monedha (sikke) ( më vonë doli se ishte Jehuda, Judah apo Judas) dhe shtoi: “Pas kësaj ai i cili do të më shesë, jam i bindur se do të vritet në emrin tim. Kështu që Zoti do të më ngrejë prej toke në qiell dhe fytyra e tij (shitësit tim) ashtu do të ndryshohet që çdo kush do të mendoj se jam unë. Megjithatë, vdekja në mënyrë të keqe do të hapë rrugë për njollosjen time. Por, njolla mbi mua do të pastrohet me ardhjen e Muhamedit, gjegjësisht, të Dërguarit të Shenjtë të Zoti. Zoti këtë do ta bëjë për shkak të besnikërisë që e kam treguar. Ai do të më jap shpërblimin. Në këtë mënyrë çdo kush do të kuptojë jetën time dhe (do ta ketë të qartë) se unë nuk kam pasur aspak lidhje me një vdekje të poshtër”. (Kapitulli, 113). ”(Jezusi nxënësve të tij u tha:) Pa dyshim unë juve ju them se, sikur të vërtetat të mos ishin nxjerrë nga libri i Musait, Zoti babait tonë Davudit nuk do t’i jepte libër tjetër. Dhe sikur të mos ishin bërë ndryshime në librin e Davudit, Zoti nuk do të ma jepte nua Ungjillin. Meqë Zoti nuk ishte (as) falsifikues e (as) ndryshues. Ai çdo profeti i ka dhënë të njëjtin mesazh. Kur ai, profeti, erdhi i pastroi të gjithë infektimet që ia kanë bërë librit tim mosbesimtarët”. (Kapitulli, 124).

## **Suprimimi i tri ndryshimeve**

Në këto lajme dhe shenja të qarta dhe të thukëta vetëm tri gjëra janë të dyshimta. Në vende tjera në Ungjillin e Bernabës, theksohet me këmbëngulje se Jezusi nuk ka qenë vetë Mesia. Së dyti, jo vetëm në transmetimet e përmendura më lart, por edhe në shumë vende në Ungjill është përkujtuar qartë se emri i tij origjinal arabisht është “*Muhamed*”.



Është vërejtur se profetët, kur kanë lajmëruar për ardhjen e tij u kanë ikur fjalëve të thukëta, veçanërisht nuk kanë dhënë emra të personave. Së treti, është të bërët fjalë në shprehjet e lartpërmendura për Muhamed Mustafanë a.s. si “*Mesib*”. Për dyshimin e parë mund të themi se jo vetëm në Ungjillin e Bernabës, por edhe në Ungjillin e Llukës ka shënime se Jezusi ka urdhëruar nxënësit dhe apostujt e tij të mos i thonë “*Mesia*”. Shprehjet në Ungjillin e Llukës janë këto: “*Ai ata i pyeti: Ju si më thirni mua? Pjetri iu përgjigj: Mesia i Zotit*”. Për këtë i urdhëroi: “*këtë mos ia thoni askujt*”. (Kapitulli, 9:20-21). Prandaj, ne mendojmë se, shkak i këtij ndalimi është mosdashja e Jezusit që të ngatërojë emrin e tij me Mesian e pritur. Siç dihet, bijtë e Izraelit presin qëmoti ardhjen e Mesias. Sipas tyre Mesia me shpatën e tij do t’i mundë të gjithë armiqtë e Zotit. Pra, për këtë edhe Jezusi ka qenë i detyruar të tregojë se ai vetë nuk është Mesia, i cili pritet të vijë, dhe se Ai do të vijë pas tij. Sa i takon dyshimit të dytë, në përkthimin latinisht të Ungjillit të Bernabës, i cili aktualisht ekziston, me të vërtetë emri i Pajgamberit Fisnik haset si Muhamed. Por askush nuk e di se nga cila gjuhë, përkthim mbi përkthim ka ardhur deri te përkthimi latinisht. Është e mundshme që Ungjilli i Bernabës të jetë në sirianishte.

Siç u cek më herët, sirianishteja e vjetër ishte gjuha e Jezusit dhe e apostujve. Po të ekzistonte origjinali i librit, do të ishte e mundshme të kuptohej se si është shkruar emri i Muhamedit a.s.. Sipas bindjes sonë, siç kemi thënë më herët, kur kemi bërë fjalë për përkthimin e Ungjillit të Gjonit nga ana Ibn Ishakut, Jezusi në të vërtetë ka përdorur emrin “*Munhamanna*”. Ka mundësi që kjo fjalë në përkthime të ndryshme të jetë dhënë në mënyra të ndryshme. Më vonë, ndoshta ndonjëri nga përkthyesit e ka shkruar emrin e tij Muhamed, duke parë se emri i peygamberit të paralajmëruar është gati i njëjtë me emrin Muhamed. Për këtë arsye, është gabim të supozohet se Ungjilli i Bernabës është shkruar nga

dora e një myslimani, vetëm ngaqë emri i Muhamedit, siç shihet, është shkruar qartë në të.

Sa i takon pikës së tretë, në të vërtetë “Mesia” është një term izraelit. Ky term është përdorur në Kur’ani Kerim për t’i bindur çifutët, të cilët mohojnë se Jezusi është Mesia. Përndryshe, ky term nuk është as i Kur’ani Kerimit e as që është përdorur në Kur’an në kuptimin të cilin kanë synuar çifutët ta përdorin. Nëse Isai ka përdorur fjalën Mesia për Muhamedin a.s., dhe nëse kjo shprehje në Kur’an nuk është përdorur, nuk do të thotë se i është veshur diçka Muhamedit a.s., që është në Ungjillin e Bernabës e nuk është në Kur’an. Në të vërtetë, në mesin e bijve të Izraelit ka pasur një traditë të këtillë. Kur diçka apo dikush është caktuar të shenjtërohet ata persona apo ato gjëra shenjtërohen duke i stërpikur me yndyrë njerëzit mbi kokë dhe gjërat sipër. Në hebraisht veprimit stërpik me yndyrë i thuhet “*mesh*”, ndërsa atyre që e stërpikin kokën e tyre quhen “*mesih*”. Çanakët, pjatat, gotat dhe poçet të cilat gjindeshin në tempull dhe në vendet e adhurimit, bëheshin *mesh* dhe shenjtëroheshin për adhurim. Fallxhinjtë dhe priftërinjtë, kur arrinin gradën e priftit, bëheshin mesh (shenjtëroheshin). Në të njëjtën mënyrë shenjtëroheshin edhe mbretërit dhe pejgamberët, duke vënë kurorën apo duke arritur në nivelin e profecisë. D.m.th. në historinë e bijve të Izraelit, sipas Ungjillit, ka pasur raste të shumta të “Mesh” - it dhe të “Mesih” - ut. Përveç kësaj, Haruni a.s., përveç lajmëtar, ka qenë edhe Mesih. Musai a.s. ka qenë lajmëtar dhe nebij, Taluti mbret, Davudi a.s mbret dhe pejgamber, Sadaku sundues dhe fallxhor dhe Eljesa si nebij. Të gjithë këta kanë qenë mesih. Më vonë, tradita e stërpikjes me yndyrë u zhduk. Ndërkaq, përcaktimi i ndonjërit nga ana e Allahut, për ndonjë pozitë apo për ndonjë detyrë, u bë e njëjtë me të bërit “mesh” apo të shenjtërimit. Për shembull, në *Mbretërit I, kapitulli 19*, është e shënuar se urdhri i Zotit i është dhënë Iljasit se, Haz’ajili, pasi të bëhet mesh, do të bëhet sundimtar i Aramit (Sirisë), djali i Nemiut si të bëhet mesh, do të bëhet sundimtar i Izraelit dhe si të bëhet mesh

Eljesa do të bëhet peygamber në vend të Iljasit. Koka e asnjërit prej tyre nuk është stërpikur me yndyrë. Vetëm se, shpallja se janë sjellë në detyrë nga ana e Zotit, ka kuptimin e të bërit mesh (shenjtërimit). D.m.th., sipas traditës dhe të kuptuarit e bijve izraelit fjala “*mesih*” ka kuptimin “*të ngarkuarit me detyrë nga ana e Zotit*”. Edhe Jezusi fjalën *Mesia* për Muhamedin a.s. e ka përdorur në këtë kuptim.<sup>264</sup>

---

<sup>264</sup> Për shpjegime më të hollësishme për të të kuptuarit e fjalës *mesih* nga ana e izraelitëve shih, *Encyclopedia of Biblical Literature*, materijen *Messiah*.



## Isai në Kur'an\*

*Muhammad Ata ur - Rahim*

Kur'ani, Libri i fundit i shenjtë, të cilin Krijuesi ia shpalli Pejgamberit të fundit, është burim për njohjen e Jezusit (Isait), që është i panjohur edhe për shumë studiues të krishterimit. Kur'ani nuk na udhëzon vetëm ta njohim më mirë Isain, por, gjithashtu, na shton edhe më tepër respektin dhe dashurinë ndaj tij. Shpallja e fundit, e cila ka ardhur afër gjashtëqind vjet pas lindjes së Isait, na njofton me më të rëndësishmen për jetën dhe mësimet e tij, kurse rolin e tij si pejgamber, për të cilin uniterianët sajajnë gënjeshtër, e vë në një perspektivë të gjerë. Kur'ani jep perspektiva të cilat nuk mund t'i japë ndonjë burim tjetër.

Kur'ani nuk e përshkon jetën e Isait në hollësi, siç bën për ngjarjet specifike. Atij i referohet vetëm me muhizet dhe fuqinë që i është dhënë, në të shumtën e rasteve me shprehje të përgjithshme. Librit, të cilin ai e ka marrë nga Allahu, gjegjësisht Inxhilit, që përmendet disa herë (në Kur'an), nuk i provohet përmbajtja ekzakte. Mirëpo, Kur'ani është shumë specifik sa u takon qëllimeve të tij, si u shfaq ai (Isai) në tokë, kush është ai, dhe, me peshë paralele, kush nuk është ai dhe si përfundoi misioni i tij.

---

\* Teksti është marrë nga vepra *JESUS A Prophet of Islam*, 1979 Londër, f. 206 - 220

Para se të vëzhgojmë jetën e tij, do të na ndihmonte ekzaminimi se ç'ishte funksioni i tij në tokë, si ai iu përshtat modelit që ka ardhur para tij dhe do të vijë pas tij: ai (Kur'ani) përsëri, dhe përsëri ngul këmbë se Isai është një nga vargu i gjatë i pejgamberëve të cilët i janë dërguar popujve të kësaj bote; se ai është pejgamber, udhëzimet dhe mësimet e të cilit ishin riafirmim dhe vazhdim i udhëzimeve të pejgamberëve të dërguar para tij, dhe, gjithashtu, një përgatitje për udhëzimet me të cilat do të dërgohen pejgamberët që do të vijnë pas tij.

Përmendja e Isait në Kur'an bëhet që më herët:

*“Ne i patëm dhënë Musait librin dhe pas tij patëm dërguar shumë pejgamberë. Isait, birit të Merjemës i dhamë argumente (mrekulli) dhe e fuqizuam me (Xhibrilin) shpirtin e shenjtë...” (Bakara, 87).*

Paragrafi vijues i Kur'anit na përkujton vargun e pejgamberëve, pjesë e të cilit është edhe vet Isai. Pas përmendjes së Ibrahimit ajeti vazhdon kështu:

*“Ne atij (Ibrahimit) i falëm Ishakun dhe Jakubin dhe secilin prej tyre e udhëzuam. Më parë edhe Nuhun e patëm udhëzuar. E nga pasardhësit e tij (të Ibrahimit) udhëzuam Davudin, Sulejmanin, Ejjubin, Jusufin, Musain dhe Harunin. Kështu i shpërblejmë bamirësit. Shpërblyem edhe Zekerianë, Jahjanë, Isain, Ilijasin, të gjithë prej të mirëve të përsosur. Shpërblyem edhe Ismailin, Eljesanë, Junusin dhe Lutin. Të gjithë këta i veçuam mbi njerëzit e tjerë.” (En'am, 84 - 86).*

Ndërkaq kjo listë e pejgamberëve nuk është e plotë, por ka edhe:

*“Dhe (dërguam) të dërguar më parë që të rrëfyem për ta, dhe të dërguar të tjerë për të cilët nuk të rrëfyem...” (Nisa, 164).*

Në fakt, Muhamedi, paqja e Allahut qoftë mbi të, thotë se Isai është njëri prej njëqind e njëzet e katër mijë pejgamberëve, mes të cilëve nuk ka shkak apo argument për konflikt. Allahu në një paragraf të Kur'anit i thotë pejgamberit të Tij:

*“Thuaj: Ne i kemi besuar Allahut, edhe asaj që na u zbrit neve edhe asaj që i është zbritur Ibrahimit, Ismailit, Ishakut, Jakubit dhe pasardhësve. Edhe asaj që i është dhënë Musait dhe Isait, edhe asaj që u është zbritur të gjithë peygamberëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë kurrfarë dallimi në mes tyre dhe ne vetëm Atij i jemi dorëzuar.” (Ali Imran, 84).*

Të gjithë peygamberët kanë qenë mirë të informuar (të vetëdijshtë) se të gjithë ata kanë qenë të dërguar nga ana e Allahut për një qëllim dhe me mesazh të njëjtë:

*“(përkujto) Kur Ne morëm (me betim) prej peygamberëve premtimin e tyre; edhe prej teje, prej Nuhut, Ibrahimit, Musait, Isait birit të Merjemes, pra morëm prej tyre besë të fortë. Për t’i marrë në pyetje këta të sigurtë për sigjeritetin e tyre, e për jobsimtarët Ai ka përgatitur ndëshkim të dhembshëm.” (Ahzab, 7 - 8).*

*“(Ne u patëm thënë) O ju të dërguar, hani atë që është e lejuar dhe e mirë dhe bëni vepra të mira se unë e di atë që ju veproni. Kjo fe juaj është e vetmja fe e Unë jam Zoti juaj, ruajuni dënimit Tim.” (Mu`minun, 51 - 52).*

*“Ai ju përcaktoi juve për fe atë që ia pati përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me çka e patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain. (I porositëm) Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të...” (Shura, 13).*

Kështu, figura që shpaloset (për Isain) nuk paraqet veçse njeriun e rëndësishëm që është paraqitur në tokë, si një ngjarje e izoluar në një botë tjetër kaotike, ndërkaq, sa i takon peygamberit Isa, ai, si edhe të gjithë peygamberët e tjerë, ka qenë i dërguar për kohën dhe periudhën e tij. Një pjesë e urdhrave të tij shpalosin universin:

*“Ne vazhduam gjurmët e tyre (të peygamberëve) me Isain, birin e Merjemes, vërtetues i Tevratit që kishim më parë. Atij i dhamë Inxhilin, që është udhëzim i drejtë dhe dritë, që është vërtetues i Tevratit që kishin më parë, që ishte udhëzues dhe këshillues për të devotshmit.” (Maide, 46).*



Përveç kësaj, koha, kur Isai ka qenë plotësisht i vetë-dijshëm, ka qenë e kufizuar; e kufizuar me kohën para dhe pas tij:

*“Dhe, kur Isai, bir i Merjemes, tha: O bijë të Izraelit, unë jam i dërguar i Allahut te ju, jam vërtetues i Tevratit që ishte para meje dhe jam përgëzues për një të dërguar që do të vijë pas meje, emri i të cilit është Ahmed!... ”. (Saff, 61).*

Koncepti dhe lindja e Isait janë të regjistruara në Kur'an në detaje. Ai jep dritë për fillimin e lindjes dhe të edukimit të nënës së tij, gjë që na ndihmon të kuptojmë se si ajo u përgatit nga ana e Allahut për të qenë nëna e Isait, dhe se si ajo u zgjodh nga Ai:

*“(Pëkujtohu) Kur gruaja e Imranit pati thënë: Zoti im, këtë që është në barkun tim, unë vendosa ta kushtoj thjesht vetëm për shërbimin Tënd, pra pranoje këtë prej meje, vërtetë Ti je Ai që dëgjon e di! E kur ajo e lindi, tha: Zoti im, unë e linda femër. Po Allahu e di më së miri atë që ajo e lindi. E mashkulli nuk është si femra. Dhe unë e emërtova atë Merjeme, e atë dhe pasardhësit e saj po t'i lë Ty në mbrojtje prej Djallit të mallkuar. Zoti i saj e pranoi premtimin ashtu si është më mirë, e rriti me një edukatë të mirë dhe të plotë dhe e vuri nën kujdesin e Zekerijasë. Sa herë që Zekerijaja hynte në mihrabin (dhomën) e saj gjente tek ajo ushqim e thoshte: Oj Merjeme, prej nga ty ky ushqim? Ajo i thoshte: Ai është nga Allahu, se Allahu atë që do, pa masë e furnizon!. Aty në atë moment Zekerijaja e lut Zotin e tij e thotë: Zoti im, më fal edhe mua nga ana Juaj një pasardhës (fëmijë) të mirë, vërtet, Ti je dëgjues i lutjes. E duke u falur ai në faltore, engjëjt e thërrasin: Allahu të përgëzon ty me Jahjanë, që do të vërtetojë fjalën (Isain) e ardhur nga Allahu, e që do të jetë prijës i matur dhe peygamber nga të dalluarit! Ai (Zekerijaja) tha: Zoti im, si mund të kem unë djalë kur mua më ka arritur pleqëria dhe shoqja ime është beronjë? Tha (Allahu): Kështu, Allahu punon çka të dojë! Ai (Zekerijaja) tha: Zoti im, më jep mua një*

*shenjë! Shenja e jote - tha Ai - është që tri ditë nuk do të mund t'u flasësh njerëzve, pos me gjeste (mimikë), e ti përmende shumë Zotin tënd dhe madhëroje mbrëmje e mëngjes!". (Ali Imran, 35 - 41).*

Jahja ishte peygamberi i cili i parapriu Isait. Lindja e jashtëzakonshme (mu'xhize) e Jahjasë në Kur'an përmendet përsëri në suren "Merjem":

*"(Ky është) Përkujtim i mëshirës së Zotit tënd ndaj robit të vet Zekerijjasë, kur ai iu lut Zotit të vet me një zë të ulët, e tha: Zoti im! Vërtet, mua më janë dobësuar eshtrat, më janë përhapur thinjat në kokën time, e me lutjen time ndaj Teje o Zoti im, asnjëherë nuk kam qenë i dëshpëruar". Unë ua kam frikën pasardhësve të mi pas meje (kushërinjve se do ta humbin fenë), ndërsa gruaja ime është sterile, pra më fal nga ajo mirësia Jote një pasardhës (një fëmijë). Të më trashëgojë mua dhe t'i trashëgojë ata nga familja e Jakubit, dhe bëre atë, o Zoti im, të këndshëm! (të vyeshëm)! O Zekerija, Ne po të përgëzojmë ty me një djalë, emri i të cilit është Jahja, e që askush para tij nuk u emërtua me këtë emër. Ai tha: Zoti im, si do të kem unë djalë kur gruaja ime është që nuk lind, e unë kam arritur pleqëri të thellë? Tha: Ja, kështu Zoti yt ka thënë, se ajo për Mua është lehtë; Unë të krijova më parë ty, që nuk ishe fare! Ai (Zekerija) tha: Zoti im, më jep mua një shenjë (që të di)! Ai (Allahu) tha: Shenja jote është se, (duke qenë shëndoshë e mirë), nuk do të mund t'u flasësh njerëzve tri net (e tri ditë). Dhe ai doli prej faltores para popullit të vet dhe u dha shenjë adhuroni (Allahun) mëngjes e mbrëmje. O Jahja, merre librin me shumë kujdes dhe ashtu Ne i dhamë atij urtësi kur ishte fëmijë. Dhe nga ana Jonë i mundësua të jetë i butë, i pastër dhe respektues (i dëgjueshëm). Edhe i sjellshëm ndaj prindërve të vet, nuk ishte kryelartë e i padëgjueshëm. Dhe selam (prej nesh) atij ditën kur u lind, ditën kur vdes dhe ditën kur ngrihet i gjallë (e përshëndetëm dhe i garantuam)!". (Merjem, 2 - 15).*



Ngjarja e lindjes së Isait tregohet në dy vende të ndryshme në Kur'an:

*“Përkujto kur engjëjt i thanë: Oj Merjeme, Allahu të dalloj ty (me besim e karakter), të pastroi (nga shpifjet hebraike), dhe të lartësoi mbi gratë e botës. Oj Merjeme, vazhdoje adhurimin ndaj Zotit tënd, bën sexhde dhe falu bashkë me ata që falen! Këto janë nga lajmet e fshehta (të hershme) që po t'i shpallim ty. Ti nuk ishe ndër ta kur hidhnin shortet se kush prej tyre do të bëhej kujdestar i Merjemes, nuk ishe pranë tyre edhe kur ata ziheshin mes vete. Përkujto kur engjëjt i thanë: Oj Merjeme, Allahu të përgëzon me fjalën e vet (me lindjen e një fëmije si rezultat i fjalës së Zotit) emri i të cilit është Mesih, Isa, bir i Merjemes, i famshëm në dynja e ahiret dhe nga të afërmit ( e Zotit). E që duke qenë në djep (foshnje) u fletë njerëzve, e edhe si i ritur e që është nga të përsosurit. Ajo tha: Zoti im, si mund të kem unë djalë e mua s'më ka prekur njeri (nuk jam e martuar)? Ai (Allahu) tha: Ja, kështu, Allahu krijon çka të dojë. Kur Ai vendos për një çështje, vetëm i thotë: Bëhu! Ajo menjëherë bëhet. Ai (Allahu) ia mundëson atij librin (besimin), urtësinë, Tevratin dhe Inxhilin. Dhe, të dërguar te bijtë e israilit: unë kam ardhur nga Zoti juaj me argument, unë nga balta ju bëjë diç si shpendi, i fryej atij dhe ai me lejen e Allahut bëhet shpend, unë i shëroj të verbërit, të sëmurët në lëkurë, dhe unë me lejen e Allahut ngjalli të vdekurit. Unë ju tregoj për atë që e hani dhe për atë që e depononi nëpër shtëpitë tuaja. Vërtet, kjo është fakt për ju nëse jeni besimtarë. Dhe (kam ardhur) që t'ju vërtetoj Tevratin që e keni para duarsh, t'ju lejoj disa që u ishin ndaluar juve, kam ardhur me argument nga Zoti juaj, pra kijeni frikë Allahun dhe më dëgjoni mua. Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj. Adhurojeni Atë; kjo është rrugë e drejtë!. E kur e kuptoi Isai vendosmërinë e tyre në mosbesim (dhe qëllimin që ta mbysin), tha: Kush janë ndihmëtarët e mi për në rrugë të Allahut? Havrijjunët thanë: Ne jemi ndihmëtarë të fesë së Allahut, ne i besuam Allahut, e ti dëshmo për*



*ne se jemi myslimanë (të bindur, të dorëzuar)! Zoti ynë, ne e besuam atë që e zbritte (shpalljen), e pasuam të dërguarin (Isain), pra shënona bashkë me ata që dëshmojnë (besimin e drejtë)!”. (Ali Imran, 42 - 53).*

Kjo ngjarje gjithashtu tregohet edhe në suren “Merjem”:

*“E, përkujtoju në këtë libër (tregimin për) Merjemen kur ajo u largua prej familjes së saj në një vend në lindje. Ajo, vu-ri një perde ndaj tyre, e Ne ia dërguam asaj Xhibrilin, e ai iu paraqit asaj njeri në tërësi. Ajo tha: Unë i mbështetem të Gjithëmëshirshmit prej teje, nëse je që i frikësohesh Atij (pra më lër të lirë)! Ai (Xhibrili) tha: Unë jam vetëm i dërguar (melek) i Zotit tënd për të dhuruar ty një djalë të pastër (Pejgamber). Ajo tha: Si do të kem unë djalë, kur mua nuk më është afruar njeri (nuk jam e martuar), e as nuk kam qenë e pamoralshme. Ai (Xhibrili) tha: Ja, kështu, ka thënë Zoti yt; ajo për mua është lehtë, e për ta bërë atë (djalin e krijuar pa babë) argument për njerëzit e edhe mëshirë nga ana Jonë. Kjo është çështje e kryer. Ajo e barti atë (Isain), andaj (me të në bark) u izolua në një vend të largët. E dhembja (e lindjes) e mbështeti atë te një trup i hurmës. Ajo tha: Ah sa mirë ka qenë për mua të kisha vdekur para kësaj e të isha e harruar qëmoti! E prej së poshtmi atë e thirri (Xhibrili): Mos u brengos, Zoti yt bëri pranë teje një përrockë (uji). E ti shkunde trupin e hurmës se do të bijen dy hurma të freskëta. Ti pra, ha dhe pi e qetësohu, dhe nëse sheh ndonjë prej njerëzve thuaj: Unë kam vendosur heshtje për hir të të Gjithëmëshirshmit, andaj asnjë njeriu sot nuk i flas! Dhe duke e bartur ngrykë shkoi me të te të afërmit e vet ata i thanë: Oj Merjeme, ke bërë një punë shumë të keqe! Oj motra e Harunit, babai yt nuk ishte njeri i prishur e as nëna jote nuk ka qenë e pamoralshme! Atëherë ajo u dha shenjë kah ai (Isai). Ata thanë: Si t’i flasim atij që është foshnjë në djep? Ai (Isai) tha: Unë jam rob i Allahut, mua më ka dhënë (ka caktuar të më japë) librin dhe më ka bërë pejgamber. Më ka bërë dobiprurës kudo që të jem dhe më ka porositur me namaz (fajle) e zeqat për sa të jem gjallë! Më ka bërë të mirësjellsh-*

mëm ndaj nënës sime, e nuk më ka bërë kryelartë as të padëgjueshëm! Selami (shpëtim prej Allahut) është me mua ditën kur u linda, ditën kur të vdes dhe ditën kur të dal (prej varrit i gjallë! Kjo është (fjalë) e vërtetë, rreth Isait, birit të Merjemes te e cila ata shkaktojnë dyshime. Nuk i takoi (nuk ka nevojë) Allahu të ketë ndonjë fëmijë, i pastër është Ai, kur dëshiron një send Ai vetëm i thotë atij: "Bëhu!". Ai menjëherë bëhet. (Isai i tha popullit të vet) Dhe se Allahu është Zoti im dhe Zoti juaj, pra adhurojeni Atë, kjo është rrugë (fe) e drejtë." (Merjem, 16 - 36).

Vendi ku ka lindur Isai përmendet edhe në një paragraf tjetër të Kur'anit:

"Edhe të birin e Merjemes dhe nënën e tij i paraqitëm si argumente (mrekulli) dhe i vendosëm që të dy në një rrafshnaltë dhe me ujë rrjedhës". (Mu'minun, 50).

Fëmijëria dhe burrëria më e hershme e tij nuk përmenden në Kur'an. Përgjigjja e dishepujve të tij përshkruhet edhe ajo në ajetin vijues:

"O ju që besuat, bëhuni ndihmëtarë të Allahut, si Isai biri i Merjemes havarijjetëve (besimatrëve të vet të singertë) u pat thënë: Kush është ndihmëtar imi për në rrugën e Allahut? Havarijjetët i thanë: Ne jemi ndihmëtarë të rrugës së Allahut! E një grup prej beni israilëve besoi, e një grup refuzoi, ...". (Saff, 14).

Më poshtë, në një sure tjetër, hasim edhe hollësira të tjera për çështjen në fjalë:

"Dhe kur i frymëzove havarijjetët (I urdhërova): Të më besoni Mua dhe të dërguarin Tim! E ata thanë: Ne besuam, e Ti dëshmo se ne jemi myslimanë. Dhe (përkujto) kur havarijjetët thanë: O Isa, bir i Merjemes, Zoti yt a mund të na zbresë një tryezë nga qielli? (Isai) Tha: Kijeni frikë Allahun nëse jeni besimtarë! (Ata) Thanë: Ne dëshirojmë të hamë nga ajo dhe të na binden (edhe më shumë) zemrat tona dhe të vërtetojmë bindshëm se na e the të vërtetën e të bëhemi dëshmues të saj! Isai, bir i Merjemes,



tha: O Allah, Zoti ynë, zbritna nga qielli një tryezë, të na jetë festë (gëzim) për ne dhe për ata (që vijnë) pas nesh, të jetë argument prej Teje, dhe dhurona se Ti je furnizuesi më i mirë! Allahu tha: Unë atë jua zbres, e kush prej jush mohon pastaj, Unë atë e dënoj me një dënim që nuk e dënoj asnjë nga njerëzit”. (Maide, 111 - 115).

Kur mësimet e Isait filluan të përhapen, disa udhëzime të tij u pranuan e disa u refuzuan:

“Kur iu përmend popullit tënd si shembull biri i Merjemes, ata brohoritën. Dhe thanë: A janë më të mirë zotat tanë apo ai? Ata nuk të thanë atë, vetëm si polemikë, por ata janë njerëz ngatërrestarë. Ai (Isai) ka qenë vetëm një rob, të cilin e bëmë pejgamber dhe e bëmë shembull të jashtëzakonshëm si përvojë për beni israilët”. (Zuhruf, 57 - 59).

“... e dërguam Isain të birin e Merjemes dhe atij i dhamë Inxhilin, e në zemrat e ithtarëve të tij dhuruam butësi e mëshirë, ndërsa murgërinë ata vetë e shpikën. Ne atë nuk ua bëmë obligim atyre, mirëpo edhe pse kishin për qëllim të vetëm të arrijnë kënaqësinë e Allahut, ata nuk iu përmbajtën asaj si duhet përmbajtur, prandaj atyre që besuan, Ne u dhamë shpërblimin e tyre, po shumë prej tyre janë mëkatarë (jobesimtarë)”. (Hadid, 27).

Mesazhin të cilin e solli ai është i qartë:

“Po kur Isai erdhi me argumente, tha: Erdha te ju me pejgamberllëk dhe erdha t’ju sqaroj atë pjesë që e kundërshtonit, pra kijeni frikë Allahun dhe më respektoni mua! S’ka dyshim, Allahu është Ai Zoti im dhe Zoti juaj, andaj Atë adhurojeni! Kjo është rrugë e drejtë!” (Zuhruf, 63 - 64).

Mrekullitë e tij përmenden përsëri:

“Allahu (atë ditë) i thotë: O Isa, bir i Merjemes, përkujtoi të mirat e Mia ndaj teje dhe ndaj nënës sate, kur të fuqizova me shpirtin e shenjtë (Xhibrilin), e ti u fole njerëzve (kur ishte) në djep dhe (kur ishte) i pjekur (si burrë), kur ta mësova ty librin e urtësisë Tevratin e Inxhilin, kur me lejen Time formova nga balta si formë shpeze i fryve asaj dhe me urdhrin Tim u bë



shpezë, kur i shërove të verbërin dhe të sëmurin nga sëmundja e lëkurës me dëshirën Time, kur me urdhërin Tim i nxore (të gjallë) të vdekurit, kur i sprapsa beni isarailët prej teje (që dëshën të të mbysin) atëherë kur u erdhe me argumente, e disa prej tyre që nuk besuan thanë: Kjo (mrekullia e Isait) nuk është tjetër veçse magji e qartë!” (Maide, 110).

Konceptet e gabuara për lindjen e Isait rrjedhin nga lansimi i tij si “bir i Zotit”:

“(Pas të gjitha argumenteve) ata (jobesimtarët) thanë: Allahu ka fëmijë. Larg asaj është Allahu, Ai s’ka nevojë, e Tij është ç’ka në qiej dhe ç’ka në tokë, ju nuk keni argumente për këtë (që ta thoni), a thoni për Allahun çka nuk dini?” (Junus, 68).

“(përkujto, o i dërguar) Kur Allahu tha: O Isa, Unë po të marr ty, po të ngre tek Unë, po të shpëtoj prej (sherrit të) atyre që nuk besuan. E ata që të besuan ty, do t’i ngre lart mbi ata që nuk besuan deri ditën e kiametit, pastaj vetëm tek Unë është kthimi juaj, e Unë gjykoj mes jush për atë që kundërshtoheshit. Për sa u përket atyre që nuk besuan, Unë do t’i ndëshkoj me një ndëshkim të ashpër në këtë botë dhe në botën tjetër, dhe ata nuk do të kenë ndihmëtarë. E për sa u përket atyre që besuan dhe bënë vepra të mira, atyre u jap shpërblim të plotë. Allahu nuk i do të padrejtët. Këto që po t’i lexojmë ty (o i dërguar) janë nga ajetet, janë nga Kur’ani i pa të meta (i rezistueshëm). Vërtet, çështja e Isait (të lindur pa baba) tek Allahu është sikur çështja e Ademit. Atë e krijoi Ai nga dheu, e pastaj atij i tha: Bëhu!, ai u bë.” (Ali Imran, 55 - 59).

“Ata (ithtarët e librit) thanë: Allahu ka fëmijë!? I pastër është Ai nga kjo e metë! E Tij është gjithçka në qiej e në tokë, gjithçka i është nënshtruar Atij. Ai është shpikës i qi-  
ejve dhe i tokës (pa kurrfarë modeli të mëparshëm) e kur dëshiron diçka, Ai vetëm i thotë: Bëhu!, në atë moment bëhet”. (Bekare, 116 - 117).

“E ata thanë: I Gjithëmëshirshmi ka fëmijë! Larg asaj qoftë madhëria e Tij! Ja ata janë robë të ndershëm! Që nuk

flasin para Tij, ata veprojnë me urdhrin e Tij. Ai (Allahu) e di çka vepruan më parë dhe çka do të veprojnë, dhe ata nuk përpiqen të ndihmojnë pos për atë me të cilin është i kënaqur Ai, e ata nga frika prej Tij janë të kujdesshëm. Ndërsa, kush thotë prej tyre se unë jam zot pos Tij, ndëshkimi për të është xhehenemi. Kështu i ndëshkojmë Ne zullumqarët. A nuk e dinë ata, që nuk besuan se qiejt e toka ishin të ngjitura, e Ne i ndamë ato të dyja dhe ujin e bëmë bazë të jetës së çdo sendi; a nuk besojnë?” (Enbija, 26 - 30).

“Ata edhe thanë: I Gjithëfuqishmi ka fëmijë. Ju (besimtarë) vërtet sollët një fjalë shumë të shëmtuar. Aq të shëmtuar sa gati i copëtuan qiejt, gati pëlciti toka dhe gati u shembën kodrat nga ajo (fjalë). Për atë se të Gjithëmëshirshmit i përshkruan fëmijë. E të Gjithëmëshirshmit nuk i takon të ketë fëmijë. Nuk ka tjetër vetëm se gjithçka është në qiej e në tokë ka për t’iu paraqitur Zotit si rob”. (Merjem, 88 - 93).

Kur’ani mohon shenjtërinë e Isait:

“E mohuan (e bënë kufr) të vërtetën ata që thanë se: Zot është ai, Mesihu bir i Merjemes. Thuaju: Nëse dëshiron Allahu ta shkatërrojë Mesihun, birin e Merjemes, nënën e tij dhe gjithë ç’ka në tokë, kush mund ta pengojë atë? Vetëm Atij i takon pushteti i qiejve, i tokës dhe ç’ka në mes tyre. Ai krijon çdo gjë që dëshiron. Allahu është i gjithëfuqishëm për çdo gjë”. (Maide, 17).

“Dhe kur Allahu tha: O Isa, bir i Merjemes, e ti njerëzve u the: Më besoni mua dhe nënën time dy zota pos Allahut!? (Isai) Tha: Larg asaj të mete je Ti (o Zoti im). Nuk më takon mua të them atë që s’është e vërtetë. Ta kisha thënë unë atë, Ti do ta dije. Ti e di ç’ka në mua, e unë nuk di ç’ka në Ty. Ti je më i dijsmi i të fshehtave! Unë nuk u kam thënë tjetër atyre, pos asaj që Ti më urdhërove; ta adhuroni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj, dhe sa isha ndër ta, kam qenë përcjellës i tyre, e pasi që më more mua, Ti ishe roje (dhe dëshmues) i tyre. Ti je dëshmitar për çdo send! Nëse i dënon ata, në të vërtetë ata janë robërit e Tu, e nëse u falë atyre, Ti je i gjithëfuqishmi, i urti”. (Maide, 116 - 118).



*“Ai (Isai) tha: Unë jam rob i Allahut, mua më ka dhënë (më ka caktuar të më japë) librin dhe më ka bërë pejgamber. Më ka bërë dobiprurës kudo që të jem dhe më ka porositur me namaz (falje) e zeqat për sa të jem gjallë! Më ka bërë të mirësjellshëm ndaj nënës sime, e nuk më ka bërë kryelartë as të padëgjueshëm!” (Merjem, 30 - 32).*

Kur’ani refuzon konceptin e trinisë:

*“O ithtarë të librit, mos teproni në fenë tuaj dhe mos thoni tjetër gjë për Allahun, përveç asaj që është e vërtetë. Mesihu Isa, bir i Merjemes, ishte vetëm i dërguar i Allahut. Ishte fjalë e Tij (bëhu) që ia drejtoi Merjemes dhe ishte frymë (shpirt) nga Ai. Besojeni pra Allahun dhe të dërguarin e Tij e mos thoni: Tre (trini). Pushoni (së thëni), se është më mirë për ju. Allahu është vetëm një Allah; larg qoftë asaj që Ai të ketë fëmijë. Ç’ka në qiej dhe ç’ka në tokë është vetëm e Tij. Mjafton që Allahu është planifikues i pavarur. Mesihu nuk tërhiqet prej asaj se është rob i Allahut, nuk tërhiqen as engjëjt më të zgjedhur. Kush tërhiqet prej adhurimit ndaj Tij dhe bën mendjemadhësi, Ai do t’i ringjallë dhe do t’i tubojë të gjithë pranë Tij. E përsa u përket atyre që besuan dhe vepruan mirë, atyre do t’u përmbushet shpërblimi i merituar, por edhe do t’u shtohet prej dhuntisë së Tij. Përsa u përket atyre që u tërhoqën dhe mbajtën veten kryelartë, ata do t’i ndëshkojë me një ndëshkim fort të dhembshëm dhe pos Allahut nuk do t’i gjejnë vetes as mbrojtës as ndihmës”. (Nisa, 171 - 173).*

Kur’ani mohon kryqëzimin e Isait, kurse pohon ngritjen e tij:

*“Madje për shkak të thënies së tyre: Ne e kemi mbytur Mesihun, Isain, birin e Merjemes, të dërguarin e Allahut. Po ata as nuk e mbytën as nuk e gozhduan por atyre u përngjau. Ata që nuk u pajtuan rreth (mbytjes) tij, janë në dilemë për të (për mbytje) e nuk kanë për të kurrfarë dije të saktë, përveç që iluzojnë. E ata me siguri nuk e mbytën atë. Përkundrazi, Allahu e ngriti atë pranë Vetes. Allahu është i plotëfuqishëm, i dijshtëm”. (Nisa, 157 - 158).*



Sa për fund:

*“Bënë kufr (mohuan të vërtetën) ata që thanë: Allah është ai, Mesihu, bir i Merjemes. E vetë Mesihu, (Isai) tha: O beni israilë, adhurojeni Allahun, Zotin tim dhe Zotin tuaj, sepse ai që i përshkruan Zotit shok, Allahu ia ka ndaluar (ia ka bërë haram) xhenetin dhe vendi i tij është zjarri. Për mizorët nuk ka ndihmës. Gjithashtu bëjnë kufr ata që thanë: Allahu është i treti i treve. S’ka në gjithësi tjetër pos një Allahu, e nëse nuk pushojnë nga ajo që thanë (tre zota), do t’i kap dënim i dhembshëm, ata që nuk besuan prej tyre. E pse të mos pendohen dhe të kërkojnë te Allahu falje, kur Allahu dihet se falë shumë, është mëshirues? Mesihu, bir i Merjemes, nuk është tjetër, veçse i dërguar; para tij pati shumë të dërguar. Nëna e tij ishte e drejtë (e ndershme). Që të dy ishin që ushqeheshin (si njerëzit e tjerë). Ja, si u sqarohen atyre argumentet dhe shih pastaj se si i kthejnë shpinën së vërtetës!” (Maide, 72 - 75).*

*“Këta (për të cilët të rrëfyem) janë të dërguarit, disa prej tyre i dalluam prej të tjerët, prej tyre pati që Allahu u foli, disa i ngriti në shkallë më të lartë, Isait, birit të Merjemes, i dhamë argumente dhe e përforcuam me shpirtin e shenjtë (Xhibrilin). E sikur të donte Allahu, nuk do të mbyteshin ndërmjet vete ata (populli) që ishin pas tyre, pasi atyre u patën zbritur argumentet, por ata megjithatë u përçanë. E pati prej tyre që besuan dhe pati të tillë që nuk besuan, e sikur të dëshironte Allahu ata nuk do të mbyteshin, por Allahu punon çka dëshiron”. (Bekare, 253).*

Dhe:

*“Gjithqysh ti do të vëresh se jahuditë dhe ata që i përshkruan Zotit shok, (idhujtarët) janë njerëzit me armiqtësi më të fortë kundër besimtarëve (kundër myslimanëve). Ndërsa do të vëresh se më të afërmit si miq për besimtarët janë ata që thanë: Ne jemë nasara – të krishterë. Këtë ngase prej tyre (të krishterëve) ka dijetarë (ulema) dhe të devotshëm, dhe se ata nuk janë kryeneçë”. (Maide, 82).*

## Hebraizmi dhe krishterimi sipas islamit\*

*Muhammed Abdurrauf*

### Tri dimensionet e temës

Së pari islami është i detyruar të merret me fetë e tjera të botës dhe, përmes tyre, edhe me njerëzimin në përgjithësi, për shkak se është fe më e re<sup>265</sup> se fetë e tjera monoteiste, dhe pse, brenda mirëkuptimit të tij, ka për qëllim të bëhet fe e mbarë njerëzimit. Së dyti, ai është i detyruar të krijojë marrëdhënie me të gjitha fetë semite, të krijojë marrëdhënie me selefët (paraardhësit) e kësaj tradite për shkak se është ripërforcim dhe kristalizim i traditës fetare semite. Së treti, islami është i detyruar të ketë marrëdhënie të forta me hebrenjtë dhe të krishterët, sepse, brenda të të kuptuarit të tij, e sheh vetveten shumë më të afërt me këto fe.

---

\* Teksti është i marrë nga libri *Ibrahimi Dinlerin Diyalogu* ed. Ismail R. Faruki, Stamboll: Pınar Yayınları, 1993, f. 51 - 61.

<sup>265</sup> Islami është fe më e re në aspektin e ardhjes së Muhammedit [sal - lallahu alejhi ve sel - le] si peygamber në fund të hallkës së peygamberëve. Përndryshe, islami është fe edhe e Ademit dhe e Musait, por edhe e Isait [alejhimus - selam]. (Shënim i përkthyesit)

## a. Njeriu ose dimensionin universal

Islami aprovon ekzistimin e një *religio naturalis* - it, me të cilin njeriu lind, e që është fe natyrore, origjinale, e dhuruar njerëzimit nga ana e Allahut të madhërishëm. Ajo u është dhuruar të gjithë njerëzve, pa asnjë përjashtim, sepse lind bashkë me ta. Është një pjesë plotësuese e ekzistencës dhe e personalitetit të tyre. Allahu i madhërishëm, këtë fe, që lind me njeriun (fitrat), e quan “Fe të Tij”, dhe i urdhëron të gjithë njerëzit që e respektojnë dhe pasojnë atë: *“Përqendro vetveten tënde sinqerisht në fenë, i larguar prej çdo të kote, (e ajo fe), fe e Allahut në të cilën i krijoi njerëzit, s’ka ndryshim (mos ndryshoni) të asaj natyrshmërie të krijuar nga Allahu, ajo është fe e drejtë por shumica e njerëzve nuk e dinë.”* (Er - Rum: 30). Këtë fe origjinale (*Asl - Dini’ni - Ur - Religion*) islami e identifikon me dhuntinë e mendjes dhe të konceptit, d.m.th. me faljen e kapabilitetit (aftësisë) natyror kritik:

*“... po këta nuk i kupton kush pos dijetarëve,”* (El - Ankebut: 43)

Mendjen dhe shqisat e njeriut islami i ka shpall organe të diturisë: *“A nuk i dhamë Ne atij sy? Edhe gjuhë e dy buzë? Dhe i sqaruam atij për të dy rrugët.”* (El - Beled: 8 - 10). Ndërsa gjuhën dhe shkrimin, bulevardet të diturisë: *“Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të shkruajë me penë. I mësoi njeriut atë që nuk e dinte.”* (El - Alak: 1 - 5); *“Nun. Beto hem në penën dhe në atë çka shkruajnë!”*. (El - Kalem: 1)

Të gjitha këto, janë “perfeksionime” të dhuruara e të krijuara nga Allahu, me qëllim që njeriu, duke i përdorur ato, të arrijë lumturinë. Përdorimi i të gjitha këtyre aftësive dhe perfeksionimeve, të cilat Allahu i ka urdhëruar që të përdoren, e bëjnë të domosdoshme përgjegjësinë, d.m.th.



kjo, me realizimin e asaj që quhet lumturi, duhet të çojë drejt fesë së Allahut: *“Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke nohuri, pse të dëgjuarit, të pamurit dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi.”* (El - Isra: 36).

Feja origjinale, në kuptimin universal të saj, në vete përmban detyrueshmëri, sepse, të gjithë njerëzit, të cilët që në lindje janë të pajisur me të gjitha aftësitë e tyre për të njohur atë, janë të detyruar që ta jetojnë.

Për këtë arsye, feja është shkaku i ekzistimit të tyre (raison d'être). Elementi i parë i të gjitha këtyre është pranimi se askush tjetër përpos Allahut nuk është Zot i vërtetë. Pjesa tjetër ka të bëjë me krijesat e krijuara, të cilat përpara Krijuesit janë robër të Tij; kjo është një marrëdhënie, që nuk ka kuptim tjetër veçse adhurim dhe varshmëri: *“Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër, pos që të më adhurojnë.”* (Edh - Dharijat: 56). Feja është nënshtrim shembujve, të cilat mund të kuptohen me anë të mendjes, të dërguar gjithë njerëzimit nga ana e Allahut të madhërishëm. Për këtë arsye askujt nuk mund t'i falet kufri (mosbesimi). Dhe kushdo që futet në politeizëm nuk mund të falet. Njohja e Allahut si Zot dhe pranimi i Tij (Zot), është një çështje e cila është e drejtë e çdokujt, është brenda kufijve të mundësisë dhe është detyrë e lartë e çdonjërit. Islami nuk i aprovon teoritë dhe fetë që bëjnë diferencime ndërmjet njerëzve që në lindjen e tyre, e që thonë se në mes njerëzve ka të mjaftueshëm, gjegjësisht të aftë dhe të paaftë në çështjen e njohjes së Zotit të Vetëm (të Allahut, Zot dhe Krijues të Vetëm).

Me mëshirën e Tij të lartë Allahu ka dërguar peygamberë, me qëllim që ata t'ua dërgojnë njerëzve mesazhin hyjnor, që ata ta limitizojnë fenë vetëm për Të: *“Ne të dërguam ty me atë që është e vërtetë, lajmgëzues e qortues, e nuk pati asnjë nga popujt që nuk pati të dërguar.”* (Fatir: 24); *“Ne nuk dërguam asnjë të dërguar para teje, e të mos i kemi shpallur atij se: nuk ka zot tjetër përveç*

*Meje, pra më adhuroni!*” (El - Enbija: 25). Kështu që të gjitha arsyetimet janë të privuara nga argumenti (baza). Njerëzit, duke lënë në një anë se si ata e mohojnë njerëzshmërinë e tyre, ata nuk pranojnë që ta kuptojnë realitetin, superioritetin dhe Njëshmërinë e Allahut, ndërsa kanë qenë mjaft të informuar dhe u është tërhequr vërejtja nga peygamberët e dërguar nga Allahu.

Nga ky aspekt, hebrenjtë dhe të krishterët islami i pranon rob të Allahut, të cilëve Ai u ka dhënë mendje dhe inteligjencë të mjaftueshme për ta njohur superioritetin dhe Njëshmërinë e Tij. Përmes mendjes dhe inteligjencës ata do të duhej ta njihnin Allahun si Zot të vetëm, i Cili gjindet mbi gjithçka dhe është më i Larti i të lartëve. Përveç kësaj, islami, në saje të dërgimit (sjelljes) të së njëjtës gjë nga të gjithë peygamberët, të gjithë hebrenjtë dhe të krishterët i konsideron pranues (kontaktes) të shpalljes (vahjit) së Allahut. Kjo thirrje, atyre të cilët e kishin humbur gjënë (fenë) e tyre origjinale dhe të domosdoshme, u është bërë nëpërmjet peygamberisë (si asgjë tjetër), vetëm si dhunti e Allahut.

Me këto cilësi, hebrenjtë dhe të krishterët janë njohur me fenë origjinale. Këtë të vërtetë (të fesë) origjinale asnjë mysliman nuk mund ta mohojë, pa mos e mohuar islamin dhe pa rënë në kundërshtim me Kur'anin.

Pranimi i kësaj të vërtete është diçka që vjen prej besimit të tij. Me fjalë të tjera, myslimanët e pranojnë se feja e Allahut u është dhuruar hebrenjve dhe të krishterëve dy herë: e para, me anë të natyrës origjinale, si e domosdoshme dhe universale, kurse tjetra përmes peygamberëve të dërguar me mëshirën e Allahut.



## b. Dimensioni i traditës semite

Hebrenjtë dhe të krishterët, megjithëse janë njerëz të kësaj bote (të krijuar në këtë botë) dhe pranues të shpalljes (pejgamberisë) universale, domosdoshmërisht, me dallim nga niveli i parë, si trashëgimtarë të traditës fetare semite, islami i pranon dhe i konsideron edhe si njerëz (pronarë) dhe pjesëtarë të fesë së vërtetë dhe legjitime. Hebrenjtë dhe krishterët, ndoshta nga shkak i ekzistimit të shumë pejgamberëve të tyre, janë pjesëtarë (trashëgimtarë) të traditës së fesë së vërtetë, e cila është traditë më e madhe. Kështu i njeh ata historia. Të jesh pronar i një trashëgimie të tillë nuk është problem i domosdoshmërisë, por mendimi se është një rastësi historike (fakt historik), është i vërtetë. Trashëgimia historike nuk mund të mohohet, as mund të lihet ose, edhe as që mund të gjindet ndonjë identitet tjetër personal. Të jesh trashëgimtar i ndokujt nuk është problem i preferimit. Por, dalja zot kësaj trashëgimie, dhe të pranuarit e saj nga hebrenjtë dhe krishterët si të tyre, është një çështje e pamohueshme. Për këtë arsye, ata islami i shpall si pjesëtarë të fesë së Allahut. Pa dyshim, ata duhet të ngarkohen (ta ngarkojnë vetveten) më këtë trashëgimi dhe ta pranojnë si trashëgimi të fesë së Allahut.

Të gjithë ata që veprojnë në këtë mënyrë, islami i nderon dhe i quan si pjesëtarë të fesë së vërtetë (gjithnjë duke pasur parasysh fenë origjinale të Allahut të madhërisëm (shënim i përkthyesit). Sipas islamit, tradita fetare semite fillon me Nuhin [alejhis - selam]. Lidhur me këtë, Kur'ani thotë: “*Në qoftë se ata nuk përgjigjen, ti thuaj: Unë u tërhoqa vërejtjen e një rrufeje (dënimi), si rrufeja e Adit e Themudit!*” (Esh - Shura: 13); “*Allahu e zgjodhi (pejgamber) Ademin, Nuhun, familjen e Ibrahimit, familjen e Imranit, nbi popujt tjerë.*” (Ali Imran: 33); “*Ne të fry-*



*mëzuam ty me shpallje sikurse e patëm frymëzuar Nuhun dhe peygamberët pas tij; e patëm frymëzuar Ibrahimin, Ismailin, Is'hakun, Jakubin dhe pasardhësit e tij, Isain, Ejubin, Junusin, Harunin, Sulejmanin, e Davudit i patëm dhënë Zeburin.*” (En - Nisa: 163). Historia dhe arkeologjia, krahas emrave që i përmend Kur'ani, përmendin edhe Sargonin nga Akkadi, Lippid Ishtarin, të cilët, ligjet (kanunet) që i kanë marrë prej Zotit, i kanë legjitimuar, dhe të gjitha i kanë thirrë në respektim Zotin.

Feja e fëmijëve (pasardhësve) të Nuhit [alejhis - selam] përbëhet prej të gjitha parimeve të cilat janë nxjerrë prej shpalljeve (vahj) të përsëritura gjithë (popujve) semitëve. Parimi i parë është transcendenca e Allahut, i Cili është diç tjetër prej çdo gjëje të krijuar, dhe i Cili shprehet në formë alteracioni (başkalığı). Parimi i dytë është marrdhënia e Allahut me krijesat e tjera të Tij; këtu është fjala për shkakun e ekzistencës (raison d'être), qëllimin dhe detyrën e saj, dhe për disa parime me të cilat e vazhdon jetën çdo krijesë. Sipas parimit të tretë, njeriu, me anë të zbulimit (duke i lexuar shenjat në botë), me anë të shkencës (studimit të ligjeve ose modeleve të pashoqe të natyrës), ose me anë të peygamberisë, d.m.th., përmes aftësisë së të kuptuarit të shpejtë të Tij në saje të shpalljes, fiton njohuri për këtë relacion (interes) hyjnor...

Sipas parimit të katërt, njerëzit, duke qenë se Allahu u ka dhënë njohuri dhe aftësi veprimi, janë kompetentë për t'i çuar në vend urdhrat e Zotit. Sipas parimit të pestë, njerëzit janë përgjegjës dhe janë të nënshtruar ndaj vendimeve të nxjerra për ta – në rast se i respektojnë, do të shpërblehen, në rast se kundërshtojnë ose i kalojnë kufijtë (e hallallit), dënohen. Këto pesë parimet janë esenca dhe qenësia e të gjitha feve semite, prej Nuhit [alejhis - selam] e deri te Muhammedi [sal - lAllahu alejhi ve sel - lem].

### c. Dimensioni i hebrenjve dhe i të krishterëve

Pranimi i të lartpërmendurave nga islami, të cilat në Kur'an kanë ardhur si shpallje hyjnore (komunikatë hyjnor, e padyshimtë) dhe e pakundërshtueshme, është përforcua edhe me një arsyetim të tretë. Dy nivelet e para nxorën parime, duke i pranuar si të vërtetë hebrenjtë dhe krishterët, të cilët i shpallin si praktikues të atyre (parimeve). *“Vërtet, ata që besuan, ata që ishin jehudi, të krishterë dhe sabejë (të cilët kishin lëshuar fenë e adhurorin engjëjt), kush besoi prej tyre (sinqerisht) Allahun dhe botën tjetër, dhe bënë vepra të mira, ata e kanë shpërblimin te Zoti i tyre. Për ta nuk ka as frikë e as pikëllim (pasi besuan Allahun, librat, të dërguarit, në mesin e të cilëve edhe Muhammedi).” (El - Bekare: 62)*<sup>266</sup>

Kjo ishte diç më tepër se pranimi i hebrenjve dhe i të krishterëve si të drejtë (të vërtetë). Problemi i hebraizmit dhe i krishterimit me islamin nuk është problem vetëm i përshtatshmërisë dhe ngjashmërisë mes tyre, por, është problem i identifikimit të islamit vetëm me ta. Është më se e qartë se nuk mund të gjendet e as të ofrohet ndonjë arsye më e madhe se kjo. Zotin e hebrenjve dhe të krishterëve (duke pasur parasysh burimet e tyre të pashtrembëruara, shënim i përkth.) islami e sheh si Zot të vetin; peygamberët e tyre si peygamberë të vet; shpalljen dhe librat e tyre si shpallje dhe libra të vet. Islami e mbron mendimin se së bashku me këto dy fe përbën një njësi fetare (një fe të përbashkët). Çka mund të kërkohet dhe dëshirohet më tepër?

Në fakt, çdo kritikë që islami ua ka drejtuar hebrenjve, të krishterëve dhe simpatizuesve të tyre, ata ia kanë drejtuar vetvetes së tyre. Për këtë arsye, dëshira fetare që ka mbartur islami për hebrenjtë dhe të krishterët është e

---

<sup>266</sup> Shih, El - Maide: 70; El - Ankebut: 49; El - Bekare: 136.



njëta dëshirë që ka gjallëruar në zemrat e hebrenjve dhe të të krishterëve disa shekuj me radhë. Islami i kritikon hebrenjtë në çështjen e dështimit të tyre në vërtetimin e Teuratit: “ *Ne patëm marrë besën prej beni israilëve; atyre u dërguam peygamberë, por sa herë që u erdhi atyre ndonjë peygamber që (me mësim) nuk u pëlqeu epsheve të tyre, ata disa prej tyre i përgjënjeshtroan, kurse disa të tjerë i mbytën.* ” (El - Maide: 70); në çështjen e qetësisë së tyre (pandijsshmërinë e tyre shpirtërore - morale): “ *Përkujto (O i dërguar) kur Musai i tha popullit të vet: O popull imi, përkujtojeni dhuratën e Allahut ndaj jush ku në mesin dërgoi peygamber, iu mundësoi të jeni sundues dhe ju tha çka nuk i tha askujt nga popujt.* ” (El - Maide: 20); në çështjen e ekstremizmit të rabinëve, si ligjvënës dhe si të tepërt në përdorimin e aftësive të tyre: “ *Ata i konsideruan ‘ahbarët’ (priftër jehudi) e tyre, ‘ruhbanët’ (murgjit e krishterë) e tyre dhe Mesihum (Isain) birin e Merjemes, për zota pos Allahut, ndërsa ata nuk janë urdhëruar për tjetër (nga peygamberët) pos për adhurimin ndaj Allahut Një, e që nuk ka të adhuruar tjetër pos Tij. I lartë është Ai nga çka i shoqërojnë.* ” (Et - Teube: 31); në çështjen e ndryshimit të teksteve të shenjta: “ *Një palë nga jehuditë është që ndryshojnë fjalët (e Zotit) nga vendet e veta, e (kur i thërret ti) ata thonë: Dëgjuam (fjalën tënde) dhe kundërshtuam (thirrjen tënde), dhe thonë: Dëgjo, mos dëgjoftsh! (dhe thonë): Rajna (këto i thonë) duke përdredhur gjuhët e tyre dhe duke atakuar fenë. E sikur të thoshin ata: Dëgjuam, respektuam, dëgjo dhe vështrona do të ishte më mirë për ta dhe më e drejtë, por për shkak të refuzimit të tyre Allahu i mallkoi, prandaj besojnë vetëm pak (besim gjysmak).* ” (En - Nisa: 46), dhe: “ *...Ata i ndryshojnë fjalët (në Tevrat) nga domethënia e tyre dhe braktisën një pjesë me te cilën ishin urdhëruar. Ti vazhdimisht do të vërejtsh tradhtinë e një pjese të tyre, përpos një pakice nga ata ...* ” (El - Maide: 13). Të gjitha këto janë të meta të cilat asnjë



prej historianëve të hebraizmit dhe krishterimit nuk mund t'i mohojë. Përveç kësaj, islami nuk e fajëson asnjëherë në tërësi popullin hebraik, meqë ajete të këtij tipi gjenden krahas ajeteve që i vërteton hebrenjtë, dhe Kur'ani në mënyrë kategorike i ndan ata që janë në rrugë të vërtetë dhe ata që nuk janë në rrugë të vërtetë: *“Ata (ihtarët e librit) nuk janë të njëjtë. Nga ihtarët e librit ka që janë në rrugë të drejtë, gjatë natës lexojnë ajetet e Allahut duke u lutur. I besojnë Allahut dhe Ditës së Gjykimit, këshillojnë për të mirë dhe largojnë nga të këqijat, përpiqen për punë të dobishme edhe ata janë prej të mirëve.”* (Ali Imran: 113-114).

Ndërsa, kur është fjala për të krishterët dhe krishterimin, islami sa e ka kritikuar doktrinën e trinisë (En - Nisa: 171-172), murgërinë (jetën monastike) (El - Hadid: 27) dhe të kapërcyerit e limitit në problemet fetare (En - Nisa: 171), aq i ka kritikuar ata në aspektin e shenjtërimit në mënyrë evidente të Isait [alejhis - selam].

Por, për shkak të modestisë dhe altruizmit, frikës së tyre ndaj Allahut i lavdëron ata në të njëjtën shkallë, dhe i shpall për më të afërmit e tyre (myslimanëve).

Megjithatë, si në çdo kritikë tjetër, edhe në këto çështje islami nuk mbetet vetëm. Shumë e shumë dijetarë të Biblës (Librave të Shenjtë) dhe teologë e kanë thënë të njëjtën gjë. Edhe patrikët Apostuj, pa dyshim edhe ata që kanë marrë pjesë në Nike, dhe shumë të tjerë, kundërshtarë të Nikes apo, më vonë, simpatizues të saj, kanë deklaruar, përafërsisht, të njëjta mendime.

Kisha Katolike e korigjoi kundërshtimin e saj ndaj islamit dhe myslimanëve në Koncilin II të Vatikanit. Edhe pse mbetet i pamjaftueshëm në çështjen e paraqitjes së saj të drejtë (të vërtetë), ky ndryshim është hap i parë që meriton të lavdërohet. Deri tash nuk ka dalë asnjë zë as nga koncili i Kishës Botërore as nga ndonjë organizatë protestante autoritative, siç është Koncili i Ki-

shës Nacionale, as nga Kisha Ortodokse Ruse dhe Greke dhe as nga ndonjë organizatë tjetër hebraike. Thirrja që ua bën Allahu i madhërishëm hebrenjve dhe të krishterëve, si në kohën kur erdhi për të parën herë, e po kështu edhe sot, vazhdon të jetë e nevojshme:

*“Thuaju (o i dërguar): O ithtarë të Librit (Teurat e Inxhil), ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: Të mos adhurojmë tjetër pos Allahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos konsiderojmë njëri - tjetrin zot pos Allahu! E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: Dëshmoni pra, se ne jemi myslimanë (besuam një Zot)!” (Ali Imram: 64).*

Dhe gjëja që do të mundësojë që islami të pranohet plotësisht fe legjitime nga ana e hebrenjve dhe e të krishterëve, është vetëqëndrimi (pikëpamja) i islamit. Derisa të realizohet kjo, myslimanët do të vazhdojnë të ecin në dialog, në qëllimin e tyre të mirë dhe në çështjen e bashkëkuptimit, shumë më para se shokët e tyre aktivistë hebrenj dhe të krishterë.

## Feja në Izrael\*

*Idriz Gürsoy*

Vlerësimi i një biznesmeni, pas përfundimit të një shëtitjeje në Izrael, të organizuar nga Dhoma Industriale e Regjionit të Egjeut, ishte ky: “Përveç fesë, këtu nuk ka asgjë tjetër”. Sipas fjalëve të përkthyesit tonë hebre, Izraeli, në të vërtetë „është një shtet teokratik”. Disa grupe të Turqisë, po t’i shihnin rrugët e Tel - Avivit, e sidomos rrugët e Jerusalemit, do të bërtitnin „reaksion (prapambeturi)” (*irtica*). Biznismenët e grupit tanë u habitën; edhe fëmijët e vegjël kishin veshur tesha fetare. Izraelianët, me flokë të prerë sipas menyrës së tyre specifike, me zylyfe të gjata dhe me teshat e tyre të zeza ecnin lirisht nëpër rrugët e Tel-Avivit. Në hotelet më luksoze, në zyrrat shtetërore, në shkolla, shkurt thënë në të gjitha porët e jetës ballafaqoheshim me kostumet fetare. (Në Izrael ka material të mirë për raportuesit.)

Në vendet ku fetarët jetonin më dendur dominonte ngjyra e zezë. Në kokat e meshkujve kishte kësula të quajtura ‘kipa’, gjë që shpreh adhurimin ndaj Zotit. Femrat fetare përdornin mbulesën (duke mbuluar edhe kokën, Q.N.). Fanatikët i qethnin flokët deri në rrënjë. Ato të cilat nuk i mbulonin flokët dhe nuk donin që për shkak të besimit fetar t’iu dukeshin ato, vendonin paruka.

---

\* Teksti është marrë nga gazeta *ZAMAN*, Republika e Turqisë.



Kundërshtarët tanë të fesë, të cilët punojnë për ta mbërthyer fenë në ndërgjegje dhe për të fshirë çdo gjurmë fetare që ekziston në jetën tonë të përditshme, në Izrael do të ishin shumë të shqetësuar. Udhëheqësi ynë shpjegoi: „Ditëve të Shtuna të Shenjta, në vendet ku fetarët qarkullojnë më shumë, nuk mund të hysh me automjete. Autobusëve urbanë, me vendimin e marrë nga qeveria, u ndalohet qarkullimi. Gratë veshin fustane të gjata. Nëse një mashkull atë ditë nuk vë kësulë, qortohet. Rreptësisht është e ndaluar të punohet të Shtunën”. A mund ta paramendoni, është e ndaluar bile të shtypësh edhe butonin e ashensorit. Disa hotele e kanë programuar ashensorin ashtu të ndalet në çdo kat.

Në Jerusalem dhe në Tel - Aviv, në çdo vend dhe në çdo gjë përpara nesh del hebraizmi. Në paratë e tyre gjenden fotografitë e fetarëve të mëdhenj. Rrugëve mbajnë emrat e tyre. Përdorin gjuhën hebraike e jo latine, dhe punojnë në përhapjen e saj. Të gjithë periodikët, shkrimet janë në hebraisht. Ligjet janë përgatitur sipas ligjeve fetare hebraike. Përkthyesi ynë hebraik tha: „Këtu nuk ka ligj civil, këtu janë në fuqi ligjet e Teuratit”. Në Izrael feja nuk manifestohet vetëm në rrugë, por edhe në parlament dhe universitet. Partitë fetare marrin pjesë në çdo qeveri. I japin kahje politikës se jashtme dhe të brendshme. Klerikët hebraikë para zgjedhjeve deklarojnë se cilën parti do ta mbështesin. Hebraizmi është i rëndësishëm edhe në universitete.

Tek ne (në Turqi) vlerat fetare fyhen; Këshilli për Arsim të Lartë (YÖK - Turqi) i largon nga puna profesorët për të cilët vërtetohet se janë fetarë kurse në Izrael ndodh krejtësisht e kundërta. Udhëheqësi ynë, i cili studion gjuhën dhe letërsinë angleze, tha se: „gati sa nuk është përjashtuar nga shkolla” për shkak të përdorimit në mënyrë kritike të pjesës hyrëse të Teuratit në tezen e tij.

Një grup fetarësh, edhe pse nuk punojnë marrin rrogë prej shtetit. Shkaku: „Ata bëkan dua për Izraelin. Prandaj Izraeli është bërë një shtet i fortë dhe i mund armiqte e tij”.

Në Izrael ka grupe që janë laike dhe grupe që janë kundër fesë. Por, këto nuk synojnë t'i zhdukën fetarët siç bëhet në Turqi. Askush nuk duket i shqetësuar nga emittimi i programeve fetare nëpër televizione apo publikimi i të njëjtave nëpër gazeta e revista si dhe nga pamja e hebrenjve me tesha fetare në rrugë. Nën fotografite e meshkujve me kësula dhe të femrave me mbulesë nuk vihen tituj kryesorë gazetash nga ”rreziku reaksionar” (*irticai tehlike*). Fetarët nuk ekzekutohen. Fetarët nuk fajësohen për “uzurpues të shtetit”.

Gjatë tërë shetitjes, biznesmenët tanë krahasonin shpesh Turqinë me Izraelin. Ky shtet “teokratik”, që ka shumë pak burime mbitokësore dhe nëntokësore, ndërsa tokë (pjellore Q.N) e sidomos ujë nuk ka aspak, ka bërë emër në bujqësi dhe teknologji. Inflacioni pas procesit paqësorë ka rënë prej 400 për qind në 5 për qind. Të ardhurat kombëtare kanë arritur deri më 17 mijë dollarë. Në Izrael qëndruam tri ditë; sikur të kishim qëndruar edhe tri ditë të tjera, biznesmenët tanë do t'i vinin në dyshim disa aplikime në vendin tanë. Më thjeshtë: A nuk u shpall modernizimi (në Turqi) luftë fesë dhe vlerave të shenjta fetare? A mos e pengon përparimin (e Turqisë) qenia e një fetari që nuk ka faj tjetër përveç që thotë: “Zoti im është ALLAHU”.

▲  
▲  
▲  
▲  
**mr. Qani Nesimi**  
**DIALOGU OBLIGIM HYJNOR**

▲  
▲  
▲  
▲  
**Boton: Logos-A**  
**Biblioteka: Mendimi Islam**

▲  
▲  
▲  
▲  
**Për botuesin: Adnan Ismaili**  
**Kryeredaktor: Husamedin Abazi**  
**Redaktor biblioteke: Nexhat Ibrahim**

▲  
▲  
**Recensentë: Selver Xhemali**


▲  
▲  
▲  
▲  
**Redaktor gjuhësor: Rexhep Zlatku**  
**Redaktor artistik & disenjator: Edi Agagjyshi**  
**Redaktor teknik & faqësës: Suhejb Xhemali**

▲  
▲  
▲  
▲  
**Mbikëqyrës i shtypit: Imer Gogjufi**  
**Përgatitja kompjuterike: Focus Pro - Shkup**  
**Shtypi: Focus - Shkup**

▲  
▲  
**Copyright©Logos-A, 2005**

▲  
▲  
▲  
▲  
**Shënimi i CIP katalogut i këtij libri gjendet**  
**në Bibliotekën Kombëtare Universitare**  
**ISBN 9989-58-158-4**

▲  
▲  
▲  
▲  
**[www.logos-a.com](http://www.logos-a.com)**







ISBN 998958158-4

